



KOMANDA E DOKTRINËS DHE STËRVITJES

REVISTA USHTARAKE

**Organ teoriko–shkencor
i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes**

Nr. 2/2011

Tiranë, qershor 2011

Bordi i Botimit të Revistës Ushtarake

Miratuar me Urdhër të Ministrit të Mbrojtjes Nr. 1538, datë 18/08/2010

Kryetar

Gjeneral Brigade Dr. Agim Lala

Anëtarë

Kolonel Thimi Hudhra

Kolonel Prof.As.Dr. Kristaq Xharo

Gjen.Major (R) Prof. Dr. Ruzhdi Gjata

Gjen. Major (R) Prof. Dr. Kostaq Karoli

Redaktor

Silvana Markgjonaj

Operatore

Lindita Kuçana

Art design

Teuta Mullisi

Copyright © 2010 nga Qendra e Analizave të Mbrojtjes (QAM) të Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes).

Copyright © 2010 by the Centre for Defence Analyses (CDA) of the Albanian Training and Doctrine Command.

Pikëpamjet dhe opinionet e shprehura në Revistën Ushtarake janë tërësisht të autorit/autorëve dhe jo domosdoshmërisht reflektojnë politikat apo pozicionet zyrtare të Mini-strisë së Mbrojtjes, Shtabit të Përgjithshëm dhe Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes.

Autori/Autorët e shkrimeve të Revistës Ushtarake nuk do të jenë subjekt i ndëshkimit për shprehjen e lirë të qëndrimeve e pozicioneve të tyre individuale edhe sikur përmbajtja e tyre të mos jetë në përputhje me qëndrimet zyrtare të institucionit të mbrojtjes.

Njëkohësisht, autori/autorët mbajnë përgjegjësi për shpifjet, shtrembërimet e fakteve, sharjet si dhe kopjimet e pa referuara të krijimeve dhe mendimeve të autorëve të tjerë.

Ky botim i Revistës Ushtarake gjendet në website <http://www.tradoc.mil.al/>

Në rast se nuk mund të merrni informacionin që kërkonte në internet lutemi të kërkonte një kopje të tij në adresën: e-mail: revistaushtarake@aaf.mil.al ose qam@aaf.mil.al

Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes

Qendra e Analizave të Mbrojtjes

Dega e Botimeve

PËRMBAJTJA

RUBRIKA E PARË: Përshkrim për Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes

Rreziqet Konvencionale ndaj NATO-s, çfarë ka ndryshuar dhe Implikimet mbi Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura

Gjeneral Brigade Dr. Agim Lala

Nënkolonel Enrik Ago

6

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM)-Proces i Transformimit dhe Gjenerimit të Reformave Afatgjata në Forcat e Armatosura

Kolonel Thimi Hudhra

Nënkolonel Editson Zarka

14

Politika e re e NATO-s për Mësimet e Nxjerra

Nënkolonel Fatmir Lokaj

Nënkolonel Arben Cenolli

27

RUBRIKA E DYTË: Analiza dhe Vlerësime të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Sfidat e reformimit të Shërbimeve të Inteligjencës në demokracitë e reja

Kolonel Eduart Bala

34

Zhvillimi i udhëheqësve strategjikë

Nënkolonel Dr. Edmond Braneshi

50

Menaxhimi i Materialeve në strukturat e FARSH sipas

Konceptit Logjistik të Integruar të NATO-s

Nënkolonel Enrik Ago

57

Fuqia dhe Roli i Informacionit në Sigurinë Kombëtare

Nënkolonel Hysni Gjergji

66

Taktikat, teknikat dhe metodat që ndiqen nga forcat talibane për marrjen nën kontroll të fshatrave dhe zonave të caktuara të Afganistanit

Nënkolonel Ramazan Martini

Nënkolonel Mehmet Hamdi

75

Konceptet e mbrojtjes kolektive, sigurisë kolektive dhe sigurisë bashkëpunuese në kuadër të Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s

Nënkolonel Xhemil Hurdha

83

Pranvera e trazuar arabe Kol. ® Zeno Jahaj	95
Integrimi i perspektivës gjinore si një pjesë natyrale e organizatave ushtarake dhe operacioneve ndërkombëtar Kolonele Suzana Jahollari	105
Një luftë e re me themele të vjetra. Debatet e politikës së sigurimit mbi “Luftën asimetrike” Kapiten Dipl. Pol. Genti Bardhi	113
“Doktrina Bush”, parimet e politikës së re amerikane të sigurisë, pas 11 shtatorit 2001 Granit Zela	126
RUBRIKA E TRETË: Çështje didaktike, mësimore dhe kulturore	
Integrimi i punës studimore në procesin mësimor, kërkesë e kohës Nënkolonel ® Prof. As. Dr. Agron Agolli	136
Gjuha Angleze - Gjuhë Parësore Operacionale e NATO-s Doc. Shqiptonjë Dautaj Msc. Eva Reveli	147
E folura në publik Majlinda Cukalla	155
RUBRIKA E KATËRT: Çështje historike	
Pikëpamjet politike të Hobsit Dr. Lavdosh Ahmetaj	167
Marrëdhëniet NATO-BE MA. Edmond Nushi	175
Vështrim i përgjithshëm për tre sisteme ndërkombëtare të paqes Elira Luli	184
<i>Kujtesë për bashkëpunëtorët e Revistës Ushtarake</i>	189

RUBRIKA E PARË

RISHIKIMI STRATEGJIK I MBROJTJES NË REPUBLIKËN E SHQIPËRISË

Të nderuar lexues!

Siç jeni ne dijeni, ashtu si shumë vende të tjera aleate, pas Samitit të Lisbonës të Nëntor 2010, edhe Shqipëria ka filluar procesin e Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes. NATO dhe vendet anëtare të saj po promovojnë reforma të thella për një 'smart defence' të drejtuar nga slogani "si të prodhojmë më shumë kapacitete duke harxhuar më pak".

Përgjigjet më të sakta për pyetje të tilla intriguese mund të jepen vetëm nëpërmjet procesit të Rishikimit Strategjik, proces i cili përbën themelin e reformave të thella dhe të transformimit cilësor në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Kjo rubrikë është vetëm fillimi i një debati konstruktiv dhe shkencor mbi Rishikimin Strategjik. Ajo trajton vetëm disa nga aspektet kryesore të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes sipas eksperiencës më të mirë të vendeve të zhvilluara të NATO-s dhe BE-së. Kjo do të shërbejë si "food for thoughts", duke iniciuar fillimin e një komunikimi të gjithë ekspertëve dhe studiuesve të kësaj fushe.

Duke qenë se Rishikimi Strategjik është një proces i hapur dhe transparent, Revista Ushtarake do të jetë zëri i ekspertëve të fushës për çështjet më themelore të këtij procesi. Të gjithë ekspertët dhe studiuesit janë të mirëpritur të japin mendimet e tyre në edicionet e ardhshme të Revistës Ushtarake të muajit shtator dhe dhjetor.

Rreziqet Konvencionale ndaj NATO-s, çfarë ka ndryshuar dhe Implikimet mbi Shqipërinë dhe Forcat e Armatosura

Gjeneral Brigade Dr. Agim Lala
Komandant i Komandës së Doktrinës dhe Stërvitjes

Nënkolonel Enrik Ago
Pedagog në Akademinë e Mbrojtjes

Abstrakt: *Përfundimi i Luftës së Ftohtë, zgjerimi që ka marrë globalizmi në përgjithësi, shoqëruar me zhvillimet e jashtëzakonshme në fushën e teknologjive sidomos të informacionit, të cilat e kanë ndryshuar botën në kohë dhe hapësirë, kanë sjellë edhe ndryshime në natyrën e rreziqeve tradicionale ndaj NATO-s dhe më gjerë.*

Evoluimi i natyrës konvencionale të rreziqeve dhe kërcënimeve u trajtua në Samitin e Lisbonës, ku u hodh Koncepti i parë Strategjik i Aleancës për shekullin e 21-të, i fillimit të një reforme të ristrukturimit të Aleancës për përballimin e sfidave të reja të sigurisë, i zhvillimit të kapaciteteve të reja për kërcënimet dhe rreziqet e ardhshme përtej asaj tradicionale ushtarake.

Si vend anëtar i Aleancës, më shumë se kurdoherë tjetër, Shqipëria dhe Forcat e saj të Armatosura do të kenë efekte direkte që lidhen me impaktin dhe natyrën e re të rreziqeve që kërcënojnë paqen dhe stabilitetin.

Tashmë rreziqeve konvencionale u janë shtuar, madje me intensitet përherë e më të lartë rreziqet asimetrike (hibride), të cilat kërkojnë ndryshimin e konceptit dhe metodave tradicionale për përballimin e tyre.

Hyrje

Politika e Mbrojtjes e një shteti bazohet në perceptimet e rreziqeve dhe kërcënimeve të interesave ndaj kombit. Rreziqet dhe kërcënimet janë identifikuar si të vërtetë në veprimet e perceptuara të një kundërshtari të mundshëm, duke vepruar me qëllim apo pa vetëdije, që mund të ndikojë negativisht në kombin e kërcënuar. Ato klasifikohen si konvencionale dhe jo-konvencionale.

Kërcënimet Konvencionale janë veprime kërcënuese ose veprimet e mundshme të një shteti të identifikuar qartë armiqësore, të cilat janë kundërshtuar fillimisht me anë të diplomacisë, e nëse këto dështojnë, atëherë mund të kundërshtohet me forcë ushtarake si mjetin e

fundit. Natyrshëm, kërcënimet konvencionale ndikojë në marrëdhëniet ndërmjet shteteve-kombeve dhe Aleancës. Këto kërcënimë shpesh janë të lidhura me mosmarrëveshje territoriale ose çështje të sovranitetit, mund të vijnë nga jashtë apo brenda vendit.

Forcat Konvencionale janë ato forca të afta për zhvillimin e operacioneve duke përdorur armët jo nukleare, ndërsa termi Armët Konvencionale në përgjithësi i referohet armëve të cilat janë në përdorim të gjerë dhe nuk janë Armët e Shkatërrimit në Masë, të tilla si Nukleare, Kimike dhe Biologjike.

Armët konvencionale përfshijnë armët e lehta të këmbësorisë, minat detare dhe tokësore, bombat jo bërthamore, predhat, raketat dhe municionet e tjera jo bërthamore. Këto armë shfrytëzojnë materialet eksplozive, bazuar në energjinë kimike, në ndryshim nga ato nukleare që shfrytëzojnë energjinë nukleare.

Pritshmëria e përdorimit të të gjitha tipeve të armëve konvencionale në kohë lufte administrohet nga Konventat e Gjenevës. Tipe të veçanta të tyre në luftë janë të rregulluara ose të ndaluara nga Karta e Kombeve të Bashkuara në Konventa mbi Sigurinë e Armëve Konvencionale, futur në fuqi me 10.11.1983, që kërkon nga të gjitha palët ndalimin dhe kufizimin e përdorimit të armëve, të cilat konsiderohen si shumë dëmtoese ose efektet e përdorimit të tyre janë diskriminuose.

Ndalime e kufizime të tjera të përdorimit tyre janë parashikuar në Konventat për Municionet si dhe Konventa për Ndalimin e Përdorimit, Grumbullimit, Prodhimit dhe Transportimit të Minave Anti-Personel, etj.

Evoluimi i rreziqeve konvencionale

“Në erën e kërcënimeve asimetrike, nga të cilat siguria jonë kombëtare kërcënohet seriozisht nga grupe apo shtete jo miqësore është domosdoshmërisht, që mësimet e nxjerra në të shkuarën të mos harrohen, por të risillen përsëri në vëmendje dhe disiplinë e paralajmërimit të rigjallërohet”¹.

Në realitetin e ri, ku Aleanca është e përfshirë në operacione dhe përballet me rreziqe dhe kërcënime, të cilat nuk ishin të pa imagjinueshme deri sot shtrohet pyetja, sipas dhe perceptimit të qytetarëve të shteteve anëtare dhe jo anëtare të NATO-s: cilat kërcënime ndaj Komunitetit Ndërkombëtar përbëjnë rreziqe për Aleancën ose a konsiderohen të gjitha kërcënimet ndaj sigurisë në interesin e NATO-s? Cilat duhet të jenë prioritetet ndaj sfidave dhe kërcënimeve të tilla si terrorizmi, përhapja e armëve të shkatërrimit në masë, sulmeve kibernetike, siguria e energjisë, siguria e komunikacionit strategjik, etj? Si do të perceptohen këto rreziqe dhe si do të konfigurohet Aleanca për tu përballur me to?

Rreziqet në përgjithësi, që tani nuk mbeten thjesht brenda kufijve të një vendi, por që influencojnë në sigurinë dhe mbrojtjen në shkallë botërore janë:

- Terrorizmi ndërkombëtar;
- Përhapja e armëve të shkatërrimit në masë;
- Shtete të paqeverisshëm;
- Lufta informatike;

¹ LTG James Williams (Ret.), USA, Former Director, Defense Intelligence Agency

- Pasiguria energjetike;
- Ndryshimet klimaterike;
- Pakësimi i rezervave ujore, etj.

Në vijim të këtij konteksti, krahas kapaciteteve për mbrojtjen tradicionale të territoreve të saj Aleanca vendosi zhvillimin e kapaciteteve të reja për t'u mbrojtur ndaj kërcënimeve moderne të shekullit të 21-të. Ajo inicioi zhvillimin e programit të mbrojtjes ndaj raketave balistike në përgjigje të rrezikut në rritje të programeve raketore të rreth 30 vendeve jashtë Aleancës, ku disa prej të cilave mund të përbëjnë kërcënim për vendet aleate. E njëjta gjë mund të thuhet për zhvillimin kapaciteteve të mbrojtjes kibernetike.

Kërcënimet aktuale të këtij lloji ndaj vendeve të NATO-s janë shtuar kohët e fundit deri në 100 sulme në ditë të intensiteteve të ndryshme, por që e ardhmja do të shpалosë kërcënime të paparashikuara, ku deri tani, Estonia, Gjeorgjia dhe rasti Wikileaks evidentohen si tre raste tipike. Po ashtu, zhvillimin e kapaciteteve të sigurisë së energjisë, të sigurisë së rrugëve të komunikacionit strategjik, të kërcënimeve të piraterisë, apo të aspekteve të tjera të sigurisë.

Përfaqsa gjithëpërfshirëse përbën një transformim të NATO-s në fushën e menaxhimit të krizave, që është rrjedhojë logjike e mësimave të nxjerra nga operacionet e saj, të cilat tregojnë se krizat nuk mund të menaxhohen me sukses vetëm me mjete ushtarake. Zbatimi i këtij koncepti kërkon një ndryshim tek institucionet e sigurisë dhe mbrojtjes, i cili nënkupton gjithashtu trajnim të civilëve dhe ushtarakëve në nivele të ndryshme; pjesëmarrjen e tyre në fazat e planifikimit të operacioneve; pjesëmarrjen në stërvitje të përbashkëta; vendosjen e linjave të koordinimit; ndërtimin e besimit reciprok si dhe ndërtimin e një strategjie komunikimi efektive.

Megjithëse siguri në përgjithësi tani është një koncept më i gjerë, ai përsëri përmban elementë shumë të rëndësishëm ushtarakë, por edhe në këtë rast, rreziqet ndaj sigurisë në kohën e sotme do të kërkojnë një reagim ushtarak shumë të ndryshëm nga ai i kohës së mëparshme. Këto rreziqe tashmë nuk mund të përballohen thjesht me mbrojtje pasive apo masa ruajtje. Ushtritë e sotme mund të përdoren edhe në operacione në mbështetje të policisë së shtetit ose mund të dislokohen për të vepruar kundër kërcënimeve në vendet ku ato lindin.

Prandaj shtetet sot ballafaqohen me sfidën e vështirë të një reforme të gjerë ushtarake, forcat e së cilës duhet të jenë më të afta dhe të zhdërvjellëta, që më tej do të thotë do të jenë më të kushtueshme. Për këtë arsye për të mos rritur tej mase shpenzimet e mbrojtjes ushtarake duhet të jenë më të vogla. Kjo do të thotë që vendet e vogla nuk mund të jenë në gjendje të ndërtojnë një forcë të armatosur që të kryejë çdo funksion në një konflikt ushtarak, gjë që nënkupton prioritarizmin e roleve, e cila nga ana e vet nënkupton se themelore është pjesëmarrja në aleanca.

Trajtimi i rreziqeve në konceptin e ri strategjik

“Kërcënimet asimetrike, terrorizmi kanë si karakteristikë të tyre krijimin e rrjeteve, ku secila nyje funksionon si organizatë më vete, por me një fleksibilitet të admirueshëm bashkëpunimi dhe shkëmbimi të informacionit në mënyrë të shpejtë dhe të sigurt”².

² Paul R. Pilar “Attacking terrorism-Elements of a grand strategy

Tashmë rreziqeve konvencionalë u janë shtuar ato asimetrike, përballimi i të cilave kërkon metoda dhe kapacitete specifike jo tradicionale. Sfidat për përballimin e rreziqeve janë permanente ndaj kërkohet:

- Përmirësimi i sistemeve për mbrojtje efektive kundër terrorizmit dhe rrjeteve të internetit, armëve të shkatërrimit në masë.
- Reformimi i strukturave operacionale të FA-së.

Reagimet ndaj rreziqeve dhe sfidave të ardhme duhet të bazohen në njohjen dhe kuptimin e këtij realiteti të ri. Kjo kërkon që problemet të shikohen në një kontekst më të gjerë dhe të konsiderohen mënyra të ndryshme për zgjidhjen e tyre. Gjithashtu kjo kërkon që organizimi, institucionet dhe kapacitetet për sigurinë të ndërtohen në mënyrë të tillë që të përballojnë realitetin e ndryshimeve të shpejta dhe pasojave të tyre. Në realitetin e sotëm me konflikte gjithnjë e më komplekse asnjë institucion ose agjenci e vetme nuk mund të realizojë zgjidhje efikase për problemet që mund të lindin, kjo kërkon një koordinim dhe bashkëpunim sa më të gjerë të burimeve dhe strukturave të sigurisë.

Rreziqet e sotme terroriste apo kibernetike, që në formë dhe në mjetet e përdorura ndryshojnë krejt me çka përfytyrohej vite më parë, krijojnë teren të diskutueshëm në kuadër të së drejtës ndërkombëtare, nëse ato janë pastër “sulme të armatosura” të ardhura nga jashtë.

Bota e sotme si dhe aktorët e roli i tyre kanë ndryshuar në formë/dukje, kushte/natyre. Rreziqet konvencionalë ushtarake këto vite po përballen dhe me kërcënime guerilase, shtetet nuk kanë më monopolin e dijes, të fuqisë dhe burimeve. Organizatat apo individët që gëzojnë lehtësirat e demokracisë, teknologjisë së informacionit etj, kanë mundësinë të kërcënojnë dhe dëmtojnë shtete apo një pjesë të popullsisë. Pra duket se jetojmë në një kohë kur është shumë më e vështirë për të mbrojtur qytetarët sesa një shtet, ndaj duhet të përgatitemi për tu përballur në këtë mjedis global, në të kundërt s’kemi realizuar transformimin që kërkohet.

Rreziqet konvencionalë nuk mund të injorohen, shumë rajone dhe vende në botë janë dëshmitarë të përvetësimit të kapaciteteve thelbësore, moderne ushtarake me pasoja për sigurinë ndërkombëtare dhe sigurinë Euro-Atlantike që janë të vështira për t’u parashikuar. Kjo përfshin përhapjen e raketave balistike, të cilat përbëjnë një kërcënim real gjithnjë e në rritje për rajonin Euro-Atlantik.

Përhapja e armëve nukleare dhe armëve të tjera të shkatërrimit në masë, dhe mënyra e lëshimit të tyre, përbën kërcënim të pallogaritshëm për stabilitetin global dhe prosperitetin. Gjatë dekadës tjetër, përhapja do të jetë më e mprehtë në disa prej rajoneve më të ndryshueshme të botës.

Mungesa e stabilitetit ose konflikti përtej kufijve të NATO-s mund të kërcënojë në mënyrë direkte sigurinë e Aleancës, duke përfshirë nxitjen e ekstremizmit, terrorizmit dhe aktiviteteve ilegale trans-nacionale si trafikimi i armëve, lëndëve narkotike dhe popujve.

Sulmet kibernetike po bëhen të shpeshta, më të organizuara dhe më të kushtueshme në dëme pasi ato depërtojnë tek administratat qeveritare, bizneset, ekonomitë, dhe potencialisht gjithashtu edhe në rrjete të transportit, furnizimit dhe në infrastruktura të tjera kritike; ato mund të arrijnë një prag që kërcënon prosperitetin kombëtar dhe Euro-Atlantik, sigurinë dhe stabilitetin.

Një numër prirjesh domethënëse të lidhura me teknologjinë, që përfshijnë zhvillimin e armëve lazer, luftën elektronike dhe teknologji që pengojnë përdorimin e hapësirës, duket të jenë gati për të pasur efekte madhore globale dhe do të ndikojnë në planifikimin ushtarak të operacioneve të NATO-s.

Kufizime kyçe mjedisore dhe në burime, që përfshijnë rreziqet e shëndetit, ndryshimet klimaterike, mungesën e ujit dhe nevoja gjithnjë e më të mëdha të energjisë do të formësojnë mjedisin e ardhshëm të sigurisë në fusha të rëndësishme për NATO-n dhe kanë potencialin për të ndikuar në mënyrë domethënëse në planifikimin dhe operacionet e saj.

Analiza e vlerësimit të mjedisit ndaj rreziqeve

Në Samitin e NATO-s, ku u aprovua nga krerët e shteteve pjesëmarrëse “Koncepti i ri strategjik”, u theksua se: *Aleanca do të angazhohet në mënyrë aktive për të përmirësuar sigurinë ndërkombëtare, nëpërmjet partneritetit me vende të rëndësishme dhe organizata të tjera ndërkombëtare; duke kontribuar në mënyrë aktive në kontrollin e armëve, mospërhapjen e çarmatimit, si dhe duke e mbajtur derën e anëtarësimit në Aleancë të hapur për të gjitha demokracitë europiane që përmbushin standardet e NATO-s.*

Mjedisi i ri strategjik është bërë më kompleks dhe më i pasigurt dhe për të formuluar një strategji efektive duhet bërë një rivlerësim i këtij mjedisi. Parashikimi i të ardhmes është i pamundur, por nga ana tjetër do të ishte mungesë përgjegjësie të mos shikohen tendencat e zhvillimit të sotëm e të ardhshëm, si dhe shkaqet e këtyre tendencave.

Përcaktimi i rreziqeve dhe kërcënimeve lidhet me interesat e sigurimit kombëtar, rajonal dhe global, nëse këto interesa përcaktohen me objektivitet atëherë dhe rreziqet që cenojnë ato përcaktohen drejt.

Vendet anëtare të NATO-s kanë interesa kombëtare jo të njëjta, si pasojë edhe rreziqet e kërcënimit s’janë njëlloj për të gjithë, sidomos vendet e vogla kanë risk më të lartë ndaj tyre, aq më tepër nëse ato janë shtete të rinj apo kanë pësuar shndërrime të rëndësishme. Sidoqoftë shtete të ndryshme për vetë kushtet e rrethanat e tyre rrezikohen e kërcënohen në mënyra të ndryshme, por në përgjithësi mjedisi i ardhshëm përmban shumë rreziqe, ku tiparet kryesore që karakterizojnë këtë mjedis janë:

- Rreziqet më kërcënuese do të vijnë nga shtete të dobët, të dështuar, autoritarë, të cilët nuk zbatojnë ligjet ndërkombëtare dhe përbëjnë streha të sigurta për organizatat terroriste dhe kriminale.
- Terrorizmi do të vazhdojë të jetë rreziku kryesor për sigurinë globale.
- Modernizimi i teknologjisë do t’i mundësojë grupeve terroriste mjete të sofistikuara, veprime të decentralizuara të tyre.
- Qarkullimi i pa kontrolluar i teknologjive të komunikimit, do tu lejojë përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë.
- Rrjetet kriminale ndërkombëtare do të shfrytëzojnë gjithnjë e më tepër mungesat e ligjit, duke zgjeruar aktivitetin nga trafikimi i njerëzve, drogave dhe shërbime ndaj terroristëve.

Sot rajoni Euro-Atlantik është në paqe dhe kërcënimi i një sulmi konvencional ndaj NATO-s është i ulët, ky është një me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit.

Ky angazhim mbetet i palëkundur dhe i përbashkët, NATO do të frenojë dhe mbrohet nga çdo lloj kërcënimi apo agresioni, si dhe ndaj sfidave të sigurisë që shfaqen kurdo që ato kërcënojnë sigurinë themelore të secilit prej aleatëve ose të Aleancës si një e tërë.

NATO do të përdorë në mënyrë aktive në masën e duhur të dyja instrumentet politikë dhe ushtarakë në ndihmë të menaxhimit të krizave në zhvillim, që kanë potencialin për të ndikuar në sigurinë e Aleancës, para se ato të përshkallëzohen në konflikte, për të ndaluar këto konflikte kur ato ndikojnë në sigurinë e Aleancës dhe për të ndihmuar në konsolidimin e stabilitetit në situata post-konfliktuale kur kjo kontribuon në sigurinë Euro-Atlantike.

Aleanca është e ndikuar dhe mund të ndikojë, në zhvillimet politike dhe të sigurisë përtej kufijve të saj, ajo do të angazhohet në mënyrë aktive për të përmirësuar sigurinë ndërkombëtare, nëpërmjet partneritetit me vende të rëndësishme dhe organizata të tjera ndërkombëtare, duke kontribuar në mënyrë aktive në kontrollin e armëve, mospërhapjen dhe çarmatimin, si dhe duke e mbajtur derën e anëtarësimit të hapur për të gjitha demokracitë europiane që përmbushin standardet e saj.

Frenimi, bazuar në një kombinim të duhur të kapaciteteve nukleare dhe konvencionale mbetet një element themelor i strategjisë në tërësi. Duke u nisur nga sa më sipër, Aleanca do të sigurojë spektrin e plotë të kapaciteteve të nevojshme që NATO të frenojë dhe mbrohet nga çdo lloj kërcënimi ndaj mbrojtjes fizike dhe sigurinë e popullsisë. Rrjedhimisht, do të:

- Ruhet një kombinim i duhur i forcave nukleare dhe konvencionale;
- Zhvillohen dhe ruajtur forca konvencionale të fuqishme, të lëvizshme dhe të dislokueshme për të përmbushur si përgjegjësitë e Nenit 5 ashtu dhe operacionet ekspeditë të Aleancës, duke përfshirë Forcën Reaguese të NATO-s;
- Zhvillohen kapacitetet për të mbrojtur popullsitë dhe territoret ndaj sulmit me raketa balistike si një element thelbësor i mbrojtjes kolektive, i cili kontribuon në sigurinë e pandashme të Aleancës;
- Zhvillohen më tej kapacitetet e NATO-s për t'u mbrojtur ndaj kërcënimit të armëve kimike, biologjike, radiologjike, dhe atyre të shkatërrimit në masë;
- Zhvillohen më tej aftësitë për të parandaluar, gjurmuar, mbrojtur dhe riparuar nga dëmet e sulmeve kibernetike, duke përfshirë procesin planifikues të NATO-s për të përmirësuar dhe koordinuar kapacitetet kombëtare të mbrojtjes kundër-kibernetike, duke bërë që të gjitha institucionet e NATO-s të kenë një mbrojtje të centralizuar, ndërgjegjës, paralajmërim, dhe reagim më të mirë të integruar me kombet anëtare;
- Nxitë kapacitetin për të gjurmuar dhe mbrojtur ndaj terrorizmit ndërkombëtar, duke përfshirë analizën e avancuar të kërcënimit, më shumë konsultime me partnerët dhe zhvillimin e kapaciteteve të duhura ushtarake, që përfshijnë ndihmën për të trajnuar forcat lokale në luftën që ata vetë bëjnë kundër terrorizmit;
- Zhvillojë kapacitetin për të kontribuar në energjinë e sigurisë, duke përfshirë mbrojtjen e strukturës kyçe energjetike, zonat dhe linjat transit, bashkëpunimin me partnerët, dhe konsultimet mes Aleatëve në bazë të vlerësimeve strategjike dhe planeve paraprake për raste emergjencash;

- Aleanca siguron se është në pararojë të vlerësimit të impaktit tek siguria e teknologjive që shfaqen, dhe që planifikimi ushtarak merr në konsideratë kërcënimet potenciale;
- Vazhdon të rishikojë qëndrimin e përgjithshëm për frenimin dhe mbrojtjen e NATO-s ndaj spektrit të plotë të kërcënimeve, duke marrë në konsideratë mjedisin evolues ndërkombëtar të sigurisë.

Implikimet e rreziqeve konvencionale ndaj Shqipërisë dhe FARSH-së

Dokumentet më të rëndësishme në fushën e sigurisë kombëtare në vendin tonë, përcaktojnë në mënyrë të qartë rreziqet, të cilët i kanosen vendit në fusha dhe perspektiva të ndryshme. Kështu dy dokumentet bazë mbi politikën e sigurisë kombëtare Strategjia Kombëtare e Sigurisë dhe Strategjia Kombëtare e Forcave të Armatosura, vendosin piketat mbi kërcënimet e mundshme ndaj RSH-së dhe qytetarëve të saj, ku dallojnë disa rreziqe potenciale në kontekstin kombëtar dhe ndërkombëtar, duke veçuar elementët më të rëndësishëm në fushën e sigurisë. Megjithatë vlen të theksohet se kërcënimet e identifikuar në dokumente të ndryshëm kanë prevalencë të ndryshme në 15 vitet e fundit, në varësi të situatave dhe ngjarjeve në nivel kombëtar, rajonal dhe ndërkombëtar, ku disa prej tyre mund të quhen të rastësishme siç mund të jenë shkelja e mundshme e integritetit territorial, katastrofa natyrore, sulme terroriste etj. Ndërkohë të tjera mund të jenë me karakter jetëgjatë dhe perceptohen si konstante si varfëria, krimi i organizuar etj.

Të tjera çështje që konsiderohen si rrezik potencial në fushën e sigurisë janë katastrofat natyrore dhe çështjet mjedisore, të cilat mund të kenë ndikim negativ në shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik në raste dhe momente specifike. Kështu vendi ynë është i ekspozuar ndaj përmytjeve, reshjeve të shiut, borës që mund të dëmtojnë prodhimet agro-bujqësore dhe infrastrukturën rajonale. Rrjeti i transportit (rrugor dhe hekurudhor) shpesh gjatë dimrit bëhen të pakalueshme, duke shkaktuar problem në ekonomi dhe sfida për institucionet shtetërore për përballimin e këtyre emergjencave.

Duke u bazuar në dokumentet strategjike mund të ndalemi në faktin se mund të identifikojmë disa elementë të paqartë dhe të diskutueshëm në konstatimin e kërcënimeve për sa i përket referencës që i bëhet “*dezinformimit publik*”³. Artikulli 12 në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë në mënyrë të qartë thekson nevojën për të ndaluar dhe censuruar informacionin e klasifikuar “sekret”, nëse siguria kombëtare mund të preket. Kjo gjë bëhet edhe më shqetësuese kur media shprehimisht konsiderohet si rrezik potencial për stabilitetin e vendit, në të njëjtën kategori me krimin e organizuar, paqëndrueshmërinë ekonomike, emigrimin ilegal dhe lëvizjet e pa kontrolluara demografike.

Për sa i përket diferencave mes perceptimeve të publikut dhe rreziqeve të njohura dhe të pretenduara nga institucionet shtetërore ka një kontrast që mund të na drejtojë në disa argumente mbi kërcënimet reale dhe artificiale në fushën e sigurisë duke iu referuar perceptimit të publikut. Si rrjedhojë mund të pranojmë idenë e Gyarmantit⁴, i cili thotë:

³ Gyarmanti, Istan and Stancic Darko, *Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans, DCAF, 2007*

⁴ Gyarmanti, Istan and Stancic Darko, *Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans, DCAF, 2007*

“dokumentet kombëtarë strategjikë dhe mendimi i njerëzve reflektojnë një prirje artificiale të kërcënimeve të sigurisë, si rrjedhojë situata aktuale në Ballkanin Perëndimor mund të karakterizohet si “siguri virtuale” me “kërcënime artificiale”.

Përfundime

Krizat dhe konfliktet përtej kufijve të NATO-s, mund të përbëjnë një kërcënim direkt ndaj territorit dhe popullsisë të Aleancës, rrjedhimisht ajo do të angazhohet, ku është e mundur dhe e nevojshme, për të parandaluar, menaxhuar krizat, stabilizuar situatat post-konfliktuale dhe mbështetur rindërtimin.

Mësimet e nxjerra nga operacionet e NATO-s, sidomos në Afganistan dhe Ballkanin Perëndimor, e bëjnë të qartë që një qasje e gjithanshme politike, civile, dhe ushtarake, është e nevojshme për menaxhim efektiv krizash. Aleanca do të angazhohet në mënyrë aktive me aktorët e tjerë ndërkombëtarë para, gjatë dhe pas krizave për të inkurajuar analizat, planifikimin dhe kryerjen e përbashkët të aktiviteteve në terren, në mënyrë që të maksimizohet koherenca dhe efektiviteti i përpjekjes së përgjithshme ndërkombëtare.

Mënyra më e mirë e menaxhimit të rreziqeve është parandalimi i tyre para se të ndodhin, ndaj kur parandalimi i konfliktit rezulton të jetë i pasuksesshëm, NATO do të jetë e përgatitur dhe e aftë për të menaxhuar armiqësitë e vazhdueshme, ajo ka kapacitete unike të menaxhimit të konflikteve, të cilat përfshijnë kapacitetet të pakrahasueshëm për të dislokuar dhe mbajtur kapacitete të fuqishme ushtarake në terren.

NATO kërkon sigurinë e saj me nivelin më të ulët të mundshëm të forcave, kontrolli i armëve, çarmatimi dhe mospërhapja e armëve kontribuojnë në paqen, sigurinë dhe stabilitetin, dhe duhet të sigurojnë siguri të plotë për të gjithë anëtarët e Aleancës. Ajo do të vazhdojë të luajë rolin në forcimin e kontrollit të armëve dhe nxitjen e çarmatimit si të armëve konvencionale dhe të armëve të shkatërrimit në masë, sikurse përpjekjet e mospërhapjes.

Me ndryshimet në mjedisin e sigurisë që prej fundit të Luftës së Ftohtë, janë reduktuar mjaft numri i armëve bërthamore të vendosura në Evropë dhe NATO është angazhuar për kontrollin e armëve konvencionale, të cilat ofrojnë parashikueshmëri, transparencë dhe një mjet për të mbajtur armatime në nivelin më të ulët të mundshëm për stabilitet, si dhe do të punojë për forcimin e sigurisë në bazë të transparencës, reciprocitetit dhe me pëlqimin e kombeve pritës.

Referenca:

1. Strategjia e Sigurisë Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, 2004.
2. Strategjia Ushtarake Kombëtare e Republikës së Shqipërisë, 2008.
3. Jean-Marc Rickli, “European small states” military policies after the Cold War: from territorial to niche strategies Vol 21 Issue 3, 2008.
4. Manuali i NATO-s, Public Diplomacy Division, NATO 1110 Brussels, 2006.
5. Revista ushtarake – mars 2010 (Koncepti i ri i NATO-s).

Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM) - Proces i Transformimit dhe Gjenerimit të Reformave Afatgjata në Forcat e Armatosura

Kolonel Thimi Hudhra
Qendra e Analizave të Mbrojtjes, KDS
N/Kolonel Editson Zarka
Drejtoria e Politikave të Mbrojtjes, MM

Abstrakt: Ky artikull merr shkas nga procesi i filluar kohët e fundit mbi Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes (RSM) të Republikës së Shqipërisë si vend anëtar i Aleancës Euroatlantike, dhe aplikant për kandidat i BE-së. Në të hidhet dritë mbi disa aspekte themelore të RSM-së, në teori dhe në praktikë.

Në fillim, artikulli bën një përshkrim informativ se si ka filluar procesi i RSM 2011 në RSH, më tej ai vazhdon me origjinën e konceptit të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes, pastaj ai trajton eksperiencën e deritanishme kombëtare dhe ndërkombëtare mbi këtë proces, shqyrton çështjet kryesore që duhet të synojë, si dhe konkludon me disa rekomandime paraprake për RSM – 2011 në RSH.

Rishikimi Strategjik është një proces i hapur dhe transparent. Ai është një proces ciklik që bëhet 4-6 apo më shumë vjet. RSM është një dokument vizionar i shoqëruar me reformat përkatëse. Rezultatet e tij shpallen nëpërmjet një raporti final për të gjithë autoritetet dhe institucionet e sigurisë dhe të mbrojtjes së vendit.

RSM-ja bëhet kur ka ose priten ndryshime madhore në mjedisin e sigurisë, kur kemi ndryshime të ndjeshme në politikat e mbrojtjes, kur ka ndryshime të qeverisjes që shoqërohen me platforma të tjera, kur ka ndryshime në përmbushjen e rolit dhe të misionit të FA, kur ka ndryshime në të mirë apo jo për sa i përket mbështetjes financiare, kur priten reforma të sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes, apo reforma në menaxhimin e institucionit të mbrojtjes, kur kërkohet një rishikim i kapaciteteve ushtarake ekzistuese, apo edhe kur kemi ndryshime në disa nga çështjet e përmendura më sipër.

RSM-ja është një metodë bashkëkohore e përmirësimit të kapaciteteve të mbrojtjes. Ajo mund të kryhet kryesisht nga ato vende që kanë potenciale intelektuale të spikatura dhe analitike në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes. Synimi final i RSM-së është drejtimi i procesit afatgjatë të transformimit dhe gjenerimit të reformave në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes. Autorët mendojnë se Shqipëria i ka të gjitha kapacitetet për ta bërë këtë rishikim. Inicimi i tij është në kohën e duhur dhe produktet e tij duhet të vlerësohen në nivel maksimal.

1.Si ka filluar dhe vijon procesi i RSM 2011 në RSH

Miratimi i Konceptit Strategjik të NATO-s në Samitin e Lisbonës hapi rrugën për reforma të thella në Aleancën Euroatlantike dhe në vendet anëtare të saj. Reformat që kërkohet të kryhen janë shumë-planëshe dhe komplekse. Aq më shumë, ato parashikohet të kryhen nën efektet e pas-krizës financiare, të drejtuara nga koncepti për një “*smart defence*”¹.

Shumë vende aleate kanë filluar një proces të Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM), ndër të cilat edhe vendi ynë. Ky proces do të kryhet në bashkëpunim të ngushtë me Departamentin e Mbrojtjes së SHBA.

Procesi i RSM-2011 do të kryhet në nivel ndërinstitucional, sipas Urdhrit të Kryeministrit, Nr. 50 dt. 12.04.2011 “*Për ngritjen e Grupit Ndërmnistror të Punës për përgatitjen e dokumentit për Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes të RSH*”. Ky grup kryesohet nga Zëvendësministri i Mbrojtjes, z. Arian Starova. Institucionet kryesore të përfshira në këtë proces janë: Ministria e Punëve të Jashtme, Ministria e Brendshme, Ministria e Drejtësisë, Ministria e Financave, Ministria e Punëve Publike dhe Transportit, si dhe Shërbimi Informativ Shtetëror. Secila prej tyre ka ngritur Grupet e Punës me ekspertë të fushave të linjës, të cilët do të kontribuojnë në vlerësimin e mbrojtjes kombëtare nga këndvështrimi dhe përgjegjësia e tyre.

Fazat e Procesit RSM. Procesi i RSM-së do të kryhet brenda një afati kohor prej 18-muajsh, sipas një programi të qartë dhe gjithëpërfshirës. Fazat kryesore të këtij procesi janë:

- **Faza e I-rë**, përfshin ngritjen e Grupit Ndërmnistror të Punës për RSM, grupet e punës respektive për çdo ministri, ngritjen e Sekretariatit të RSM, si dhe përgatitjen e dokumentacionit fillestar për fillimin e procesit të RSM-së. Në këtë fazë evidentohet mjedisi ku veprohet, pra shqyrtohen aspektet ligjore, trashëgimia dhe përvoja specifike e vendit etj.
- **Faza e II-të**, përfshin aspekte të kuptimit dhe përcaktimit të kuadrit të politikës së sigurisë kombëtare, nëpërmjet analizës së dokumenteve ekzistuese strategjike kombëtare, si dhe përgatitjes së vlerësimit të mjedisit strategjik në nivel kombëtar. Gjatë kësaj faze do të vijojë identifikimi i objektivave dhe interesave kombëtare e institucionale, si dhe përcaktimi i rolit dhe misionit të ministrive dhe agjencive të ndryshme të përfshira në sigurinë dhe mbrojtjen kombëtare.
- **Faza e III-të**, përfshin zhvillimin e skenarëve të planëzimit të lidhura me mbrojtjen e vendit. Në bazë të këtyre skenarëve do të diskutohet edhe roli i institucioneve kryesore që lidhen me mbrojtjen kombëtare, duke synuar një përjasje gjithëpërfshirëse të instrumenteve politik, ekonomik, social, mjedisor dhe ushtarak. Instrumente të tjerë të planëzimit mund të shtohen bazuar në diskutimet e Grupit Ndërmnistror të Punës.
- **Faza e IV-të**, përfshin përcaktimin e detyrave kryesore të misionit dhe zhvillimin e një analize të detajuar lidhur me mungesat apo tepricat e kapaciteteve që mund të evidentohen për mbrojtjen kombëtare.

¹ “Mbrojtje e zgjuar”, citim i Sekretarit të NATO-s, Rasmussen në Konferencën e Sigurisë, Munich, 2011

- **Faza e V-të**, përfshin gjetjen dhe zhvillimin e opsioneve për kapacitetet e kërkuara, duke i parë të lidhura ngushtë me aspektet financiare. Kjo fazë do të kërkojë përgatitjen dhe propozimin e kurseve të veprimit para autoriteteve vendim-marrësve në nivel strategjik.
- **Faza e VI-të**, përfshin paraqitjen e gjetjeve kryesore për RSM-në, si dhe nxjerrjen e akteve përkatëse ligjore e nënligjore për zbatimin e tyre në periudhën afatshkurtër, afatmesme dhe afatgjatë.

Zhvillimi i të gjitha këtyre fazave do të bëhet në bashkëpunim të ngushtë me palën amerikane duke organizuar takime, workshope dhe “tavolina të rumbullakëta” me ekspertë të fushave të ndryshme të sigurisë dhe mbrojtjes. Gjithëpërfshirja, puna në grup, transparencë ndaj institucioneve të tjera dhe ndaj publikut do të jenë disa tiparet e procesit të rishikimit.

2. Origjina dhe Koncepti i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes (RSM)

Ç’është Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes (RSM)? Cili është përkufizimi i pranuar i RSM-së (në anglisht SDR)? Ku dhe kur u iniciua ai fillimisht, dhe kush ishin shkaqet? Si është përqafuar ai në vende të ndryshme? Kush janë qëllimet dhe objektivat e tij? Cilat janë elementët kryesore të një Rishikimi Strategjik të Mbrojtjes? Cilat janë gjetjet dhe produktet kryesore të këtij procesi?

Origjina e RSM. Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes është një proces që e ka origjinën pas Luftës së Ftohtë. Ai lindi si nevojë e ndryshimeve madhore në sigurinë dhe mbrojtjen e vendeve aleate në kuadrin e mungesës së rreziqeve konvencionale për të cilat ato ishin përgatitur të përballonin. Ky ndryshim i ndjeshëm i mjedisit të sigurisë, i shoqëruar me promovimin e shumë faktorëve ekonomikë e socialë, imponuan që shumë shtete të fillonin procesin e abandonimit të kapaciteteve ushtarake “të vjetëruara” dhe të ndërtimit të kapaciteteve të tjera “moderne”, për të përballuar rreziqet dhe kërcënimet e pritshme.

Ky ndryshim i thellë i natyrës së kapaciteteve, nuk mund të kryhej me vendimmarrje të pjesshme, por vetëm me rishikime të thella të gjithë biznesit të institucioneve të sigurisë dhe të mbrojtjes. Kërkimet e bëra në këtë fushë rezultojnë se këto ndryshime të thella mund të arrihen vetëm nëpërmjet institucionalizimit të proceseve periodikë që synojnë transformimin e mentalitetit, të marrëdhënieve, të menaxhimit, të kapaciteteve, e të shumë aspekteve të tjera prioritare.

Për herë të parë, procesi i Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes është iniciuar në vitin 1997, nga Shtetet e Bashkuara të Amerikës, dhe në vitin 1998 nga Mbretëria e Bashkuar. Më pas, ky proces u përkrah nga shumë vende të tjerë si mënyra më e mirë për të kryer reforma në sektorin e sigurisë dhe të mbrojtjes.

Në Shtetet e Bashkuara, Rishikimi i Mbrojtjes njihet me emërtimin Rishikimi Katërvjeçar i Mbrojtjes (Quadrennial Defence Review - QDR) dhe është iniciuar nga Sekretari i Mbrojtjes i asaj kohe, William Cohen, bazuar në ligj² ku “Sekretari i Mbrojtjes duhet të zhvillojë çdo 4 vjet një vlerësim gjithëpërfshirës të strategjisë së mbrojtjes kombëtare, të strukturës së forcës, të planeve të modernizimit të forcës, të infrastrukturës, planeve buxhetore, si dhe të elementëve të tjerë të politikave dhe programeve të mbrojtjes, me

²The US National Defense Authorization Act - 1997

synimin për të përcaktuar strategjinë e mbrojtjes së Shteteve të Bashkuara dhe programin e mbrojtjes për 20 vitet e ardhshme. Çdo QDR kryhet në konsultim me Kryetarin e Shefave të Bashkuar të Mbrojtjes³. Që nga ajo kohë, SHBA kanë kryer edhe tre Rishikime, respektivisht në vitin 2001, 2006 dhe i fundit në vitin 2010.

Në Mbretërinë e Bashkuar, procesi emërtohet Rishikim Strategjik i Mbrojtjes u inicia u në vitin 1998 nga ish-Sekretari i Shtetit për Mbrojtjen, Sir George Robertson, më pas Sekretar i Përgjithshëm i NATO-s. Më vonë, Mbretëria e Bashkuar kreu Rishikimin e dytë të saj në vitin 2010, duke e zgjeruar atë në kuadrin e përfaqësjes gjithëpërfshirëse, duke e emërtuar si një Rishikim Strategjik të Sigurisë dhe të Mbrojtjes – SDDR.

Me tej, shtetet e tjera filluan të kryejnë Rishikime Strategjike të Mbrojtjes së tyre për të aktualizuar zhvillimin e forcave të armatosura me mjedisin e sigurisë së kohës dhe ato të pritshme. Në fillim, vazhdoi Gjermania, Franca, Italia, Polonia, Kanadaja, Danimarka, Norvegjia e deri tek Hungaria, Republika Çeke, Kroacia, Sllovenia, vendet Baltike, etj. Pavarësisht se jo në të gjitha rastet dokumenti ka të njëjtin emër, përmbajtja, mesazhet dhe objektivat e “Librit të Bardhë” të Francës, të “Politikës së Mbrojtjes së Bundeweherit” të Gjermanisë, apo të “Danish Defence Agreement” të Danimarkës, etj, janë Rishikime të pastra Strategjike sipas specifikës së këtyre vendeve.

Po ashtu, në Aleancën e Atlantikut të Veriut, Rishikimi i Strategjik i Mbrojtjes është një proces periodik që përfshin përveç strukturat e NATO-s, edhe të gjitha vendet aleate. Ai kryhet nëpërmjet Konceptit të ri Strategjik të Aleancës, që vijon me tej me procesin e Rishikimit të Kërkesave të Mbrojtjes (DRR), të Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes së NATO-s (NDPP), të cilat rezultojnë dhe përkthehen në çështje transformimi, reforma dhe zhvillimi të kapaciteteve përkatëse të Aleancës për 10 vitet e ardhme, si dhe të shteteve anëtare në veçanti. Në këtë proces është përfshirë dhe vendi ynë, qysh prej vitit 2009 si vend aleat, dhe qysh prej vitit 1996 si vend i procesit të PARP-it.

Përfaqja Politike. Në të gjitha rastet, Rishikimi Strategjik i Mbrojtjes është një përpjekje dhe proces politik. Ai iniciohet nga autoritetet politike, dhe shpreh vullnetin politik të tyre për zhvillimin e reformave në sektorin e sigurisë dhe mbrojtjes. RSM mund të përdorë dhe përfshijë në proces të gjithë mekanizmat, kapacitetet institucionale, institucionet kërkimore, shoqërinë civile, personalitete të shquar, mediat, organizatat jo-qeveritare, dhe aktorë të tjerë të interesuar.

Megjithë përfaqësimin politik të procesit, ka shumë rëndësi të kuptojmë që gjetjet dhe produktet e RSM duhet të mos influencohen nga politika. Ato duhet të jenë rezultat i një analize të thellë dhe të pavarur të ekspertëve të fushave të ndryshme që përfshin ky proces. Çdo ndërhyrje paraprake për të politizuar përfundimet e procesit mund të diskreditojë përpjekjet e bëra.

Në fund të procesit, pranimi i gjetjeve të tij është përsëri politik. Zgjedhjet e politikës mbi përfundimet dhe gjetjet e RSM-së mund të jenë të ndryshme; ajo mund t’i pranojë ose mund të mos i pranojë ato, apo mund të kërkojë zgjidhje të tjera të ndërmjetme bazuar në trekëndëshin e famshëm: objektivat, mënyrat dhe mjetet (*ends ways and means*⁴). Nëse

³ USC 10, §118 (a) bazuar në Kodin e SHBA “Title 10”.

⁴ *Making Modern Strategy*, Bartlett, Holman and Lykke, Vol 1, Faqe 231

gjetjet shprehin objektiva (*ends*) që kërkojnë më shumë burime financiare (*means*) mund të gjenden mënyra të tjera (*ways*) për kompensimin e kapaciteteve ushtarake të nevojshme për përmbushjen e tyre, apo ato mund të shtrihen në një kohë më afatgjatë për tu realizuar. Pra, teoria na jep dhjetëra mënyra të tjera për të balancuar trekëndëshin me anë të negociatave të tipit *trade-offs* midis politikanëve dhe ekspertëve të lartë, për të përmbushur gjetjet finale të Rishikimit Strategjik.

Produktet/Gjetjet e RSM. Produktet/Gjetjet kryesore të Rishikimit Strategjik ndryshojnë nga një vend në tjetrin. Secili shtet ka specifikat e tyre, por shumica e shteteve kanë shumë gjëra të përbashkëta. Të gjitha shtetet konfirmojnë që qëllimi i RSM është përcaktimi i drejtimit dhe gjenerimi i një numri reformash për "*përmirësimin e performancës, kapaciteteve, menaxhimit, dhe koordinimit të instrumentit të mbrojtjes kombëtare për avancimin e interesave kombëtare në periudhën afatgjatë, në koordinim me instrumentet e tjerë të fuqisë kombëtare*"⁵.

Një gjetje e rëndësishme është përcaktimi i rolit, misionit dhe detyrave të forcave të armatosura në mjedisin e ardhshëm të sigurisë. Natyrisht roli, misionet dhe detyrat mund të jenë të përafërta në parim, por mënyra sesi ato do të përmbushen dhe kapacitetet që do të kërkojnë për përmbushjen e tyre, do tu nënshtrohen ndryshimeve të ndjeshme.

Një gjetje tjetër është edhe saktësimi i skenarëve/situatave të planëzimit. Bazuar në rolet dhe misionet e ardhshme të Forcave të Armatosura, pika fillestare e gjetjeve të RSM-së do të jenë skenarët/ situatat e planëzimit ku mund të angazhohen njësitë e forcave të armatosura në spektrin e operacioneve luftarake dhe jo-luftarake brenda dhe jashtë vendit. Përcaktimi i këtyre skenarëve do të ketë efekte direkte mbi organizimin, trajnimin, arsimimin, doktrinën, pajisjet, infrastrukturën dhe cilësitë e forcës së ardhshme.

Pas përcaktimit të tyre, gjetja tjetër e rëndësishme e RSM-së ka të bëjë me kapacitetet që i nevojiten forcave të armatosura për tu angazhuar në skenarët/ situatat e planëzimit në planin afatgjatë. Paralel RSM-ja bën një vlerësim midis kapaciteteve të ardhshme dhe atyre ekzistuese, duke evidentuar boshllëqet dhe tepricat e kapaciteteve. Më tej, RSM-ja mund të japë organizimin e kapaciteteve të nevojshme në një strukturë organizative të forcës së armatosur, e cila quhet strukturë objektive **2020**.

Një gjetje tjetër e RSM-së është përcaktimi i strukturës së ardhshme të forcës. Kjo bëhet duke e testuar zhvillimin e saj me mbështetjen financiare të parashikuar në periudhën afatgjatë. Mbështetja financiare mund të ushtrojë ndikimin e saj për mirë apo për keq në zhvillimin e forcës së dëshiruar. Mbështetja financiare parashikohet në përqindje të GDP, duke vlerësuar njëkohësisht edhe disa supozime në interes të planifikimit afatgjatë (si rritja vjetore e GDP, inflacioni etj).

Nuk po ndalemi në gjetjet e tjera të fushës së reformave të menaxhimit të institucionit të mbrojtjes; si ato të futjes së formave moderne të menaxhimit të institucionit, të strukturave të integruara të drejtimit, të menaxhimit të burimeve, të planëzimit të centralizuar dhe ekzekutimit të de-centralizuar, etj, që mund të jenë objekt i një shkrimi tjetër.

Procesi i RSM. Planëzimi i kujdesshëm dhe respektimi i procesit ka një rëndësi të veçantë. Teorikisht, procesi i RSM-së ndahet në disa hapa kryesore, por edhe praktikisht duhet të

⁵ *Fighting the Long War*, Peter Barnett, NDU Press, Defence Focused Studies 2009

ndodhë e njëjta gjë. Secili hap i procesit ka afatin/periudhën e vet kohore, ka produktin/produktet e veta, si dhe personat/institucionet përgjegjëse. Është shumë e rëndësishme që secilit hap ti atashojmë gjithashtu edhe njësinë matëse të progresit të tij. Në këtë kontekst, ndër hapat kryesore të procesit të RSM-së mund të rreshtojmë: evulimi i rolit dhe misionit të forcave të armatosura, ngritja e skenarëve/ situatave të planëzimit ku do të angazhohen ato, përcaktimi i kapaciteteve përkatëse të tyre, eliminimi i kapaciteteve të vjetëruara, zhvillimi i kapaciteteve të reja, zhvillimi i strukturës së forcës së ardhshme, komandimi dhe drejtimi operacioneve të ardhshme, zhvillimi i planeve të modernizimit, i planeve të infrastrukturës, i planeve buxhetore, i reformave të menaxhimit, dhe i planeve të tjerë themelore për 20 vitet e ardhshme.

Për të bërë sa më sipër, dokumenti i RSM fillon me një vlerësim realist të mjedisit të ardhshëm të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale dhe tendencat e zhvillimit të tij për 10-20 vjet përpara, duke rekomanduar prioritetet strategjike dhe përfaqset më të mira për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve e ardhshme, dhe shfrytëzuar edhe oportunitetet e mundshme.

Sa më sipër, mund të ketë ndryshime sipas specifikave të secilit vend, bazuar në objektivat kryesore që i vihen Rishikimit të Mbrojtjes. Kjo do të varet shumë nga qëllimet dhe shkaqet kryesore për të cilat inicohet çdo RSM. Përgjithësimi 'për të gjitha e për gjithçka' i RSM-së mund të devijojë vëmendjen nga problemet kyçe të tij për rastin e vendit tonë.

Programi i RSM. Kohëzgjatja e procesit të Rishikimit të Mbrojtjes do të varet nga shumë faktorë. Në përgjithësi ai varion nga 1 vit në 1,5 vjet. Në vartësi të kohës së dhënë në dispozicion, bëhet një program i detajuar i Rishikimit Strategjik. Në pamje të parë kjo duket një kohë e gjatë, por në fakt, kjo kohë do të duket shumë e shkurtër pas fillimit të punës dhe shtrimit të çështjeve për zgjidhje. Eksperienca ka treguar që nuk ka kohë boshë në këtë periudhë, nëse synojmë të bëjmë një Rishikim Strategjik të thellë që ti shërbejë reformave të ardhshme.

Normalisht, programimi bëhet në mënyrë graduale dhe logjike. P.sh., fillimisht duhet të bëhet vlerësimi i mjedisit të ardhshëm strategjik dhe pastaj të bëhet vlerësimi i kapaciteteve përkatëse për përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve që ai evidenton. Apo, në fillim përcaktohen kapacitetet operacionale të nevojshme dhe pastaj bëhet struktura organizative e Forcave të Armatosura. E kështu me radhë.

Rreshtimi në mënyrë logjike dhe graduale i problemeve dhe shtrimi i pyetjeve të drejta që kërkohet tu jepet zgjidhje është pjesa e parë më e rëndësishme, që do të orientojë suksesin në fazën e dytë. Shtrimi i shtrebrëuar i çështjeve do të bëjë që puna të çalojë në zbatimin e procesit.

Metoda e RSM. Metoda e kryerjes së Rishikimit Strategjik ka një rëndësi të madhe. Gjetjet dhe produktet do të ndikohen shumë nga metoda e përdorur. Procesi i Rishikimit Strategjik nuk mund të bëhet nga zyra. Ai duhet të parashikojë një program të larmishëm aktivitetesh si takime, konsultime, anketime, vëzhgime, mësim të nxjerra, kërkime apo studime krahasuese, si dhe vizita në vendet që e kanë kryer këtë proces kohet e fundit, apo ftesën e tyre në Tiranë.

Praktika ka treguar që, për çështje të caktuara, mund të kërkohen studime apo kërkime të mirëfillta që mund të kërkojnë kohë. Për këtë qëllim, rekomandojmë që programit të

Rishikimit Strategjik ti bashkëlidhet edhe një program të studimeve apo kërkimeve përkatëse. Për këto mund të përdoren tezat kërkimore të KLO, tezat e masterave, të doktoraturave apo të studimeve të tjera të Akademisë së Mbrojtjes, Qendrës së Analizave të Mbrojtjes, dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore e të arsimimit dhe trajnimit të FASH, apo dhe jashtë tyre.

Çdo gjetje e grupeve përkatëse duhet të testohet në takime, metodave të tipit “brainstorming” apo “round tables”, apo edhe nëpërmjet seminareve e konferencave shkencore specifike. Nuk mund të quhet e mbyllur një çështje e caktuar pa marrë konsensusin e të gjithë aktorëve të përfshirë në diskutimet e saj. Është e nevojshme që të gjitha gjetjet dhe produktet e RSM duhet normalisht të diskutohen me institucionet/njësitë që do t'i nënshtrohen reformave të këtij procesi.

Përfshirja në RSM. Rishikimi Strategjik, sipas eksperiencës së deritanishme, kërkon një përfshirje të gjerë të ekspertëve dhe analistëve më të mirë kombëtarë në të gjitha fushat që ai do të eksplorojë, duke mos përjashtuar asistencën ndërkombëtare. Puna e integruar në ekip është ndër faktorët vendimtarë për gjetje realiste dhe të koordinuara. Gjithëpërfshirja, mundësisht e një numri sa më të madh ekspertësh, jo në kuptimin e vijës së masës, e bën konceptin jo vetëm shumë përfaqësues, por edhe më të zbatueshëm në praktikë.

Mund të marrim si shembull, zhvillimin e Konceptit Strategjik të Aleancës, i cili është dokumenti themelor që drejton procesin e Planifikimit të Mbrojtjes të saj, nëpërmjet procesit të Rishikimit të Kërkesave të Mbrojtjes (DRR). Për këtë koncept, të zhvilluar për një periudhë më shumë se një vjeçare, të ndarë në tre faza, u ngrit “Grupi i të Urtëve” me rreth 15 vetë, por nëpërmjet një procesi të mirë-organizuar, u angazhuan direkt dhe indirekt më shumë se 6000 personalitete në spektrin e fushave të sigurisë, nga mbi 40 shtete, si dhe mbi 400 organizma jo-qeveritarë dhe ndërqeveritarë.

Po ashtu, në mënyrë proporcionale me madhësinë dhe me ambicjet e çdo shteti, kjo përqasje vërehet në proceset e përfshirjes në grupeve të punës së çdo shteti, për Rishikimin e tyre Strategjik. Për ilustrim po përmendim vetëm procesin e Rishikimit të Mbrojtjes së Polonisë, i cili u mbyll vetëm 2 muaj më parë, i drejtuar nga një grup drejtues kryesor, i mbështetur nga 7 grupe pune të fushave kryesore të ekspertizës, si dhe përfshirjen e 500 ekspertëve të fushave të ndryshme brenda dhe jashtë institucionit të mbrojtjes. Apo në librin e Bardhë të Francës, ku grupi i punës i firmosura nga Presidenti Sarkozy, përfshin rreth 50 personalitete të fushave të ndryshme, ndërsa aktivizimi i organizmave dhe i aktorëve të tjerë ishte mbi 600.

Kur flasim për përfshirjen e RSM, nuk duhet të harrojmë se ai përfshin, përveç institucionit të mbrojtjes, edhe institucione të tjera të sigurisë që lidhen me politikën e mbrojtjes, si diplomacinë, financat, rendin, drejtësinë, etj. Përfshirja e këtyre ekspertëve ja rrit vlerat Rishikimit të Mbrojtjes, si dokument me karakter kombëtar dhe jo vetëm i institucionit të mbrojtjes.

3. Eksperienca Kombëtare mbi RSM

Pse Shqipëria duhet të bëjë një Rishikim Strategjik të Mbrojtjes? Dhe nëse ka vendosur ta bëjë, a është e aftë të prodhojë një dokument që të mos mbetet në letër, për fat të keq, si disa dokumente të tjerë të periudhës së fundit 20 vjeçare? Cili mund të jetë qëllimi kryesor

i këtij Rishikimi Strategjik, dhe cilat mund të jenë specifikat e tij, duke e krahasuar me teorinë dhe eksperiencën e vendeve të tjera? A ka Shqipëria një eksperiencë të vetën në këtë fushë?

Institucionalizimi i RSM. Siç u trajtua edhe më sipër, procesi i Rishikimit të Mbrojtjes duhet të jetë procesi i vetëm që duhet të ndjekë edhe vendi ynë për të drejtuar reformat e mbrojtjes në periudhën afatgjatë. Është e vërtetë që në dy dekadat e fundit janë bërë ndryshime të mëdha, por një pjesë e reformave nuk kanë qenë të thella. Në mënyrë të paqëllimshme, për shkak të eksperiencës së pakët, një pjesë e tyre kanë synuar të bëjnë më shumë reduktime sasiore se sa reforma cilësore. Një pjesë e mangësive të menaxhimit të forcës nuk janë eliminuar, ato janë mbartur nga strukturat më të mëdha në strukturat më të vogla që i kanë pasuar ato.

Ka pasur edhe raste kur reformat janë identifikuar vetëm me ndryshime në strukturën organizative të forcave të armatosura. Jo rallë kemi kaluar brenda një periudhe të shkurtër nga një strukturë në tjetrën, vetëm dhe vetëm pse janë fajësuar strukturat në vend të njerëzve që i kanë drejtuar ato. Nga ky realitet, personeli i njësive të FA është ndjerë nën presionin e këtyre "reformave", gjë që nuk mund të themi se nuk ka ndikuar në uljen relative të moralit dhe të performancës së tyre.

Kjo gjë këtej e tutje nuk duhet të ndodhë më. Futja e metodës së Rishikimit periodik të Mbrojtjes duhet ti japë fund amatorizmit dhe subjektivizmit të reformave. Kjo do të thotë se ka ardhur koha që ne të institucionalizojmë me ligj Rishikimin Strategjik të Mbrojtjes. Kjo mund të reflektohet tek Ligji i autoriteteve të Komandimit dhe Drejtimit Strategjik të Forcave të Armatosura, i cili është në proces rishikimi.

Eksperienca jonë e RSM. Ku proces nuk është i pari në RSH dhe në Forcat e Armatosura; ai është kryer të paktën dy herë me nivelet më të mira të ekspertizës së përbashkët shqiptaro-amerikane: në vitin 2001-2002 dhe në vitin 2006-2007. Pra, pavarësisht se nuk ka qenë i institucionalizuar, ky do të jetë Rishikimi i tretë Strategjik në RSH dhe në Forcat e Armatosura.

Rishikimi i parë Strategjik i Mbrojtjes 2001-2002, u krye në bashkëpunim me kompaninë amerikane SAIC (Science Application International Corporation) & CUBIC. Gjetjet e këtij rishikimi u pasqyruan në dy volume. Ky rishikim rezultoi me një strukturë të Forcës Objektive dhe të një Plani Afatgjatë të Zbatimit 2002-2010 për zbatimin e saj. Padyshim ky është Rishikimi më i thellë i Mbrojtjes në FASH, i cili u pasua me reforma të thella jo vetëm në strukturën e tyre. Vlen për tu përmendur që në këtë Rishikim të Mbrojtjes u punua për gati 1,5 vjet nga një ekip drejtues shqiptaro-amerikan dhe 8 ekipe të përbashkëta ekspertësh në fusha të ndryshme, me rreth 50 vetë gjithsej. Po ashtu, nga të dhënat paraprake, gjatë procesit u angazhuan edhe mbi 200 vetë të tjerë, personel ushtarak dhe civil, brenda dhe jashtë forcave të armatosura, si dhe u bënë një numër i konsiderueshëm takimesh në ministritë e ndryshme me peshë në RSM.

Rishikimi i dytë Strategjik i Mbrojtjes 2006, u zhvillua si një Vlerësim i Mbrojtjes së FASH në koordinim me DFI & ALION, të financuar nga zyra e Sekretarit të Mbrojtjes së SHBA. Pothuaj, paralelisht me këtë vlerësim u krye edhe një Vlerësim i Mbrojtjes i kryer nga Komanda e NATO-s për Transformimin (ACT). Të dy këta vlerësime kishin shumë gjera të përbashkëta, por edhe disa përjasje të ndryshme, që nuk janë objekt i këtij shkrimi.

Edhe këto Vlerësime të Mbrojtjes kishin vlerat e tyre të cilat u shprehën në reforma sektoriale të çështjeve të mbrojtjes.

Sa më sipër, mendoj se mund të shërbejë si bazë mirë startimi për Rishikimin e Mbrojtjes 2011-2012 të vendit tonë. Po ashtu, disa persona të spikatur që u aktivizuan në Rishikimet e kaluara mund të aktivizohen me kohë të pjesshme. Metoda e përdorur mund të avancohet, procesi mund të përmirësohet, mësimet e nxjerra mund të reflektohen. Kemi disa volume me mbi 1200 faqe të shkruara mbi Rishikimet e mëparshme të Mbrojtjes. Pra, kemi se çfarë të mësojmë nga ajo që kemi bërë.

4. Çfarë duhet të synojë RSM - 2011 në RSH

Shqipëria është tashmë një vend anëtar i Aleancës. Ajo ka aplikuar dhe po ndjek gjithashtu etapat për të qenë anëtare e BE-së. Si pjesë e këtyre organizatave, ajo merr përfitimet dhe vë në dispozicion kontributet që i takojnë, bazuar në "... *ndarjen e roleve, peshës dhe të përgjegjësisë* ..." ⁶. Atributet si vendet anëtar i Aleancës i japin Shqipërisë mundësinë të rishikojë kapacitetet ushtarake të saj, duke pasur parasysh angazhimin në mbrojtjen kolektive dhe në emergjencat kombëtare. Po ashtu, nuk duhet të harrojmë edhe vlerësimin e kapaciteteve civile në interes të përqsjes gjithëpërfshirëse.

Niveli i Ambicjes. Normalisht, që të zhvillojmë kapacitetet e nevojshme duhet fillimisht të përcaktojmë nivelin e ambicjes kombëtare. Kush do të jetë Shqipëria dhe forcat e armatosura të saj, çfarë roli do të luajmë ne në axhendën e organizatave ndërkombëtare të sigurisë? Po ashtu, çfarë roli do të luajnë forcat e armatosura në spektrin emergjencave të brendshme? Si do të ndahet pesha e kapaciteteve midis institucioneve për të evituar dublikimet?

Në fakt, çështja nuk është kaq e thjeshtë: sa do të japim e sa do të marrim. Ekuacioni është me më shumë të panjohura, ashtu siç është vetë pasiguria e angazhimit në mjegullën e luftës "*fog of war*" të Klausewitzit ⁷. Kjo është pikërisht arsyeja kryesore që Shqipëria do të zhvillojë një Rishikim Strategjik të Mbrojtjes.

Ambicja jonë mund të jetë e lartë, e mesme dhe modeste; ne rekomandojmë që Shqipëria duhet të ketë një agjendë modeste dhe tepër selektive të nivelit të saj të ambicjes. Si vend i vogël dhe me burime të kufizuara, ne duhet të kemi kapacitete të justifikuara plotësisht? Ky rishikim strategjik duhet ti shpallë luftë kapaciteteve parazitare, kapaciteteve paralele, dhe kapaciteteve që u ka kaluar koha.

Pra, gjykojmë që Shqipëria nuk mund të ketë kapacitete kombëtare të veçanta për jashtë vendit, dhe kapacitete të tjera për brenda vendit. Po ashtu, ne nuk mund të kemi kapacitete të veçanta për NATO-n, dhe kapacitete të tjera për BE-në, OKB-në, apo koalicionet e ardhshme. Rekomandojmë që, në kuadrin e nivelit të ambicjes kombëtare, ky RSM të promovojë konceptin e zhvillimit të një "*grupimi të vetëm forcash - single set of forces*" për operacione kombëtare dhe ndërkombëtare, me kapacitete civile dhe ushtarake.

Disa Specifika të RSM 2011. Mbi bazën e eksperiencës kombëtare dhe ndërkombëtare

⁶ *Koncepti Strategjik i Aleancës, Lisbon 2010*

⁷ *Karl Von Klausewitz, On War, Michael Howard and Peter Paret, Oxford 2006 Edition.*

të trajtuar më sipër, po japim në vijim disa nga specifikat, synimet dhe objektivat e këtij Rishikimi Strategjik të Mbrojtjes 2011.

Nga një vështrim nga brenda FA, lind natyrshëm pyetja: Çfarë synojnë të bëjnë me këtë Rishikim të Mbrojtjes? Çfarë mund të ndryshojmë më tej në këtë forcë kaq të vogël prej jo më shumë se 12 mijë vetë forcë aktive? Ku do të shkojmë më tej? Çfarë mbetet realisht për të ndryshuar?

Ndërsa nga një vështrim nga jashtë FA, pyetja mund të artikulohet ndryshe: Shqipëria tani është anëtare e NATO-s, synon BE-në, dhe si e tillë, një forcë 12 mijë vetëshe është shumë. Kemi prioritete të tjera deri sa nuk kemi kërcënime imediate ndaj sigurisë së vendit. A nuk shpenzojmë shumë për mbrojtjen kur justifikohet pak?

Këto pyetje janë të natyrshme dhe duhet të mirëkuptohen nga këndvështrimi dhe sensibilizimi i njëanshëm që ato paraqesin. Një gjë është e sigurt: forcat e armatosura të çdo vendi i nënshtrohen kontrollin civil të autoriteteve të ligjshme, dhe vullnetit të taksapaguesve shqiptarë. Pra, sasia e tyre, misioni, burimet financiare, kuadri ligjor dhe politikat e zhvillimit, etj, nuk janë atribut i ushtarakëve, por i ligjvënësve civilë.

Nga ana tjetër nuk duhet paragjykuar qysh tani që forca e ardhshme do të jetë më e vogël. Paragjykimi do të ishte absurd dhe mund të çojë në përjasje të influencuar. Përcaktimi “*how much is enough*”⁸ duhet patjetër të kryhet nga ky Rishikim Strategjik, i cili duhet të përfshijë të gjithë pikëpamjet e aktorëve të interesuar. Grupi permanent i punës duhet të jetë i vogël, por duhet të përfshijë të gjithë aktorët me peshë në këtë proces. Aktivizimi i aktorëve të tjerë, sidomos i atyre jashtë institucioneve shtetërore, mund të bëhet në forma të tjera.

Specifika jonë duhet të jetë reforma për zhvillimin e një forcë të vogël profesioniste, të motivuar, të mirë-trajnuar, të pajisur, të ndërveprueshme, dhe të aftë për të përmbushur me profesionizëm të lartë detyrat e misionit kushtetues sipas setit të skenarëve të parashikuar brenda dhe jashtë vendit.

Elementët e RSM-2011. Rishikimi Strategjik i RSH duhet të vlerësojë më prioritet zhvillimin e kapaciteteve specifike të FA në planin afatgjatë. Jo patjetër procesi i RSM-2011 i RSH duhet të trajtojë të gjitha çështjet që trajton në mënyrë klasike një Rishikim Strategjik, apo ato që trajton, le të themi QDR 2010 i SHBA, apo SDDR i Anglisë, të cilët i kushtojnë vëmendje prioritare kapaciteteve bërthamore, mbrojtjes raketore, nën-ujore, mbi-ujore, të hapësirës satelitore, të goditjes strategjike globale, atyre cyber, etj, që nuk kanë relacion me rastin tonë.

Dy elementë kryesorë nuk duhet të harrojmë kur të fillojmë procesin e RSM: *e para*, duhet të shfrytëzojmë eksperiencën e metodologjisë të përdorur nga RSM-të e mëparshme ndërkombëtare dhe kombëtare, *dhe e dyta*, duhet të përcaktojmë që në fillim të procesit, çështjet themelore të RSM-2011 që janë specifike për realitetin shqiptar.

Duke mos pretenduar se kemi ezauruar gjithçka, mund të shprehim se disa nga pyetjet kryesore që do të kërkojnë përgjigje analitike në RSM-2011 të RSH mund të jenë: kush do të jetë mjedisi i ardhshëm i sigurisë në 10-20 vitet e ardhshme; si do të evulojnë

⁸ ‘Sa duhet të kemi, që të kemi aq sa duhet’ – shënim i autorit

interesat dhe objektivat kombëtarë; cili do të jetë niveli i ambicjes i RSH ne fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes; si do të evoluojë spektri i rolit, misioneve dhe detyrave të FA; cili do të jetë roli i instrumenteve të tjerë të fuqisë kombëtare; cilët do të jenë skenarët strategjikë/ situatat e planëzimit të angazhimit të FA; përmirësimi i sistemit të planifikimit të mbrojtjes dhe atij operacional si vend aleat, cilët do të jenë kapacitetet e ardhshme ushtarake dhe civile; resurset e ardhshme kryesisht financiare ne dispozicion; reformat e menaxhimit të mbrojtjes; marrëdhëniet bilaterale, rajonale dhe aleancat; reforma e sistemit të trajnimit dhe arsimimit; reforma e menaxhimit të burimeve të mbrojtjes, njerëzore, materiale dhe financiare; modernizimi i FA; kërkimi dhe zhvillimi në FA; struktura e ardhshme e FA; reforma e komandim-kontrollit të FA; reforma për konsolidimin e Ministrisë së Integruar të mbrojtjes, etj.

Sa më sipër, një nga reformat që duhet të promovojë RSM-ja jonë duhet të jete reforma e sistemit të planifikimit të mbrojtjes së Republikës së Shqipërisë. Akoma sistemi i planifikimit të mbrojtjes është i mbarur me disa elementë të kohës kur vendi ynë ishte vend partner dhe aspirant. Ky RSM duhet të analizojë elementët kryesore të aktualizimit të planifikimit të mbrojtjes së RSH si vend aleat, duke harmonizuar planifikimin e mbrojtjes kombëtare me planifikimin e mbrojtjes kolektive, në kohë, dokumente, procese, metodologji, kapacitete dhe produktet përkatëse.

Një drejtim tjetër i reformave është ajo e skenarëve/ situatave të planëzimit të operacioneve të forcave të armatosura; kombëtare dhe ndërkombëtare, RSM duhet të japë një panoramë të plotë të spektrit të operacioneve që do të angazhohen forcat e armatosura deri në vitin 2020 ose 2030. Ajo duhet të bazohet në 3 tipet e misioneve të NATO-s, në 17 llojet e detyrave, dhe 39 skenarët/ situatat e planëzimit. Natyrisht, ne nuk do të marrim pjesë në të gjithë këtë spektër, por duhet të përzgjedhim spektrin tonë të skenarëve me koeficientët përkatës të intensitetit të veprimeve luftarake. Kjo do të shërbejë për të ndërtuar kapacitetet tona të nevojshme.

RSM duhet ti përgjigjet pyetjes nëse forca e ardhshme do të vazhdojë të jetë një forcë tradicionale apo një forcë modulare me kapacitete të vogla dhe të afta për të vepruar në mjedisin e ardhshëm të sigurisë. Sipas parashikimeve, e ardhmja e operacioneve të FA do të jetë veprimi i tyre në formatin 'task force' modulare të vogla të nivelit kompani deri në batalion, maksimumi deri në grup-batalion. Kjo tregon që struktura tradicionale në një forcë të vogël nuk do të jetë më e përshtatshme, përveç se honorifike, përfaqësuese, dublikuese, dhe shpesh here penguese. Reforma e reduktimit të shtabeve dhe e forcimit të kapaciteteve, mund të jetë një nga elementët e Rishikimit të Mbrojtjes

Po ashtu, një drejtim tjetër i rishikimit mund të jetë zhvillimi i konceptit të kapaciteteve kombëtare në vend të kapaciteteve paralele të disa institucioneve shtetërore në tokë, ajër dhe det. Në disa aspekte ka progres, por akoma ka edhe palosje dhe dublikime të kapaciteteve të institucioneve shtetërore të disa ministrive. Ky RSM duhet ti japë mesazhe të forta për kapacitete sipas misionit. Pra nevojitet më shumë bashkëpunim ndër-institucional për zhvillimin e kapaciteteve kombëtare, të koordinuar nga niveli qeveritar. Prandaj, do të ishte më mirë që procesi të mos ishte vetëm Rishikim Strategjik i Mbrojtjes (RSM), por një Rishikim Strategjik i Sigurisë dhe Mbrojtjes (RSSM).

Një vëmendje prioritare RSM-ja duhet ti kushtojë zhvillimit të kapaciteteve cilësore për të gjithë spektrin e Emergjencave Civile kombëtare. Imazhi publik por edhe justifikimi i

forcave të armatosura rritet ndjeshëm kur ato i shërbejnë komunitetit. RSM duhet të mbështesë konceptin e sotëm të reformës në sistemin e sigurisë, që i përcakton forcat e armatosura, dhe të gjitha instrumentet e tjerë të sigurisë, si shërbime publike, si të gjitha shërbimet e tjera.

Krahas misioneve kombëtare, RSM-ja duhet të vlerësojë zhvillimin e kapaciteteve në zbatim të Objektivave të Forcës (FG) ushtarake dhe civile në planin afatgjatë; kryesisht të Grup-Batalionit. Konsolidimi i kompletimit, pajisjes, stërvitjes, mbështetjes, doktrinës së përdorimit, të drejtimit të kësaj njësie 'task force' do të kërkojë kohë dhe përpjekje shumë vjeçare. Po ashtu, përdorimi i grup-batalionit apo i çdo 'task force' në operacione ndërkombëtare do të kërkojë kapacitete mbështetëse cilësore të atyre që quhen 'enabling capabilities'⁹, si ato të NNEC-ut, të SATCOM-it, të mbrojtjes së forcës, të ISTAR-it, të CIMIC-ut, të C-IED-së, të NSE, etj, për një dislokueshmëri në nivel 10 me 50% të kapaciteteve tokësore etj.

Në zhvillimin e kapaciteteve, RSM-ja mund të orientojë përjasje të reja që sugjerohen edhe nga Koncepti Strategjik i Aleancës, ku në mënyrë të veçantë vlerësojmë ndërtimin e kapaciteteve rajonale, në mënyrë të veçantë me Republikën e Kosovës. Po ashtu, zhvillimi i një koncepti për kapacitetet 'niche' të forcave të armatosura është akoma një fushë që duhet të eksplorohej më thellë.

Përveçse sa më sipër, RSM duhet të promovojë nevojën për ndryshime ligjore në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Një pjesë e ligjeve të paketës ligjore të mbrojtjes i përgjigjet situatave të tejkaluara. Pra, RSM duhet të parashikojë ndryshime apo mendime ligjore e nën-ligjore në kohën e përshtatshme, në interes të reformave që mund të gjenerohen në të ardhmen.

Çështje të tjera mund të përfshijnë konsolidimin e forcës profesionale si dhe vlerësimin e zhvillimit afatgjatë të një komponenti rezervë vullnetar të Forcave të Armatosura. Po ashtu, një rishikim i infrastrukturave të FA është e nevojshme të jetë një nga elementet e RSM. Nuk mund të përjashtohet konsolidimi i proceseve të blerjeve të pajisjeve dhe sistemeve madhore të FA, të cilat duhet të afrohen në nivelin e rreth 20% të buxhetit të mbrojtjes.

Sistemi i trajnimit, arsimimit, stërvitjeve dhe vlerësimit (Creval, Taceval, Mareval) duhet të jetë pjesë e RSM-së, për t'ju përshtatur spektrit të operacioneve të skenarëve të ardhshme. Reforma doktrinale, standardizimi dhe mësimet e nxjerra duhet të kthehen në procese institucionale në FA. RSM-ja duhet të zhvillimin e një force të bazuar mbi dijen dhe përmirësimin e vazhdueshëm të vetvetes.

5. Rekomandime paraprake për RSM – 2011 në RSH

Procesi i RSM-së është një proces kompleks dhe i vështirë. RSM është një dokument i nivelit strategjik, por ai përcjell efekte të thella në nivelin operacional dhe në atë taktik. Ai sjell reforma dhe transformime të thella në mënyrën se si do të drejtojmë, si do të menaxhojmë, si do të planifikojmë, si do të trajnohem, si do të luftojmë, si do të shpenzojmë, si do të koordinojmë, etj. Prandaj, në mënyrë që procesi RSM të bëhet më i kuptueshëm nga të gjithë, në fazat e formulimit dhe të zbatimit, rekomandojmë disa çështje orientuese:

⁹ 'Kapaciteteve mbështetëse' – shënim i autorit

- Të përcaktohet në kohën e duhur kush do të jetë institucioni apo autoriteti që do ta miratojë këtë dokument pas formulimit të tij, dhe si do të vijojë puna më tej për zbatimin e tij;
- Të drejtohet i gjithë procesi i RSM-së nga një autoritet i lartë politik, për të treguar vullnetin politik për përpjekje të tilla, pa ndikuar në gjetjet fundore të rishikimit;
- Të sqarohet që në fillim lidhja midis Rishikimit Strategjik të Mbrojtjes dhe dokumenteve të tjerë në hierarkinë e dokumenteve të sigurisë kombëtare, si SSK, SU, etj;
- Të caktohen kriteret dhe njësitet matëse të suksesit për çdo masë të Planin e Rishikimit Strategjik që do të zbatohen nga autoritetet përgjegjëse;
- Të përgatitet Shtabi i Përgjithshëm që, pas Rishikimi Strategjik të Mbrojtjes, të zhvillojë një Plan Veprimi Afatgjatë 2020 për zbatimin e gjetjeve të tij?
- Të sigurohen të dhëna të përafërta financiare nga Ministria e Financave për mbështetjen e planeve të transformimit të mbrojtjes në periudhën 2012-2020;
- Përtej MM dhe SHP, pra përveç ushtarakëve, duhet të përfshihen në proces edhe ekspertë të lartë të fushave si diplomatë, financiarë, analistë strategjik, jurist, menaxherë; etj.
- Të përfshihen në procesin e RSM të gjitha institucionet e arsimit dhe të kërkimit në forcat e armatosura, në veçanti institucionet e KDS;
- Të përcaktohet roli i drejtorive të MM/ SHP, dhe i Komandave kryesore, gjatë gjithë procesit, nëpërmjet aktivizimit të një Sekretarie të Grupit Drejtues të RSM;
- Të mbahet transparencë dhe besueshmëri për procesin, të informohet në vijimësi personeli i FA dhe opinioni publik nëpërmjet shtypit të shkruar dhe atij elektronik;
- Të evitohet politizimi i RSM-së, si dhe të arrihet konsensusi mbi bazën e mendimit të pavarur të grupit të eksperteve.
- Të vlerësohet reforma e menaxhimit të resurseve si një nga pikat kritike të RSM-së: si të ndërtojmë më shumë kapacitete me më pak resurse nën konceptin 'smart defence';

Këtij Rishikimi Strategjik të Mbrojtjes do ti kushtohet një Rubrikë e veçantë në edicionin e ardhshëm të muajit shtator të Revistës Ushtarake. Jeni të mirëpritur të kontribuoni me shkrimet tuaja.

Referencat:

1. Rishikimi i Mbrojtjes, Albania 2002, Volumi i Parë
2. Vleresimi i Mbrojtjes, Albania 2006, DFI & Alion
3. ACT Assessment Report, Albania 2006
4. US Quadrennial Defence Review 2010, US QDR-2010,
5. UK Strategic Security and Defence Review, SSSDR - 2010.
6. Polish Strategic Defence Review, April 2011.
7. Livre Blanc sur la Defence, France 2010
8. Bundeswehr Defence Policy. 2009
9. "Danish Defence Agreement" të Danimarkës
10. Slovenian Defence Review 2004
11. Croatian Defence Review 2004
12. Bulgarian White Paper on Defence, 200

Politika e re e NATO-s për Mësimet e Nxjerra

Nënkolonel Fatmir Lokaj
Shef i Degës së KO&MN, QAM
Nënkolonel Arben Cenolli
Oficer Shtabi për MN, QAM

Abstrakt: *Mësimet e Nxjerra (MN) nga operacionet apo stërvitjet e ndryshme që zhvillohen në NATO, kanë implikime në mënyrën se si zhvillohen operacionet aktuale, planëzimin e operacioneve të ardhshme, si dhe për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes. Me qëllim që të sigurohet implementimi efektiv i MN-ve është e nevojshëm e prania e lidërshiptit më të lartë në të gjitha nivelet. Inicimi dhe zbatimi i një procesi të Mësimeve të Nxjerra është një përgjegjësi e Komandës ose të niveleve më të larta të Menaxhimit.*

Pas miratimit të Strategjisë së Re, në kuadër të rishikimit të të gjithë politikave të saj, NATO rishikoj dhe miratoj edhe një politikë të re për MN. Objektivat e kësaj politike të Mësimeve të Nxjerra të NATO-s janë që të përmirësohet efektiviteti i konsultimeve dhe vendimmarrjes politiko – ushtarake, për të mundësuar zhvillimin tërësor të koncepteve dhe doktrinës, si dhe për të kontribuar në planëzimin dhe kryerjen e operacioneve koherente, duke mundësuar adoptimin/mishërimin e shpejtë të Mësimeve të Nxjerra në mënyrë simultane edhe gjatë periudhës së zhvillimit të operacioneve. Nga ana tjetër çdo komandë dhe strukturë duhet të ketë procedurat e brendshme të mësimeve të tyre të nxjerra për të përmirësuar kryerjen e aktivitetit të tyre.

Në Maj 2011, nisur nga kompleksiteti i ambientit të sotëm të sigurisë që po ndryshon me shpejtësi, aftësia për të identifikuar dhe implementuar në mënyrë të shpejtë të gjitha arritjet dhe përmirësimet e mundshme, NATO miratoi politikën e re për Mësimet e Nxjerra. Kjo politikë merr një rëndësi të jashtëzakonshme dhe padyshim do të ndikojë dhe do të japë efekte pozitive në rritjen e kapaciteteve të Aleancës për të realizuar gjithë spektrin e misionëve të saj. Mësimet e Nxjerra nga aktivitetet e NATO-s, përveç atyre të operacioneve dhe stërvitjeve të ndryshme, janë pjesë e një procedure *identifikimi, përshtatjeje dhe implementimi*, e cila çon në rritje të efektivitetit, efikasitetit dhe shkëmbimit të praktikës më të mirë.

Politika e kaluar e Mësimeve të Nxjerra të NATO-s u miratua në tetor 2008 dhe fillimisht ishte krijuar paraprakisht si një mjet për të identifikuar problematikat, mësimeve të nxjerra dhe nevojën për ndryshim në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Sipas kësaj politike dhe direktivës Bi-SC 80-6, gjatë procesit të implementimit, sistemi i MN nuk u shtri deri

në strategjinë e lartë dhe nivelin politiko-ushtarak të NATO-s që t'iu mundësonte vendeve anëtare që të shkëmbenin MN individuale ndërmjet njëri-tjetrit. Ashtu siç është vërejtur se ekziston edhe një natyrë e mundshme të MN-ve, të cilat nuk janë thjesht ushtarake, por që janë politiko-ushtarake.

Me synimin që politika e re e NATO-s për MN të jetë më shumë e hapur sesa përcaktohet në direktivën Bi-SC 80-6 dhe me qëllimin që Mësimet e Nxjerra të jenë një produkt që kanë fushë aplikimi më të gjerë se thjesht shtabet e NATO-s, politika e re e MN synon përfshirjen gjerësisht në NATO edhe të kësaj game të re, të fushës politiko-ushtarake, e cila do të detajohet më tej nëpërmjet direktivave të veçanta për çdo nivel, si dhe të përfshijë edhe integrimin e MN-ve të çdo vendi anëtar të Aleancës.

MN nga operacionet apo stërvitjet e ndryshme që zhvillohen në NATO kanë implikime në mënyrën se si zhvillohen operacionet aktuale, planëzimin e operacioneve të ardhshme si dhe për zhvillimin e kapaciteteve të mbrojtjes.

Procesi i Mësimeve të Nxjerra është një komponent i rëndësishëm i një kulture organizative dhe një doktrine operacionale që synon zhvillimin dhe përmirësimin e saj të vazhdueshëm. Krijimi dhe zhvillimi i një kapaciteti efektiv të Mësimeve të Nxjerra në NATO dhe mjeteve të nevojshme për të implementuar ndryshimet e vërejtura është një tregues i qartë i gatishmërisë së Aleancës për t'u adaptuar, zhvilluar dhe transformuar. Në mënyrë që procesi i MN-ve të jetë efektiv, është e nevojshme që të mbizotërojë një kulturë që eviton "*përcaktimin e fajtorit*". Politika e re e MN-ve tërheq vëmendjen e drejtuesve më të lartë që të mundësohet një implementim i shpejtë dhe drejtpërdrejtë i MN-ve.

Objektivat e kësaj politike të MN-ve të NATO-s janë që të përmirësohet efektiviteti i konsultimeve dhe vendimmarrjes politiko-ushtarake, për të mundësuar zhvillimin tërësor të koncepteve dhe doktrinës dhe për të kontribuar në planëzimin dhe kryerjen e operacioneve koherente, duke mundësuar adoptimin/mishërimin e shpejtë të Mësimeve të Nxjerra në mënyrë simultane edhe gjatë periudhës së zhvillimit të operacioneve. Për më tej, ajo synon të përmirësojë sistemin e Arsimimit, Përgatitjes, Stërvitjes dhe Vlerësimit (Education, Training, Exercise and Evaluation-ETEE) dhe eksperimentimit si dhe praktikën administruese që përfshijnë menaxhimin e burimeve të mbrojtjes dhe diplomacinë publike duke mbështetur kësaj transformimin e vazhdueshëm të Aleancës.

Kjo politikë synon që sistemi i MN-ve të përfshihet tërësisht edhe në fushat e zhvillimit të kapaciteteve të mbrojtjes dhe planifikimit të saj si dhe për të vendosur parimet kryesore të përqasjes tërësore të Aleancës karshi Mësimeve të Nxjerra për të siguruar transparencën dhe një kuptim të plotë të synimit të saj.

Politika e re e NATO-s përfshin gjithë spektrin e aktorëve të Aleancës duke synuar përfshirjen e sistemit e procesit të MN në të gjithë organizmat, agjencitë dhe shtabet e NATO-s, gjithë vendet anëtare dhe jo anëtare që marrin pjesë në aktivitetet e NATO-s. Shkëmbimi i praktikave më të mira dhe Mësimeve të Nxjerra me organizatat e tjera ndërkombëtare mbi operacionet, trajnimin dhe stërvitjen duke përfshirë edhe standardet e ndërveprueshmërisë, brenda udhëzimeve të miratuara nga Këshilli i Atlantikut Verior (NAC) bazohet mbi parimin e reciprocitetit. Duke qenë se, nga ana tjetër, për shkak të natyrës së veçantë, disa nga Mësimet e Nxjerra mund të jenë dhe/ose përmbajnë shumë informacione sensitive. Kjo nuk mundëson shkëmbimin e tyre me gjithë vendet dhe/ose organizmat e

tjerë ndërkombëtarë jashtë NATO-s. Në të gjitha rastet nxjerrja/dhënia e praktikave më të mira dhe Mësimeve të Nxjerra të NATO-s vendeve jo anëtare të Aleancës, që kontribuojnë në operacionet e udhëhequra nga kjo e fundit dhe organizatave, duhet bërë në përputhje me rregullat e NATO-s për sigurinë dhe duke reflektuar marrëveshjet e përbashkëta të Aleancës.

Qendrat e Ekselencës (Qendrat Studimore) të NATO-s gjithashtu kanë potencialin që të përfshihen në procesin e MN-ve duke ndërmarrë projekte analizimi në interes të Aleancës.

Politika e Mësimeve të Nxjerra të NATO-s kërkon fokus dhe progres përgjatë gjashtë linjave të zhvillimit të tyre **të cilat përbëjnë dhe normëzojnë kapacitetin e mësimeve të nxjerra të një vendi/organizate:**

- **Mendësia**-NATO promovon një kulturë të të mësuarit dhe demonstroi një mendësi ku i gjithë personeli i saj kupton vlerën e Mësimeve të Nxjerra;
- **Procesi**-Përgjegjshmëria siguron zbatimin efektiv dhe eficient të të gjithë procesit të Mësimeve të Nxjerra të NATO-s;
- **Personeli dhe Trajnimi**-Oficerët e shtabit dhe analistët në të gjitha nivelet duhet të jenë të pajisur me, ose t'u mundësohet aksesit për njohuritë, aftësitë dhe mundësitë e duhura në mënyrë që të jenë të aftë që në mënyrë të suksesshme të kryejnë proceset e mësimeve të nxjerra në fushën respektive të ekspertizës dhe kompetencës së tyre;
- **Teknologjia**-Teknologjia dhe mjetet të optimizuara kërkohen për të mbështetur aktivitetet e Mësimeve të Nxjerra;
- **Standardet**-Standardet krijohen dhe mbahen për të implementuar dhe zbatuar Mësimet e Nxjerra;
- **Shpërndarja dhe Publikimi**-Mësimet e Nxjerra duhet të shkëmbehen lehtësisht dhe të njihen nga të gjitha organizmat, strukturat dhe personeli i tyre.

Procesi i zgjeruar i MN-ve në NATO

Një proces i Mësimeve të Nxjerra është një procedurë për përpunimin e vëzhgimeve nga një aktivitet i kryer dhe pas zhvillimit të analizës dhe vlerësimit të implementimit të veprimeve e masave korrigjuese, shndërrimin e tyre në MN. Procesi i Mësimeve të Nxjerra kombinon dy faza të cilat, nga ana e tyre, përfshijnë një numër hapash të provuara tashmë nga NATO dhe organizata të tjera. Modeli i kësaj përjasjeje jepet si më poshtë:

Faza I: **Analizimi**

- a. **Vëzhgimi:** Një vëzhgim i ndjekur nga një kërkesë për analizë nxit procesin e Mësimeve të Nxjerra.
- b. **Analiza:** Një kuptim i mundësive për përmirësim është zhvilluar përmes mbledhjes dhe analizimit të të dhënave. Veprimet korrigjuese rekomandohen për të të çuar/udhëhequr në nxjerrjen e Mësimeve të Identifikuara.
- c. **Rezultati:** Mësimi i Identifikuar-Një observim për të cilin një veprim korrigjues duhet ndërmarrë dhe është propozuar një strukturë zbatuese për kryerjen e këtij veprimi.

Faza II: **Veprimet Korrigjuese**

- a. Miratimi dhe dhënia e detyrës**-Mësimi i Identifikuar miratohet në nivelin e caktuar. Një strukturë zbatuese identifikohet dhe caktohet për të zhvilluar një plan veprimi dhe ndërmarrë kësajsoj përgjegjësinë për implementimin e saj.
- b. Implementimi dhe monitorimi**-Struktura zbatuese ndërmerr veprimet korrigjuese duke u monitoruar nga autoriteti përkatës/urdhërues.
- c. Vlerësimi**-Vlerësimi mund të jetë i nevojshëm për të përcaktuar nëse çështja/problemi original është rregulluar nga veprimet korrigjuese.
- d. Rezultati:** Mësimi i Nxjerrë-Një mësim i nxjerrë rezulton nga implementimi i një veprimi korrigjues që prodhon/jep një performancë të përmirësuar ose një kapacitet më të rritur. Një Mësim i Identifikuar, sapo zyrtarisht ndryshon në Mësim të Nxjerrë, regjistrohet në Database - in e Mësimeve të Nxjerra të NATO-s. Kur një Mësim i Nxjerrë adoptohet, ai shndërrohet në praktikë standarde.

Kjo përjasje është udhëzuese për gjithë Komandat dhe organizmat e NATO-s se si duhet të adresojnë çështjet, adoptojnë praktikat dhe të ndërmarrin përmirësimet e nevojshme.

Shpërndarja e Mësimeve të Nxjerra duhet të kryhet menjëherë sapo ka përfunduar vlerësimi i Veprimeve Korrigjuese, megjithatë pavarësisht këtij parimi të kryerjes së këtij procesi në dy faza, mësimet kritike në kohë dhe për mbarëvajtjen e operacionit duhet të shkëmbehen nëpërmjet një procesi më të shkurtuar të MN-ve.

Me qëllim që të sigurohet implementimi efektiv i MN-ve është i nevojshëm dhe i domosdoshëm prania e lidershit më të lartë në të gjitha nivelet. Inicimi dhe zbatimi i një procesi të Mësimeve të Nxjerra është një përgjegjësi e Komandës ose të nivele më të larta të Menaxhimit. Çdo komandë dhe strukturë e NATO-s kryen pjesën e saj në procesin e Mësimeve të Nxjerra me qëllim përmirësimin e praktikave më të mira të NATO-s. Nga ana tjetër çdo komandë dhe strukturë duhet të ketë procedurat e brendshme të mësimeve të tyre të nxjerra për të përmirësuar kryerjen e aktivitetit të tyre.

Komanda e Transformimit të Aleancës (Allied Command Transformation ACT) udhëheq procesin e Mësimeve të Nxjerra kur ka të bëjë me ato mësime që i adresohen dhe zgjidhen në nivelin e Komandave Strategjike dhe më poshtë, ajo mbështetet nga Komanda e Operacioneve të Aleancës (Allied Command Operations ACO) në planëzimin dhe kryerjen e kësaj detyre.

Qendra e Bashkuar e Analizave dhe MN-ve (JALLC) **është pjesë e strukturës komanduese** të NATO-s dhe varet nga ACT.

Komanda e Operacioneve të Aleancës udhëheq produktin e përgjithshëm të procesit të Mësimeve të Nxjerra të NATO-s për planëzimin dhe kryerjen e operacioneve dhe stërvitjeve ushtarake. Kjo komandë është mundësuesi/furnizuesi kryesor i Mësimeve të Nxjerra nga operacionet e, për rrjedhojë, ajo është një kontribuues kyç i Database-it të Mësimeve të Nxjerra të NATO-s. Në analizimin, planëzimin dhe kryerjen e kësaj detyre ACO mbështetet si nga ACT ashtu edhe nga JALLC.

Në fushën e zhvillimit të kapaciteteve të mbrojtjes mënyra më e mirë për të implementuar procesin e MN-ve është përmes Procesit të Planifikimit të Mbrojtjes të NATO-s i cili do

të sigurojë që MI njihen dhe përfshihen në mënyrën e duhur në aktivitetet planëzuese të këtij procesi.

Përfundime/Rekomandime

Nëpërmjet implementimit të kësaj politike të re të NATO-s për MN edhe në strukturat e FARSH përmirësohet efektiviteti i konsultimeve dhe vendimmarrjes politiko-ushtarake, duke mundësuar zhvillimin tërësor të koncepteve dhe doktrinës dhe kontribuar në planëzimin dhe kryerjen e operacioneve koherente, duke mundësuar adoptimin/mishërimin e shpejtë të Mësimeve të Nxjerra në mënyrë simultane edhe gjatë periudhës së zhvillimit të operacioneve. Gjithashtu, përmirësohet sistemi i Arsimimit, Përgatitjes, Stërvitjes dhe Vlerësimit, tregues ky pse rekomandohet që funksioni/struktura e Mësimeve të Nxjerra duhet të përfshihet/mishërohet në strukturat J3/G3/A3/N3 dhe S3.

Sistemi i MN duhet kuptuar dhe përdorur si një instrument shumë i rëndësishëm në duart e çdo komandanti, drejtuesi apo lideri ushtarak e civil, për të mësuar nga sukseset dhe gabimet e veta dhe të tjerëve gjatë kryerjes së operacioneve ushtarake, stërvitjeve të ndryshme, apo në tërësi, të procesit të reformës dhe transformimit të FARSH-it.

Zhvillimi i FA, rritja e kërkesave tona dhe obligimet që duhet të plotësojmë në kuadrin e integritetit të plotë në NATO, diktojnë që të konsolidojmë dhe të rrisim më tej efikasitetin e Sistemit të Mësimeve të Nxjerra, institucionalizimin e plotë të këtij sistemi në të gjitha strukturat e Forcave të Armatosura.

Sistemi i Mësimeve të Nxjerra në strukturat tona ushtarake është ngritur dhe cikli i funksionimit të tij në një stërvitje apo mision është mbyllur. Tani duhet që t'i japim më tepër nxitje, më tepër saktësi, shpejtësi, realizëm, objektivitet, vlerësim, gjykim për ta perfeksionuar, institucionalizuar e konsoliduar më tej dhe për të rritur cilësinë e produkteve që sistemi i Mësimeve të Nxjerra do të prodhojë në shërbim të zhvillimit të Forcave të Armatosura.

Përvoja dhe eksperiencia e fituar deri tani në zbatimin e sistemit të MN, tregon se ky sistem mund dhe duhet të bëhet plotësisht funksional, pasi ka vlera përdorimi e aplikimi jo vetëm në rang FA dhe jo vetëm për rritjen e kapaciteteve operacionale të reparteve e nënreparteve ushtarake.

Duke qenë se Politika e re e NATO-s për MN synon edhe zgjerimin e gamës së tyre në nivelin Politiko-Ushtarak, përfshirjen/implikimin e tyre në zhvillimin e kapaciteteve mbrojtëse dhe proceset e planifikimit të mbrojtjes, duhet rishikuar konfigurimi i sistemit të MN-ve, si dhe rishikuar/hartuar direktiva e MM, udhëzimet e SHSHPFA, si dhe manuali i MN-ve dhe udhëzimet përkatëse për këtë qëllim.

Kësisoj procesi i Mësimeve të Identifikuara dhe të Nxjerra duhet të jetë pjesë integrale e gjithë strukturave të Forcave të Armatosura, duke u sanksionuar si funksion/strukturë minimalisht nga nivel batalioni dhe më lart, kryesisht në fushën e operacioneve dhe të stërvitjes.

Gjithashtu strukturat ushtarake që implementojnë Mësimet e Nxjerra në përputhje me politikën e re të NATO-s duhet të paraqesin gjithë produktet e tyre të mësimeve të nxjerra në interes të Database-it të MN, të kërkojnë mbështetje specifike, analizimi, të mundësojnë

ekspertët e tyre të fushave të veçanta (Subject Matter Expert SME) për të mbështetur ekipet e analizave dhe të kërkojnë mbështetje për zhvillimin e kapaciteteve të Mësimeve të Nxjerra.

Implementimi i shpejtë i Database-it të MN-ve, jo vetëm të NATO-s por edhe të Forcave tona të Armatosura, do të mundësojë që veçanërisht komandantët/drejtuesit dhe planëzuesit e të gjitha strukturave ushtarake të kenë mundësi aksesit të plotë, përnjohje me to, kështu do të mund t'iu referohen atyre gjatë gjithë procesit të planëzimit dhe kryerjes së stërvitjeve dhe operacioneve ushtarake.

Për më tej implementimi i kësaj politike të re të NATO-s për MN synon që sistemi i MN-ve të përfshihet tërësisht edhe në fushat e zhvillimit të kapaciteteve të mbrojtjes dhe planifikimit të Aleancës dhe, në këtë kuadër, edhe të vendit tonë karshi Mësimeve të Nxjerra për të siguruar transparencën dhe një kuptim të plotë të synimit të saj.

Referenca:

1. Manuali i Mësimeve të Nxjerra në FARSH, Tiranë 2009.
2. NATO Lessons Learned Policy, 3rd draft MCM 0021-2011.

RUBRIKA E DYTË

ANALIZA DHE VLERËSIME TË SIGURISË DHE MBROJTJES

Kjo rubrikë tradicionale fokusohet në analiza dhe vlerësime për çështje specifike në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Autorët e saj janë analistë, studiues dhe pedagogë, të cilët japin këndvështrimet e tyre mbi aspekte të veçanta të ekspertizës së tyre.

Një nga fushat kryesore për trajtim është evoluimi i mjedisit të sigurisë. Autorët kanë shprehur mendimet e tyre për gjendjen aktuale dhe tendencat e zhvillimit të mjedisit të sigurisë kombëtare, rajonale dhe globale. Nga ana tjetër, jepen roli i komponentëve të fuqisë kombëtare në përballimin e kërcënimeve dhe rreziqeve të ardhshme tradicionale dhe jo-tradicionale të mjedisit të sigurisë.

Kjo rubrikë do të vazhdojë të mbetet një nga rubrikat qendrore të Revistës Ushtarake. Synimi i saj do të jetë të kultivojë zhvillimin e analizave, parashikimeve dhe vlerësimeve strategjike në interes të zhvillimit të kapaciteteve përkatëse, më vete dhe në kuadrin e mbrojtjes kolektive.

Bordi i Revistës Ushtarake mirëpret punimet kërkimore të autorëve dhe të ekspertëve, brenda dhe jashtë Forcave të Armatosura, të bazuara në analizë dhe rekomandime konkrete mbi aspekte të veçanta të kësaj fushe kaq të rëndësishme.

Sfidat e reformimit të Shërbimeve të Inteligjencës në demokracitë e reja

Kolonel Eduart Bala
Shef i Departamentit të Strategjisë dhe Sigurisë Kombëtare
në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt. Në këtë artikull, autori ka theksuar se cilat janë sfidat që i dalin përpara demokracive të reja në kuadër të reformimit të shërbimeve të inteligjencës si dhe të vendosjes së tyre nën kontrollin demokratik civil. Deri tani, është shkruajtur pak rreth shërbimeve të inteligjencës dhe marrëdhënieve të tyre me procesin e demokratizimit të shoqërisë. Shumica e studimeve rreth këtyre shërbimeve është prodhuar nga shoqëritë me demokraci të stabilizuara. Për këtë arsye, ky shkrim nxjerr në pah raportet e shërbimeve inteligjente me shoqërinë demokratike, nevojën e kësaj shoqërie për inteligjencën por edhe për vënien e kontrollin e saj në bazë të ligjeve. Ky punim e sheh këtë proces në kuadër të marrëdhënieve civilo-ushtarake, kryesisht për demokracitë e reja, duke nënvizuar edhe rëndësinë e inteligjencës, si profesion në këto demokraci.

Për më tepër, ky shkrim përmbledh së bashku tre probleme të cilat, zakonisht, analizohen të veçanta si: procesi i demokratizimit, marrëdhëniet civilo-ushtarake dhe studimet për shërbimet e inteligjencës.

Sfidat e konsolidimit demokratik

“Konsolidimi” është një koncept i njohur nga të gjithë në shkencat politike dhe është i vlefshëm sepse ai reflekton idenë që proceset e ndërtimit të strukturës të pushtetit të ri janë duke u bërë të qëndrueshme. Duhet thënë se një regjim demokratik është i konsoliduar atëherë kur elita e tij politike dhe masat e pranojnë atë “si e vetmja lojë në fushë” dhe mbështesin institucionet e tij.¹ Ky pranim nuk është një punë e lehtë, veçanërisht nëse ne marrim në konsideratë se çfarë karakteristikash esenciale një regjim duhet të ketë, me qëllim që të jetë demokratik. Ndërsa Filip C. Shmitër (Philippe C. Schmitter) e Teri Lin Karl (Terry Lynn Karl), me konceptin e demokracisë bashkëkohore, përcaktojnë: “Një demokraci politike moderne është një sistem qeverisjeje në të cilin sundimtarët japin llogari për veprimet e tyre tek qytetarët, duke vepruar në mënyrë jo të drejtpërdrejtë, nëpërmjet konkurrencës dhe bashkëveprimit me përfaqësuesit e tyre të zgjedhur”.²

¹ Juan J. Linz and Alfred Stepan, “Problems of Democratic Transition and Consolidation: Southern Europe, South America and Post-Communist Europe,” (Baltimore: Johns Hopkins University Press, 1993), 5-6.

² Philippe C. Schmitter and Terry Lynn Karl, “What Democracy is ... and is Not” in *The Global Resurgence of Democracy*, ed. Larry Diamond and Marc F. Plattner (Baltimore: Johns Hopkins University Press), 40.

Në demokracitë e reja, aparati i inteligjencës së regjimit të shkuar është jo shumë i gatshëm të vendoset nën kontrollin demokratik të qeverisë dhe, nga ana tjetër, ose ruan të njëjtin pushtet mbi zyrtarët civilë, ose vepron akoma në bazë të planeve të tij. Kjo duket qartë, p.sh. në Peru, nën drejtimin e Presidentit Alberto Fuxhimori (Alberto Fujimori) dhe në Afrikën e Jugut gjatë periudhës së presidencës së të Klerk (de Klerk). I parë në tërësi, ky është një problem që qëndron në shumicën e këtyre vendeve që janë në hapat e para të demokracisë.

Në qoftë se qeveritë demokratike të zgjedhura nuk i kontrollojnë strukturat e inteligjencës, do të thotë se ato nuk janë demokraci të konsoliduara sepse konsolidimi demokratik kërkon si ngritjen e shërbimeve të inteligjencës ashtu edhe kontrollin demokratik të tyre. Ligjshmëria është thelbësore në kontrollin demokratik. Në qoftë se një qeveri është e monitoruar ose e kërcënuar nga shërbimet e inteligjencës, si pasojë përfaqësuesit e zgjedhur do të dyshonin në legjitimitetin e demokracisë, kurse besimi i qytetarëve tek institucionet e demokracisë do të dëmtohej. Konsolidimi demokratik është një sfidë shumë e madhe për një demokraci të re e çdo handicap, veçanërisht mungesa e ligjshmërisë, është një pengesë e vështirë për t'u kaluar.

Shërbimet e inteligjencës dhe demokracia

Të gjitha shtetet i kanë aparatet e tyre të inteligjencës për interesat e tyre dhe me një aftësi të caktuar. Një pyetje që ngrihet për demokracitë e reja është se për çfarë lloj strukture inteligjence ato kanë nevojë dhe si mundet që ato të kontrollohen. Ndërsa sfida është veçanërisht e qartë për këto demokraci, kontrolli demokratik i inteligjencës. Ky kontroll është subjekt i një debati të gjerë së paku për katër arsye:

Së pari, siç pohon Pat Holt (Pat Holt) “Sekreti është një armik i demokracisë”³, kjo për arsye se fshehtësia nxit abuzimin. Në qoftë se ka një veprim të fshehtë, si mund të ketë dhënie llogarie për të, pra të veprojnë mekanizmi i kontrollit demokratik, veçanërisht kur të dy, si furnizuesi po ashtu edhe përdoruesi i fundit i informacionit sekret kanë përfitime reciproke nga përjashtimi i mbikëqyrjes. Për arsye se shërbimet inteligjente veprojnë në fshehtësi, ato i shmangen shumë parimit “*checks and balances*”, në të cilin demokracia është bazuar.

Së dyti, agjencitë e inteligjencës mbledhin dhe analizojnë informacione dhe informacioni do të thotë pushtet.⁴ Zyrtarë të lartë në organizatat e inteligjencës kanë mundësinë ta përdorin aksesin tek informacioni i klasifikuar, për të caktuar kërkesat dhe qëllimet, në interes të tyre, duke përfshirë edhe përfitimet e “miqve” të tyre në qeveri. Në këtë mënyrë, strukturat e inteligjencës mund të bëhen autonome nga kontrolli i shtetit nëpërmjet përdorimit të informacionit që të tjerët nuk e disponojnë, bile mund edhe të përcaktojnë politikën e shtetit.

³ Pat M. Holt, *Secret Intelligence and Public Policy. A Dilemma of Democracy* (Washington DC: CQ Press 1995), 1-3.

⁴ Robert Jervis, “Intelligence, Civil-Intelligence Relations, and Democracy” in *Reforming Intelligence: Obstacles to Democratic Control and Effectiveness*, ed. Thomas C. Bruneau and Steven C. Boraz (Austin: University of Texas Press, 2007), vii.

Së treti, shërbimet e inteligjencës, në mënyrë rutinore, thejnë ligjet e shtetit tjetër ku ata vepronë, pra spiunimi është një aktivitet ilegal kudo. Oficerët e shërbimeve të inteligjencës, rregullisht, nxjerrin fonde për të paguar në mënyrë të fshehtë: a) shtetas të huaj për të vepruar si agjentë; b) përgjojnë telefonat; c) vjedhin dokumentacion; veprime këto që janë të gjitha kundër ligjit. Në shumicën e rasteve, operativët nuk pranojnë se kush janë në realitet dhe për cilat organizata punojnë, pra qëndrojnë ilegalë. Kjo kulturë, ku këta inspektorë janë të paguar që të operojnë jashtë ligjeve dhe pa u ndëshkuar, mund krijojë problem për mosbërjen e dallimit nga thyerja e ligjit jashtë vendit me atë të thyerjes në vendin e tij.

Së katërti, oficerët e shërbimeve të inteligjencës gjithmonë pretendojnë se puna e tyre është shumë e rëndësishme për mbrojtjen e vendit. Ata lehtësisht mund të zhvillojnë perceptimin se njohin më mirë se kushdo tjetër çfarë ndodh jashtë vendit dhe sa i rrezikshëm është ky kërcënim, pra kanë mundësinë që të njohim informacione që të tjerët nuk kanë këtë mundësi. Ky fakt i kombinuar me “licencën” de fakto për të operuar jashtë rregullave të shoqërisë, lehtësisht mundet t’i çojë ata në një ndjenjë mbivlerësimi për vetveten dhe punën e tyre, bile mund të çojë deri në një sjellje armiqësore ndaj atyre që nuk janë anëtarë të këtyre shërbimeve.

Kushte të domosdoshme për reformimin e inteligjencës

Për reformimin e shërbimeve të inteligjencës në shtetet demokratike është e domosdoshme që të aprovohet një strukturë ligjore e saktë dhe e hollësishme për veprimtarinë e tyre. Këto shërbime, siç është trajtuar më sipër, kanë tendencë që t’i rrëshqasin ligjin në qoftë se ai, për veprimtarinë e tyre nuk është i qartë dhe i hollësishëm, duke vështirësuar edhe kontrollin demokratik ndaj tyre.

Ligji për organizimin e shërbimeve të inteligjencës është një kusht i domosdoshëm për kontrollin demokratik të veprimtarisë së tyre, por vet ligji nuk mjafton për realizimin efektiv të këtij kontrolli.⁵

Ka tre kushte themelore dhe disa dytësore që duhen të ndërmerren për vendosjen e një kontrolli demokratik efektiv mbi shërbimet e inteligjencës. Këto alternativa duhet të përcaktohen brenda një strukture ligjore të qartë dhe të hollësishme dhe të miratuara nga parlamenti.

Kushti i parë është përcaktimi se cilin nga katër funksionet e inteligjencës do të implementojë vendi dhe në ç’masë do ta mbështesë atë financiarisht. Pjesës së parë të kësaj pyetjeje mund t’i përgjigjemi vetëm duke bërë një vlerësim real të situatës globale dhe rajonale, të aleancave, historisë së kohëve të fundit dhe mundësive. Pjesa tjetër “sa shumë vlen inteligjenca” është një vendim politik. Qartësisht, ajo ka një vlerë të madhe në qoftë se siguron pavarësinë e kombit me mjetet e duhura përballë kërcënimeve të brendshme e të jashtme. Nëpërmjet inteligjencës shteti vlerëson kërcënimet ndaj tij si dhe mundëson krijimin e një ushtrie të vogël dhe efektive ndaj kërcënimeve më serioze e, në këtë mënyrë, zvogëlon koston e mbajtjes dhe atë të veprimeve operacionale. Por a është e mundur që duke patur një nga funksionet e inteligjencës në një nivel të caktuar, të parandalojë qëllimet

⁵ Shaun McCarthy, “South Africa’s Intelligence Reformation,” *International Journal of Intelligence and Counterintelligence* 9, no 1 (1996).

dhe veprimtaritë armiqësore ndaj vendit? Në situatën aktuale më shumë varet edhe nga marrëdhëniet e qeverisë me shtetet më të fuqishme që mund të jenë të gatshme të ndajnë informacionet e inteligjencës me të në bazë dhe brenda disa kushteve dhe rrethanave. Këto zgjidhje domosdoshmërisht duhet të integrohen brenda një strukture të përgjithshme institucionale në marrjen e vendimeve të mbrojtjes, bazuar në vlerësimin se çfarë kërkon kombi dhe sa ai është i gatshëm të paguajë për të.

Drejtuesit e lartë të ekzekutivit të shtetit (presidenti ose kryeministri si dhe anëtarë të tjerë të kabinetit qeveritar) duhet të marrin përgjegjësinë për bërjen e këtyre vendimeve duke e shikuar atë në sinkron me strukturat e tjera të mbrojtjes kombëtare. Pra qeveria duhet të strukturojë nga ana burokratike shërbimin që menaxhon ose integron funksionet e inteligjencës në nivel kombëtar. p.sh. në SHBA drejtori i CIA-s kujdeset për produktin e integruar të inteligjencës, por është Këshilli i Sigurisë Kombëtare që duhet të koordinojë politikën kombëtare.⁶ Në Brazil, pas reformave të fundit, Sekretariati Institucional i Sigurisë ka përgjegjësinë për këtë koordinim dhe është në vartësi direkte nga presidenti i vendit. Pas reformës në Afrikën e Jugut, rreth mesit të viteve 1990, Komiteti Nacional i Koordinimit të Inteligjencës raporton direkt tek presidenti dhe kabineti për problemet e inteligjencës. Ndërsa në vendin tonë edhe një përpjekje e bërë rreth viteve 2000-2003, ku roli i agjencisë së koordinimit iu la SHISH-it, dështoi dhe aktualisht ky mekanizëm mungon.

Zgjedhja e dytë e rëndësishme por edhe shqetësuese që hasin qeveritë e demokracive të reja është raporti ndërmjet përfshirjes së civilëve dhe ushtarakëve në inteligjencë, si në funksionin e mbledhjes dhe analizën e informacionit ashtu edhe në konsumimin e tij. Në shumicën e vendeve autoritare, ushtria kishte monopol mbi produktin e inteligjencës si dhe ishte konsumatori kryesor i saj. Gjatë procesit të konsolidimit demokratik, drejtuesit duhet të vendosin nëse shërbimet e inteligjencës ushtarake duhen të vendosen në tërësi ose si pjesë e një shërbimi të ri civil. Një alternativë është t'u japësh ushtarakëve përgjegjësinë vetëm për inteligjencën ushtarake ndërsa civilëve përgjegjësinë për inteligjencën strategjike dhe kundërinteligjencën. Pyetja se kush do të ketë akses tek produkti final është aq e rëndësishme sa edhe mbledhja e kësaj inteligjence. Tek kush duhet të shkojë prodhimi i inteligjencës? Do të jetë i përcaktuar ky akses vetëm për presidentin e vendit, kryeministrin, për drejtorin e shërbimit, anëtarët e kabinetit ose lidërshpirt ushtarakë? Duhet që anëtarët e parlamentit ose dikush tjetër të përfshihet në këtë rreth? Pra, aksesit tek informacioni i inteligjencës dhe forma se si ai është përpunuar dhe është bërë i vlefshëm, si p.sh. i hapur ose i klasifikuar, raport i shkruar ose prezantim gojor, i jep pushtet dhe autoritet personave që e marrin atë.

Një tjetër nënçështje për raportin ndërmjet institucioneve civile me ato ushtarake është edhe marrëdhënia midis shërbimeve të inteligjencës së brendshme me ato të jashtme. A duhet që i njëjti shërbim të ketë përgjegjësinë për survejimin brenda shtetit, i cili është shërbim sigurie, për të operuar edhe jashtë vendit? A duhet që këto funksione të bashkohen dhe, nëse po, çfarë kontrolli nevojitet me qëllimin që veprimtaritë dhe produktet e saj të mos përdoren për qëllime politike? Në shumicën e vendeve demokratike funksionet e inteligjencës së brendshme janë të ndara nga ato të jashtme. Për shembull, FBI merret me kundërinteligjencën dhe sigurinë brenda SHBA-së, ndërsa CIA ka përgjegjësinë për

⁶ Lowenthal, 277.

mbledhjen e inteligjencës dhe kundërinteligjencës jashtë vendit. Shumica e demokracive evropiane, këto funksione i ka të ndara ndërmjet shërbimeve të sigurisë së brendshme dhe shërbimeve të inteligjencës së jashtme. Kjo ndarje nuk ka qenë ndonjë problem për vendet e demokracive të reja sepse shërbimet që ato kanë trashëguar ishin fokusuar, në shumicën e rasteve, në problemet e brendshme. Duhet të vihet në dukje që shërbimi i inteligjencës së brendshme është i lirë nga ana financiare në krahasim me shërbimet e inteligjencës së jashtme dhe për pasojë shumica e vendeve nuk janë në gjendje t'i mbështesin ato në gjithë veprimtarinë e tyre.

Kushti i tretë për problemin që hasin demokracitë e reja në marrëdhëniet midis inteligjencës dhe politikës është një çështje që zgjidhet në mënyrë logjike dhe përfshin koordinimin midis shërbimeve të inteligjencës. Problemi qëndron nëse e gjithë veprimtaria e shërbimeve të inteligjencës duhet të koordinohet në mënyrë formale nga një drejtori qendrorë e inteligjencës, si p.sh. në SHBA duke e mbajtur të ndarë nga politikëbërësit (duke e patur të shkëputur drejtorin nga kabineti i presidentit). Alternativë tjetër mund të jetë që shërbimet të vendosen të ndara në ministri të ndryshme, si p.sh. MI5 dhe MI6 në Britaninë e Madhe dhe të bazuara më shumë në procedura të drejtimit kolegjal. Këto çështje reflektojnë një debat të vazhdueshëm rreth implikimit politik të analizës së shërbimeve të inteligjencës kur ajo është afër dhe e lidhur me politikën, në raport me humbjen e supozuar të efikasitetit të saj, duke e pasur këtë analizë jo të lidhur me politikën. Shtete demokratike të ndryshme e menaxhojnë këtë problem në forma të ndryshme.⁷

Zbatimi i këtyre kushteve varet, në pjesën më të madhe, nga traditat politike dhe ndërtimi strukturor i administratës të secilit vend që ndërmerr këtë reformë. P.sh. kritikuesit e operacioneve të fshehta në SHBA pretendojnë që të tilla operacione njollosin dallimin ndërmjet inteligjencës dhe politikës në CIA. Më tepër se prodhimin e një inteligjence objektive, CIA zhvillon politika, i kryen ato dhe, në masën më të madhe, bën edhe vlerësimin e tyre. Hastid (Hasted), i cili ka shkruar për kontrollin e shërbimeve të inteligjencës, jep vlerësimin e tij të qartë në këtë problem: “Qëllimi i inteligjencës është të informojë dhe paralajmërojë politikëbërësit. Zgjedhja e problemit që do të bëhet varet vetëm nga politikëbërësit. Në qoftë se inteligjenca është shumë afër e në kontakte me politikën bën që ajo të shkojë drejt një rreziku që të bëhet e “korruptuar politikisht”.⁸ Në demokracitë e reja, është shumë shpejt të thuhet se qeveritë janë duke u marrë me problemin e mësipërm, qëkurse ato janë akoma në procesin e ndërtimit dhe implementimit të strukturave shtetërore, duke përfshirë këtu edhe ato të inteligjencës.

Të tre këto vendime institucionale kanë një ndikim të rëndësishëm për kontrollin demokratik mbi shërbimet e inteligjencës. Zgjedhja e çështjes së parë, pra ç’lloj funksioni inteligjence të kemi dhe financojmë, do të ketë një efekt të qartë veçanërisht në qëllimin e operacioneve të kundërinteligjencës. E dyta, vendimi ku do të vendoset inteligjenca, pra në strukturat civile apo në ato ushtarake, do të influencojë direkt në kontrollin civil si ndaj forcave të armatosura, ashtu edhe mbi shërbimet e inteligjencës. E treta, lidhjet e ngushta me politikanët mund t'i bëjnë shërbimet e inteligjencës më pak funksionale në kryerjen e detyrave të tyre e, për më tepër, një mjet të përdorur nga politika për ruajtjen e pushtetit.

⁷ Johnson, 129-131.

⁸ Hasted, 10.

Në rastet në të cilat ky studim është bazuar si p.sh. në Argjentinë, Brazil, Guatemalë, Rumani dhe Korenë e Jugut, të dhënat tregojnë që këto shtete kanë rezultate pozitive në dy problemet e para, kurse zgjidhja për problemin e tretë ngelet ende një sfidë.

Mekanizmat për kontrollin e inteligjencës

Mekanizmi i përgjithshëm i kontrollit të inteligjencës është ndarja e saj në agjenci të ndryshme me qëllimin që të parandalojë çdo shërbim nga pasja e monopolit ndaj produktit dhe përdorimit të tij. Ky është modeli i strukturimit në SHBA. Një formë tjetër organizimi mund të jetë edhe mbajtja e shërbimeve të veçanta të inteligjencës për çdo strukturë, si në forcat e armatosura ashtu dhe në polici si dhe shërbime të ndara për inteligjencën e brendshme dhe atë të jashtme. Ky shtim i organizatave mund të mos jetë eficient si sistem që kurse agjenci të ndryshme përpiqen dhe luftojnë ndërmjet njëra-tjetres mbi territorin dhe aksesin e vendimmarrësit, por nga ana tjetër kjo shmang shanset për një monopol nga ndonjë shërbim ose edhe individ dhe krijon mundësinë për një kontroll demokratik. Shumica e vendeve që janë duke punuar për reformimin shërbimeve të tyre të inteligjencës kanë lëvizur në këtë drejtim. Në Afrikën e Jugut, Korenë e Jugut, Argjentinë, Brazil dhe Guatemalë, qeveritë e këtyre vendeve kanë krijuar shërbime inteligjente civile, p.sh. dy, në rastet e Brazilit dhe Guatemalës, që kompensojnë homologët e tyre ushtarakë. Një rast ekstrem dhe i veçantë është Rumania⁹, e cila duke krijuar shumë agjenci të vogla dhe bën që konkurrenca dhe tepria e këtyre shërbimeve të ulë efektivitetin e tyre.

Mekanizmi tjetër për kontrollin demokratik të inteligjencës është mbikëqyrja e jashtme e saj. Kjo do të thotë: a ka një organizëm që bën mbikëqyrjen e shërbimeve apo vetë shërbimet e kanë këtë përgjegjësi për monitorimin e performancës së tyre? Opinioni i dytë është shumë i rrezikshëm për demokracinë. Në SHBA, mbikëqyrja është rritur e zgjeruar nga viti në vit dhe kështu sot, jo vetëm që agjencitë kanë nga një inspektor të përgjithshëm, por edhe qeveria dhe dy dhomat e Kongresit kanë nga një komision që kryen mbikëqyrjen.¹⁰ Megjithëse mbikëqyrja formale në Britaninë e Madhe është shumë e vogël, institucionet demokratike janë të konsoliduara dhe garantojnë një nivel të lartë dhënie llogarie. Ndërsa demokracitë e reja që janë në procesin e konsolidimit të tyre e që duan ta vënë inteligjencën nën një kontroll demokratik duhet që t'i ngrënë këto institucione të mbikëqyrjes.

Siç shkruan edhe Marina Kaparini (Caparini), mbikëqyrja ekzekutive, në përgjithësi, shqetësohet për eficientësinë dhe kryerjen e detyrave të dhëna.¹¹ Mbikëqyrja e gjyqësorit kryesisht përfshin çështjet e drejtësisë dhe ligjshmërisë. Ligjvënësit i monitorojnë të dyja, si eficientësinë dhe drejtësinë e aktivitetit të shërbimeve të inteligjencës. Në shumicën e shteteve të reja, që kanë hyrë në proceset demokratike, ndjehet nevoja e këtij kontrolli. Por nëse këto mekanizma kontrolli në fakt punojnë ose jo, kjo gjë varet në kompozimin e komitetit të mbikëqyrjes dhe në sasinë dhe cilësinë e stafit që punon aty. Kontrolli i publikut mbi këto shërbime, kryesisht është i lidhur me funksionin e kontrollit nëpërmjet medias, e cila

⁹ Në Rumani kemi pesë shërbime inteligjence, në nivel kombëtar.

¹⁰ Steven C. Boraz, "Executive Privilege: Intelligence Oversight in the United State," in *Reforming Intelligence: Obstacles to Democratic Control and Effectiveness*, ed. Thomas C. Bruneau and Steven C. Boraz (Austin: University of Texas Press, 2007), 29-34.

zakonisht fokusohet në probleme në lidhje me të drejtat e veprimtarisë së shërbimeve të inteligjencës.¹²

Aksesi tek produkti i inteligjencës

Qëkur kemi thënë se informacioni është pushtet, është shumë e rëndësishme të specifikohen kush duhet të njihet me inteligjencën dhe në çfarë forme. A është kjo e kufizuar vetëm si p.sh. për ushtarakët me certifikatat “*need to know*” apo kjo duhet të shtrihet që edhe sektori civil ta ketë këtë të drejtë. Po deputetët e legjislativ ? Çështja e aksesit tek informacioni është një çështje delikate, në shumë vende, për arsye se nga zgjedhjet demokratike bëhet e mundur që ish opozita dhe bile edhe guerilasi ndonjëherë, të zgjidhen në organet legjislative dhe ekzekutive. Shtetet duhet të caktojnë kriteret dhe procedurën të sakta për shpërndarjen e inteligjencës tek zyrtarët e zgjedhur me qëllim që t’i lejojë e ndihmojë ata në vendimmarrjen, pa rritur mundësinë që privilegji tek informacioni i klasifikuar të keqpërdoret për qëllime politike. Probleme thelbësore të tilla si p.sh. nëse një ose të gjithë zyrtarët duhet të kenë akses në bazë të parimit “*need to know*” edhe përpara operacioneve sensitive si operacionet e fshehta, rrit shqetësimin jo vetëm të daljes së sekretit, por rrit edhe vështirësinë e grumbullimit të informacionit, pas një periudhe të caktuar kohore. Mundësia e një shpërndarjeje të gjerë nënkupton mundësinë për kontrollin demokratik të operacioneve. Në qoftë se agjencitë e inteligjencës e dinë që, në të ardhmen, dosjet e tyre do të hapen për kontroll nga ana e publikut, ato, në mënyrë logjike, kanë gjasa të mbajnë nën fre sjelljet e personelit të tyre.

Por një dilemë qëndron në çështjen e kontrollit dhe kjo është ajo ndërmjet kontrollit demokratik mbi inteligjencën dhe efektivitetit të shërbimeve të inteligjencës në bërjen e detyrave të tyre në mbrojtje të kombit. Kjo dilemë mund të thjeshtohet në një tension ndërmjet përgjegjësisë për punën e shërbimeve, e cila kërkon transparencë edhe të funksioneve të inteligjencës, që kërkojnë fshehtësi. P.sh. a mundet që sekretet e shërbimeve të dekonspirohen nga kontrolli legjislativ dhe identitetet e agentëve të shërbimeve të zbulohen ? Në shtetet demokratike ka përplasje në mënyrë konstante për këtë çështje, e cila nuk ka një zgjidhje të lehtë ose të sigurtë. Kur diskutohet për mbikëqyrjen legjislative në demokracitë e konsoliduara, çështja e sigurisë ose ndjenja e përgjegjësisë të ligjvënësve del gjithmonë në pah. Është shumë e vështirë të bëhet, në mënyrë *a priori*, gjykimi për këtë çështje, por duhet theksuar se, p.sh. që nga viti 1970 kur kontrolli legjislativ ka filluar të ushtrohet në SHBA, janë të pakta rastet që anëtarët e kongresit ose anëtarët e stafëve të tyre të kenë nxjerrë sekrete shtetërore, kjo edhe në raport me rrjedhjet e informacioneve nga ekzekutivi. Në demokracitë e reja, më tepër se problemi i kontrollit legjislativ, është çështja se si dhe prej kujt mbikëqyrja duhet të implementohet.

Një problem tjetër, pothuajse paradoksal, është që përfaqësuesit civilë, të zgjedhur në mënyrë demokratike në demokracitë e reja, mund të mos të jenë të interesuar për kontrollin demokratik të shërbimeve të inteligjencës. Në të vërtetë, në të gjitha këto vende, procesi

¹¹ Marina Caparini, “Challenges of Control and Oversight of Intelligence Services in a Liberal Democracy” (Geneva: paper presented at the Workshop on Democratic and Parliamentary Oversight of Intelligence Services, DCAF, October 2002), 8-9. Available at: http://www.dcaf.ch/news/Intelligence%20oversight_051002/ws_papers/caparini.pdf (last accessed, March 08, 2009).

¹² *Ibid.*

zgjedor për të përcaktuar se kush do të jetë lidershpi i ri i shoqërisë është një mjet i ri dhe shumë i brishtë, i cili përcakton se kush e fiton pushtetin. Bile edhe në demokracitë e vjetra, liderët e shtetit preferojnë “*plausible deniable*”, të drejtën e pretenduar me pafajësi prej mosdijes, më tepër sesa aksesin tek informacioni i kërkuar, apo për të kontrolluar një shërbim ose operacion të rrezikshëm e të diskutueshëm. Me përjashtim të rasteve të vetme të pasjes së ndonjë krize ose skandali, shumica e politikanëve, në shtetet demokratike, kanë pak interes për të fituar nga detyra e të shërbyerit në komitetet e mbikëqyrjes së inteligjencës ose dhe nga përfshirja e vetvetes në sektorët që merren me inteligjencën.

Kjo vjen prej vetë natyrës së inteligjencës. Si rrjedhojë, ata nuk presin ndonjë mirënjohje nga ana e zgjedhësve për kryerjen e këtyre detyrave në këto sektorë dhe për pasojë, fitojnë pak kapital politik. Fakti më i vërtetuar është që reformat në sektorin e inteligjencës zakonisht ndodhin vetëm në rastet kur një skandal i madh zbulohet duke i detyruar politikanët që t’iu përgjigjen kërkesave të publikut që “bëni diçka”.¹³ Kjo situatë është mbizotëruese edhe në demokracitë e reja, të paktën për tre arsye. Së pari, politikanët mund që të frikësohen prej kundërveprimit armiqësor të shërbimeve të inteligjencës ngaqë kërkojnë t’i kontrollojnë ato, për arsye se këto shërbime mund të kenë informacione sensitive për t’i fshehur. Së dyti, ata (politikanët) mund të jenë të frikësuar sepse shërbimet inteligjente në të shkuarën kanë qenë të përfshira në akte arbitrare ose edhe violente dhe ata tremben se përsëri këto shërbime mund të kryejnë këto akte ndaj tyre. Dhe e treta është se, ndoshta ata, nga kontrolli që ushtrojnë ndaj veprimtarisë së shërbimeve të inteligjencës, nuk fitojnë asnjë votë. Kjo, sepse ky aktivitet që ata kryejnë, për shumicën e popullit, nuk ka shumë interes dhe vlerë.

Inteligjenca si profesion

Problem themelor dhe institucional, për të dyja, si për kontrollin ashtu edhe rritjen e efektivitetit të shërbimeve të inteligjencës është problemi i rekrutimit, edukimit, trajnimit, menaxhimit dhe ndërprerjes së daljes në pension të punonjësve profesionistë të inteligjencës. Mekanizmi i kontrollit të jashtëm, ndërsa është një nevojë thelbësore për kontrollin demokratik, mund të jetë shkatërrues për efektivitetin e punës së agjencive të inteligjencës. Kjo është e dukshme në rastin e Brazilit, ku vazhdimësia e abuzimeve solli si pasojë shkrirjen e Shërbimit të Inteligjencës Kombëtare (NIS) në vitin 1990 prej presidentit Fernando Kolor de Melo (Fernando Collor de Melo). Natyrisht, si në Brazil ashtu dhe Peru, në vitin 2004, shkrirja e agjencisë kryesore të inteligjencës solli pasojë të pakta në rritjen e efektivitetit të shërbimeve.

Pra, sfida e kontrollit demokratik mbi inteligjencën është kombinimi i saj me efektivitetin e këtyre shërbimeve. Të fokusuar tek inteligjenca si profesion, është veçanërisht me vend që të theksojmë se pjesëtarët e shërbimeve të inteligjencës, më shumë se çdo lloj tjetër specialisti i administratës shtetërore, janë të ndrydhur në kryerjen e detyrave të tyre, më shumë prej rregullave të profesionit sesa prej kontrollit. Bile kjo është e dukshme edhe në demokracitë e zhvilluara.¹⁴ Ndërsa forcat e armatosura e kanë të rregulluar veprimtarinë e

¹³ Christopher Andrew, *For the President's Eyes Only: Secret Intelligence and the American Presidency from Washington to Bush*, (New York: Harper Collins Publishers, 1995), 478-493.

¹⁴ Glenn P. Hastedt, “Controlling Intelligence: The Values of Intelligence Professionals” in *Controlling Intelligence*, ed. Glenn P. Hastedt (Cass Series-Studies in Intelligence. London: F.Cass, 1991), 97-112.

tyre me disa elementë si p.sh. buxheti, rritja në karrierë dhe një pafundësi tjetër mekanizmesh të kontrollit civil, specialistët në profesionin e inteligjencës janë të kontrolluar vetëm prej produktit përfundimtar ose prej strukturave të brendshme të kontrollit, në qoftë se ka.

Inspektorët e shërbimeve të inteligjencës janë të garantuar nga mosndëshkimi për “thyerjen” e ligjeve jashtë vendit të cilit i shërbejnë si dhe kanë një liri veprimi shumë të madhe për të thyer edhe ligjet e shtetit të tyre. Ata operojnë në mënyrë sekrete dhe jashtë sistemit “*checks and balances*”, janë të rrethuar nga një burokraci nëpunësish me të njëjtin koncept, zhvillojnë mentalitetin e një “klubi” të mbyllur e, në të njëjtën kohë, janë shumë dyshues për ata, të cilët nuk janë anëtarë të këtij grupimi, duke përfshirë herë pas here edhe superiorët e tyre. Në demokracitë e reja, ku dhënia e llogarisë është minimale në çdo rast, mosndëshkimi i punonjësve të shërbimeve të inteligjencës, për pasojat e veprimeve të gabuara të tyre, është një gjë që iu është dhënë *de fakto*.

Si shumica e profesioneve, edhe profesioni i inteligjencës mund të përkufizohet në termat e tre kritereve: të ekspertizës, bashkëpunimit dhe përgjegjesisë. Kriteri i parë, ekspertiza, përmblledh katër funksionet e inteligjencës: grumbullimin, analizën, kundërinteligjencën dhe operacionet e fshehta. Ndërsa renditja se çfarë bëjnë inspektorët profesionalë të inteligjencës është shumë e gjerë. Por ajo që i bashkon ata ose i përcakton ata si profesionistë të inteligjencës është fshehtësia. Edhe profesioni i ushtarakut gjithashtu ka elementë të sekretit, por kjo cilësi është më shumë e spikatur tek intelijenca.

Në lidhje me operacionet e fshehta, një specialist amerikan i inteligjencës Riçerd M. Bisell I Riu (Richard M. Bissell Jr.) i thekson të dyja, si shumëllojshmërinë e punonjësve operativë të inteligjencës ashtu dhe fshehtësinë që është karakteristike e tyre në sentencën: “Kompetenca profesionale e një shërbimi sekret qëndron në atë (fshehtësinë), si dhe matet me aftësinë e tij që të kryejë operacione të fshehta (ose mohimin e tyre, nëse duhet). Kjo është e njëjtë me kompetencën e juristëve e cila qëndron në aftësinë e tyre të fitojnë çështjet në gjyq ose në aftësinë e mjekëve që të parandalojnë ose trajtojnë sëmundjet. Shërbimet sekrete mund të numërojnë se në radhët e punonjësve të tyre kanë shumë gazetarë brilantë, luftëtarë të aftë si dhe analistë të nivelit të lartë, në fushën e politikës, por zotësia si profesionist, për secilin prej tyre dhe ajo për të cilën ata janë të punësuar, është aftësia për të organizuar dhe realizuar operacione në mënyrë të fshehtë. Kjo është një aftësi e spikatur pothuajse vetëm tek shërbimet e inteligjencës ose ato të sigurisë”.¹⁵

Kriteri i dytë, shpirti i bashkësisë (ose fryma e repartit) e një shërbimi sekret shtrihet në aksesin e tij në sistemin e dokumenteve të klasifikuara, të informacionit, të burimeve dhe operacioneve. Klerancat janë mekanizmat e kontrollit për të dhënë licencën si anëtar i këtij profesioni si dhe për vazhdimësinë e punës. Ka disa kërkesa strikte, për profesionin e inteligjencës, të vështira për t’u ndryshuar, bile edhe ndërmjet shërbimeve të inteligjencës së një shteti dhe kjo është e lidhur kryesisht me aksesin tek informacioni i klasifikuar që ato kanë. Kleranca e sigurisë dhe natyra e klasifikuar e profesionit rforcojnë kulturën e qëllimshme të të quajturit të vetes si pjesëtar i një “klubi” të veçantë ose një “klubi elite”. Kjo kulturë mund edhe të rritet në një nivel të rrezikshëm të arrogancës, duke shkuar deri në sensin e pandëshkueshmërisë së tyre. P.sh. të drejtën për tu njohur se çfarë detyrash

¹⁵ Bissell Jr., 216.

kryejnë në realitet këto shërbime e kanë vetëm ata që janë punonjës efektiv të brendshëm të këtyre shërbimeve, pra si mundet që punonjësit e tjerë administratës shtetërore, të cilët nuk janë efektiv të brendshëm t'i kontrollojnë këto shërbime për punën që kryejnë? Për më tepër, si ka mundësi që nëpunës që janë jashtë këtyre institucioneve mund të gjykojnë vlerën e punës së inteligjencës, ose edhe efektivitetin e operacioneve të tyre, kur atyre iu mungon aksesit tek i gjithë informacioni i klasifikuar?

Kriteri i tretë, përgjegjësia profesionale e inteligjencës është që t'i shërbejë mbrojtjes së shtetit demokratik. Por në qoftë se ne i marrim në konsideratë të dy kriteret e para, ekspertizën, të kryer në mënyrë sekrete dhe kulturën e bashkëpunimit, të bazuar në certifikatën e klerancës së sigurisë, ne jemi të detyruar ta shohim profesionin e inteligjencës si një profesion që në mënyrë të gjerë qeveris vetveten sipas rregullave të veta të përgjegjësive. Në demokracitë e reja kjo është dy herë më e rrezikshme, së pari nga trashëgimia, pasi regjimi i mëparshëm nuk jepte llogari përpara popullit të vet në përgjithësi dhe së dyti, për arsyen se punonjësit e inteligjencës mund të mos kenë qenë ndonjëherë objekte të kontrollit shtetëror.

Kjo trashëgimi na kërkon të përcaktojmë se kush duhet të dijë se çfarë duhet të kontrollojmë si dhe cili duhet ta kryejë këtë kontroll. Kontrolli demokratik i shërbimeve të inteligjencës është një përgjegjësi shumë e rëndësishme institucionale për një shtet demokratik edhe në demokracitë që ne i quajmë stabilizuara, kjo sepse nga gabimet ose incidentet në punë që mund të bëjnë këto shërbime lindin shkëndija që të shkaktojnë dyshimin ose shqetësimin se mos punonjësit e këtyre shërbimeve nuk janë duke i shërbyer shtetit. Ose, më tepër se shqetësim, është problemi se mos këta punonjës janë duke punuar në akord me kërkesat e kërkuara nga drejtuesit e shërbimit dhe jo në përputhje me kërkesat e dhëna nga udhëheqësit politikë, të zgjedhur në mënyrë demokratike. Në demokracitë e reja, kjo situatë është edhe më e vështirë dhe destabilizuese sepse, siç e shpjeguam, komuniteti i inteligjencës nuk e ka në traditën e vet të japë llogari tek shteti demokratik, kështu që procesi i ndërtimit të profesionalizimit, siç e kemi përkufizuar në këtë material, do të jetë problematik edhe në rastin më të mirë.

Ka edhe një problem serioz praktik në reformimin e punës së shërbimeve të inteligjencës që përfshin dinamikën organizative të transformimit të tij. Argumentet më këmbëngulëse dhe të vazhdueshme kundër reformimit të shërbimeve të inteligjencës janë se ky proces transformimi do të bëjë që shteti të ngelet i cenueshëm nga të dy llojet e kërcënimeve, si ato të brendshme dhe të jashtme. Në shumicën e organizatave të inteligjencës një proces transformimi radikal do të sillte një periudhë të rënies së efikasitetit në punë për realizimin e detyrave nga ana e tyre. Gjatë këtij procesi transformimi duhet patur parasysh që të kufizohet kjo rënie nëpërmjet minimizimit të periudhës që ky proces do të duhet të kryejë me qëllimin që shërbimet të rimarrin veten shpejt.


Siç e përkrahim, në eksperiencën e tij, një oficer i lartë i shërbimit të inteligjencës të Afrikës së Jugut, gjatë këtij procesi del një problem i cili qartësohet më shumë kur niveli i efikasitetit të shërbimit arrin pikën më të ulët të tij dhe duket në atë që shërbimi ri është në amulli dhe nuk arrin as në nivelin e punës së shërbimit të vjetër. Reagimi i zakonshëm për këtë problem është përpjekja që të thellohet riorganizimi me synimin që të rritet efektiviteti ose të rritet kontrollin drejtues mbi të gjithë organizatën. Rezultati i zakonshëm pas kësaj është përsëri një rënie tjetër e efikasitetit të shërbimit. Ky problem mund të bëhet sistematik

në qoftë se drejtuesit e shërbimeve nuk e njohin atë dhe nuk i lënë këtij procesi transformimi të shërbimit një kohë të mjaftueshme të adaptojë këto ndryshime dhe duke rimarrë veten në mënyrë graduale (figura 1).

Në këtë grafik, pika e parë kritike e divergjencës ndodh në rendimentin pas fillimit të procesit të riorganizimit (C). Menaxherët presin të shohin një rritje të efikasitetit të pasqyruar në një rritje të nivelit të dëshirës që është niveli (X), kurse shërbimi duket qartë që shkon në një nivel edhe më të ulët të efikasitetit. Kur ky ndryshim nuk ndodh në kohën e pritshme, ka një tendencë për ta thelluar, riorganizuar shërbimin (D), kështu që, në mënyrë të natyrshme, procesi shkon në një tjetër rënie të efikasitetit (rënia D-E) dhe shkojmë përsëri në një tjetër riorganizim. Ky proces mund të kthehet në një proces humbës për një demokraci që po konsolidohet dhe që është në rrugën e përpjekjeve të transformimit të aparatit të inteligjencës në një organizate efçente dhe që jep llogari tek institucionet demokratike.

Figura 1. *Problemet e efçencës së shërbimit gjatë reformës organizative: A, Niveli i efçencës operacionale në organizatën e vjetër; B, pika e fillimit të ndryshimeve; C, niveli i efçencës së organizatës së re; D, pika e riorganizimit; E, niveli i efçencës së shërbimit pas riorganizimit; F, pikë riorganizimi; X, niveli i dëshiruar i efçencës së shërbimit mbas reformës të shërbimit. (Konceptet janë bazuar në një material të Qendrës për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake, të Shkollës Pasuniversitare të Marinës, Monterey, Kaliforni).*

Drejtuesit politikë duhet ta dinë që çdo riorganizim ka koston e vet në lidhje me efçencën e organizatës, së paku për një kohë të shkurtër, ndërsa transformimi i agjencive të inteligjencës është një proces afatgjatë. Konstruktimi fillestar i strukturës si dhe përgjegjësit e saj janë problem kritik dhe ka mundësi të influencojë marrëdhëniet organizative dhe kulturën profesionale të anëtarëve të saj, për vitet në vazhdim. Ndërsa struktura burokratike



mund të krijohet në një hapësirë kohore relative, ndryshimet e anës kulturore të profesionit duan vite. Oficerëve të rinj të inteligjencës, të dedikuar profesionalisht që do të punojnë brenda një sistemi demokratik, mund t'iu duhet një periudhë e gjatë kohe në shërbim përpara së të bëjnë progres në pozitë, nga ku ata të kenë edhe mundësinë të bëjnë ndryshime të rëndësishme në kulturën e inteligjencës së shërbimit të tyre.

Përfundime

Të gjitha shtetet kryejnë veprimtari inteligjence në një shkallë të caktuar. Shumica e udhëheqësve politikë në botë besojnë se shtetet e tyre duhet të mbledhin inteligjencë sepse edhe shtetet e tjera e bëjnë këtë gjë. Pra, asnjë qeveri nuk mund të qëndrojë e paditur për atë që ndodh, si brenda vendit ashtu edhe jashtë territorit të saj. Për më tepër, liderët duhet të jenë të përgatitur që, nëse është e nevojshme, t'i kundërvihen përpjekjeve të shteteve të tjera që mund të kërcënojnë zhvillimin e vendit të tyre. Sulmet terroriste të 11

Shtatorit 2001 si dhe ato pasuese në Bali, Spanjë, Rusi, Britani dhe në vende të tjera, kanë shtuar nevojën për efektivitet dhe efikasitet të shërbimeve të inteligjencës si dhe për një përqendrim më të madh të vëmendjes, në lidhje me kërcënimet që vijnë nga aktorët jo shtetërorë. Historia ka treguar se, në shumicën e rasteve, trashëgimia e shërbimeve të inteligjencës që kanë mbështetur regjimet autokratike ka qenë dëmuese për demokracinë.

Procesi i kontrollit demokratik mbi shërbimet e inteligjencës, si element i sfidës së konsolidimit demokratik të shoqërisë, i ka të dyja anët e medaljes, si nevojën për kontroll ashtu edhe vështirësitë e mëdha për realizim. Pa një veprimtari vendimtare të qeverive të reja demokratike, trashëgimia negative e organizatave të inteligjencës do të vijojë edhe në sistemin e ri dhe do të mbetet një pengesë në konsolidimin demokratik. Vendet që dëshirojnë të ndërtojnë sistemin e kontrollit demokratik civil mbi aparatet e inteligjencës duhet të marrin disa masa. Këto masa janë të ngjashme me ato të që janë vënë për të ushtruar kontroll demokratik mbi FA në përgjithësi, por që janë më të ndjeshme dhe më të nevojshme për arsye të kërkesave të ruajtjes së fshehtësisë dhe të penetrimit, në kuadër të linjës së kundërinteligjencës si funksion.

Detyra e parë është për të motivuar drejtuesit civilë që të mësojnë rreth inteligjencës të cilën duan ta kontrollojnë. Kjo do të thotë që punonjësve të shtetit iu nevojitet të çmitozoj inteligjencën dhe ta vendosin atë nën një kontroll civil që mund ta bëjë më efektive në shërbim të kombit. Në vendet që kanë qenë regjime autokratike, inteligjenca ishte shpesh monopol i ushtrisë. Këto shtete nuk do të jenë në gjendje të ushtrorë kontrollin ndaj shërbimeve të tyre të inteligjencës në qoftë se drejtuesit, e zgjedhur në mënyrë demokratike, nuk mbështesin së pari, përgatitjen e administratës civile për të mësuar se çfarë është inteligjenca dhe së dyti, që të arrijnë një nivel të caktuar bashkëpunimi me këto shërbime.

Në angazhimet e qeverive për reforma janë edhe objektivat për ngritjen e shërbimeve civile të inteligjencës. Si në rastin e marrëdhënieve civilo-ushtarake, punonjësit civilë nuk kanë motivim të vijnë dhe të punojnë në shërbimet e inteligjencës, veçse në qoftë se ata do të kenë shanse të bëjnë karrierë në këtë fushë. Këta punonjës duhet të mësojnë se çfarë është dhe pse duhet inteligjenca dhe kjo bëhet e mundur duke lexuar dhe përfutur nga eksperiencat dhe trajnimet e afuara nga shtetet e tjera me demokraci të konsoliduara në fushën e inteligjencës siç janë p.sh. SHBA, Britania e Madhe, etj.

E dyta detyrë, më e gjerë, është nxitja e një kulture politike që mbështet rolin e pranueshëm të inteligjencës në një demokraci por nuk e lejon atë të ecë në mënyrë të pakontrolluar. Xhejms A. Shlesinger (James A. Schlesinger) thekson që “të ruash sekretin, veçanërisht në një demokraci, siguria duhet të jetë pjesë e një modeli sjelljesh të pranuar, si jashtë ashtu edhe brenda qeverisë”.¹⁶ Përgjegjësia duhet të bëjë që sistemi të punojë në të dy drejtimet: nga komuniteti i inteligjencës tek drejtuesit civilë të zgjedhur në mënyrë demokratike me qëllimin që t’iu japë atyre të gjithë informacionin e nevojshëm në kuadër të sigurisë kombëtare dhe nga zyrtarët civilë tek komuniteti i inteligjencës dhe shoqëria në përgjithësi, me qëllim që të parandalojë lëshimin e paautorizuar të informacionit të klasifikuar, si për arsye personale ashtu dhe politike.

¹⁶ Cituar nga Adda Bozeman, “Political Intelligence in Non-Western Societies: Suggestion for Comparative Research,” in *Comparing Foreign Intelligence: The U.S., the USSR, the UK, and the Third World*, ed. Roy Godson (Washington, DC: Pergamon-Brassey’s International Defense Publisher, 1988), 33.

Kjo kulturë mund të nxitet në kuadër të marrëdhënieve civilo-ushtarake në përgjithësi, duke ushqyer një debat publik që do të depërtojë në mbeturinat e apatisë ose frikës që ekziston në popullsisë civile, në lidhje me inteligjencën. Në disa demokraci të vjetra, duke përfshirë Kanadanë, Francën, Britaninë e Madhe dhe SHBA, ky debat është stimuluar prej OJQ-ve të ndryshme dhe masmedias, në mënyrë të rregullt, dhe është iniciuar prej dështimeve të inteligjencës në ato raste që ato janë bërë publike. Angazhimi i përfaqësuesve politikë të cilët kanë një politikë të qartë në fushën e inteligjencës mund të veprojë si një katalizator i dobishëm tek debati i gjerë shoqëror.

Diskutimi publik i rolit të inteligjencës në një demokraci shërben për një numër të rëndësishëm qëllimesh. Largimi i çdo misteri për inteligjencën lejon pjesën tjetër të shoqërisë që nuk është pjesë e këtij komuniteti, të vlerësojë, në mënyrë më realiste, nevojën dhe vlerat që ka intelijenca për vendin, krijon mundësinë ligjore për civilët që dëshirojnë të bëhen specialistë të inteligjencës dhe vendos presion mbi qeverinë që të bëjë funksionimin e shërbimeve të inteligjencës më transparent. Disa Organizata Jo-Fitimprurëse (OJF) ndërkombëtare e kombëtare (si për shembull: Federata e Shkencëtarëve Amerikane, Qendra për Kontroll Demokratik të Forcave të Armatosura në Gjenevë, Qendra për Marrëdhënie Civilo-Ushtarake e Shkollës Pasuniversitare të Marinës në Monterey, SHBA, Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim në Shqipëri) janë të gatshme të asistojnë dhe të marrin dhe zhvillojnë këtë debat.¹⁷

Referenca:

1. Caparini, Marina. "Controlling and Overseeing Intelligence Services in Democratic States." In *Democratic Control of the Intelligence Services Containing Rogue Elephants*, edited by Hans Born and Marina Caparini. Aldershot & Burlington: Ashgate, 2007, 3-24.
2. Gill, Peter. *Policing Politics Security Intelligence and the Liberal Democratic State*. New York: Fran Cass, 1994.
3. Herman, Michael. *Intelligence Power in Peace and War*. Cambridge & New York: Cambridge University Press, 1996.
4. Jervis, Robert. "Intelligence, Civil-Intelligence Relations and Democracy." In *Reforming Intelligence: Obstacles to Democratic Control and Effectiveness*, edited by Thomas C. Bruneau and Steven C. Boraz. Austin: University of Texas Press, 2007, vii-xxii.
5. Lowenthal, Mark M. *Intelligence: From Secret to Policy*. Washington DC: Congressional Quarterly Press, 2003.
6. Matei, Cristiana. "Intelligence Community in Romania: From an Instrument of Dictatorship to Serving Democracy." *International Journal of Intelligence and CounterIntelligence*, Vol. 20, Issue 4 (December 2007):629-660.
7. Schmitter, Philippe C. "The Consolidation of Political Democracies: Processes, Rhythms, Sequences and Types." in *Transitions to Democracy*, edited by Geoffrey Pridham. Aldershot: Dartmouth, 1995, 536-660.

¹⁷ Shiko Federation of American Scientists botimi periodik online Intelligence Resource Program,

8. Shulsky, Abraham N. *Silent Warfare: Understanding the World of Intelligence*. Washington, D.C.: Consortium for the Study of Intelligence, 1993.
9. Stepan, Alfred. "Rethinking Military Politics: Brazil and the Southern Cone." in *The Brazilian Intelligence System in Comparative Perspective*, edited by Alfred Stepan. NJ: Princeton University Press, 1988.

Zhvillimi i udhëheqësve strategjikë

Nënkolonel Dr. Edmond Braneshi,
Shef i Seksionit të Udhëheqjes Ushtarake
në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt: Shkrimin “Zhvillimi i udhëheqësve strategjikë” ia kushtoj akademistëve të Kursit të Lartë të Oficerit (KLO). Për ta, është një çast i rëndësishëm në fushën profesionale, pasi do të kalojnë në një nivel më të lartë drejtimi. Kjo kërkon zgjerimin e kuadrit vetjak të referencës dhe vënien e saj në shërbim të organizatës dhe mjedisit përkatës strategjik. Në këtë kuadër, procesi i zhvillimit të tyre (udhëheqësve strategjikë) përfshin përshtatjen me nivelin pasardhës të drejtimit, ku rëndësi i kushtohet vetëvlerësimit dhe planifikimit të zhvillimit. KLO është një ngjarje e veçantë në jetën e oficerit, pasi ai vendos mbi shina të sigurta karrierën ushtarake në vazhdim. Prandaj çdo akademist duhet të shfrytëzojë në maksimum vitin mësimor në KLO për ngritjen e tij profesionale dhe vetjake.

“Kohërat e ndryshimeve të mëdha sjellin një nevojë të qëndrueshme dhe të domosdoshme për të bërë më shumë në drejtim të zhvillimit të drejtuesve”

Sullivan dhe Harper

Hyrje

Një koncept i shkëlqyer mbi zhvillimin e udhëheqësve strategjikë vjen nga artikulli i Xhorxh B. Forsajt (George B. Forsythe) “Përgatitja e Udhëheqësve Strategjikë”. Forsajt (Forsythe) argumenton që përcaktimi i dikujt për zhvillim varet nga mënyra se si e formon ai konceptin. Këndvështrimi i parë është që ta shohësh udhëheqësin nga perspektiva e të mësuarit dhe ta konsiderosh zhvillimin e tij si “përvetësim të njohurive, aftësive dhe vlerave të shoqëruara me udhëheqje efektive”. Ky lloj zhvillimi do të thotë: “shtimi i vlerave të reja në morinë e vlerave”. Kur ne identifikojmë kërkesat e performancës strategjike, duke përdorur këtë metodë, njëkohësisht ne specifikojmë njohuritë dhe aftësitë e reja që do t’iu nevojiten udhëheqësve strategjikë.

Por udhëheqja në nivel strategjik është më shumë se përvetësimi i njohurive dhe aftësive; ky i fundit konsiston në “mënyrat e ndryshme cilësore të të bërit të gjërave”. Në këtë

kuadër, këndvështrimi i dytë është perspektiva zhvilluese. Kjo perspektivë përqendrohet jo në përvetësimin e njohurive, por në atë se si t'i interpretosh dhe çfarë të bësh me to (njohuritë). Metoda ose rruga për zhvillim “merakoset” më shumë se kush është drejtuesi dhe si e percepton ai botën. Kështu, kjo metodë është e interesuar më tepër në zgjerimin e kuadrit të referencës, vizionin perspektiv, ndërtimin e hartave mendore dhe në zhvillimin e kapaciteteve konceptuale se sa në shtimin e aftësive dhe njohurive.

Të gjithë drejtuesit me vetëdije ndërtojnë ose ngrenë një kuadër vetjak reference, ku bazë është shkollimi i tyre, përvoja, vetëstudimi, vlerësimi dhe si reflektohen këto në ngjarjet e ditës apo në situata të caktuara. Udhëheqësit e nivelit strategjik krijojnë një kuadër të plotë reference në funksion të organizatës së tyre dhe njëkohësisht, e vendosin këtë referencë në mjedisin strategjik. Për të ndërtuar një kornizë të dobishme, ata janë të hapur ndaj përvojave të reja dhe ndaj komenteve apo vërejtjeve të të tjerëve, duke përfshirë këtu edhe vartësit.¹ Ata reflektojnë, janë të matur dhe nuk kanë frikë të mendojnë sërish e të reagojnë ndaj përvojave të kaluara, me qëllim që të mësojnë prej tyre. Në këtë këndvështrim, procesi i zhvillimit të drejtuesit përfshin ndryshimin përshtatës në kuadrin e referencës së tij, meqë ai përparon në nivele më të larta të organizatës.

Kush i jep impulset për këtë ndryshim përshtatës? Në të shumtën e rasteve, është identifikimi ose njohja e faktit se ekzistenca e kuadrit të referencës nuk është e mjaftueshme për t'u marrë me kërkesat e kryerjes së detyrës që vihen para individit. Mendo për të si një qenie që është “jashtë zonës së komoditetit”. Kur një drejtues ndeshet me karakteristikat e paqëndrueshmërisë, pasigurisë, kompleksitetit dhe paqartësisë së mjedisit strategjik, të cilat nuk mund të shpjegohen me tërësinë e njohurive dhe ideve ekzistuese, gjendet një impuls apo nxitje për të zhvilluar ndryshimin përshtatës, duke çuar përpara sistemet që kanë të bëjnë me kërkesat. Si e nis një drejtues zhvillimin e kuadrit të ri të referencës dhe rritjen e kapaciteteve konceptuale? Ai përfshin dy hapa: **vetëvlerësimin** dhe **planifikimin e zhvillimit**.

Këto hapa japin pamjet e duhura që çojnë tek ndryshimet përshtatëse. Feedback-u krahasohet me vetëvlerësimin, ose konfirmon gjëra që ju pothuajse i keni ditur rreth vetes tuaj ose ju pajis me perceptime të reja. Nëse ju ndaloni në këtë pikë, gjithsesi, ju akoma nuk keni filluar procesin e ngritjes dhe të ndryshimit. Vetëm kur ju angazhoheni vetë në mbarëvajtjen e procesit të zhvillimit, vlerat e vërteta të procesit të vlerësimit realizohen ashtu siç duhen. Çështja kryesore në të cilën duhet të përqendroheni është: “Si mund të rris në maksimum nivelin profesional dhe vetjak?”.

Zhvillimi përfshin ndryshime gjatë gjithë ciklit jetësor dhe në çdo pjesë të jetës do të shoqëroheni me arritje dhe sfida. Hapi i parë në planin e zhvillimit është vetëvlerësimi. Megjithatë, procesi i vetëvlerësimit shkon përtej përdorimit të instrumenteve vlerësues të feedback-ut. Kur ju angazhoheni në vetëvlerësim, shikoni të gjitha fushat e jetës tuaj. Arsyetimi është i thjeshtë: jeta juaj është një njësi e integruar, është një sistem. “*Sa më i madh është integrimi i personalitetit të individit – thekson Erik From (Erich Fromm) në librin “Arratisje nga liria” – aq më e madhe është qartësia ndaj vetvetes, aq më e madhe është forca e tij. Njohja e vetvetes mbetet një nga kërkesat themelore, që synojnë të krijojnë*

¹ “Army Leadership, Competent, Confident and Agile” FM 6-22, October 2006, faqe 12-10.

*bazën e forcës dhe të lumturisë së njeriut*². Objektivat, aspiratat, sfidat dhe mundësitë apo shanset tuaja në një fushë, patjetër që do të kenë ndikimin e tyre në fushat e tjera. Një pyetje shumë e rëndësishme për t'ia adresuar zhvillimit është: “Si mund të arrij një drejtpeshim ose ekuilibër në jetën time?”

Profesioni

Çfarë po ndodh me jetën tuaj profesionale? Fakti që ju jeni përzgjedhur për të ndjekur Kursin Lartë të Oficerit do të thotë që ju jeni vlerësuar midis kandidatëve që kanë patur efektivitet më të lartë në detyrat ku keni shërbyer deri tani. Ju keni krijuar një emër të mirë në profesionin tuaj dhe keni arritur të emëroheni në poste të barazvlerësuar me gradën e nënkolonelit. Sipas Samuel Hantigton (Samuel Hantigton), *përgjegjësia dhe përkushtimi ndaj shoqërisë e ndaj aftësive dhe veçorive të profesionit ushqejnë dhe mbajnë gjallë motivin profesional*.³

Shumica e përvojës tuaj vjen nga nivele të drejtpërdrejta të drejtimit. Me udhëheqje të drejtpërdrejtë nënkuptojmë atë nivel drejtimi ku ndërveprimet janë në nivel personal dhe ballë për ballë. Kjo mënyrë drejtimi ushtrohet në ato organizata ku vartësit mund të shohin e kontaktojnë drejtuesit e tyre drejtpërsëdrejti gjatë gjithë kohës. Kufijtë e ndikimit të drejtuesit e drejtpërdrejtë, domethënë mjedisi ku drejtuesi mund të komunikojë e kontaktojë fizikisht me vartësit e tij, mund të jetë nga një pakicë deri disa qindra njerëz. Drejtuesit e nivelit të drejtpërdrejtë edukojnë e zhvillojnë vartësit e tyre një për një, gjithashtu ata ushtrojnë ndikimin e tyre në organizatë nëpërmjet vartësve të tyre. Për drejtuesit e nivelit të drejtpërdrejtë, mjedisi dhe problematika për zgjidhje paraqet më shumë siguri dhe më pak kompleksitet, krahasuar me drejtuesit në nivel organizativ dhe strategjik⁴. Drejtuesit e nivelit të drejtpërdrejtë ndodhen shumë afër vartësve, kështu që, shumë shpejt ata mund të shohin se si funksionojnë apo nuk funksionojnë gjërat dhe si të trajtojnë çdo problem të shtruar për zgjidhje. Në Forca (tokësore, ajrore, detare) udhëheqja e drejtpërdrejtë shkon deri tek niveli nënkolonel. Kur ju ndërveproni me pjesëtarët e komandës tuaj, ju jeni duke punuar në nivelin e udhëheqjes së drejtpërdrejtë. Shumë nga ju nuk mund të kenë pasur detyra në shtabe apo detyra në funksione specialistësh (si mirëmbajtjeje ose logjistike, etj.). Shumë nga ju nuk e kanë pasur fatin të shërbejnë në nivele të vendimmarrjes strategjike në komandat kryesore apo në shtabet e bashkuara. Pasi keni arritur majën e nivelit të drejtpërdrejtë të udhëheqjes⁵, ju duhet të bëheni gati për të kaluar në një nivel më të lartë.

Gjenden dy fusha të ndryshme ku rruga mund t'ju çojë në të ardhmen e afërt të profesionit tuaj. Disa nga ju do të vazhdojnë linjën e komandimit në nivelin kolonel e kapiten i rangut të I-rë, që ndoshta do të thotë të shkosh drejt një roli udhëheqjeje jo të drejtpërdrejtë. Duke iu referuar Teorisë së Sistemeve të Shtresëzuara⁶, kërkesat e përmbushjes së detyrave dhe kërkesat e postit në nivelin operacional të udhëheqjes janë shpesh ndryshe nga

² Erich Fromm “Arratisje nga liria”, Phoneix, Tiranë 2000, faqe 184

³ Samuel Hantigton “Ushtaraku dhe shteti”, SHBU, Tiranë 1995, faqe 13.

⁴ Prof. Dr. Ruzhdi Ramadani, “Lidershipi Strategjik”, Tiranë 2006, faqe 56.

⁵ Nënkolonel/kapiten i rangut të II-të.

⁶ Teoria e Sistemeve të Shtresëzuara është “trungu” i teorisë që shpall detyrat e lidershipit të nivelit të lartë, të cilat janë krejt ndryshe nga ato të niveleve më të ulët. Kështu, duke iu referuar shkallës së madhësisë së organizatave gjenden

ato të nivelit të drejtpërdrejtë. Shumë nga ju do të jenë duke punuar në një nivel të lartë shtabi siç janë shtabet e komandave kryesore, në drejtoritë e Ministrisë së Mbrojtjes, ose në Shtabin e Përgjithshëm, që i përkasin nivelit strategjik. Kështu, pjesë e zhvillimit tuaj duhet të jetë edhe përgatitja për të punuar në këtë nivel.

Disa nga ju mund të kenë qenë në funksione specialistësh, si specialistë prokurimesh, specialistë logjistike, analistë buxheti apo analistë sistemesh, etj. Ata mund ta kenë kaluar gjithë karrierën në një specialitet të ngushtë. Ata janë në një pikë tranzicioni, sepse duhet të shkojnë në një nivel më të lartë organizativ, të përparojnë në profesion dhe të zgjerojnë kuadrin e tyre të referencës.

Vetvetja

Çfarë gjasash keni që të provoni dhe përjetoni individualisht dhe personalisht këtë fazë të jetës suaj? Libri magjepsës dhe mbresëlënës i Geil Shihaj (Gail Sheehy), “Shtigjet e reja: Planifikimi i jetës tuaj nëpërmjet kohës”⁷, është strukturuar rreth fazave ose etapave të jetës dhe rrugëtimit që hasen midis këtyre fazave. Një nga pohimet e saj është që cikli tradicional i jetës, që ne jemi mësuar ta besojmë se do të ndodhë si më parë, nuk mund të zbatohet në ditët e sotme. Aq të mëdha janë ndryshimet në jetëgjatësinë e njeriut, sa që piketat referuese të përdorura më parë janë tepër të vjetruara sot. Për të kuptuar se çfarë është e mundur të ndodhë gjatë jetës në një moshë të caktuar, duhet që kuadri i referencës t’i përkasë brezit ose gjeneratës tuaj. Ju nuk mund të gjykoni se çfarë mund t’ju ndodhë në jetë, duke këqyrur përvojën e prindërve tuaj; e juaja do të jetë krejt ndryshe.

Shihaj (Sheehy) parashikon që rreth moshës 45 vjeç, shumë prej nesh do të jenë objekt tranzicioni ose ndryshimi, pasi kalojmë nga Moshë e Parë Madhore në Moshën e Dytë Madhore. Ajo e quan këtë tranzicion *midëllshencë* si një lojë fjalësh me termin adoleshencë. Teza e saj është se me rritjen e jetëgjatësisë, ata që janë në të dyzetat mund ta shohin të

tri shtresa niveli i lartë (strategjik), niveli i mesëm (operacional) dhe niveli i ulët (taktik). Drejtuesit pa përvojë të niveleve të ulët, përgjigjen për kryerjen e detyrave, kështu që ata përqendrohen në veprimet konkrete. Ata kanë pak liri veprimi apo autonomi në marrjen e vendimeve, në zbatimin e procedurave dhe në sjelljen e risive, sepse në nivelin e tyre të drejtimit, pandryshueshmëria e veprimit është e rëndësishme.

Nivelet e mesëm përgjigjen për vendosjen e objektivave afatmesëm dhe përpunimin e planeve, procedurave dhe proceseve që do të shfrytëzohen nga nivelet më të ulëta. Planet, procedurat dhe proceset e hollësishme janë mjete shumë të rëndësishëm për koordinimin e përpjekjeve, veçanërisht në organizatat e mëdha, me shumë reparte autonome që duhet të veprojnë në mënyrë të koordinuar. Gjithashtu, nivelet e mesëm përgjigjen për vendosjen e prioriteteve dhe shpërndarjen e burimeve për të përshtatur aftësitë tek nivelet më të ulëta. Kjo përfshin mbikëqyrjen e planeve të shpërndarjes së burimeve për të zbatuar konceptet e përpunuara prej niveleve të larta. Drejtuesit e **niveleve të lartë** përgjigjen për drejtimin strategjik të organizatës, brenda kuadrit të mjedisit strategjik e global. Termi “strategjik” nënkupton një fushë të gjerë, një model të përparuar vizioni që shtrihet në intervale të gjata kohore. Kështu, udhëheqja dhe vendimmarrja strategjike është një proces prej të cilit, këto organizata të mëdha janë përgjegjëse në vendosjen e direktivave afatgjatë dhe i arrijnë ato përmes ndërtimit të konsensusit, përkrahjes së nevojshme, dhënë personelit përkatës për angazhimin e burimeve.

⁷ Titulli origjinal i librit: “New Passages: Mapping Your Life Across Time”.

ardhmen e tyre në një moshë të re madhore që fillon nga 45 deri 75 e më shumë. Zonja Shihaj (Sheehy) e shikon këtë lëvizje drejt moshës së dytë madhore si një mundësi për një ngritje dhe zhvillim të pamasë. Tashmë nuk duhet ta konsiderojmë veten, që në fund të dyzetave fillon një cikël i gjatë i “perëndimit” apo i tatëpjetës drejt moshës së pleqërisë. Jo, veten duhet ta shohim si fillim i një moshe të re madhore, që mund të jetë po aq frytdhënëse sa edhe mosha e parë madhore.

Drejtueshimi (Ekuilibri)

“Si mund të vendosim një ekuilibër në jetën tonë?” Ajo që duket qartë nga reflektimi se çfarë po ndodh në jetën tuaj është që, para jush ndodhen kërkesa, sfida dhe mundësi të shumta. Pyetja shtrohet se si do t’i ndiqni, në të njëjtën kohë, këto synime e objektiva të shtrira në fushat e ndryshme të jetës? Përgjigja është: “Ju nuk mundeni”. Normalisht, ajo çfarë ndodh është se ne ndjekim objektivat e një fushe, në dëm të objektivave të fushave të tjera. Kështu, jeta jonë del jashtë ekuilibrit në secilën fushë si ajo profesionale, familjare, e komunitetit, ose e vetvetes.

Për shumicën, ekuilibri më i vështirë për t’u arritur është ai midis profesionit dhe familjes. Duke cituar Majk Miërs (Mike Mears), në librin “Elementet e Udhëheqjes”, ai shkruan: *“Qëllimi i mbajtjes së një ekuilibri nuk është të ndryshosh vendin e detyrës, nga të punuarit në punë në të punuarit në shtëpi. Të arrish ekuilibrin do të thotë të shpenzosh kohë me njerëzit të cilët janë të rëndësishëm për ju dhe të kryesh veprimtari që juve ju japin kënaqësi. Qëllimi juaj duhet të jetë zvogëlimi i stresit, rifreskimi i pikëpamjeve ose këndvështrimeve dhe të ushqyerit e shpirtit tuaj”*⁸. Në këtë kuadër, kërkesat profesionale për shumë nga ne janë aq të mëdha sa nuk mbetet kohë për ta kaluar me familjen ose të paktën nuk mbetet kohë me vlera të mjaftueshme.

Ju mund të provoni të njëjtin problem ekuilibrimi gjatë kohës që jeni në Kursin e Lartë. Ky vit shkollor përfaqëson një mundësi për të reflektuar, mësuar, përparuar ose, e thënë ndryshe, për t’u zhvilluar. Gjithashtu, ju mund të shpresoni që do të mund të përfitoni më tepër kohë prej normalitetit të punëve tuaja dhe të kaloni më shumë kohë me familjet këtë vit. Si do të arrini ju një ekuilibër të caktuar, po të marrim rastin që ky vit do t’ju sjellë një rritje profesionale, por gjithashtu, edhe ngritje në fushat e tjera? E vetmja mënyrë për të zgjidhur këtë dilemë është përcaktimi i prioriteteve. Vendosni objektiva në çdo fushë të jetës tuaj dhe pastaj, vendosni se cilët janë më të rëndësishëm. Nëse shikoni se jeta juaj nuk është në ekuilibër, heqja e disa objektivave nga një fushë mund t’ju japë mundësi për arritje në fushat e tjera.

Disa pyetje kyçe

Përveç pyetjes që shtroni para vetes se si të arrini ekuilibrin në jetën tuaj, gjenden edhe disa pyetje të tjera kyçe. Një nga këto është, *“Cilat janë sfidat kryesore me të cilat do të ndeshem në të ardhmen?”*. Një pjesë e madhe e dukurive apo ngjarjeve që ndodhin ju përgatisin për të përballuar sfidat më të rëndësishme të parashikuara. Për shembull, ne ju kemi sugjeruar që një sfidë shumë e rëndësishme profesionale mund të jetë përgatitja juaj për të punuar në fushën strategjike në një nivel më të lartë organizativ. Shembull i një sfide

⁸ Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, Universe, Inc. New York Bloomington 2009, faqe. 6.

tjetër të rëndësishme në fushën e familjes mund të jetë kujdesi për familjen apo për prindërit që po plaken. Hapi i parë themelor në planifikimin e zhvillimit dhe ngritjes tuaj është parashikimi i sfidave që çdokujt prej jush do t'i duhet të përballojë në të ardhmen.

Një tjetër pyetje është: “*Çfarë mund të kontrolloj?*” Disa momente në jetë janë jashtë kontrollit tuaj. Ju nuk mund të ktheni prapa procesin e plakjes. Megjithatë, në mënyrë kategorike, ju mund të zgjidhni stilin e të jetuarit, i cili mund të ngadalësojë ose përshpejtojë këtë proces (procesin e plakjes). Dhe në fushën profesionale, në njëfarë mënyre, emërimi nuk varet nga ju, por ju mund të përgatisni veten se si do ta përballoni emërimin në një post të caktuar. Një pjesë themelore e planifikimit të zhvillimit është pikërisht, se **ku** i keni preferencat tuaja në jetë dhe **kur** mund të ushtroni kontrole gjatë jetës suaj.

Hedhja e vështrimit drejt së ardhmes

“*Ku dëshiroj që të jem në të ardhmen?*” Ky është hapi i dytë në planifikimin e rrugës së jetës tuaj: përfytyrimi apo parashikimi i së ardhmes. Kthejeni vëmendjen drejt së nesërme. Shiko drejt së ardhmes dhe pyesni veten tuaj “*Ku dua të jem pas pesë vjetësh, pas dhjetë vjetësh, pas njëzet vjetësh?*” Kujtoni konceptimin që i bëri Shili (Sheely) moshës së dytë madhore si një shtrirje nga moshja 45 deri 75 e më shumë. Çfarë doni të bëni në moshën e dytë madhore? Thelbësore, në rrugëtimin e suksesshëm drejt moshës së dytë madhore, është të shikuarit e këtij kalimi si një zgjerim i mundësive për zgjedhje ose alternativa të reja dhe jo si kufizim i mundësive dhe mospasje hapësire për këto alternativa. Rritja e jetëgjatësisë na ka dhënë mundësi më të shumta, krahasuar me prindërit tanë, që ndoshta kurrë nuk e kanë pasur kohën për të ndërtuar një periudhë sa më të gjatë frytdhënëse në moshën e dytë madhore. Kjo do të na japë shanse të papara për ngritjen tonë, vetëm në qoftë se ne do t'i përkushtohemi tërësisht mundësive të dhëna. Llogarisni se ku mund të jeni pas pesë apo dhjetë vjetësh, ose ku do t'ju pëlqente të ishit.

Skeptikët thonë “Përse përfytyroni një të ardhme që nuk mund ta arrini?”. Nëse përfytyrimi i së ardhmes është një ëndërr rreth rezultateve të paarrtshme, atëherë ajo është një humbje e kotë kohe. Por, në qoftë se ju vështroni më nga afër ata që realizojnë ëndrrat e tyre, ju do të zbuloni se ata kurrë nuk heqin dorë nga ëndërimi se ku do t'iu pëlqente të ishin në të ardhmen. Ata pyesin veten, “*Çfarë mund të bëj për të arritur atje dhe për të realizuar objektivat e mia?*”. Pastaj ata bëjnë një plan dhe e zbatojnë atë pikë për pikë për të arritur synimet e tyre.

Përkushtimi apo angazhimi ndaj zhvillimit

Për të sjellë në vëmendje përsëri disa pyetje të tjera vendimtare ju duhet të pyesni. Së pari, “*A dua unë me të vërtetë t'i përkushtohem zhvillimit?*”. Gjenden mundësi të konsiderueshme për ngritjen dhe zhvillimin tuaj gjatë arsimit në vitin aktual në Kursin e Lartë të Oficerit. MekKoll (McCall), Lombardo (Lombardo) dhe Morison (Morrison) në “*Mësimet e përvojës: Sa i suksesshëm është zhvillimi i menaxherëve në punë*”, paraqesin një model për zhvillimin, i cili përfshin tre alternativa.

Alternativa e parë është njohja e të metave të tua ose identifikimi i fushave ku ka hapësira për ngritje dhe përmirësim. Të gjithë ne kemi pika të forta dhe të dobëta dhe në

⁹ Titulli i origjinalit, “*The Lessons of Experience: How successful Executives Develop on the Job*”.

qoftë se do t'i mposhtim pikat e dobëta apo të metat tona, alternativa e parë, me të cilën duhet të merremi, është të identifikojmë dobësitë tona. *Kur ju pranoni ndershmërisht të metat, ju jepni impulse për të përmirësuar ose rregulluar situatën, gjithashtu ju arrini diçka që do të ndihmojë organizatën tuaj në të ardhmen. Kështu, ju jepni një shembull ndershmërie dhe vartësit tuaj do ta ndjekin këtë sjellje*¹⁰. Në këtë ilustrim, autorët besojnë se, shpejt a vonë, ju do të detyrohemi të përballeni me të metat tuaja, sepse ato, gjithsesi, do të dalin në shesh, në një mënyrë apo në një tjetër.

ALTERNATIVA: Zbulo rreth	<----->	SHMANG: të metave
Prit për një katastrofë që të nxjerrësh në shesh një dobësi.	OSE	Ndiq në mënyrë aktive një portret të saktë të vetes.
- Shpejt ose vonë (gabim i madh)		- Merru me situata të reja
- Shpejt ose vonë (nuk u graduat, vlerësim negativ, ulje në gradë, lirim)		- Kërko për informacion
		- Kërko feedback
		- Shiko brendësinë

Alternativa e dytë është **pranimi i përgjegjësive për mangësitë e tua**. Nëse ju nuk pranoni asnjë përgjegjësi për dobësitë tuaja, atëherë nuk ka asnjë arsye që të përpiqeni për të bërë ndonjë korrigjim rreth tyre. Nëse ju jeni i prirur për t'i kapërcyer të metat, ju, patjetër duhet të pranoni përgjegjësitë për këto dobësi dhe paskëtaj të përcaktoni shkaqet e tyre. Kevin Kashman, në librin e tij "Udhëheqja nga brenda jashtë", ndër të tjera, trajton edhe kriteret që duhet të zbatojë një drejtues për të pasur një epërsi vetjake. Si kriter të parë, ai vendos: "Merr për vete tërë përgjegjësinë". *Nuk ka rëndësi se me çfarë sfide do të përballeni në jetë..., nuk ka rëndësi se në çfarë rrethanash do të ndodheni. E rëndësishme është përgjegjësia... Meqë ne marrim përgjegjësi gjithmonë e më tepër për jetën, ne përgatitemi të marrim përgjegjësi për të drejtuar të tjerët. Baza dhe themeli për udhëheqjen e vërtetë ndërtohet me vetudhëheqje, vetëpërgjegjësi, vetëbesim*¹¹. Përgjegjësia përmban besimin e njerëzve që punojnë për ju. Ja si shprehet R. Xhuliani në librin "Udhëheqja": "Më shumë se çdokush, udhëheqësit duhet të jenë të përgjegjshëm. Asgjë nuk mund të krijojë më shumë besim te një drejtues se sa kur ai tregon vullnet për të marrë përsipër përgjegjësinë ndaj asaj që ndodh, kur ai është në drejtim"¹².

¹⁰ Mike Mears, "Leadership Elements, a guide to building trust", Universe, Inc. New York Bloomington 2009, faqe 258.

¹¹ Kevin Kashman, "Leadership from the inside out, becoming a leader for life", second edition, Bertrett-Koehier Publishers, Inc. San Francisco, BK business book, 2009, faqe 55.

¹² Rudolph Giuliani "Udhëheqja", SHB "Dudaj", Tiranë 2006, faqe 85.

ALTERNATIVA: Pranimi i përgjegjësisë.		<—>	MOS PRANO Diagnoza e të metave.	
- Rezultat i mungesës së njohurive, përvojës ose aftësive.	OSE	- Rezultat i personalitetit, aftësive të pakta, ose mospërshtatje me situatat.		
- Rezultat i mungesës së njohurive,	OSE	- Rezultat i personalitetit, aftësive të përvojës ose aftësive të pakta, ose mospërshtatje me situatat.		

Alternativa e tretë është se **çfarë do të bëni për dobësitë tuaja**. Autorët sugjerojnë katër tipe strategjish, bazuar në diagnozën se përse ekzistojnë këto të meta: krijo forca të reja, parashiko situatat, kompenso dhe ndrysho vetveten.

Alternativa: Çfarë të bësh për këtë? < — > INJOROJE

Krij forca të reja	Parashiko situatat	Kompenso	Ndrysho vetveten
Gjej situata ku të mundësuarit e gjërave të reja është thelbësore	Bëj pyetje "të heshtura"	Shmang situata të veçanta	Konsultim intensiv, trajnim
Gjej mënyra për të ndihmuar dhe mbështetur ndërsa mund.	Kërko këshilla, konsultim	Delegoja të tjerëve	Përpjekje vetjake për ndryshim
	Shpenzo kohë duke mësuar	Zgjidh në shtab njerëz që mund të mbulojnë dobësitë	Ndrysho atë që është e mundur
	Përdor ekspertizën e të tjerëve	Ndrysho situatën	

Përkushtimi ndaj zhvillimit do të thotë njohja e fushave për zhvillim, marrja e përgjegjësisë për ngritje në këto fusha dhe hartimi i një plani se si do ta kryesh konkretisht këtë zhvillim. Nëse ju jeni të përkushtuar ndaj zhvillimit, dy pyetjet e fundit janë:

- Si mund ta shfrytëzosh sa më mirë vitin mësimor në KLO?
- Si mund të rris në maksimum mundësitë e mia për ngritjen profesionale dhe vetjake?

Përgjigjet që dalin nga këto pyetje do të përcaktojnë nëse ky vit, me të vërtetë do të jetë një vit transformimi, rritjeje, zhvillimi dhe ndryshimi për ju.

Përfundime

Siç u shprehëm në fillim, përvoja e Kursit të Lartë të Oficerit i shërben zhvillimit tuaj. Ndërkohë që ju keni kaluar modulën "Udhëheqja Strategjike", ne shpresojmë që ai t'ju

ketë dhënë impulsin e duhur për të nxitur disa mendime rreth zhvillimit dhe t'ju ndihmojë të mendoni rreth pyetjes që fillimisht, ju kërkua që të përqendroheshit: “Si do të rris në maksimum ngritjen profesionale dhe vetjake, gjatë vitit akademik në KLO?” Rëndësinë e kësaj pyetjeje e nënvizon Herri Boks (Harry Box), tek vepra e tij “Arti i imponimit”: “...duhet të jesh i mësuar; nëse do t’iu imponohesh të tjerëve, është e domosdoshme që të tjerët të besojnë se ti di më shumë se ata. Krijë një kulturë të gjerë, të larmishme, të gjallë. Studio, mëso, lexo”¹³. Prandaj, ndërsa jeni duke ndjekur Kursin e Lartë të Oficerit në Akademinë e Mbrojtjes, ne shpresojmë që ju do të vazhdoni të përqendroheni në zhvillimin tuaj si drejtues me një vizion të qartë për të ardhmen, duke shfrytëzuar çdo mundësi për të ngritur vërtet maksimalisht vlerat tuaja në fushën profesionale dhe vetjake.

Referenca:

1. Harry Box, “Arti i imponimit”, SHB “Shkolla e jetës”, Tiranë 1999.
2. Erich Fromm, “Arratisje nga liria”, Phoenix, Tiranë 2000.
3. Rudolph Giuliani “Udhëheqja”, SHB “Dudaj”, Tiranë 2006.
4. Samuel Hantigton “Ushtaraku dhe shteti”, SHBU, Tiranë 1995.
5. Kevin Kashman, “Leadership from the inside out, becoming a leader for life”, second edition, Berrett-Koehler Publishers, Inc. San Francisco, BK business book, 2009.
6. McCall, Lombardo dhe Morrison, “The Lessons of Experience: How successful Executives Develop on the Job”.
7. Mike Mears, “Leadership Elements, a guide to building trust”, Universe, Inc. New York Bloomington 2009.
8. Prof. Dr. Ruzhdi Ramadani, “Lidershipi Strategjik”, Tiranë 2006.
9. Gail Sheehy, “New Passages: Mapping Your Life Across Time”.
10. “Army Leadership, Competent, Confident and Agile”, FM 6-22, October 2006.

¹³ Harry Box “Arti i imponimit”, SHB “Shkolla e jetës”, Tiranë 1999, faqe 159.

Menaxhimi i Materialeve në strukturat e FARSH sipas Konceptit Logjistik të Integruar të Standardit të NATO-s

Nënkolonel Enrik Ago
Pedagog në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt. *Menaxhimi i Materialeve sipas Konceptit Logjistik të Integruar të Standardit të NATO-s është një nga Objektivat më të rëndësishme për FARSH. Ndërtimi i Sistemit të Mbështetjes Logjistike (SIL) në FARSH nevojitet për të mbështetur operacionet e strukturave të FARSH në vend dhe dislokime jashtë.*

Koncepti mbulon elementët operacionale që krijojnë Sistemin Logjistik Ushtarak të përafuar me standardet e NATO-s, që siguron kapacitetet e përbashkëta të nevojshme mbështetëse bazuar në nevoja për përmirësimin e Sistemit Logjistik (Kombëtar dhe NATO), Bazat Doktrinarë, Struktura Organizative, Funksonet e Përgjegjësitet, si dhe Sistemet e Proceset.

Nisur nga parimi bazë, që Mbështetja Logjistike në operacionet e NATO-s është një përgjegjësi kombëtare, komandantëve të çdo niveli do t’iu krijo-hen probleme dhe vështirësi për kryerjen e detyrës. Është kjo arsyeja, që autoritetet e NATO-s theksojnë nevojën e zgjidhjeve të përbashkëta dhe të krijimit të strukturave të Mbështetjes Logjistike, të cilat jo vetëm do të krijojnë siguri për ko-mandantët e formacioneve shumëkombëshe, por edhe do të sjellin përfitime ekonomike, sidomos për shtete me pjesëmarrje të kufizuar të trupave në operacion, përfshirë edhe vendin tonë.

Ky shkrim hedh dritë mbi konceptin doktrinar, sistemin e centralizuar të materialeve sipas klasave të furnizimit, përgjegjësitë dhe zbatimin e Menaxhimit të Zinxhirit të Furnizimit sipas Konceptit Logjistik të Integruar të NATO-s në operacionet shumëkombëshe të drejtuara nga NATO.

Hyrje

Menaxhimi i gjithë spektrit të materialeve (Klasa 1-5), që disponojnë strukturat e FA është një proces që ndikon drejtpërdrejt në kryerjen me sukses të operacioneve të përbashkëta në kuadrin e NATO-s.

Strategjia Ushtarake e RSH, synon shndërrimin e FA në forcë të aftë për të përballuar sfidat e sigurimit, të së tashmes dhe të së ardhmes, në interes të misionit të tyre kushtetues dhe të integritetit të vendit në strukturat euroatlantike. Zbatimi i Strategjisë Ushtarake në krijimin dhe shkallëzimin e materialeve është detyrim dhe përgjegjësi për të patur një

mbështetje logjistike të pandërprerë sipas misionit të parashikuar dhe realizimin e tij me sukses. Por që të arrihet një mbështetje e plotë dhe e pandërprerë i kushteve operacionale, logjistika synon të realizojë standardizimin e mjeteve dhe pajisjeve, kodifikimin, indeksimin e rezervave, hartimin e procedurave standarde, arritja e standardeve në përdorimin e gjuhës së përbashkët, etj.

Ne DPU-10 thuhet se një nga objektivat kryesore të operacioneve ushtarake në nivel strategjik është sigurimi i burimeve të nevojshme për mbështetjen e gjithanshme e në vijimësi te operacioneve ushtarake, që përfshin: burimet njerëzore, materiale, ekonomike e financiare për të siguruar fuqinë e domosdoshme luftarake në interes të realizimit të misionit brenda një kohe relativisht të gjatë. Për këtë ndërthuren masat që merren qysh në kohë paqeje me ato emergjente të kohës së luftës, sigurimi i rezervave të gjithanshme në sasinë e duhur dhe përdorimi racional i tyre në kohën e duhur e cila përbën çelësin e suksesit të operacioneve ushtarake.

Gjithë spektri i materialeve krijohen në funksion të misionit kushtetues të FA, sigurimi i tyre mbështetet në kapacitetet e disponueshme të komandave, buxhetin e mbrojtjes dhe burimet kombëtare. FA evidentojnë burimet kombëtare (publike apo private) në interes të misionit dhe në përputhje me legjislacionin përkatës, planëzojnë masa konkrete për përdorimin e tyre në rast nevoje.

Koncepti doktrinar për krijimin dhe menaxhimin e materialeve

Koncepti përmban bazat mbi të cilat do të ndërtohet Sistemi i Mbështetjes Logjistike të FARSH, që nevojitet për të mbështetur dhe siguruar operacionet në vend dhe dislokime jashtë vendit. Ai mbulon elementët operacionale që krijojnë Sistemin Logjistik Ushtarak të përafëruar me standardet e NATO-s, që siguron kapacitetet e përbashkëta të nevojshme mbështetëse bazuar në:

- Nevoja për përmirësimin e Sistemit Logjistik (Kombëtar dhe NATO),
- Bazat Doktrinarë,
- Struktura Organizative,
- Funkcionet dhe Përgjegjësitë,
- Sistemet dhe Proceset.

Kërkesat operacionale të Strategjisë Kombëtare Ushtarake kërkojnë që FARSH të transformojë vetveten në një forcë të lëvizshme, të dislokueshme, të qëndrueshme dhe ndërvepruese, ku implikimet logjistike janë:

- E Lëvizshme: Një forcë “më e lehtë” në kapacitetet e sistemet e armëve luftarake dhe jo-luftarake, ML, SHML (Shërbime të Mbështetjes Luftarake), dhe e transportueshme,
- E Dislokueshme: Personeli i njëjësive, pajisjet dhe furnizimet janë më të lëvizshme dhe të konfiguruar në mënyrë më efikase për transport; sistemet e ndërveprimit të transportit ajror, detar dhe tokësor.
- Të Qëndrueshme: Sistemi SH.U.L dhe organizatat SHML dhe kapacitetet e tyre janë të ndërveprueshme dhe sigurojnë për mbështetjen e vazhdueshme dhe të pandërprerë në vend dhe jashtë tij.

Synimi është që Operacionet Logjistike (OPLOG) të FARSH - sistemi SHML, të jenë të përputhshëm dhe të ndërveprueshëm me sistemet e NATO-s, bazuar në burimet, kapacitetet dhe limitet kombëtare të FARSH.

Sasia e materialeve (Kl. 1-5) të krijuara dhe përshkallëzuara (sipas Procesit të Ditëve të Furnizimit DOS) - “sasia totale e furnizimeve të nevojshme për një ditë mesatare bazuar në vlerat e Grupit të Përhershëm Logjistik të NATO-s dhe/ose vlerat kombëtare sipas rastit”, në funksion të misionit të strukturave të FARSH, janë baza për mbështetjen reale logjistike në operacione dhe përdorimi i tyre i standardizuar do të varet nga:

- a. Prioritetet që kanë përdorimi i strukturave të FA, pasi s’është e mundur financiarisht të plotësohen paralelisht në nivele të plota logjistike, në funksion të qenies operacionale këto struktura.
- b. Kushtet operacionale të organizimit dhe të zhvillimit të operacioneve (problemet dhe lehtësirat), ku do të zhvillohet një operacion shumëkombësh, që nënkupton dhe krijimin e skalionimin e materialeve jo të njëjta. Kështu që nuk mund të bëhet një zgjidhje e njëjtë për krijimin dhe skalionimin e materialeve për strukturat në varësi të FT, FD apo FAj, për një operacion të caktuar, nëse nuk merren parasysh me parë misioni operacionale, që do të zhvillojnë këto struktura. Në lidhje me sa më lart, me rëndësi është zbrërthimi i detyrave të logjistikës në mbështetje të planeve operacionale nga organet përkatëse, për krijimin e ngarkesave operacionale logjistike sipas standardeve të NATO-s.

Parimet që ndiqen për krijimin dhe menaxhimin e materialeve

Menaxhimi i materialeve është monitorimi i gjendjes faktike, sigurimi i kontrollit të cilësisë, katalogimi, përcaktimi i kërkesave, porositja e materialeve, mirëmbajtja e stokut, mirëmbajtje, tjetërsimi, dhe shpërndarja (furnizimi dhe transporti) i materialeve. Sistemi i Menaxhimit të Materialeve kërkon strukturë organizative efikase, standarde pune, modele veprimi dhe proces prokurimi, gjithashtu një model efikas operacional të Sistemit të Mbështetjes Logjistike, që është i ndërtuar për të mbështetur një Cikël Jete të vazhdueshëm.

Kërkohej një Sistem i Informacionit Logjistik Funkcional (përdorimi i kodeve dhe materialeve standard të integruar sipas NATO-s), i siguruar nga një Sistem (SIL) i automatizuar. FARSH ka nevojë për një (SIL) që të përfshijë kërkesat dhe informacionet që lidhen me Furnizimin, Mirëmbajtjen dhe Menaxhimin e Burimeve Financiare, që të ofrojë një pamje të përgjithshme me informacione aktualë, të rëndësishëm dhe të përdorshëm.

SIL ofron mbështetje me software dhe hardware për Qendrën e Menaxhimit të Materialeve (QMM)- brenda strukturës së Brigadës Logjistike, këshillon shefin e QMM dhe stafin për çështjet e përpunimit automatik të të dhënave të (PDSH) dhe të teknologjisë së informacionit (IT) dhe menaxhon automatizimin e përditësuar të operacioneve të QMM.

Modeli operacional i Sistemit të Mbështetjes Logjistike është i ndërtuar për të mbështetur një Cikël Jete të vazhdueshëm “nga fillimi në fund”. Modeli i veprimit Logjistik të FASH duhet të ndërtohet për të mbështetur madhësinë dhe kërkesat e FASH dhe duhet të sigurojë një metodë të vazhdueshme, sistematike dhe logjike që klienti i FASH të parashikojë,

kërkojë, marrë, përdorë dhe të kthejë materiale dhe shërbime për Furnizimin & Shërbimet, Riparimin & Mirëmbajtjen, Lëvizjen & Transportin dhe Mbështetjen Mjekësore.

Nivelet e krijimit dhe ruajtjes së materialeve

Në Strategjinë Ushtarake të Republikës së Shqipërisë thuhet se “Objektivi kryesor i planifikimit të burimeve të mbrojtjes do të jetë sigurimi i kapaciteteve operacionale të kërkuara nga FA për realizimin e misionit të tyre, si dhe mundësimi i përdorimit me efektivitet të burimeve të disponueshme”. Planifikimi dhe zhvillimi i infrastrukturës kombëtare duhet të mbajë parasysh përdorimin e saj nga FARSH në situata të ndryshme të përmbushjes së misionit të tyre, si dhe realizimin e detyrimeve të Vendit Pritës në mbështetje të operacioneve të Aleancës. Gjithë burimet materiale që vihen në dispozicion të FA, si nëpërmjet prokurimeve nga buxheti i mbrojtjes, ashtu edhe nga ndihmat e aleatëve dhe partnerëve, synohet të jenë në përputhje me standardet e NATO-s. Sigurimi i sasisë së mjaftueshme të burimeve për mbrojtjen dhe standardizimi i tyre përfshin të gjitha fushat e mbështetjes logjistike të FA.

Operacionet e FA planëzohen dhe kryhen në tre nivele: taktik, operacional dhe strategjik. Logjistika si lloj kryesor i mbështetjes me shërbime të FA, ndihmon komandantët për krijimin dhe mbështetjen e fuqisë luftarake dhe është faktor i rëndësishëm për këto operacione.

Rezervat materiale caktohen në njësi/reparte me urdhër të eprorit mbi bazën e një studimi për veprimet e pritshme (planin operacional), si dhe duke patur parasysh dhe faktorë të tjerë të lëvizshmërisë, kapacitetit, aftësisë menaxhuese të tyre dhe autonomisë.

NATO përkufizon Rezervat e Materialeve Operacionale si pajisje (automjete luftarake & jo-luftarake, komunikacion, speciale dhe pajisjet kimie) dhe rezerva materiale (furnizimet). Rezervat e Materialeve janë kategorizuar nga Klasat 1-5 të furnizimit të NATO-s dhe menduar për të mbështetur dhe siguruar njësitë operacionale dhe taktike, në vend dhe jashtë tij, bazuar në misionet, vendndodhjen dhe intensitetin për të gjithë kohëzgjatjen e operacionit.

Sasia e materialeve që i nevojiten strukturave të FASH është e matur në disa mënyra, bazuar në pajisjet dhe kërkesat operacionale, por procesi i zakonshëm që mbështet Programi i Gjendjes së Materialeve, quhet ai i Ditëve të Furnizimit (DOS), ku përkufizohet si “sasia totale e furnizimeve të nevojshme për një ditë mesatare bazuar në vlerat e Grupit të Përhershëm Logjistik”.

Menaxhimi i materialeve në funksion të operacionalitetit të Shërbimeve të Mbështetjes Luftarake (SHML)

Programi i Rezervave Materialeve është i bazuar në parimin që strukturave të FASH i nevojiten për tipe dhe sasi specifike materialesh (pajisje dhe materiale), për të siguruar sasi të mjaftueshme të rezervave operacionale gjendje në depo (në përdorim), në porosi, dhe rezervë të mjaftueshme në nivelet operacional dhe taktik të mbështetjes.

Menaxhimi i Programit të Rezervave Materiale përfshin proceset e mëposhtme:

- Identifikimi i kërkesave, porositja ose kërkesa për artikuj materialesh,

- Burimi, Marrje hyrje, Magazinim, Shpërndarje, Kthimi dhe tjetërsimi i gjendjes së materialeve,
- Gjurmimi dhe menaxhimi i parashikimit të artikujve të materialeve dhe inventarizimi i tyre, dhe gjendja e tyre fizike e operacionale.

Sistemi i Automatizuar i Informacionit Logjistik gjurmon stoqet në secilin nivel mbështetje, shtyn furnizimet sa më përpara që të jetë e mundur mbështetur nga transporti, gjurmon menaxhimin e inventarëve, gjurmon koston e ciklit jetësor të pajisjeve, dhe përdor “kontraktim-terreni” në dislokim. Ky funksion zgjidh problemet e sistemit dhe menaxhimin e operacioneve të përditshme të SIL, pranimin, shpërndarjen, dhe kontrollin e inputeve dhe outputeve të konsumatorëve për të garantuar përpunimin e duhur në përputhje me procedurat e përcaktuara të Modullit të Furnizimit, përpunimin dhe kontrollin e dokumenteve të marra nga vendet e magazinimit, depot dhe njësitë e mbështetjes, mirëmbajtjen e sistemit të automatizuar SIL të gjithë FASH, kryen zbritje të dhënash dhe ndarje ciklesh, menaxhon të dhënat e përpunuara dhe organizon e rishikon të dhënat e papërpunuara para përpunimit.

Menaxhimi i Materialeve nuk mund të funksionojë pa qenë efikas procesi i prokurimit të materialeve, njëkohësisht s’ mund të ketë mbështetje logjistike të plotë dhe të shpejtë pa një proces prokurimi efektiv.

Procesi i identifikimit të kërkesave, që përdoret aktualisht, si për investimet e zakonshme dhe ato kapitale (pajisje të mëdha ose sisteme armatimi) duhet të jetë më përgjegjës dhe efikas, kjo nuk është një detyrë e lehtë, por ka procese që mund të bëhen më efikase dhe ndërkohë që kryhen ndryshimet e rregullave.

Këto përfshijnë:

- Të qenurit të aftë për të parashikuar kërkesat e materialit,
- Parashikimi dhe planifikimi i prokurimeve për investime kapitale në pajisje për t’iu përshtatur modernizimit logjistik,
- Lidhja e kërkesave të materialeve që nevojiten (të mëdha, të vogla) me procesin e Planifikimit, Programimit dhe Buxhetimit (PPB).

Standardizimi dhe kodifikimi i materialeve në strukturat e FASH

Standardizimi është tërësia e kërkesave që caktohen si të detyrueshme për një lloj rezerve, për grupe rezervash, ose për proceset e përdorimit të tyre. Standardizimi i rezervave, pajisjeve, makinerive, mjeteve të transportit dhe materialeve, bëhet që këto t’i përshtaten sa më mirë kërkesave të operacionit, dhe të afrohen me strukturat e NATO-s. Qëllimi është që të plotësohen sa më mirë kërkesat në operacionet e përbashkëta dhe të përfitohet nga furnizimi, shërbimet, riparimet e përbashkëta, etj.

Kodifikimi është një sistem numrash, që përdoren si mjet për të identifikuar rezervat, pa shkruar emrin, cilësitë, vendin e prodhimit të rezervave, etj. Këto identifikohen me numra a grup numrash të standardizuara nga NATO, për të siguruar bashkëveprimin e logjistikave a organeve të tjera në njohjen e materialeve, nëpërmjet gjuhës së shifrave. Ne objektivin e forcës FG-4055 kërkohet që Sistemi i Automatizuar i Informacionit Logjistik (SIL) i FASH dhe Sistemi i Menaxhimit të Materialeve të jenë ndërtuar bazuar

në Sistemin e Kodifikimit të NATO-s (SKN).

(SKN) është gjuha e furnizimit, që lehtëson bashkëveprimin, eliminon dublikimet, lehtëson shkëmbyeshmërinë, maksimizon mbështetjen logjistike dhe siguron kursime financiare të konsiderueshme. Thelbi i operacioneve logjistike (burim, porosi, marrje, magazinim, shpërndarje, kthim, tjetërsim) është i ndërthurur dhe drejtohet nga identifikimi i saktë i pajisjeve bazuar në SKN, i cili krijon bazat për qëllimet e mirëmbajtjes, artikujve të furnizimit, inventarizimit. Çdo artikull (Klasat 1-5 NATO) identifikohet si një Artikull Furnizimi (AF), çdo AF emërohet, përshkruhet, identifikohet dhe klasifikohet në mënyrë që të njihet vetëm nga një Numër Stoku NATO (NSN) 13 shifror. NSN identifikon çfarë nivelesh furnizimi dhe mirëmbajtjeje janë të autorizuara, gjatë Menaxhimit të Ciklit të Jetës së Materialit, për ta mbështetur atë.

Bashkëpunimi i logjistikave brenda forcave dhe midis forcave, në kuadrin e operacioneve të NATO-s, bazohet në faktin që forcat dhe shtetet mund të komunikojnë me një gjuhë standarde në fushën e menaxhimit të materialeve, e cila përmbledh në një kod llojin e materialit, prodhuesin, dhe të dhëna të tjera që e identifikojnë lehtësisht materialin që kërkohet. FARSH trashëgojnë një sistem kodifikimi të ndryshëm nga ai i NATO-s, i cili e bën të vështirë bashkëpunimin e logjistikave, të forcave, midis tyre, dhe në kuadrin e operacioneve të NATO-s, etj, pasi forcat dhe shtetet nuk mund të komunikojnë me pjesëmarrës që përdorin gjuhë të ndryshme në fushën e menaxhimit të materialeve. Në këtë rast për të realizuar bashkëpunimin e logjistikave do të duheshin shpjegime të gjata për të identifikuar dhe për të menaxhuar materialet, në një kohë që ndërtimi i një kodifikimi të përbashkët midis forcave, sipas modelit të NATO-s, do të krijonte një gjuhë standarde në fushën e menaxhimit të materialeve.

Adaptimi i konceptit të kodifikimit të NATO-s konsiderohet si një masë e rëndësishme në fushën e logjistikës për të siguruar nderveprueshmëri dhe mbështetjen efektive të logjistikës. Koncepti i kodifikimit të NATO-s nuk përshkruan vetëm rregullat dhe procedurat për kodifikimin e materialeve, por ai ka gjithashtu një sistem të plotë dhe të zhvilluar për shkëmbimin e informacioneve midis vendeve anëtare e organizatave dhe siguron dukshmëri për secilin nga materialet e kodifikuara, për përdoruesit dhe prodhuesit.

Implementimi i kërkesave përfshin, por nuk është i limituar tek zhvillimi i një sistemi kombëtar kodifikimi të përputhshëm me atë të NATO-s në gjendje për të vendosur dhe kontrolluar numrat e artikujve dhe proceset e tjetërsimit të pajisjeve të vjetra. Sistemi duhet gjithashtu të identifikojë detajet e lidhura me 'jetën në raft', ndërrueshmërinë, përdorimin e kufizuar, kategorinë e riparimit dhe materialet e rrezikshme, dhe duhet gjithashtu të sigurojë inventarizimin dhe fleksibilitetin operacional.

Principet që ndiqen për menaxhimin e materialeve

NATO Force Goal G 4055 Menaxhimi i Zinxhirit të Furnizimit: Në fillim të 2010, të mundësojë që personeli i furnizimit që dislokohet në operacione të NATO-s dhe në mbështetje të tyre të jetë i familjarizuar me proceset e furnizimit të Aleancës. Zhvillimi i vizibilitetit në kohë reale për të gjithë artikujt e furnizimit dhe pajisjeve parashikimi për shpërndarjen, në gjendje, transit, të dislokuar dhe të planifikuar për tjetërsim. Zhvillim i mjeteve (mënyrave) kombëtare për parashikimin e kërkesave për pjesë këmbimi fillestare për pajisjet e reja dhe përlogaritja e magazinimit (*stockpile*) të 90 ditëve operationale. Një mënyrë e shkallëzuar për të arritur këtë objektiv përfshin:

- Vazhdimi i futjes së kapaciteteve të përputhshme me të NATO-s bazuar në ndjekjen e dorëzimeve.
- Zhvillimi i kapacitetit të ndjekjes së artikujve siç identifikohet në PG G 2860.

Modeli i Menaxhimit të Furnizimit/Materialeve (prioritet kryesor Logjistik) është i përbërë nga të paktën 11 modele procesesh, që janë të ndërlidhur me njëri-tjetrin për të ndarë informacion dhe për të krijuar një sistem informimi të integruar, të cilët janë:

- Parashikimi dhe Planifikimi i Kërkesave, Burimeve të Furnizimit, Kontrata, Blerje dhe Inventar të Materiale,
- Transferim ndërmjet Njësive, Dërgimi i Problemeve të Materialeve, Kthimi i Kërkesave për Tjetërsim.

Krijimi dhe shkallëzimi i rezervave materiale bëhet nëpërmjet sigurimit të veprimit të bashkërenduar të principeve të logjistikës, pa të cilat nuk do të kishim një planëzim real, efikas në kohën dhe vendin e duhur, në funksion të realizimit të misionit të FA, për mbështetjen logjistike të tyre në çdo situatë. Në kuadrin e Aleancës mëvetësia nevojitet për të siguruar detyrat specifike që do të kryejnë FA, këto kushtëzojnë nevojën organizative të logjistikës që t'u sigurohet mëvetësia më e madhe njësive dhe reparteve nga ana e sigurimit material. Kjo arrihet kur njësitë, repartet a nënrepartet kanë në strukturën e tyre organike reparte mbështetëse, rezerva e struktura logjistike në masën e nevojshme për të realizuar në çdo kohë, vend e situatë luftarake mbështetjen e plotë logjistike.

Qendra e Menaxhimit të Materialeve

Misioni i saj është të sigurojë njësitë operacionale dhe njësitë teknike të FASH me menaxhim të centralizuar dhe të integruar të materialeve për Klasat e NATO-s për Furnizim 1, 2, 3, 4, 5 dhe mirëmbajtjes. Për të përmbushur misionin e saj, ajo përcakton kërkesat për zhvillimin dhe mbikëqyrjen teknike të niveleve të autorizuara të rezervave dhe menaxhon Sistemin e Informatizimit Logjistik të Automatizuar (SIL). Kërkesat përmes procesit të prokurimit, të gjitha furnizimet e nevojshme autorizuar nga FASH dhe menaxhon shpërndarjen e tyre pas marrjes në përdorim të FASH. Menaxhon të dhënat e pronave të FASH (pajisje dhe materiale). Krijon dhe mban një libër të centralizuar të pronës për të gjitha njësitë e FASH. Menaxhon ngarkesën e punës për mirëmbajtjen e njësive të FASH dhe nivelit 3-4 të Mirëmbajtjes Operacionale. Menaxhon nivelin e dytë Pjesë Riparimi/Mirëmbajtje për FASH dhe nivelin e dytë për sistemin e mbështetjes mjekësore. Menaxhon shpërndarjen e materialeve të FASH përmes transportit të konsoliduar dhe operacioneve në depo.

Për të ndjekur këtë proces të rëndësishëm të menaxhimit të materialeve në vartësi të kësaj Qendre janë disa zyra dhe sektorë të cilët do të ndjekin më nga afër këtë proces, për të patur një kontroll sa më të efektshëm të menaxhimit të tyre.

Këta zyra dhe sektorë përgatitin, shqyrtojnë dhe miratojnë planet e detajuara dhe politikat për furnizim dhe operacionet e mirëmbajtjes nga një këndvështrim i administrim/mbështetjes. Mirëmbajnë, përmes Sistemit të Informatizimit Logjistik (SIL), statusin e menaxhimit të materialeve dhe profilin e gatishmërisë logjistike të FASH, ofrojnë kërkim katalogu dhe shërbime korrigjimi, zhvillojnë kërkesat për operacionet e tanishme dhe të paparashikuara, gjithashtu analizojnë dhe ndihmojnë në zhvillimin e pjesës së furnizimit (anekset) të operacioneve logjistike ose urdhrave administrativë.

Sektori i menaxhimit të mirëmbajtjes, mirëmban dhe klasën e 2-të (pjesë riparimi) për FASH, harton dhe menaxhon inventarin e klasës 2-pjesë riparimi të FASH dhe drejton çështjet për Klasën 2-pjesë riparimi, bazuar në nevojën dhe kërkesat për gatishmërinë operative.

Përfundime dhe rekomandime

Një ndërthurje efektive e sektorit shtetëror me atë privat, siguron burime materiale cilësore dhe në kohën e duhur, për mbështetjen e objektivave të mbrojtjes. Burimet e pamjaftueshme materiale, kërkojnë rritjen e efikasitetit të shfrytëzimit të tyre me qëllim që me burimet e disponueshme, të sigurohet arritja e objektivave për mbrojtjen e vendit dhe për kontributin në kuadër të NATO-s.

Krijimi dhe përshkallëzimi i rezervave materiale të bëhet duke u bazuar në kërkesat dhe prioritetet për mbështetjen e forcave në përputhje me planin operacional, pasi strukturat, rajonet e detyrave luftarake, mënyra e veprimit për mbështetje është e ndryshme për llojet e forcave.

Gjatë krijimit të rezervave duhet të merren parasysh problemet e shumta pasi ato mbeten një komponent i rëndësishëm i misionit të FA, probleme të cilat kanë rezultuar gjatë magazinimit dhe administrimit të rezervave materiale, vështirësi në trajnimet e ndryshme, automatizimi apo modernizimi akoma i vjetruar i shërbimeve të mbështetjes logjistike, e cila ul ndjeshëm gatishmërinë e vënies në përdorim të rezervave.

Vizioni i zhvillimit të rezervave materiale të FA ka si qëllim zhvillimin dhe reformimin e tyre. Iniciativat e zhvillimit të planit të rezervave janë të dizenuara për të lejuar zhvillimin e infrastrukturës aktuale të logjistikës, për të rritur gatishmërinë e njësisve e reparteve, dhe për të mundur logjistikën që të zhvillohet në një spektër të plotë, bazuar në sistemin e shpërndarjes që përfshin shpejtësinë e shpërndarjes dhe teknologjinë e plotë të informacionit të tyre.

E gjithë mbështetja direktet e FARSH dhe Shërbimet e Mbështetjes Luftarake si pjesë e mbështetjes së përgjithshme, e cila ka për mision furnizimin sipas standardeve të sistemit të furnizimit, do t'u mundësojë atyre që të sigurojnë kontrollin e menaxhimit të materialeve si dhe buxhetin për mbështetjen e përgjithshme dhe magazinimin e materialeve dhe pajisjeve.

Menaxhimi i materialeve do të kryhet nga Qendra e Menaxhimit të Materialeve, pra një organizëm i vetëm, e cila është plotësisht në gjendje të realizojë sigurimin dhe shpërndarjen e materialeve, gjë e cila siguron përdorimin sa më efikas të burimeve dhe mbështet gatishmërinë operacionale të FASH. Gjithashtu ofron menaxhimin e centralizuar dhe të integruar të materialeve në Klasat 1-5 të furnizimeve dhe menaxhimin e centralizuar të mirëmbajtjes së pajisjeve.

Referencat:

1. Doktrina e Përbashkët e Forcave të Armatosura të RSH (DPU-10), 2004.
2. Doktrina e Mbështetjes Logjistike e Forcave të Armatosura të RSH, 2004.
3. MC 319/2-NATO Principles and Policies for Logistics, 2003.
4. AJP-4.6 (A)-Multinational Joint Logistic Centre Doctrine (MJLC), 2001.

5. Koncepti i Mbështetjes Logjistike të Integruar sipas Standardit të NATO-s,
6. SHP i FA (J-4), shtator 2010.
7. Menaxhimi i Materialeve: Përbërësit, Funkcionet & Përgjegjësitë, Organizatat dhe Plani i Veprimit për Implementim, SHP i FA (J-4).

Fuqia dhe Roli i Informacionit në Sigurinë Kombëtare

Nënkolonel Hysni Gjergji
Shef i Sektorit të Menaxhimit të Informacionit
Drejtoria e Zbulimit

Abstrakt. Çdo shtet, meqë ka specifika të ndryshme në elementet e Sigurisë Kombëtare¹, dhe për rrjedhojë, menaxhon dhe i jep përparësi atij ose atyre elementëve të cilët gjykojnë më dominues për këtë shtet. Shtete të mëdha i japin më shumë rëndësi komponentëve ekonomikë dhe shtete më të vogla, diplomacisë, aleancave, mbrojtjes kolektive apo fuqisë së informacionit që këto shtete janë të afta të grumbullojnë, që posedojnë dhe që lidhet me ekonominë, diplomacinë, shkencën e teknologjinë, mbrojtjen, etj.

Informacioni që e zotëron këtë fuqi nuk duhet të ekuivalentohet vetëm me informacionin mediatik që qarkullon në internet apo burime të tjera të hapura dhe që është shumë i bollshëm. I tillë është ai informacioni i cili prodhohet nga shërbimet e inteligjencës civile dhe ushtarake të vendit, si produkt analitik i një game të gjerë burimesh të hapura, sekrete dhe konfidenciale, si kooperim teknologjish, disiplinash, efektiviteti dhe dobësisht dhe, më e rëndësishmja, ky produkt informativ parashikon pritshmëri dhe iu serviret politikëbërësve dhe vendimmarrësve të vendit.

Nga ana tjetër, duhet të marrim parasysh që jetojmë në epokën e “cyber-crime”², si shkelje ligji; dhe të “Wikileaks”, si shkelje e parimit kryesor në punën me informacionin e klasifikuar, të njohur me termin “need to know”³, në emër të transparencës, të cilat dëmtojnë, ulin dhe komprometojnë, në mënyrë të paimagjinueshme, fuqinë e informacionit.

I- Informacioni si komponent i Fuqisë⁴ Kombëtare

¹ “Siguria kombëtare” është kërkesë për të ruajtur mbijetesën e shtetit, nëpërmjet përdorimit të fuqisë ekonomike, ushtarake, politike dhe ushtrimit të diplomacisë. Ky koncept është zhvilluar kryesisht në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, pas Luftës së Dytë Botërore.

² Krimi në haptesirën kibernetike

³ Term gjersisht i përdorshëm në fushën e informacionit të klasifikuar i cili percakton “nevojen për njohje” si një nga kushtet e që një person duhet të plotësojë për të qenë perdorues i këtij informacioni ⁴ “Fuqia është aftësia për të influencuar sjelljen e të tjerëve, me qëllim për të marrë rezolutën e kërkuar. Historikisht, fuqia ka qenë matur me kriteret e numrit të popullsisë, madhësisë së territorit, burimet kombëtare, fuqinë ekonomike, forcën ushtarake dhe stabilitetin social. “Hard power” i detyron të tjerët të

Fuqia Kombëtare e një kombi tani nuk është më vetëm një term filozofik por, madje, një shkencë e cila kalkulon shkencërisht çdo element natyror ose social të kësaj fuqie⁵. Fuqia Kombëtare, nga studiues dhe strategë politologë, pranohet të ketë komponentët përbërës natyrorë dhe jo natyrorë. Këta komponentë janë mjaft të ndërlikur mes tyre dhe mjafton që vetëm njëri nga këta të jetë i dobët dhe e gjithë fuqia kombëtare dhe, për rrjedhojë siguria kombëtare si e tërë, do të jetë e dobët. Nga ana tjetër, duhet konsideruar edhe koncepti i fuqisë kolektive, pasi një vend si Shqipëria, anëtare e NATO-s kontribuon por edhe përfiton fuqi dhe, për rrjedhojë, siguri nga aleanca. Në Konceptin e Ri Strategjik të vitit 2010, NATO, për herë të parë, ka përfshirë, përveç 28 vendeve anëtare, edhe kontributin e 32 vendeve jo anëtare; më shumë se 90 OJQ (NGO); 30 korporata dhe agjenci ndërkombëtare si dhe më shumë se 4500 individë që punojnë për aleancën. Pra, edhe vetë NATO nuk e mbështet fuqinë e saj vetëm në shumatoren e fuqive të 28 anëtarëve të saj, por merr parasysh edhe kontribuues të tjerë.

Menaxhimi apo llogaritja e fuqisë kombëtare është aftësia e integritit të këtyre komponentëve dhe arritja e funksionimit të tyre në një mënyrë të koordinuar, efektive dhe të harmonizuar, si në kohë paqe ashtu edhe në kohë krizash e lufte, me qëllim arritjen e rezultatit maksimal⁶. Evoluimi i konceptit të menaxhimit të sigurisë kombëtare, në dekadat e fundit, ka identifikuar edhe disa nënkomponentë të tjerë, përfshirë këtu edhe *fuqinë e butë*,⁷ të cilët kërkojnë të njëjtën vëmendje për ruajtjen e sigurisë kombëtare. Përveç këtyre edhe rreziku i mosmenaxhimit, ndërprerja e kontrollit të menaxhimit, zbutja dhe menaxhimi i pasojave të katastrofave-qoftë kur këto janë të karakterit natyror, ose të shkaktuara nga njeriu-si dhe menaxhimi i rimëkëmbjes kombëtare janë faktorë ndikues në performancën e sigurisë kombëtare.

Kërcënimet jo konvencionale, që vijnë nga aktorët jo shtetërorë, janë po kështu komponentë që ndikojnë në sigurinë kombëtare: të tillë si grupet rebele, terroristët, kriminelët ndërkombëtarë, trafikantët e narkotikëve, falsifikatorët, përhapësit e ADM-ve, të cilët, relativisht, në vende të ndryshme, janë rritur. *“Ne nuk kemi luksin të vendosim se për cilën sfidë duhet të përgatitemi dhe cilën duhet ta injorojmë. Ne duhet të merremi me të gjithë spektrin e kërcënimeve: konvencionale ose jo, shtetërore ose rrjete terroriste, përhapjen e teknologjive vdekjeprurëse apo ideologjive të urrejtjes, piratin e modelit të shekullit të 18-të dhe kërcënimin e krimit kibernetik të shekullit 21-të.”*⁸

Shekulli i 21-të ka shënuar edhe një shtim të elementëve anësore të fuqisë kombëtare si

bëjnë dhe të sillen sipas interesit të poseduesit të kësaj fuqie, sipas teorisë së “shkopit dhe karotës.” “Soft power” është aftësia për t'i tërhequr të tjerët në anën tënde, pa shtrëngim.

⁵ Instruments of national power in US NATO Military Terminology Group (2010). JP 1 (02) “Dictionary of Military and Associated Terms”, 2001 (As amended through 31 July 2010).

⁶ “Power of intelligence in peace and war”, NATO publication 9. 2009.

⁷ Disa shkencëtarë politikë bëjnë dallimin midis dy llojeve të fuqisë: Hard dhe Soft. I pari është detyrues, ndërsa i dyti është tërheqës, atraktiv. Hard i referohet taktikave detyruese: kërcënimit ose përdorimit të forcave të armatosura, presionit ekonomik ose sanksioneve. Joseph Nye është idhtar kryesor dhe teoricien i pushtetit të butë.

⁸ B. Obama, maj 2010, në fjalimin në Akademinë e Detarisë, SHBA.

Media⁹, OJQ-të (NGO), Organizatat ndërkombëtare, korporatat e fuqishme, etj.

Detyra kryesore e KSK¹⁰ së një vendi mbetet integrimi dhe koordinimi i politikave të jashtme, të brendshme dhe atyre të mbrojtjes, në një mënyrë të tillë që të arrihet ruajtja e sigurisë kombëtare dhe zhvillimi i interesave kombëtare jashtë vendit. Korrupsioni llogaritet të jetë një komponent negativ, dobësi që influencon në uljen e vlerës absolute të fuqisë kombëtare, pasi efekti është si në moralin shoqëror ashtu dhe në ekonomi. Kjo ka bërë që të arrihet në përfundimin që teknikat dhe mënyrat e përdorura deri tani, nuk mund të jenë më të përshtatshme për t'iu kundërvënë aktorëve të paparashikueshëm dhe të ndërlidhur jo shtetërorë. Kjo ndodh pasi çdo shtet, ashtu siç ka territorin, popullsinë, burimet¹¹ të cilat janë të veçanta dhe unike, ka edhe faktorët e tjerë jo natyrorë të cilët, po ashtu, kanë ngjashmëri por edhe shumë dallime midis tyre. Korrupsioni vlerësohet si elementi negativ që influencon si në komponentin ekonomik të fuqisë kombëtare ashtu edhe në atë psiko-social të shoqërisë.

Koncepti i vjetër i analizës së kërcënimeve është plotësuar dhe përfshin tashmë analizën e rreziqeve dhe analizën e dobësive, pra komponentët dhe nënkomponentët që ndikojnë në sigurinë kombëtare të një vendi. Pikërisht, analiza e qartë e situatës, e epërsive nga njëra anë por edhe e kërcënimeve, rreziqeve dhe dobësive, nga ana tjetër, është pikënisja e hartimit dhe e menaxhimit të një sigurie kombëtare efektive¹². Nisur nga sa më lart, Këshilli i Sigurisë Kombëtare (KSK) të çdo vendi është organi që duhet të sigurojë një trajtim të integruar kundrejt çështjeve të sigurisë kombëtare dhe të dalë me disa opsione politikash dhe përfundimesh. Në përgjithësi, Këshilli i Sigurimit Kombëtar (KSK) konfigurohet dhe përbëhet nga drejtuesit më të lartë të institucioneve drejtuese të ekonomisë, mbrojtjes, diplomacisë, rendit dhe inteligjencës¹³, pra, përfaqësues të komponentëve kryesore të fuqisë së kombit.

Nga elementet e sipërpërmendura të fuqisë kombëtare, në ditët e sotme, një fokus dhe rëndësi të jashtëzakonshme ka marrë *Fuqia e Informacionit*. Jemi dëshmitarë, tashmë, të një epoke të teknologjisë së informacionit, të aftësisë, forcës, influencës, ndjeshmërisë dhe magjisë që informacioni, si lajm mediatik dhe si e dhënë, ka në jetën shoqërore, politike, diplomatike dhe ushtarake. Informacioni që e zotëron këtë fuqi prodhohet nga shërbimet

⁹. *Instrumentet e pushtetit të butë përfshijnë vlerat kulturore, dialogë në ideologji, përpjekje për të ndikuar përmes shembullit të mirë, dhe apel për vlerat njerëzore të pranuar. Mjetet e ushtrimit të pushtetit të butë përfshijnë median, diplomacinë, informacionin, analizat, propagandën dhe programet kulturore, për të arritur qëllime politike. Joseph Nye (Soft Power), faqe 112-134.*¹⁰. Këshilli i sigurimit kombëtar

¹⁰. *Burime natyrore të fuqisë kombëtare; numri i popullsisë, madhësia e territorit, burimet kombëtare, fuqia ekonomike, forca ushtarake.*

¹¹. *The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF), 2009 publication, 16-28.*

¹². *Një agjenci e inteligjencës është një organizatë qeveritare, e përkushtuar për mbledhjen e informatave (e njohur në kontekst si "inteligjence") në interes të sigurisë kombëtare dhe të mbrojtjes së vendit, sipas "NATO Doktrine for Intelligence", publikim i vitit 2004.*

¹³. *E përbashkëta e shërbimeve sekrete të sigurisë dhe inteligjencës është: "Informacioni i lidhur me sigurinë kombëtare".JP 1 (02) "Dictionary of Military and Associated Terms", 2001 (As amended through 31 July 2010).*

e sigurisë dhe inteligjencës¹⁴ dhe është produkt analitik i një game të gjerë burimesh, teknologjish, disiplinash, efektiviteti dhe dobësisht dhe, më e rëndësishmja, parashikon pritshmëri dhe ia servir këtë produkt të klasifikuar¹⁵, politikëbërësve dhe vendimmarrësve të vendit. Analiza e informacioneve të CIA-s dhe DIA-s, për ngjarjet te 11 shtatorit, tregoi që nuk ka qenë mungesa e tyre që ka çuar në dështimin e parandalimit të tragjedisë, por e kundërta, shumica e informacionit me disa mijëra faqe, por të paintegruar e të pakoordinuar dhe të pashkëmbyer midis agjencive. Pas kësaj ngjarjeje, u pranua, pothuajse nga të gjitha vendet e botës, se qeverive iu nevojitej një pikë qendrore e vetme e cila të merrej me çështjet e sigurisë kombëtare.

II- Koordinimi i shërbimeve të inteligjencës, çelësi i rritjes së Fuqisë së Informacionit

Mbi të gjitha dhe në radhë të parë, koordinimi është i domosdoshëm, pasi detyrimi me “vullnet” të lirë i këtyre strukturave ka treguar se nuk funksionon. Përveç kësaj:

Vetëm kjo strukturë mund të vërë në lëvizje gjithë mekanizmin, duke prodhuar analiza dhe informacione për kryeministrin dhe ministrat, nga njëra anë, si dhe duke përcjellë nevojat e tyre për informacion tek shërbimet e inteligjencës, nga ana tjetër. Komuniteti i shërbimeve të inteligjencës do të fokusohet në mënyrën dhe vëmendjen e duhur mbi ato çështje, të cilat ekzekutivi i ka përcaktuar si prioritete. Në këtë mënyrë, nuk do të ketë informacione të prodhuara si rutinë, por informacione të kërkuara dhe të nevojshme nga këta konsumatorë. Koordinimi iu jep shërbimeve të inteligjencës një përcaktim të qartë mbi atë se çfarë informacioni ata duhet të grumbullojnë. Ky përcaktim nuk do të lejojë të “informohet për gjithçka”, por për ato çështje, kërcënime apo rreziqe për të cilat secili shërbim ka misionin dhe ekspertizën e duhur. Koordinimi mund të përcaktojë mangësitë në plotësimin e kërkesave dhe, në këtë mënyrë, shërbimet inteligjente kthehen në “prodhues”, ku rendimenti i tyre është i matshëm si raport i numrit të kërkesave të marra dhe informacioneve të prodhuara. Analiza e vazhdueshme e suksesit që po arrijnë grumbulluesit e informacionit ndaj objektivave kyçe është mjaft e rëndësishme për të garantuar që nuk po ndërmerret ndonjë grumbullim i fshehtë, jo i ligjshëm, me risk dhe i kushtueshëm.

Parimet e ligjshmërisë dhe kostos janë efikasë edhe në inteligjencë. Autoriteti qendror i koordinimit mund të kontrollojë nëse misionet dhe aktivitetet e shërbimeve nuk mbivendosen ose nëse agjencitë përfshihen në rivalitet mes tyre. Koordinimi mund të garantojë që po ndiqen procedura plotësuese dhe përditësuese gjatë ciklit informativ (grumbullimit, analizës, prodhimit dhe shpërndarjes). Koordinimi mund t'i përshtatet rolit të raportimit dhe mekanizmit të shpërndarjes së burimeve në mes shërbimeve, duke vlerësuar rëndësinë, fokusin, mundësinë, motivin dhe secilin burim.

¹⁴ *Informacion i klasifikuar cilësohet informacioni, në të cilin aksesimi është kufizuar vetëm për një grup të caktuar personash.” NATO definition of classified information”, publication of 2007*

¹⁵ *“Power of intelligence in peace and war” NATO publication 9, 2009, “Marrëdhëniet në mes të shërbimeve të vendeve ndryshme vendosen sipas prioriteteve dhe programeve qeveritare. Është vetëm ekzekutivi ai që vendos shkallën dhe tematikën e shkëmbimeve midis shërbimeve në nivelet: prioritar, normal, diplomatik dhe formal.”*

Koordinimi duhet të sigurojë që nevojat e qeverisë po përmbushen përmes përpjekjesh dhe një strategjie të gjerë menaxhimi. Mbi të gjitha, një organ qendror i koordinimit mund të shërbejë si një burim kyç i drejtimit për bashkëpunimin brenda komunitetit të inteligjencës. Një autoritet i centralizuar i mbikëqyrjes mund të shërbejë për t'i garantuar opinionit publik që të gjitha kapacitetet dhe agjencitë po monitorohen nga një organ, po punohet për të shmangur dublikimet dhe teprimet si dhe për të garantuar se po punohet për të mbushur boshllëqet e krijuara. Një autoritet i tillë ka gjithashtu për detyrë të koordinojë marrëdhëniet me shërbimet e huaja partnere të inteligjencës dhe sigurisë¹⁶.

Struktura koordinuese e shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, sipas përvojës së vendeve perëndimore, është një organ qendror, por jo autoritativ ose komandues. Kjo strukturë jep vetëm një orientim ose drejtim të përgjithshëm për grumbullimin dhe analizën e informacionit, por me kushtin paraprak të njohjes së mundësive dhe kursit të veprimeve të kundërshtarit, të kërcënimeve, rreziqeve dhe dobësive, nga njëra anë, dhe njohjes së kapaciteteve që kanë shërbimet e të mënyrës se si komuniteti i shërbimeve punon, nga ana tjetër.

III-Detyrat e strukturës së koordinatave ¹⁷

Mbledhja dhe thithja e informacionit strategjik nga të gjitha agjencitë dhe eliminimi i atyre që nuk kanë vlerë gjatë procesit të vlerësimit paraprak, kontrolli i cilësisë së informacionit strategjik dhe lidhja e këtyre informacioneve për të gjetur çfarë mungon ose çfarë është e pamjaftueshme, lidhur me atë që i nevojitet Kryeministrit dhe kabinetit qeveritar, orientimi i grumbullimit për të përcaktuar mungesat në informacion ose informacionet e cunguara si dhe iniciimi, orientimi dhe koordinimi i grumbullimit shtesë (plotësues), sintetizimi i informacionit të thithur nga shërbimet dhe krijimi i një vlerësimi kombëtar për hartuesit e politikave dhe marrësit e vendimeve. Vende të ndryshme, bazuar në specifikat e sistemeve politike dhe kushtetuese të funksionimit, kanë ndërtuar pranë vendimarrësit (presidentit apo kryeministrit) një organ koordinues.

Disa nga shembujt që unë kam përzgjedhur, në mënyrën e realizimit të koordinimit të shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, janë:

*1-Organi qendror i koordinimit në Britaninë e Madhe është Komiteti i Bashkuar i Inteligjencës*¹⁸, si pjesë e zyrës së Kabinetit, nën autoritetin e Ministrit të Kabinetit.

Shef i KBI-së është koordinatori i Inteligjencës. KBI mbledh bashkë, në takime javore, agjencitë dhe departamentet e tyre kryesore përdoruese, për të përcaktuar kërkesat prioritare për inteligjencë, për të vlerësuar performancën e grumbullimit dhe për të bërë vlerësime të përbashkëta. Ai i raporton Ministrit të Kabinetit dhe, përmes tij, edhe Kryeministrit. KBI është përgjegjëse për vlerësimin dhe dhënien e paralajmërimit të hershëm të kërcënimeve

¹⁶. Qeveria, në bazë të vlerësimit që ka për sigurinë, vendos mënyrat dhe detyrat e strukturës së koordinimit dhe bashkëpunimit... "The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF), 2007 publication, page 29-67; 69-79.

¹⁷. JIC Joint Intelligence Comitee.

<http://www.fas.org/irp/world/uk/jic>

¹⁸. The Director of National Intelligence (DNI), është emëruar për herë të parë nga presidenti Klinton dhe zyra është krijuar pas reformës së ndërmarrë në parandalimin e terrorizmit sipas ligjit të vitit 2004.

dhe zhvillimeve të jashtme që kanë gjasa të ndikojnë mbi interesat britanike, të marra nga të gjitha burimet e informacionit. Produktet e KBI janë vlerësime të miratuara mes departamentesh, me një perspektivë të gjerë qeveritare që i kapërcejnë kufijtë ministerialë dhe, për këtë arsye, kanë tendencën për të qenë disi të turbullta, por që pa dyshim vijnë si rezultat i konsensusit. Përdoruesit kryesorë të vlerësimeve të KBI janë kryeministri, ministrat dhe zyrtarët ekspertë të departamenteve të hartimit të politikave. Kryetari i KBI ka një staf të dedikuar, me emërtimin Organizata e Inteligjencës së Bashkuar, që e ndihmon atë në vlerësimet e inteligjencës dhe që realizon detyra të tjera të agjencive të inteligjencës. KBI është përgjegjëse dhe ruan lidhjet e tij me organizata analoge në vendet aleate.

2-Sipas modelit amerikan, Drejtori i Inteligjencës Kombëtare¹⁹ (DNI) shërben si këshilltari kryesor i Presidentit për inteligjencën dhe drejton komunitetin e inteligjencës. Autoritetet dhe përgjegjësitë e DNI-së rrisin aftësitë e komunitetit të inteligjencës për t'i dhënë Presidentit dhe këshilltarëve të tij një produkt të integruar inteligjence mbi kërcënimet e sigurisë dhe për të përmirësuar funksionin paralajmërues të inteligjencës.

DNI fokusohet vetëm në grumbullimin dhe analizën e inteligjencës së huaj si dhe në ndonjë përgjegjësi shtesë, të caktuar nga Presidenti. DNI ka një koordinator për shërbimet. DNI ka marrë autoritetin e DCI²⁰ për të mbikëqyrur programin e inteligjencës kombëtare dhe buxhetin, për të koordinuar aktivitetet e agjencive kryesore, mjaft konkurruese të inteligjencës si dhe të pjesëve të veçanta të departamentit të *Homeland Defence*; ai ka një autoritet në rritje në përzgjedhjen e personelit të agjencive të inteligjencës kombëtare. Ai mbikëqyr punën e Qendrës Kombëtare të Anti-terrorizmit (NCTC²¹) e cila nga ana e saj i raporton DNI, duke patur përgjegjësi të plotë, brenda qeverisë, për të integruar inteligjencën e huaj dhe vendase që lidhet me terrorizmin.

DNI shpërndan atë që ka qenë kurora e çmuar e CIA-s: brifingun (informacionin) ditor për Presidentin. DNI ka dhe dy detyra të tjera: menaxhimin e komunitetit të inteligjencës dhe luajtjen e rolit të këshilltarit kryesor të Presidentit për inteligjencë.

3-Franca ka 2 organe koordinuese me 1 shef: Komiteti Ndërministerial i Inteligjencës (CIR) koordinon komunitetin e inteligjencës dhe siguron sinteza inteligjence për Presidentin, Kryeministrin dhe departamentet përgjegjëse qeveritare;

Sekretariati i Përgjithshëm i Mbrojtjes Kombëtare (SGDN) koordinon aktivitetet e planëzimit strategjik mes shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë, të zbatimit të ligjit si dhe degëve të tjera juridike dhe ekzekutive.

CIR dhe SGDN janë të vendosura në zyrën e Kryeministrit dhe drejtohen nga Sekretari i Përgjithshëm, i cili është koordinator i inteligjencës e sigurisë dhe i shërbimeve të inteligjencës. CIR është përgjegjës për vlerësimin dhe dhënien e paralajmërimit të hershëm për kërcënimet dhe zhvillimet e jashtme që kanë gjasa të ndikojnë mbi interesat e Francës dhe për dhënien e këshillave strategjike për agjencitë e inteligjencës.

5-Shërbimet e Inteligjencës dhe Sigurisë Gjermane varen nga Kancelaria Federale dhe

¹⁹ Director of committee of Intelligence ka qene deri ne krijimn e DNI autoriteti mbikqyres per inteligjencen

²⁰ Nacional Counter terrorist centre

²¹ Kryetari i Këshillit të Ministrave të Republikës së Italisë (Kryeministri). www.fas.org/Italy

kanë një Ministër Shteti, i cili i raporton Kancelarit Federal dhe në to mbliidhen të gjitha kërkesat për inteligjencën nga të gjitha pjesët përbërëse të qeverisë.

Ai mbështetet nga një zëvendës, i cili është koordinator për inteligjencën dhe, si Drejtor Ministerial dhe drejtues i Divizionit të 6-të të Kancelarisë Federale, merret me të gjitha aspektet e koordinimit, bashkëpunimit, prodhimit, vlerësimit, shpërndarjes, monitorimit dhe kontrollit të agjencive federale. Një herë në javë mbledh shefat e agjencive për koordinimin, bashkëpunimin, prodhimin, vlerësimet strategjike dhe paralajmërimin e hershëm; këshillon qeverinë dhe agjencitë mbi politikat që lidhen me kryerjen e aktiviteteve të inteligjencës; përgatit ligje, direktiva dhe rregullore për shërbimet, përmirëson bashkëpunimin e tyre në ndarjen e inteligjencës dhe bashkëpunon me agjencitë e tjera qeveritare dhe të huaja; monitoron organizimin, problemet e personelit, metodat, informacionin, trajtimin e inteligjencës, nevojat për burime dhe buxhetin e agjencive.

6-Në Itali, kryeministri (PCM²²) është i veshur me një fuqi të madhe monitorimi, përgjegjësi të plotë politike dhe koordinim të inteligjencës kombëtare dhe politikave të sigurisë, për forcimin dhe për mbrojtjen e shtetit demokratik dhe të institucioneve të përcaktuara nga Kushtetuta si baza të tij.

PCM nxjerr direktiva dhe parashtron dispozita që kërkohen për organizimin dhe kryerjen e aktiviteteve dhe mbikëqyr zbatimin e kriterëve për identifikimin e çështjeve që duhet të ruhen si sekret shtetëror, si dhe organizmat që duhet t'iu besohet një detyrë e tillë. Brenda zyrës së PCM është (CIIS²³), me detyrën e dhënies së këshillave dhe bërjen e propozimeve tek PCM për linjën e përgjithshme dhe objektivat kryesore që do të ndiqen brenda politikave të inteligjencës dhe sigurisë. Bazuar në rekomandimet e CIIS, PCM, me anë të një urdhri, shpërndan fondet për shërbimet si dhe fondet sekrete që hyjnë në buxhetin e shpenzimeve të PCM dhe ministrive.

*7-Këshilli i shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë së Holandës*²⁴ është nën këshillin zyrtar i Këshillit të Ministrave-mbliidhet 3 herë në vit, ose edhe me shumë, nëse është e nevojshme. Mandati: koordinon shërbimet e ndryshme të inteligjencës dhe sigurisë, në nivel ministerial. Drejtohet nga Kryeministri. Anëtarë: Zv/Kryeministri, Ministri i Mbrojtjes, i Brendshëm, i Jashtëm, i Marrëdhënieve Mbretërore dhe Drejtësisë (edhe të tjerë, nëse kërkohet). Përbëhet nga Koordinatori i Shërbimeve të Sigurisë (shefi), Drejtori i Përgjithshëm i Rregullave, Ligjeve dhe Sigurisë, Drejtoria e MPB, Drejtori i Përgjithshëm i Çështjeve Politike të MPI, Drejtori i Përgjithshëm i Zbatimit të Ligjit i Ministrisë së Drejtësisë, Drejtori i Shërbimeve të Inteligjencës dhe Sigurisë dhe nga Drejtori i Inteligjencës Ushtarake dhe Shërbimeve të Sigurisë. Mbliidhet në takime një-mujore, por edhe më shpesh, nëse kërkohet, për të koordinuar politikat, misionet, aktivitetet dhe për vlerësime strategjike.

8-Modeli i koordinimit çek ka një ndikim të madh nga sistemi britanik. Këshilli i Koordinimit të Shërbimeve të Inteligjencës drejtohet nga Kryeministri dhe ka anëtarë: Këshilltarin e Presidentit për Çështjet e Sigurisë, Ministrin e Mbrojtjes, Ministrin e Brendshëm, Ministrin e Punëve të Jashtme, Ministrin e Financës dhe 3 shefat e agjencive të inteligjencës dhe sigurisë.

²² Komiteti Ndërministerial për Inteligjencën dhe Sigurinë në Republikën Italiane.

²³ Raad voor de Inlichtigen en Veiligheidsdiensten RIV. www.fas.org.netherland.

²⁴ www.fas.org/swiss

9- *Modeli i Koordinimit zviceran drejtohet nga Këshilli i Sigurisë i Këshillit Federal: Ministri i Mbrojtjes (Kryetar), Ministri i Punëve të Jashtme, Ministri i Drejtësisë dhe i Policisë; Stafi i Krizave: Shefi i stafit, 9 anëtarë që hartojnë planin e emergjencave (trazirave, krizave) dhe Qendra e Paralajmërimit të Hershëm; Grupi Drejtues: Anëtarët e përhershëm të Ministrisë së Shtetit, Ministri i Çështjeve Ekonomike, Prokurori i Përgjithshëm, Shefi i Forcave të Armatosura, Shefi i Zyrës Federale të Policisë, Drejtori i Inteligjencës së huaj dhe Shefi i Inteligjencës vendase si dhe anëtarë të tjerë, në varësi të situatave dhe nevojave²⁵. Shërbimet inteligjente duhet të plotësojnë disa kushte paraprake në kryerjen e misionit të tyre: realizim të pritshmërive, raportim të detyrave dhe përbushjes së tyre dhe shqyrtim të feedback-ut²⁶ dhe performancës së raportuar.*

IV- Parimet themelore të pranuar për inteligjencën²⁷

1. Garantimi i një inteligjence efektive, thelbësore për sigurinë e kombit;
2. Të paturit e një kuadri ligjor të përshtatshëm;
3. Të paturit e një sistemi efektiv menaxhimi;
4. Të qenit efektivisht i përgjegjshëm dhe i hapur për shqyrtim të brendshëm dhe të jashtëm për mbikëqyrje parlamentare.

V- Vendosja e balancës midis sigurisë së nevojshme dhe transparencës së garantuar²⁸

Kjo është thembra e Akilit të shërbimeve të inteligjencës. Transparenca duhet të bëhet me shumë kujdes, në mënyrë që hapja ndaj publikut të mos e dëmtojë aftësinë e shërbimeve të inteligjencës për të kryer misionin e tyre. Sigurimi i një lidhjeje mes shërbimeve të inteligjencës e sigurisë dhe publikut të gjerë arrihet nëpërmes deklaratave të komisioneve parlamentare²⁹. Si rregull i përgjithshëm, intelijenca duhet të mbajë plotësisht të informuar Komisionin e Mbikëqyrjes mbi aktivitetet aktuale; t'i sigurojë Komisionit, në bazë të kërkesës, informacionet apo dokumentet në ka në zotërim; të raportojë mbi aktivitetet që janë të paligjshme ose të parregullta si dhe.... mbi veprimet korrigjuese të ndërmarra ose të planifikuara. Intelijenca është një nga fushat e vetme të aktivitetit të qeverisjes, ku duhet të inkurajohet marrja në sy e rrezikut dhe e të menduarit novator³⁰. Intelijenca është një fushë që mbështetet kryesisht në gjykimin profesional dhe sinjeritetin e personelit të inteligjencës, por që është jashtëzakonisht e varur nga bashkëpunimi i agjencive të tjera, qeverive të huaja dhe individëve. Ndërsa komisioni parlamentar duhet të jenë gjithmonë i vetëdijshëm për rrezikun e përhershëm që deklaratat dhe veprimet e tij mund të shtrembërojnë perceptimin e publikut për inteligjencën, të krijojnë një përshtypje jo të

²⁵. "Feedback" në terminologjinë e shërbimeve të inteligjencës është procesi i vetëpërmirësimit dhe vetëpastrimit të ciklit informativ nëpërmjet kërkesave të pandërprera, dhe rifutjes në cikël të përditësimeve dhe rivlerësimeve të vazhdueshmeve.

²⁶. "Power of intelligence in peace and war" NATO publication 9. 2009

²⁷. Këto kufizime të sigurisë, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut "bazuar në hierarkinë e ligjeve në një sistem demokratik. Kushtetuta e RSH viti 1998, Neni 17, pjesa e dytë

²⁸. Marko Cepic "Intelijenca dhe Demokracia" page 58-94

²⁹. Michael Warner "Wanted; A definition of intelligence" 2008 page 146-187

³⁰. The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF) 2007 publication, page 29-67

mirë në radhën e burimeve potenciale, agjencive të bashkëpunimit, shërbimeve dhe qeverive të huaja si dhe të dëmtojë moralin e personelit të inteligjencës. Për këtë arsye, mbikëqyrja legjislativë duhet të jetë jo-partiake dhe e matur dhe gjykimet duhet të jenë të drejta (të ndershme). Mbikëqyrja duhet të jetë më shumë investiguese sesa kundërshtuese si dhe komisioni duhet të zgjerohet fushën e mbikëqyrjes përtej shërbimeve të inteligjencës, deri tek përdoruesit e inteligjencës³¹.

VI- Përfundime

Ekziston një mungesë e profesionalizmit dhe afektim nga e kaluara tek shërbimet inteligjente, kryesisht në vendet ish komuniste, aftësi të pakta strategjike dhe analitike si dhe koordinim i pamjaftueshëm, kjo e fundit si problemi universal i shërbimeve të inteligjencës dhe sigurisë. Për rastin e Shqipërisë, do të ishte një proces që të fillonte duke konsideruar, në radhë të parë, modelin e republikës parlamentare, peshën specifike që shërbimet shqiptare të inteligjencës civile dhe ushtarake kanë në optikën e re, gjeopolitikën e re rajonale dhe globale dhe realitetin e ri si anëtare e NATO-s. Mendoj që ngjarje të rënda, të ndodhura këto 20 vite në hapësirën shqiptare, të cilat kanë tronditur sigurinë kombëtare, do të ishin parashikuar në kohë dhe, ndoshta parandaluar, nëse do të kishte koordinim midis komponentëve të inteligjencës të RSH. Besoj se ekziston baza teorike ashtu si dhe “mësimet e nxjerra” për të ndërmarrë hapa në drejtim të krijimit të strukturës koordinuese të sigurisë, nën autoritetin e ekzekutivit.

Vlerësoj që do të ishte detyrë e strukturave të analizave të sigurisë dhe të mbrojtjes, të fillonin një proces analizimi dhe studimi të realiteteve dhe mundësive, me qëllim propozimet e nevojshme në vendimmarrjen politike dhe ushtarake, në dobi të këtij procesi.

Referencat:

1. Course in Defence and Security Studies, Tirana 2010
2. “Power of intelligence in peace and war” NATO publication 9. 2009
3. Rusell Swenson “Comparative perception of intelligence professionalism” 2005
4. Thomas Bruneau “Intelligence in new democracies”
5. Michael Warner “Wanted; A definition of intelligence” 2002
6. Allan Dallas “Historia e madhe e shërbimeve sekrete”
7. Michael Herman “ Intelligence professionalism in 2003”
8. Marko Cepic “Inteligjenca dhe Demokracia”
9. The Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces (DCAF)
10. Rusell Swenson “Comparative perception of intelligence professionalism” 2005
11. Thomas Bruneau “ Intelligence in new democracies”
12. www.abin.gov.br
13. Michael Warner “Wanted; A definition of intelligence” 2002
14. Mark Lowntheal “Intelligence, from secrets to policy” 2006
15. Wikileaks dhe inteligjenca ushtarake NY Times 21.12.2010
16. DCAF (Democratic Control in Armed Forces) “Kontrolli demokratik i shërbimeve të inteligjencës” botimi 2007, 2009, dhe 2010
17. JP 1 (02) “Dictionary of Military and Associated Terms”, 2001 (As amended through 31 July 2010). Pentagon.

Taktikat, teknikat dhe metodat e forcave talibane në Afganistan

Nënkolonel Ramazan Martini
Shef i Degës së Doktrinave e Manualeve
Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Nënkolonel Mehmet Hamdi
Oficer shtabi për Doktrinën e Forcave Tokësore/Pedagog
Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt: Në këtë material të shkurtër do të mundohemi të hedhim dritë mbi taktikat dhe teknikat që ndiqen nga Talibanët për marrjen e fshatrave, duke filluar me element shoqërorë që ndikojnë me hallkat kyçe që veprojnë në një fshat Afghan, ndikimin e elementëve shoqërorë, fetarë, individualiteti dhe sistemi i sigurisë në jetën e përditëshme të një fshati Afghan. Si funksionon kontrolli Taliban në fshatra e zona të caktuara të vendit, taktikat dhe teknikat talibane gjatë veprimeve të tyre operacionale, si dhe masat kundërvepruese të Forcave të Aleancës e të Forcave të Sigurisë Afgane ndaj Forcave Taliban, etj? Gjykojmë se materiali ka vlera të padiskutueshme për Forcat tona që kryejnë misionin e tyre në kuadrin e NATO- s në Afghanistan, duke qënë të hapur për çdo mendim vërejtje e sygjerim tuajin.

Si e marrin një fshat forcat talibane?




Fig. 1. NJETË KYÇË TË NDIKIMEVE BRENDË NJË FSHATI AFGHAN

Një metodë që përdoret aktualisht nga Forcat Talibane në Afghanistan për të kënaqur interesat e tyre për marrjen nën kontroll të zonave dhe mendohet nga ana e lidërshpilit Taliban se ata kanë interesa strategjike, duke operuar nga pozicione dhe vende të sigurta, të cilat ndodhen ose brenda territorit Afghan, ose në kufi me Pakistanin. Qëllimi i tyre është të identifikojnë fshatrat dhe të përcaktojnë objektivat (për rastin konkret mund të jenë fshatra, ose zona të caktuara), mandej t'i shkatërrojnë këto objektiva. Për t'ja arritur këtij qëllimi ata kryejnë zbulimin e

nevojshëm, përcaktojnë paisjet dhe shkallën e shtrirjes së veprimeve të tyre operacionale në këto zona përmes bashkëpunimit, këshillimeve dhe sygjerimeve me popullsinë lokale që ndodhet në to (preferohet nga ata) dhe me detyrim (kur ata e shohin të nevojshme).

Hallkat e ndikimit të talibanëve në fshatrat Afgane për të kuptuar se si Talibanët shkatërrojnë një fshat, si për shtetasit Afghanë, ashtu dhe për të huajt është e nevojshme të spjegojmë një strukturë të thjeshtë sociale model, për të identifikuar lidhjet kyçe të ndikimeve brënda të njëjtit fshat Afghan. Fshati në fjalë mund të ndahet në tre zona më të efekshme në jetën e përditëshme të fshatit. Këto zona të ndara zakonisht janë nën kontrollin administrativ, të besimit fetar dhe të sigurisë në to. Në të tre hallkat që përmëndëm njëra, e cila të bie më shumë në sy në pamjen e jashtme është *Malik-u dhe më i vjetri i fshatit*. Malik-ët dhe më të vjetrit e fshatit, përfaqësojnë aspektet politike në një fshat afgan të caktuar. Hallka/nyja e dytë kryesore lidhëse e ndikimeve është *Imami*. Imami, përfaqëson lidhjen me besimin fetar dhe ndikimeve që ai jep brënda një fshati Afghan.

Hallka/nyja e tretë kryesore e ndikimeve lokale është *individualiteti dhe sistemi i sigurisë* i ngritur brënda një fshati. Siguria në një fshat është e ngritur dhe zhvillohet nga burrat e fshatit dhe ka veçoritë e veta për çdo fshat veçmas. N.q.s njëra nga këto hallka lidhëse ose dhe njëra nga ato brënda një fshati është nën ndikimet Talibanë, ose nën ndikimet e Qeverisë Afghane, atëhere, si Talibanët, ashtu dhe Qeveria Afghane do të ndikojnë me shumë vështirësi për të vendosur kontrollin në atë fshat.

Hallkat e kontrollit taliban në një fshat Afgan

Talibanët tregohen shumë të kujdesshëm për fshatra dhe për zona të tëra të caktuara, në të cilat ata gjykojnë se mund të kryejnë veprimet e tyre operacionale, kundër forcave Aleate (NATO-s), ose dhe kundër Forcave të Ushtrisë dhe të Policisë Afghane. Kështu që, ato zona ku ka një prezencë të vogël forcash të NATO- s dhe të ushtrisë e të policisë Afghane ata i quajnë zona me përparësi, në të cilat ata synojnë t'i shkatërrojnë forcat dhe të kapin me çdo kusht këto zona. Për këtë Talibanët ndërtojnë rrjetin e tyre me luftëtarë Talebanë, me lidera/udhëheqësa shpirtërorë/fetarë, duke përfshirë këtu dhe më të vjetrit e fshatrave. Padyshim, një rrjet i tillë do të mbështesë Talibanët.

Gjithsesi, në të gjitha rastet mund të jetë përdorur me efikasitet një apo dhe më tepër se një element i këtyre rrjeteve të tyre, duke përdorur dhe fiset apo klanet e ndryshme, si dhe lidhjet e tyre familjare. Ato fshatra, që administrohen politikisht nga më të vjetrit e fiseve brënda të njëjtit fshat të përfaqësuar nga Malik-u i emëruar në këtë fshat, është një nga hallkat lidhëse më të identifikuar nga ata dhe të ndikimeve që ata kanë mbi popullsinë e fshatit. Për këtë arsye ata do të përpiqen t'a shmangin këtë Malik, të emëruar nga Qeveria, mbasi ata nuk do të jenë përkrahësit e tyre. Kjo është arsëja që ata (Malikët e emëruar), kërcënohen dhe dhunohen, ose kur ata e shohin të arsyeshme edhe mund t'i asgjësojnë/eliminonjë. Ndërsa në një fshat tjetër, ku autoritetet lokale shprehen se nuk ka Malikë të emëruar, atëhere kjo, do të kuptohet si një lehtësi në këtë fshat (në këtë rast, më të vjetrit e fshatit nuk do të binin dokort me Malikun).

Pra, siç e shohim, se do të ishte më mirë për Ata rasti kur në fshat, ose në zonë nuk do të kishte Malik të emëruar. Në këtë mënyrë, Talibanët- sipas tyre kanë neutralizuar dëshirat e tyre për të pasur përfaqësuesit e tyre në fshat. Kur autoritetet lokale janë të shtërnguar të kenë autoritetet e tyre të emëruar në një fshat të caktuar, atëhere ata do të jenë të gatshëm

t'u japin Forcave Aleate, emrin e personit, i cili do të përfaqësojë fshatin. Do të ishte e pëlqyeshme që një individ i tillë të pëlqej, të mbështetej dhe të gëzonte popullaritetin dhe në masën e Talibanëve, por dhe t'i mbështeste ata (Talibanët). Po kështu Talibanët do të përpiqen të instalojnë, apo të emërojnë një person të quajtur Malik- përfaqësuesin e fshatit të tyre- të detyruar, ose dhe me presion, siç është rasti në fjalë.

Një komandë Talibane, më e ulët në zinxhirin e komandimit mund të organizohet më së miri në një fshat, duke pasur para sysh të gjithë faktorët që prekëm pakë më lartë, si dhe duke harmonizuar veprimet e saj kundër Forcave tona (Nato- s) dhe Forcave të Ushtrisë e të Policisë Afghane, ose dhe të Malik- ut i emëruar nga ata, por që do t'u duhej t'a mbështetnin me financa të kufizuara. Komandat e niveleve më të ulëta në zinxhirin e komandimit Taliban, zakonisht kanë nën kontroll 2- 5 luftëtarë Talibanë.

Luftëtarët Talibanë do të armatosen, kryesisht me armë të kalibrit të vogël, si dhe me granata dore, kryesisht antipersonel, por dhe antitanke. Ata (Talibanët), mundet të jenë të paisur me eksplozivë të improvizuar (mina të përgatitura në mënyrë artizanale vetë), ose jo. Ata synojnë, gjithsesi të rritin kapacitetet e tyre luftarake dhe në rast se nuk është e mundur (varet nga situata) ata do të koordinojnë veprimet e tyre dhe me këto pajisje artizanale shpërthyes, të vendosura qysh më parë në rrugëkalimet më të mundshme të Forcave Aleate, ose dhe në moment të caktuar të zhvillimit të veprimeve luftarake mbrojtëse (n.q.s ja arrijnë këtij qëllimi), por dhe gjatë veprimeve të tyre operacionale mësimëse (bie fjala në pritë e ndryshme që ata organizojnë, etj).

Këto veprime do të kryhen, si kundër Forcave të Aleancës, por edhe kundër Forcave të Ushtrisë e të Policisë Afghane, njëkohësisht. Forcat Talibane, mund të qëndrojnë në një fshat të caktuar, por preferohet nga ana e tyre që këta luftëtarë të mos jenë banorë të atij fshati ku kryen veprimet operacionale të tyre. Për më tepër shih Fig.2, si më poshtë vijon:




Fig. 2 . ORGANIZIMI I TALIBANEVE PËR TË KONTROLLUAR NJË FSHAT AFGHAN

Banorët lokalë, shpesh herë mund të jenë të detyruar për të shërbyer për ata dhe për të luftuar së bashku me ata, kur Ata (talibanët) e shohin të nevojshme, por Talibanët orvaten, që në të shumtën e rasteve të aktivizojnë, luftëtarë të marrë nga fshatra të tjerë, si dhe në rastet kur niveli i kërcënimit dhe i rrezikut është i lartë, atëherë ata nuk do të përdorin fisin kundër fisit tjetër.

Imamet dhe xhamitë lokale të fshatrave Afghane, shpesh vizitohen nga Forcat Talibane. Ndodh, që jo në të gjitha rastet një veprim i tillë, kundërshtohet nga ana e fshatarëve Afghane. Për më tepër, kur është vënë re se Talibanët vijnë dhe japin mesazhe (detyra) në emër të Islamit ata nuk kundërshtohen nga banorët e fshatrave. Vizita të kësaj

natyre në xhami e Imamë të ndryshëm u ofrojnë atyre shanset për të shprehur në një farë mase mendimet e tyre, si dhe për të hedhur themelet e kontakteve me banorët lokalë në fshat. Imamët, apo liderat shpirtërorë në një fshat, gjithashtu shërbejnë për të edukuar/arësimitar fëmijët, sidomos në ato fshatra që janë mbyllur shkollat, ose për më tepër atje ku shkollat janë shkatërruar nga vetë forcat Talibane.

Xhamitë dhe Imamët në fshatrat Afghane shërbejnë si qendra edukimi për Talibanët, të cilët mandej paraqesin “shanset” për fëmijët e fshatit, që ata të bëhen të ditur e të arësimitar. Kjo nga ana tjetër paraqet një zgjidhje antipopullore, në kuptimin që shkollat të mbyllen. Është për të ardhur keq për popullin Afghan, i cili në mënyrë të vijueshme i kufizon në mënyrë evidente shanset e arësimitit dhe të diturisë, kjo dhe si rrjedhojë e sistemit të dobët arësimitar në vend.

Talibanët do t’u duhej t’a zëvendësonin Imamin lokal, n.q.s do të ishte e nevojshme dhe që do t’u shërbente si bazë për furnizimin e tyre në një fshat të caktuar.

Një fshat që nuk ka Imam, atëherë duhet të pranohet një i tillë dhe në këtë rast Talibanëve do t’u duhej që të ngrinin një xhami. Kjo xhami do të shërbejë si vend për mbledhje e takime, objekte deponi dhe si qendër arsimimi për forcat Talibane, etj.

Autoritetet lokale ndihmojnë për të siguruar ushqim dhe strehë. Një nga mënyrat për t’a bërë këtë është të njohin mirë mbështetësit e tyre për vendosjen e ushqimeve dhe batanijeve në ndërtesat më qira në lagjet e jashtëme të banimit, ose në ndërtesat e miqve, të cilat do të përdoren nga Talibanët përkohësisht, ose gjatë veprimeve operacionale brënda fshatit. Kjo u jep mundësi mbështetje atyre nga banorët për t’u tërhequr, kur është e nevojshme. Kur forcat Aleate, ose forcat Afghane (Ushtria dhe policia Afghane), mbrijnë në një fshat Afghan, ndihma e tyre në mënyrë të përgjithshme konsiston, në veshje të mundshme, duke lënë gjurmë të ndikimit të tyre në atë fshat (zonë) dhe me kontrata që nënshkruhen gjatë vizitës së tyre me palë kontraktore. Talibanët kanë përbërje heterogjene me të afërm të tyre brënda një fshati.

Talibanët mund të kontrollojnë me pak luftëtarë

Metodat e luftës Talibane kërkojnë relativisht pakë personel. Fuqia e tyre përqëndrohet në përmbyshjen lokale në shumë nivele bazë të organizimit dhe të jetës së një fshati. Afrimi i tyre është në mënyrë të decentralizuar. Jepen udhëzimet dhe mandej kalohet në zbatimin praktik nga Komandat Talibane duke interpretuar e aplikuar mënyrën se si ata do të veprojnë praktikisht. Qëllimi i tyre është, se si të mund të marrin nën kontroll fshatin në nivel lokal, e cila padyshim është e vetmja metodë efektive që përdoret nga të gjithë Komandantët Talibanë, pra për të marrë nën kontroll ndikimet në nyjet e kontrollit që kanë marrë që në fillim Forcat Aleate, por jo vetëm dhe Forcat e Ushtrisë dhe të Policisë Afghane.

Formësimi i një funksionimi të përshtatshëm: Një fshat Afghan mund të punojnë vetëm në një mënyrë që u jep mundësi të gjithë banorëve të tij të mbijetojnë, e cila është një mënyrë jetese duke pasur si mjet jetese stilin e jetesën agrare (bujqësore) dhe Talibanët e njohin mirë këtë.

Për të kontrolluar një zonë të caktuar, Talibanët identifikojnë fshatrat të cilët mund të shkatërrohen më lehtë. Mandej ata do të shpërndahen në fshatra të tjerë në një zonë të

caktuar në një kohë (njëherazi), duke u fokusuar përpjekjet e tyre gjithësesi në një hallkë/nyje, e cila duket më e pëlqyeshme dhe më e lehtë për të mbështetur përpjekjet e tyre fillestare.

Duke përdorur këtë mënyrë Talibanët do të mund të ndikojnë për të dominuar, apo për të marrë kontrollin në një luginë, apo në një zonë të caktuar me një popullsi prej 1000 deri në 2500 banorë- ose dhjetë fshatra me nga 100- 250 banorë (është marrë mesatarish 100-250 banorë një fsht). Këtë mund t'a arrijnë vetëm me rreth 20- 50 luftëtarë (efektivë) dhe rreth 10 lidera (komandantë). Aktualisht këta anëtarë të grupeve Talibane mund të na shfaqen, më tepër si popull i thjeshtë, se sa luftëtarë me uniformë. Talibanët do të kenë një rrjet të përgatitur mirë për të mbështetur luftëtarët e tyre në ato zona kua ata dominojnë, ose i kanë marrë nën kontroll. Ata do të kenë, gjithashtu shtëpi të sigurta, klinika mjekësore, vende për mbështetje, depot e fshehta për armatimin e minicion, mjete transporti, si dhe një rrjet të ngritur qysh më parë, të instruktuar për vrojtim dhe për raportim.

Forcat Aleate dhe Forcat e Sigurisë Afghane vishen me antiplumb dhe paimë të rënda dhe janë të detyruar të lënë makinat e blinduara duke vepruar në terren të hapur. Ato veprojnë me furi/shpejtëse të madhe në të njëjtën rrugë, ose shteg që të çojnë në hyrje të fshatit, ose në zonë. Talibanët mund të përdorin me sukses mashtrimin dhe tërheqjen, sa herë ata e shohin të nevojshme, për të ndjellë forcat tona larg nga vendqendrimet dhe liderat (komandantët) e tyre, me synimin e tyre të vetëm për të fituar kohë dhe për t'u rivendosur (ridislokuar), ose për ti drejtuar ato (forcat tona) në prita të organizuara dhe vdekjeprurëse.

Mbas sulmit të kryer nga këto prita, Talibanët mund të shpërndahen dhe të përzihen me popullsinë tjetër të fshatit. Fshati, zakonisht mund të mbështesë eliminimin e pasojave të humbjeve, gjatë dëmeve anësore që mund të ndodhin mbi popullatën civile. Në këtë moment vepron dhe përhapet propaganda e informacioni "se Forcat Aleate dhe ato Afghane po përdorin forca të shumta ushtarake". Forcat tona (Aleate) dhe ato Afghane mund të lënë, ose dhe të ngrenë menjëherë aty afër/pranë një postë të përparuar, por sulmi mund të vazhdojë, pasi forcat në këtë rast nuk janë brënda në fshat dhe mandej nuk mund të dihet saktësisht se ç'forca ishin ato. Kështu që në këtë rast, Forcat tona, efektivisht nuk do të jenë në gjëndje të angazhojnë me luftime Forcat Talibane, apo të ballafaqohen efektivisht me ato (forcat talibane, të cilat operojnë në një zonë të caktuar), apo dhe të përfitojnë nga hallkat kyçe të një fshati të caktuar.

Në këtë rast ne shtjelluam një rast tipik të veprimeve operacionale të forcave tona, por veprimet e tyre do të jenë në forma e në mënyra nga më të ndryshmet në përshtatje me situatën që paraqitet. Banorët lokalë janë jo të gatshëm për të dhënë ndihmesën e tyre, për arsye se kur ata i shohin duke biseduar me forcat Aleate dhe Forcat Afghane (forcat e shtrisë dhe të policisë afghane) gjatë ndonjë vizite që mund të bëjnë Talibanët në fshat mund të kërkojnë përfundime të sakta se kush bisedoj dhe çfarë bisedoj me Ato (Forcat Aleate dhe Forcat Afghane). Fshatarët Afghane e dinë se Qeveria e tyre nuk ka ndonjë plan efektiv, i cili mund të marrë në konsideratë dhe Talibanët në fshatin e tyre dhe për këtë ata vetëm u japin informacion tipik forcave Talibane, ose elementëve kriminalë duke e kthyer situatën me grindje dhe të përgjakshme. Populli Pashtu, në Afghanistan është i vendosur/këmbëngulës për sigurimin e drejtësisë dhe paqes duke qënë të gatshëm për t'a pagur këtë me gjakun e tyre këtë çmim dhe duke luftuar kundër Forcave Talibane.

Kundërveprimi ndaj talibanëve në një fshat afghan

Për të kundërshtuar çrregullimet dhe ndrydhjet Talibanë mbi popullsinë, nuk duhet të arrijmë në përfundime efektive duke ve-ndosur shumë trupa/forca në postet e përparuara. Tru-pat tona duhet të koordinojnë aktivitetin e tyre me popullsinë lokale dhe të ndërtojnë/



Fig. 3. KONTROLI TALIBAN I NJË FSHATI AFGHAN PËRGIJATE LUGINËS SË LUMIT

ngrënë sigurinë përmes këtij koordinimi brenda fshatrave. Kur Forcat Aleate/tona dhe Forcat e Sigurisë Afghane do të luftojnë për të bërë këtë (duke luftuar kundër Talibanëve), atëherë luftimet mund të kthehen në raste të veçanta tipike të dhunës duke përfshirë dhe popullsinë civile, ndërkohë që Talibanët do të orvaten të marrin kontrollin e tyre.

Forcat Aleate/tona, Forcat e Sigurisë dhe forcat Qeveritare Afghane u lind e nevojshme të identifikojnë individët për të goditur në mënyrë vdekjeprurëse, ose jovdekjeprurëse objektivat e përcaktuara. Kjo

kërkon njohje të thellë të strukturave/ ndërtimeve Tribale/Fisnore, aleancat dhe armiqësitë midis tyre. Alternativat e zbatueshmerisë/shanseve, ose nevoja e përzgjedhjes për t'i bërë të kapshme këto alternativa duhet të fokusohet në liderat dhe tek fshatarët brenda fshatit. Pikërisht, duke vendosur Forcat Aleate dhe Forcat e Sigurisë Afghane në postet e përparuara duke dhënë përshtypjen e drejtimit dhe presencës së një patrulle, zakonisht ngacmohet/tallet popullata lokale, si rrjedhojë mbledhjet (bisedimet) e quajtura “shura- në gjuhën Afghane, *Dari*”, të cilat janë planifikuar për t'u zhvilluar një herë në muaj nuk do të funksionojnë.

Identiteti Afghani, nuk është kombëtar në origjinë, brenda kufijve të shtrirjes gjeografike në kuadrin e një qeverisje të centralizuar kombëtare. Identiteti Afghani, në natyrën e tij është Tribal/Fisnor. Identiteti i pikëpamjeve Amerikane, si një qeverisje kombëtare, në fshatrat Afghane nuk egziston. Tribet/Fiset për ata janë më të rëndësishëm. Funksionimi i gjërave në vend “Afghanistani” nga Kabuli nuk kanë shumë kuptim për popullin Afghani që jeton në fshatra nën detyrimin Taliban.

Forcat Aleate dhe ato të Sigurisë Afghane duhet të jenë të afta të depërtojnë dhe të formësojnë hallkat kyçe të ndikimeve, që veprojnë në fshatrat Afghane dhe mandej të përcaktojnë qartësisht individët dhe objektivat e tyre. Pikërisht, tashmë Forcat Aleate kanë përqafuar/janë të përfshira në mënyrën e qeverisjes së centralizuar nga Kabuli dhe Qeveria e Presidentit Hamid Karzai duke ofruar përqasje që me dashje apo pa dashje deri kohët e fundit e shmangnin në një farë mase stërvitjen dhe trajnimin e Ushtrisë dhe të

Policisë Afghane me forma e metoda të ngjashme me ato të vendëve anëtare të Aleancës, por që tashmë janë vënë në efikasitet dhe në rrugën e zgjidhjes.

Procedurat dhe taktikat aktuale të Forcave Aleate të ndjekura deri në tani kanë synuar të identifikojnë Talibanët pa bërë një vlerësim të ndikimeve, ose rolit shoqëror të tyre në nivel lokal, apo fshati. Nuk u përqëndruan përpjekjet për të lidhur individualitetin e tyre nëpërmjet një zbulimi të plotë të fushëbetejës me sulmin ndaj rrjeteve të tyre të pakompletuara. Individët, të cilët në hallkat kryesore të veprimit, ose të influencës së tyre në një fshat të cilësuar si neutralë, pro, ose kundër Qeverisë Afghane, duhen identifikuar dhe mandej të hyet në marrëveshje me ata.

Rrugë tjetër e identifikuar dhe më e lehtë është t'ja lësh rastësisë, e cila nuk i vjen në takim iniciativës së Forcave tona (Aleate). Forcat e Aleancës dhe Forcat e Sigurisë Afghane gjithashtu duhet të shpikin, të sajojnë dhe të lehtësojnë taktikat e tyre për të luftuar brenda dhe jashtë fshatit. Kjo, në të vërtetë kërkon organizime ushtarake në madhësi të vogla të këmbësisë së lehtë, si dhe taktika dhe teknika reale antikryengritësve/antiterroriste, ndoshta të përinterpretuara dhe të pa lexuara nga lidhësi në manualët më të fundit që janë në përdorim të Aleancës, si dhe një angazhim të forcave për veprime operacionale në tokë.

Këto taktika duhet të mostjetërojnë paisjet e lehta dhe manovrën e shpejtë të forcave antiterror/antikundërkryengritësve, të cilat kur shkojnë të kryejnë një mision në fshat, ose zonë të caktuar duhet të bashkëpunojnë dhe të ndërveprojnë me autoritetet lokale në identifikimin e terroristëve Talibanë. Këto forca duhet të kenë aftësi për të përcaktuar kohën e nevojshme të qëndrimit në një zonë të caktuar të identifikuar tashmë në nivel lokal dhe të mundësisë për t'u kthyer prapë në bazë. Vështirësitë për manovrimin e forcave nga një vend në tjetrin në tokë me përdorimin i makinave të blinduara, për shkak të terrenit të thyer dhe tepër të thyer malor, ndërkohë vështirësia për të riangazhuar lidhësin lokal nuk duhet të proferohen nga forcat tona.

Nga ana tjetër, përcaktimi, identifikimi dhe goditja e objektivave tona me vlera thelbësore nga ana e tyre, do të mund të japë rezultatet e veta me sindroma të një grushti të forte ndaj forcave tona. Kjo do të jetë demoralizim për Forcat Aleate dhe Forcat e Sigurisë Afghane e publikun e tyre, të cilët kërkojnë të jetojnë në paqe. Forcat e këmbësisë së lehtë duhet të zhvillojnë në mënyrë të specializuar rikonicionin në një fshat Afghan, apo në një zonë të caktuar dhe të përdorin taktika të provuara, të ngjashme me stërvitjet që zhvillohen për përcaktimin e objektivave me anën e shikimit vizual për të vëzhguar terroristët talibanë brenda dhe jashtë fshatit/zonës, stërvitjeve me taktikat dhe teknikat e duhura të pritave të veçanta jashtë fshatrave, si dhe të njohin me imtësi situatën thelbësore në një fshat lokal.

Taktikat e këmbësisë duhet të përdorin me efikasitet krahëmarrjen dhe shpinëmarrjen vertikale kundër luftëtarëve talibanë, nëpërmjet helikopterit dhe parashytimit/katapultimit për të ndërprerë rrugët dhe shtigjet e largimit të tyre (talibanëve). Forcat tona duhet të zhvillojnë patrullime në këmbë brenda në fshat natën, të llogaritura mirë duke biseduar dhe dokumentuar me emra konkretë banorët, për të kryer më vonë analiza të hollësishme Ato (forcat tona) duhet të kenë vendbazime të sigurta për të kryer veprimet e tyre operacionale. Bazat e mëdha, ose bazat operacionale të përparuara, do të jenë vetëm për mbështetje. Po kështu repartet, nënrepartet dhe veprimet e tyre taktike të jenë të decentralizuara.

Referencat:

Materiali është bazuar kryesisht në eksperiencat personale të autorëve gjatë vëzhgimeve në kuadrin e misionit “Enduring Freedom” në Afghanistan, për rrjedhojë, është një analizë që bëhet nga ana jonë dhe nuk është analizë e bërë nga Institucionet, si MM, apo Shtabi i Përgjithshëm, apo ndonjë organizatë tjetër qeveritare ose joqeveritare në vend. Si burime informacioni, krahas kësaj janë shfrytëzuar:

Materialet e Qendrës së Bashkuar Amerikane; për “Analizat Operacionale” dhe konkretisht në adresat si më poshtë:

1. Anthony.crutchfield@jfc.com.mil
2. Alan.preisser@jfc.com.mil
3. Census Bureau. (2007). The statistical abstract: The national data book. US Census Bureau
nw adreswn: <http://www.census.gov/compendia/statab/population/religion>
4. [http://www.heritage.org/Research/National Security/cda05-08.cfm](http://www.heritage.org/Research/National%20Security/cda05-08.cfm)
5. <http://lcweb2.loc.gov/frd/cs/aftoc.html>
6. <http://insidedefense.com>
7. www.smallwarsjournal.com; comment @smallwarsjournal.com.
<http://blog.stevenpressfield.com>

Konceptet e mbrojtjes kolektive, sigurisë kolektive dhe sigurisë bashkëpunuese në kuadër të Konceptit të Ri Strategjik të NATO-s

Nënkolonel Xhemil Hurdha
Oficer Shtabi, analist në DKO&MN,QAM

Abstrakt: *Në studimet e shumta analitike të kryera gjatë shekullit të 19, shumë analistë të fushave të ndryshme politiko-shoqërore, por kryesisht ata ushtarakë, e përshkruanin sigurinë kolektive si një mënyrë për stabilizimin e paqes botërore. Koha do të vijë kur nevoja të kërkojë në mënyrë urdhërore ku mbajtja e një shumice, të përfaqësuar dhe të grumbulluar burrash do të jetë plotësisht e realizuar. Sundimtarët dhe mbretërit e botës do t'iu duhet të përqafojnë dhe të marrin pjesë në të dhe marrja pjesë me dëshirë në të duhet konsideruar një rrugë dhe mënyrë për të shtrirë paqen e madhe midis burrërisë në botë.*

Një paqe e tillë kërkon që fuqitë e mëdha duhet të zgjidhin që për hatër të paqes së njerëzve në botë, të jenë plotësisht të pajtuar midis vetes së tyre. Nëse donte ndonjë mbret të ngrinte armën kundër një tjetri, të gjithë të bashkuar duhet të ngrihen dhe ta ndalojnë atë. N.q.s kjo arrihet kombet e botës nuk do të kërkojnë më armatosje, vetëm për qëllimin e ruajtjes së sigurisë të mbretërisë së tyre dhe ruajtjen e rregullit të brendshëm brenda territorit të tyre. Kjo do tu sigurojë paqen dhe qetësinë çdo njeriu, qeverie dhe kombi.¹

Hyrje

Pas rënies nga brenda të ish vendeve socialiste dhe shkrirjes së traktatit të Varshavës në vitin 1990, u ngrit një pyetje mbi të ardhmen e traktatit të Aleancës së Veriut. Dyshime të mëdha u ngritën në konferencën e sigurisë dhe bashkëpunimit në Europë, e cila u perceptua nga shumë studiues si një alternativë e përshtatshme e NATO-s absolute. Shumë autorë prestigjioz veçanërisht nga shkolla realiste dhe neo-realiste parashikuan fundin e NATO-s lidhur me mosegzistencën e një armiku të përbashkët. Qysh prej fundit të luftës së ftohtë NATO ka ecur përmes një proces adoptimi që ka ndryshuar NATO-n, përtej njohjes. Në fillimin e procesit të adoptimit permanent të NATO-s, është e mundur të respektohet adoptimi i deklaratës së Londrës më 1990. Forma e NATO-s sot ndryshon thelbësisht nga ajo e luftës së ftohtë. Detyrat e NATO-s janë shtruar në mënyrë domethënëse, ashtu dhe territori, dhe numri i anëtarëve.

Rob de Javik tregon adoptimin e suksesshëm të NATO-s në situatën e re është një ngjarje e paprecedent sepse traditat ushtarake të aleancës ishin shkrirë së bashku me shpirtin e

¹ Fakte të mbledhura dhe përkthyer nga shkrimtar Shoghi Effendi botim i vitit 1983. f-248.

arsyes për ekzistencën e tyre në të shkuarën. Sidoqoftë, në respekt të kësaj është e nevojshme të merret në llogari, që NATO nuk ka qenë kurrë një aleancë e pastër ushtarake e mbrojtjes kolektive, bazuar ekskluzivisht në kalkulimet strategjike dhe interesat kombëtare të përcaktuara nëpërmjet realizmit dhe neorealizmit. Në periudhën e luftës së ftohtë, ai mori tipare të komunitetit të sigurisë.

Në veçanti, çështja e transformimit të NATO-s në një organizatë-sigurie-kolektive është diskutuar nga shumë ekspert të spikatur si në fillim ashtu dhe pas 1990. Ato e lidhin me problemin se çfarë zgjerimi të suksesshëm do të kishte NATO në atë të sigurisë-kolektive. Henri Kissinger madje doli në konkluzionin se NATO ishte kthyer më e ngjashme në një organizatë-sigurie se aleancë tradicionale. Për më tepër, gjithashtu Richard E Rupp pretendonte se “NATO e transformoi veten e saj në një organizatë që ka më shumë të përbashkët me sigurinë-kolektive se mbrojtjen-kolektive. Prandaj është e këshillueshme të tregohet kujdes në çështje se çfarë drejtimi duhet të ndjek aleanca nëse ajo vërtet synon të adoptojë tipare e veçori të një organizate-sigurisë-kolektive”.

Për tju përgjigjur kësaj pyetje ky material do të përqendrohet në idetë konceptuale të mbrojtjes, sigurisë kolektive e bashkëpunuese dhe rolin e tyre brenda NATO-s.

Në Konceptin Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut të Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë 2010 u theksua se: Mjedisi modern i sigurisë përmban një zhvillim të gjerë dhe të vendosur të sfidave për sigurinë e territoreve dhe popullsisë të NATO-s. Me qëllim garantimin e sigurisë tonë, Aleanca duhet dhe do të vazhdojë efektivisht në përmbushjen e **tri detyrave themelore kryesore, si Mbrojtjen Kolektive, Menaxhimin e Krizës, Siguri Bashkëvepruese** të cilat kontribuojnë në sigurinë e anëtarëve të Aleancës, dhe gjithmonë në përputhje me ligjet ndërkombëtare².

Koncepti i mbrojtjes kolektive

Anëtarët e NATO-s, gjithmonë do të ndihmojnë njëri-tjetrin kundër ndonjë sulmi, në përputhje me Nenin 5 të Traktatit të Uashingtonit. Ky përkushtim mbetet i fortë dhe detyrues. NATO do të parandalojë dhe mbrohet ndaj çdo agresioni dhe shfaqje të kërcënimeve të sigurisë, kur ato kërcënojnë sigurinë fundamentale të Aleatëve ose të Aleancës si një e tërë.³

Koncepti i mbrojtjes kolektive është një mjet tradicional për analizën e problemeve të sigurisë, shpesh aplikuar nga vendet në të shkuarën. Në një nivel teorik, ky koncept bazohet në besimin se funksionimi i sistemit të lidhjeve ndërkombëtare është përshkruar mjaft mirë nga teoritë realiste dhe jorealiste.

Brenda konceptit të mbrojtjes kolektive synohej drejt dimensionit politik e ushtarak të sigurisë. Thelbi është vënë gjithashtu në garantimin e sigurisë së vendeve në sistemin e anarkisë kombëtare, Objekti referues i politikës së sigurisë brenda këtij koncepti është një shtet hyrës në aleancë. Anëtarësia e aleancës është ekskluzive. Principi e mbrojtjes kolektive

² “Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë, Nëntor 2010.

³ “Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë Nëntor 2010

shtrihet në pranimin e besës, në dhënien e gjithë ndihmës së mundshme, duke përfshirë ndihmën ushtarake, n.q.s një shtet anëtarë sulmohet nga jashtë.

Brenda konceptit të mbrojtjes kolektive, siguria e shteteve anëtare nuk mund të kërcënohet nga brenda Aleancës. Aleanca e formuar në këtë mënyrë është e orientuar drejt një armiku të jashtëm. Forma kryesore e kërcënimit të sigurisë menduar brenda konceptit është një sulm ushtarak nga jashtë. Eliminimi, spastrimi i kërcënimeve jo ushtarake janë përtej kompetencave të aleancës. Koncepti i mbrojtjes kolektive mendon ekzistencën në terma afatgjatë interesa reciproke të përbashkëta të shteteve të përfshira. Sa më tepër të përmbushen interesat afatgjatë të organizatës më e fortë dhe jetike është ajo.

Koncepti i mbrojtjes kolektive nuk mendon ndërtimin e një regjimi autoritarë ndërkombëtarë duke autorizuar fuqinë ushtarake vetëm në situata vetëmbrojtëse ose veprim kolektiv kundër një agresori. Një tipar i përbashkët gjithashtu mund të prezantohet nga ndarja e vlerave reciproke duke patur efekt në procesin e formimit të interesave kombëtare të shtetit anëtarë. Sidoqoftë ajo nuk është e nevojshme të jetë kështu. N.q.s e zgjerojmë konceptin e mbrojtjes kolektive duhen ndarë vlera dhe principe reciproke, ne flasim për konceptin e një komuniteti sigurie. Në periudhën e luftës së ftohtë, të dyja NATO dhe Traktati i Varshavës ishin komunitete sigurie. Në rast se këto vlera prezantohen nga principet e demokracisë dhe liberalizmit ai është një koncept i një komuniteti sigurie pluraliste.

Koncepti i sigurisë kolektive

Koncepti i sigurisë kolektive mund të jetë i ndërlikuar. Ajo është një marrëdhënie me shumë kuptime në lidhjet ndërkombëtare. ***“Përcaktimi bazë i sigurisë kolektive është një sistem i rregullt botëror në të cilën pesha e komunitetit të tërë ndërkombëtarë do të hidhet kundër çdo agresioni të ndërmarrë nga ndonjë shtet, siç parashikohet në deklaratën e Kombeve të Bashkuara”***. Sidoqoftë, transformimi i NATO-s pas luftës së ftohtë nuk duket se e përmbush këtë përcaktim bazë. Aleatët që prej transformimit i kanë rezistuar gjerësisht thirrjes për të lëvizur drejt një sistemi Kantian ose Uillsonian të sigurisë kolektive liberale. Një sistem i tillë do të nënkuptonte obligime për tu marrë vesh me të gjithë çështjet ndërkombëtare si agresioni dhe padrejtësitë në rajonin Euro-Atlantik. Në praktik pavarësisht se teoria e përgjithshme e tyre se *“Siguria është e pandashme, aleatët kanë ndjekur vetëm sigurinë kolektive të llojit konsensus i fuqishëm madhor”* duke propozuar të veprojnë në mbështetje të sigurisë kolektive në dëshirën e këshillit të OKB dhe OSBE.

Mbrojtja kolektive shpesh afirmohet me realizëm dhe siguria kolektive me liberalizëm. Perspektiva realiste ka një pikëpamje Hobsiane për botën. Ajo është një botë ku ligjet e rregullat anarkike duhen në lidhjet ndërkombëtare në një botë pa rregulla ndërkombëtare shtrënguese dhe ku qeveritë shqetësohen më tepër për interesat e veta. Qysh kur shqetësimi më i madh i qeverive është interes personal, lidhja ndërkombëtare është për fuqi ose ti lënë vendet të bëjnë çfarë të duan. Sipas gjykimit realist bota është një lloj mbledhje me zero, ku nëse një vend i afrohet një vendi tjetër ai duhet të humbasë. Nën këto kushte një organizatë-mbrojtëse-kolektive është më efektive se një organizatë-sigurisë-kolektive sepse ajo i kërkon anëtarëve të identifikohen me një kërcënim specifik të përbashkët me to dhe mund të bien dakord për mbështetje reciproke mbrojtëse kundër kërcënimit.

Qëllimi i aleancës për siguri multinacionale do të funksionojë vetëm nëse shtetet besojnë në qenien aktive se njerëzit do të ndihmojnë apo mbrojnë interesat e tyre. Nga ana tjetër doktrina e sigurisë-kolektive është shumë e ndryshme. Koncepti i siguri kolektive bazohet në perspektivën idealiste apo liberale të lidhjeve ndërkombëtare. Koncepti i siguri-kolektive është zakonisht i lidhur me Uindrou Uilson dhe Emanuel Kant. Heqja dorë nga politikat e forcës, Uilson kundërshtoi diskutimin se shtetet pashmangshmërisht funksionojnë në një sistem vetë-ndihme në të cilën ato kanë vendin e nevojshëm dhe interesat e tyre rreth këtij shqetësimi. Ai e mbajti këtë qëndrim sepse shtetet kanë qartësisht interesa në mbrojtjen e rregullit ndërkombëtarë që ato e shikojnë si përfitim në sigurinë e tyre personale, ato do të kontribuojnë në koalicion dhe sikur ato të mos kenë interesa jetike në piketimin e agresionit aktual.

Veprimet e NATO-s më 1990 kanë përmbushur përcaktimin e sigurisë-kolektive liberale, por tenton të ketë rezultat realist. Në Bosnje NATO ishte jo decizive për një kohë të gjatë për shkak të mungesës së një zgjidhje dhe ndenjes se konflikti ishte jashtë interesit të saj direkt. Kur NATO u përfshi fuqimisht nuk kishte më druajtje se n.q.s NATO nuk vepronte do të shikohej si një dështim i saj.

Në Kosovë NATO veproi më fuqimisht por u fut akoma më shumë në probleme. Aleanca ishte e pasigurtë nëse të përdorte trupa tokësore n.q.s fushata ajrore nuk do të ishte e suksesshme, dhe aftësia për të drejtuar fushatën ajrore ishte deri diku e penguar nga rritja e numrit të anëtarëve, duke patur 19 anëtarë. Pika e rëndësishme këtu është viti 1990 kur NATO nuk ishte duke vepruar në interesat direkte të anëtarëve të saj apo nuk kishte kërcënim të qartë apo direkt, këto ardhje të vogla ishin parë si një çmim i vogël për tu paguar për veprimet e NATO-s, suksesi dhe legjimiteti.

Por pas 11 Shtatorit 2001, roli i NATO-s dhe kërcënimet ndaj botës kanë ndryshuar pothuajse plotësisht. Papritur SHBA u sulmuan, u besua e vërtetua se tani kërcënoheshin në të vërtetë interesat e saj. Nën këto kushte, disa besojnë (duke përfshirë dhe SHBA), se siguria kolektive mund të ndalojë një vend nga veprimi kundër një kërcënimi të tillë. Një shembull i mirë janë ngjarjet në Afganistan, kur SHBA nuk pyetën për asistencën e NATO-s, dhe të mendosh se NATO mbështetet në Artikullin 5 të Traktatit të Veriut. Për ta bërë më të dukshme, kur ajo erdhi në një kërcënim real SHBA nuk kanë nevojë për NATO-n, për shkak të natyrës së saj të sigurisë-kolektive.

Koncepti i sigurisë bashkëpunuese

Aleanca mund të ndikojë dhe ndikohet nga zhvillimet politike dhe sigurisë përtej kufijve të saj. Aleanca do të angazhohet aktivisht në rritjen e sigurisë ndërkombëtare, nëpërmjet partneritetit me vendet përkatëse dhe organizatave të tjera ndërkombëtare, duke kontribuar në mënyrë aktive në kontrollin e armëve, mospërhapjes dhe çarmatimit; dhe duke e mbajtur hapur derën për anëtarësimin në Aleancë të të gjitha demokracive evropiane që përmbushin standardet e NATO-s⁴. Në krahasim me konceptet tradicionale të mbrojtjes-kolektive dhe sigurisë-kolektive, koncepti i sigurisë bashkëpunuese është i ri. Origjina e formimit të tij i ka gjurmët në vitin 1970 dhe pati ngritje pas viteve 1990.

⁴ "Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë Nentor 2010

Siguria bashkëpunuese është konceptuar shumë e vlefshme nga disa studiues, të cilët sqarojnë se principet e sigurisë bashkëpunuese, janë rrugët e duhura drejt sigurisë botërore. Politikat tradicionale jo bashkëpunuese si (mbrojtja-kolektive, siguria-kolektive) në opinionet e tyre karakterizojnë përpjekjet për të garantuar sigurinë e shteteve ndaj agresionit të jashtëm. Një rol i rëndësishëm në procesin e garantimit të sigurisë luhet nga parandalimi i konflikteve.

Sipas këtyre studiuesve strategjia politike bazuar në konceptin e sigurisë-bashkëpunuese është tipike e përpjekjeve të shteteve për të ndaluar ndonjë ngritje armiqësi dhe shpërthimin e konfliktit apo të kufizojë shkallëzimin e tij që mund të çonte në dislokimin e forcave ushtarake. Metoda kryesore e përdorur është bashkëpunimi me kundërshtarin potencial. Rrugët bashkëpunuese të sigurisë bazohen në përmirësimin e sjelljeve të shteteve, eliminimin e keqkuptimeve, dhe parandalimin e konfliktit qysh në lindje të tij me anë të konsultimeve dhe negociatave. Lidhjet ndërkombëtare kryesisht shikohen si lojëra zero, që mund të sjellë përfitime për të gjithë pjesëmarrësit. Siguria nuk është garantuar kundër pjesëtarëve të tjerë por së bashku me pjesëtarët e tjerë. Të gjithë shtetet mendohet të perceptojnë logjikën e lidhjeve ndërkombëtare në këtë mënyrë dhe ato janë gati të luftojnë për garantim të sigurisë bashkë me të tjerët.

Këta studiues nuk e njohin konceptin e sigurisë bashkëpunuese si një domethënie të garantimit universal të sigurisë së shteteve, dhe ato bien dakord me kërkesën kushtëzuese të historisë së tij. Sipas këtyre, politika e sigurisë-bashkëpunuese bazohet kryesisht në represionin kundër dhunës së paqes. Në opinionin e tyre stili politik mund të dështojë në rast se është i përjasur me rritjen e konfliktit jashtë keqkuptimeve apo vlerësimit të gabuar të qëllimeve pjesëmarrëse të sigurisë. Sipas këtyre studiuesve strategjia e sigurisë bashkëpunuese është për zvogëlimin e rrezikut të shpërthimit të një konflikti për shkak të një vlerësimi të gabuar të situatës, ashtu si bashkëpunimi me armiqtë potencialë ashtu dhe shkalla e lartë e transparencës në çështjet e sigurisë përgjithësisht kufizon hapësirën për një llogaritje të gabuar të qëllimeve reciproke.

Sidoqoftë këto gjithashtu tregojnë thembrën e Akilit të konceptit të sigurisë bashkëpunuese shtrirë në mundësitë e tij të limituara për të eliminuar agresionin e qëllimshëm në pjesën e shteteve që nuk synon të kushtohet rrugëve të bashkëpunimit për garantimin e sigurisë, shteti dëshiron të identifikojë sigurinë e tij në zgjerimin shteteve të tjerë, konceptet e sigurisë bashkëpunuese dhe jo bashkëpunuese mund të plotësojnë por jo të zëvendësojnë njëra tjetrën.

Koncepti i sigurisë bashkëpunuese fokusohet kryesisht në dimensionet politike e ushtarake të sigurisë. Objekti referues brenda konceptit të sigurisë bashkëpunuese është shteti ose mundësisht një grup shtetesh.

Shtetet mendohen të mos kenë interesa identike. Siguria perceptohet e pandarë dhe ajo nuk mund të jetë e garantuar për një shtet me shpenzimet e të tjerëve. Koncepti i sigurisë bashkëpunuese bazohet në idenë e përfshirjes së shteteve të tjerë në procesin e bashkëpunimit kur bën marrëveshje për problemet e sigurisë me qëllimin e zvogëlimit të dilemave të sigurisë dhe shmangien e shpërthimit të armiqësisë. Ideja kryesore e konceptit të sigurisë-bashkëpunuese nuk është lufta për sigurimin e një shteti të veçantë, por për bashkëpunim me shtetet e tjera pjesëmarrëse, të garantojë siguri për të gjithë. Nuk është thelbësore për

bashkëpunim të shteteve brenda konceptit të sigurisë bashkëpunuese të jetë karakteristikë në ndarjen e vlerave reciproke⁵.

Madje vendet, vlerat orientuese të cilëve është i ndryshëm mund të veprojnë kundrejt njëri tjetrit mbi baza të strategjisë politike duke dalë kundër konceptit të sigurisë bashkëpunuese. Brenda këtij koncepti, kuptohet se rruga e bashkëpunimit me partnerët, situata pasardhëse do të parandalohen në çdo rast kur pjesëtarët do ta shikojnë një shtet tjetër si një armik potencial dhe gjykojnë se është me vend të shtrëngojnë dhe mbrojnë interesat e tij kundër tij, me mënyra ushtarake, ose ngritjen e instrumenteve ushtarake në mënyrë për të realizuar atë. Ideja kryesore e konceptit të sigurisë bashkëpunuese duke vlerësuar ushtrinë është parandalimi i një situatë në rrugën e bashkëpunimit me partnerët dhe transparencë në zonat ushtarake të cilat lejojnë lançimin e një organizate të suksesshme dhe përgatitjen për ta bërë këtë.

Për sa më sipër u konkludua se ideja kryesore e konceptit të sigurisë bashkëpunuese është të ndalojë një shpërthim të mundshëm armiqësie duke bashkëpunuar në çështjet e sigurisë. Prandaj është e nevojshme të tregohet kujdes në përfundimet e NATO-s në Bukuresht, Strasburg e Lisbonë për krijimin e kushteve për thellimin dhe zgjerimin e bashkëpunimit me vendet jo anëtare të NATO-s.

Qysh kur u themelua, Federata Ruse ka qenë një partner i spikatur i NATO-s. Që nga përfundimi i luftës së ftohtë NATO ka treguar kujdes të madh në ndërtimin e marrëdhënieve bashkëpunuese me Rusinë dhe ajo ka ngritur një rrjet të madh institucionesh për të mundur një bashkëpunim të tillë. NATO deklaroi të vazhdojë kjo politikë dhe në Bukuresht por dhe në Samitin e Lisbonës ku u theksua se Marrëdhëniet NATO-Rusi bazohen mbi qëllimet, parimet dhe angazhimet e Aktit Themelues NATO-Rusi dhe në Deklaratën e Romës, sidomos në lidhje me respektimin e parimeve demokratike dhe sovranitetin, pavarësinë dhe integritetin territorial të të gjitha shteteve në zonën Euro-Atlantike. Pavarësisht nga dallimet në çështje të veçanta, jemi të bindur se siguria e NATO-s dhe Rusisë është e ndërthurur dhe në bazë të partneritetit të fortë konstruktiv, transparencës, parashikueshmërisë dhe besimit reciprok mund ti shërbejë më së miri sigurisë tonë⁶.

Nga perspektiva e konceptit të sigurisë bashkëpunuese, çelësi i çështjes së tanishme midis NATO-s dhe Rusisë e ardhmja e marrëveshjes mbi forcat konvencionale të armatosura në Europë (CFE Treaty). Marrëveshja kodifikon një reduktim thelbësor të numrit të limituar të llojeve të armëve, paraqet mekanizmin e kontrollit të inspektimit, i cili mbyll procesin e armatimit në Europë. Në vitet e shkuara, aplikimi i traktatit në mënyrë thelbësore reduktonte rrezikun e një shpërthimi të konfliktit global në Europë⁷. Madje, mendimi racional i ekspertëve Rusë pranon se për shkak të kësaj marrëveshje asnjë shtet në Europën e sotme nuk është nën kërcënimin direkt ushtarak⁸.

⁵ Regarding this issue, Cohen and Mihalka have a different opinion.

⁶ "Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë Nentor 2010

⁷ HODGE, Carl Cavanagh, *Atlanticism for a New Century. The Rise, Triumph and Decline of NATO*, p. 27.

NATO përkrahu traktatin e asociim stabilizimit me obligimet përbushëse të Ruisë në lidhje me Gjeorgjinë e Moldavinë⁹, tërheqja e Ruisë nga traktati largon inspektimin e hollësishëm dhe paralajmëron sistemin ose e ka bërë shumë të vështirë të lançojë një sulm të papritur në Europë dhe kështu ai shkatërron një nga gurët themelorë në ndërtimin e sigurisë- bashkëpunuese në Europë. Megjithatë NATO ka pak mundësi për ta bindur Rusinë për rëndësinë e këtij traktati dhe ajo është në dorë të saj nëse ajo ndryshon qëndrimin e saj ose përbush obligimet e saj, ose tërheqja nga traktati do të jetë i pakthyeshëm. Por është e nevojshme të mbahet në mendje se NATO shprehu deklaratën e samitit të Bukureshtit se “Situata e tanishme, ku NATO dhe Aleatët e CFE e zbatuan traktatin ndërsa Rusia jo. Përveç kësaj NATO dëshironte të forconte bashkëpunimin me Rusinë në zonën e mbrojtjes raketore. Kjo politikë e NATO-s mund të vlerësohet si një shembull i aplikimit të strategjisë së sigurisë–bashkëpunuese sepse NATO mundohet të shmangë çdo keqkuptim me Rusinë lidhur me mbrojtjen raketore.

NATO duhet të ruajë në mendje se aplikimi i principeve të konceptit të sigurisë bashkëpunuese drejt Ruisë është një strategji e përshtatshme vetëm nëse Rusia nuk merr drejtim të qëllimshëm të konfrontimit me NATO-n. N.q.s Rusia pranon konfrontimin me NATO-n si princip bazë të marrëdhënieve me të, mund të jetë e nevojshme të ripërcaktohen politikat e aleancës kundrejt këtij vendi, dhe përbushjen e detyrimeve të traktatit të CFE. Përfundimi final i traktatit të CFE mund të interpretohet si një simptomë e qëllimit Rus për adoptimin e një politike konfrontuese kundër NATO-s, si një shembje e regjimit të kontrollit e vrojtimit, do të rezultonte një situatë që Rusia të kishte kushte më të mira për përgatitjen e një agresioni ushtarak të suksesshëm ndaj perëndimit. Fakti që Rusia tani, dhe ushtria e saj nuk është në gjendje të mirë për një politikë të tillë nuk do të thotë se ajo mbetet kështu përherë.

Nga ana tjetër NATO gjithashtu mund, në rast të një fundi ultimativ të këtij traktati, të përgatisë më me lehtësi një sulm ushtarak surprizë kundër Ruisë. Prandaj n.q.s Rusia e bën traktatin të përfundimisht të pushojë, politika e saj përkthehet në një farë mënyre se ajo nuk i trembet sulmit ushtarak të NATO-s. Kështu është e mundur të konkludohet se strategjia e NATO-s pas luftës së ftohtë kundrejt Ruisë, bazuar mbi sigurinë bashkëpunuese ishte e suksesshme.

Në të shkuarën, Aleanca zhvilloi bashkëpunime intensive sigurie me vendet në Mesdhe, Gjirin Persik madje dhe me vendet e Lidhjes Arabe. NATO ka theksuar rëndësinë e këtij bashkëveprimi në Bukuresht dhe në Lisbonë. Këto aktivitete mund të interpretohen si një aplikim i konceptit të sigurisë-bashkëpunuese. Qëllimi i këtij bashkëpunimi nuk është përgatitja e këtyre vendeve për t'u bashkuar NATO-s në të ardhmen, sidoqoftë ajo do të thotë një zgjidhje reciproke të problemeve të sigurisë, eliminimin e keqkuptimeve të thella dhe ndërtimin e marrëdhënieve të mira.

Bashkëpunimi i vazhdueshëm me Bosnje-Hercegovinën, Malin e Zi dhe Serbinë përmendur në Samit mund të interpretohen më të ngjashme si një zbatim i konceptit të sigurisë

⁸ See TSYGANOK, Anatoly D., *NATO's Istanbul Summit and Problems of the Russia-NATO Council*, pp. 205–209.

⁹ Russia promised to fulfil these obligations in the negotiations on the adapted treaty. The adapted treaty was signed in Istanbul in 1999.

bashkëpunuese se koncepti i mbrojtjes kolektive. Për këtë kohë, çështja e anëtarësimit të shteteve të lartpërmendura nuk është çështje e ditës. Qëllimi është të ndihmohen këto vende në procesin e transformimit dhe të zgjidhin dyshimet ato dhe NATO, daljen nga ngjarjet historike të lidhura me dhunën e shpërbërjes së Jugosllavisë. Megjithatë, bashkëpunimi me Maqedoninë, Ukrainën, Gjeorgjinë, Serbin Malin e Zi ka një dimension komplet ndryshe. Synimi i deklaruar i këtyre vendeve nuk është bashkëpunimi me NATO-n por të hyrjes në aleancë, dhe kështu fiton garantimin e sigurisë të themeluar nga artikulli 5 i traktatit të Uashingtonit. Kështu bashkëpunimi i lidhur në këtë mënyrë nuk mund të interpretohet si një zbatim i konceptit të sigurisë bashkëpunuese, por si një zbatim i konceptit të mbrojtjes kolektive. Maqedonia ka një shans të vërtetë për të lançuar hyrjen në bisedime sa më shpejt për zgjidhjen e mosmarrëveshjeve me Greqinë.

Një detyrë e rëndësishme e NATO-s është të ndërtojë marrëdhënie me vende të tjera të botës që shtrihen gjeografikisht jashtë zonës së interesit të aleancës duke ndarë interesa reciproke dhe vlera me NATO-n. Bashkëpunimi me vendet e Azisë jug-lindore dhe Paqësorin (artikulli 35) gjithashtu mund të interpretohet si rezultat i mendimit për sigurinë brenda konceptit të sigurisë-bashkëpunuese, më mirë se zbatimi i konceptit të mbrojtjes-kolektive.¹⁰ Shpallja e bashkëpunimit të ngushtë të sigurisë me OKB, me BE dhe organizatat e tjerë ndërkombëtare konform principeve dhe konceptit të sigurisë bashkëpunuese, e cila apriori parashikon bashkëpunim të ngushtë të pjesëmarrëseve përkatës ndërsa mbrojnë(mbajnë) siguri.

Detyrat e reja dhe partnerët e NATO-s

Siç tashmë u përmend fokusi i NATO-s përmes aktiviteteve të sigurisë ushtarake ka ndryshuar thellësisht. Në zonën e luftës së ftohtë prioriteti ishte ndalimi i armëve nukleare. Sidoqoftë këto çështje kanë qenë të vlerësuara fuqimisht. Si fillim dhe për më tepër aktivitetet e NATO-s kanë ndryshuar në drejtim jashtë zonave operacionale. Në këtë shteg NATO u mundua të krijojë lidhje të reja me jo pjesëtarë në princip të sigurisë së përbashkët.

Në konceptin e saj strategjik adoptuar në Romë në nëntor 1991, NATO themeloi një bashkëpunim të ri marrëdhëniesh me vendet e Europës Qendrore dhe Lindore¹¹.

NATO filloi të zhvillojë një set të ri forumesh dhe strukturash për të institucionalizuar këto marrëdhënie të reja. Në dhjetor 1991 ishte themelimi i Këshillit të Bashkëpunimit të Atlantikut të Veriut (NACC), në janar 1994 ishte programi i partneriteti për paqe (PfP), i cili thelloi bashkëpunimin dhe këshillimin ndërmjet NATO dhe CEEC, dhe në 1997 u themelua këshilli i partneritetit Euro Atlantik (EĒAPC) dhe bëri një ftesë të haur për të gjithë CEEC të bashkohen më aleancën. Në vitin 1999 gjithashtu u themelua Plani i Veprimit për Anëtarësim. Në samitin e Uashingtonit 1999 NATO lançoi aftësinë e kapaciteteve mbrojtëse për të mbështetur forcat e saj për detyrat e reja me qëllim ndërhyrjet në menaxhimin e krizave. Duke përmbledhur gjithë këto iniciativa është e qartë se NATO po mundohet një zgjerim më të madh se në të shkuarën. Vetëm një vështrim e i shpejtë të

¹⁰ *The Singapore case is a bit complicated because this country is not a democracy. On the other hand, Singapore and NATO countries share common interests.*

¹¹ *See NATO Handbook, available at www.nato.int/docu/handbook/2001/hb1204.htm*

programit të punës së NACC ose PFP do të zbulojë një zhvillim ekstrem aktivitetesh, disa prej të cilave janë shumë pak të lidhura me sigurinë ushtarake¹².

Çelësi për këtë NATO të re është institucionalisht fleksibël. Sipas pikëpamjeve CJTF (Combined Joint Task Force) forcat duhet të variojnë sipas kushteve. Zyrat qendrore, Shtabet, duhet të formohen Ad-hoc. Anëtarët dhe partnerët duhet të kontribuojnë si nevojë, për tu përdorur një modular të përafërt, në mënyrë të arrijnë kërkesat për misione specifike¹³. Sidoqoftë shumë pyetje rrjedhin nga ky fleksibilitet por më kritikja është se nëse NATO mund të konsiderohet si një organizatë totalisht sigurie kolektive. Shumë ekspert i përgjigjen kësaj pyetje pozitivisht duke kërkuar që roli i ri i NATO-s të ecë më shpejt me qëllim që politikat orientuese dhe aktivitetet e përbashkëta të ndajnë siguri dhe bashkim. Sigurisht kjo përgjigje mund të jetë vërtetë e kuptueshme në rast se dëshira e NATO-s dhe fleksibiliteti i koalicionit nuk janë shumë të ngatërruara.

Të gjitha iniciativat e përmendura më lart të çojnë në përfundimin se NATO po kërkon një identitet të ri dhe një strukturë të një organizate sigurie-kolektive. Kosova ishte një shembull goditës i kësaj përpjekje. Sidoqoftë Iraku 2003 i dha ushqim disa mendjeve negative rreth aftësisë së anëtarëve të NATO-s për interesat kolektive.

Veçanërisht për vendet që synojnë anëtarësim të afërt në këtë Aleancë, është shumë e rëndësishme të kuptohen përgjegjësitë e dyfishta. Ajo çka kërkohet nga vendet aspirantë është transformim për përmbushjen e standardeve të Aleancës, ndërkohë që vetë NATO po i nënshtrohet një transformimi të karakterit më shumë politiko-shoqëror, sesa ushtarako-teknik, që për pasojë do të thotë që edhe sfidat tona për arritjen e standardeve qoftë ushtarako-teknike apo politiko-shoqërore njëherazi fitojnë përmasa më të mëdha.

Sidoqoftë, megjithë miratimin e kësaj Direktive të përgjithshme transformuese, pikëpamjet për ndryshimet brenda NATO-s, për fushat dhe nivelet që duhet t'i nënshtrohen këtij transformimi jo gjithnjë kanë qenë e janë të njëjta, ashtu sikundër edhe e ardhmja e kësaj strukture nuk perceptohet njësoj nga të gjithë aktorët. Pasi i ka mbijetuar revolucionit gjeopolitik, që pasoi rënien e regjimeve komuniste të Lindjes, pasi ka qenë e suksesshme në zgjidhjen e konflikteve dhe vendosjen e paqes në Ballkan, pasi ka arritur të krijojë kapacitete të reja dhe efektive, e ka zhvilluar marrëdhënie bashkëpunimi e partneriteti me BE-në e vende të tjera jo-anëtare të NATO-s, duke u kthyer në një strukturë siguri-prodhuese e garantuese, mjaft tërheqëse për shumë vende e rajone të botës, e ardhmja e saj duket ende e paqartë.

A do të jetë NATO-ja struktura kryesore politiko-ushtarake, ku do të paraqiten e gjejnë zgjidhje të gjitha çështjet e mbrojtjes dhe sigurisë globale? Apo do të përdoret thjesht si një strukturë ndihmëse e mbështetëse në rast koalicionesh ad hoc? Deri ku do të arrijnë kufijtë e NATO-s dhe a do të shohim edhe përfshirjen e Australisë, Japonisë apo ndonjë vendi tjetër të largët në këtë Aleancë? Ky në fakt përbën edhe paradoksin e realitetit të NATO-s. Nga njëra anë kemi një kërkesë gjithnjë e në rritje për NATO-n dhe shërbimet e saj, madje edhe gjithnjë e më larg kufijve të saj zanafillor, ndërsa nga ana tjetër vendet anëtare nuk kanë arritur ende të ndajnë të njëjtin vizion për të ardhmen e saj, për misionin,

¹² Ronald D.Asmus, *Opening NATO-s Door* (New York: Columbia University Press, 2002) p-48. 57.

¹³ See NATO Handbook, available at ee.nato.int/docu/handbook/2001/hb1204.htm

kufijtë apo funksionin që do të luajë kjo strukturë e fuqishme politiko-ushtarake në arenën ndërkombëtare. Sikundër dihet mjedisi në të cilën NATO-s i kërkohet të veprojë është jashtëzakonisht më i ndërlikuar se ai zanafillor i disa dhjetëvjeçarëve më parë.

Konfliktet ndër-shtetërore dhe shtetet e pakonsoliduara, të cilat janë lehtësisht të kthyeshme në streha të kriminalitetit, korrupsionit e terrorizmit, autokracitë qartësisht potenciale për përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë apo nxitëse të terrorizmit, emigracioni i paligjshëm dhe krijimi i klasave të paintegruara, me bazë racore ose fetare, që nxisin ekstremizmin e dhunën shoqërore, pirateria, trafiku i drogës, mbrojtja nga sulmet kibernetike, janë vetëm disa prej sfidave, me të cilat NATO-s i kërkohet e duhet të përballet. Në një kontekst kaq të ndërlikuar, me sfida e kërcënime të ndërthurura, me karakter politik, shoqëror, ekonomik, mjedisor e sigurisht edhe ushtarak, më shumë se asgjë NATO-s i duhet një mbështetje e vendosur dhe harmonizim i qëndrimeve të gjithë vendeve, e jo vetëm atyre anëtare, pasi flasim jo vetëm për një zgjerim të mjedisit, ku NATO-s i kërkohet të vendosë e ofrojë siguri, por edhe për një shtrirje gjithnjë e në rritje të fushave dhe planeve të veprimit.

Transformimet dhe zhvillimet tekniko-ushtarake kanë vlerë vetëm në rastet e fuqizimit ushtarak të regjimeve totalitare apo zhvillimit e përhapjes së armëve të shkatërrimit në masë. Misionet e NATO-s në Ballkan e Afganistan kanë treguar se ndërhyrja ushtarake nuk është më e mjaftueshme dhe nuk arrin të ofrojë siguri që zgjat, e paqe të qëndrueshme, rrjedhimisht nuk mundëson zgjidhjen e problemit.

Për të qenë e suksesshme NATO-s i duhet të merret pikërisht me identifikimin e shërimit e atyre rrënjëve të padukshme, që çojnë në konflikte të dukshme, në mënyrë që të ofrojë jo vetëm ndërhyrje të suksesshme ushtarake, por edhe zgjidhje afatgjata. Përtej ndërhyrjes a pranisë ushtarake në këto vende, NATO-s i është dashur dhe i duhet të zhvillojë kapacitete të tjera shtet-ndërtuese, shtet-konsoliduese, stabilizuese, menaxhuese të krizave dhe plagëve të ndryshme shoqërore, etj.; me një fjalë të gjithë ato kapacitete, që janë të domosdoshme për periudhat pas-konfliktore. Pra edhe kur konfliktit i vjen fundi, bashkësia ndërkombëtare shpesh duhet të ofrojë mbështetje të vazhdueshme, për të krijuar kushtet për stabilitet. NATO do të jetë e përgatitur dhe e aftë për të kontribuar në stabilizimin dhe rindërtimin, dhe kur është e mundur, në bashkëpunim e konsultim të ngushtë me aktorët e tjerë përkatës ndërkombëtarë.¹⁴

Nga ana tjetër, ndryshe nga sa pritej në të shkuarën, tashmë NATO-s nuk i kërkohet që thjesht të asgjësojë një objektiv të dhënë armik, por njëherazi të zhvillojë struktura e kapacitete të afta për të zhvendosur në kohë e mbrojtur me sukses popullsinë civile, kudo qoftë ajo. Një tjetër sfidë që është shfaqur e ka qenë objekt i mjaft debateve gjatë viteve të fundit është edhe përballja me dilemat etike, morale e ligjore të veprimeve ose mosveprimeve të NATO-s. Në kontekstin e dikurshëm, përligjia morale e veprimeve të Aleancës ndaj kampit armik ishte e qartë, e kuptueshme dhe e pranueshme nga të gjithë. Ajo do të kundërvepronte ndaj çdo agresioni të armikut, që synonte të shkatërronte sigurinë dhe vlerat e vendeve të Aleancës, në mbrojtje të tyre.

¹⁴ "Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë Nentor 2010

Tanimë legjitimiteti i veprimeve ose mosveprimeve nuk është më aq i thjeshtë për t'u arritur a paraqitur. Janë vetë vendet anëtare ato që bëhen të parat gjykuese të hyrjes ose jo në veprim, prandaj arritja e një vendimi të njëzëshëm nga vendet anëtare, por edhe mbështetja morale globale, përbën edhe kyçin e suksesit të misioneve të mëpasme të NATO-s. Dhe kjo për dy arsye.

Së pari, një mision i stigmatizuar qoftë edhe pjesërisht nga publiku vendor ose global rrezikon të mos ketë miratimin publik e parlamentar të vendeve pjesëmarrëse. Së dyti nga ana tjetër do të çonte në polemika, që do të përdhosnin imazhin e NATO-s apo të krijonin asociime negative për procesin e vendimmarrjeve brenda saj. Të dyja këto do të kishin pasoja të rënda për vetë Aleancën, e cila duhet të vazhdojë të jetë, sikurse edhe në themelimin e saj, një strukturë e mbështetur në vlera demokratike mbarëbotërore. Në një rast të kundërt, misionet e saj do të rrezikonin dështim, ndërsa e ardhmja do të pësonte goditje me efekte të pariparueshme, dhe kjo për faktin që, nëse iu referohemi misioneve të viteve të fundit, për NATO-n është bërë e qartë gjithnjë e më shumë nevoja e mbështetjes nga ana e popullsisë vendore.

Një mision që ka mbështetjen e popullsisë së atij vendi ka shumë më tepër shanse për sukses dhe lehtëson në mënyrë të ndjeshme vetë barrën e NATO-s. Kjo do të thotë që kompleksiteti i sfidave aktuale kërkon kthimin e NATO-s në një strukturë, që ka mbështetje globale. Me fjalë të tjera NATO nuk mund të vazhdojë të kërkojë që të ketë vetëm mbështetjen e vendeve të EU dhe SHBA, përkundrazi ajo duhet të punojë për krijimin dhe forcimin e partneriteteve me çdo vend në botë. Shtimi i aleatëve ndërkombëtarë, zgjerimi i bashkëpunimit në nivel dypalësh e shumëpalësh do të mundësojë shndërrimin e NATO-s në një forum partneriteti global. Nga ana tjetër kjo do të ndihmonte rritjen e vetë kapaciteteve brenda NATO-s për të siguruar informacionin e nevojshëm ekonomik, shoqëror, politik e mjedisor, e për rrjedhojë do të kishim një rritje të ndjeshme të gjasave për një të ardhme të gjatë e të suksesshme të NATO-s.

Si përfundim, për të kapërcyer të gjitha sfidat e transformimit, me të cilat ndeshet sot NATO, asaj do t'i duhet të ndërmarrë një transformim vërtet të gjerë. Ky transformim shumë- përfshirës, kurrsesi, nuk nënvlerëson transformimin në fushën ushtarake, përkundrazi ai do të mundësonte përforcimin e padiskutueshëm të sukseseve, pas ndërhyrjeve ushtarake. Sfidat janë të ndërlidhura, janë globale, kanë kryesisht karakter shoqëroro-ekonomik, në pjesën më të mëdha të rasteve nuk mund të zgjidhen vetëm me ndërhyrjeje ushtarake, e shpesh herë bëhen objekt kundërshtimesh e polemikash përsa i përket moralit apo etikës së pranuar nga shumica. Me pak fjalë, sfidat janë të mëdha dhe transformimi i thellë, në mënyrë që Aleanca të vazhdojë të kryejë me sukses dy funksionet e saj parësore: të qenit struktura e veprimit të përbashkët ushtarak, por edhe forum i bashkëpunimit kolektiv në fushën e sigurisë.

Referencat:

1. Yost David, NATO Transformed (Washington, D.C.: USIP, 1998), p. 270.
2. Hall Gardner, Dangerous Crossroads: Europe, Russia, and the Future of NATO. The experience in Kosovo is another example of the rising tensions between Russia and NATO over NATO in-tervention in areas that have been historically under the influence of Moscow.

3. Stephen Walt, in Charles Kupchan (ed.), *Atlantic Security: Contending Visions*.
4. Lord Robertson, "Transforming NATO", *NATO Review* (Spring 2003).
5. Robert Kagan, "Power and Weakness", *Policy Review* (June & July 2002), p. 4.
6. COHEN, Richard, MIHALKA, Michael. *Cooperative Security: New Horizons for International Order*. Garmisch Partenkirchen:
7. VETSCHERA, Heinz. *Grenzen und Möglichkeiten kooperativer Sicherheitspolitik in Europa am Beispiel der Organisation für Sicherheit und Zusammenarbeit in Europa*.
8. WIJK Rob de. *Towards a new political strategy for NATO*. *NATO Review*. 1998.
9. Koncepti Strategjik për Mbrojtjen dhe Sigurinë e anëtarëve të Organizatës së Traktatit të Atlantikut të Veriut Miratuar nga Krerët e Shteteve dhe Qeverive në Lisbonë Nëntor 2010.

Pranvera e trazuar arabe

Kol. ® Zeno Jahaj
Drejtoria e Politikave dhe Planifikimit Strategjik,
Ministria e Mbrojtjes

Abstrakt: *Një botë arabe që fle mbi pasuri përrallore, por që nuk e gëzon atë, natyrisht është tronditëse. Një botë e tërë arabe që i erdhi koha të zgjohej nga ky gjumë letargjik, sigurisht që është një lajm domethënës për tërë botën.*

Pranvera që i dha sinjalet me tronditjet e mëdha sociale në Tunizi e Egjipt, me kryengritjen në Libi dhe shpërthimet e tjera në Siri e gjetkë, është një pasqyrë e fillimit të zhvillimeve afatgjata që iu ka ardhur koha të ndodhin në tërë botën arabe dhe ku përfshihen edhe aktorë të tjerë të komunitetit ndërkombëtar, të cilët, për këtë arsye, kanë edhe përgjegjësinë për ta menaxhuar atë. Ndërhyrja, në kohën më të shpejtë të mundshme, është një domosdoshmëri, në qoftë se ndërhyrja është zgjidhja. Ndërhyrja në kohë parandalon gjenocidin. Në të kundërtën, shfajësimet “pas të vjelave” nuk vlejnë.

Duket se një revolucion gjeopolitik ka nisur, një revolucion që nuk dihet me saktësi se ku e kur do të shkojë, ku e kur do të ndalojë, por vetëm një gjë duket qartazi: zor se do të kthehet atje ku u nis.

Kur Presidenti Tunizian, Zine El-Abidine Bin Ali u largua politikisht nga Tunizi, më 14 Janar të këtij viti, e gjithë bota do të bëhej kurioze për një fakt interesant: Tunizia kishte ushqyer me kohë pretendimin se ajo ishte më afër Europës sesa e gjithë bota tjetër arabe, madje se tunizianët janë më tepër europianë sesa arabë. Elita politike dhe ajo e biznesit tunizian ishin shumë më të shpeshtë në Paris, sesa në kryeqytetet e tjera të botës arabe.

Por kurioziteti do t'ia linte vendin “tërmetit” të asaj çfarë do të ndodhte në Egjipt: një muaj më vonë do të ishte homologu egjiptian i Zine El-Abidine Bin Ali, Presidenti Hosni Mubarak që do të dorëhiqej; politikisht edhe ai. Për miliona arabë, Tunizia nuk është veçse një “kushëri” i largët, kurse Egjipti një vëlla i madh, me derën hapur. Natyrisht, Egjipti nuk është më në “vaktin” e vet tradicional të “lokomotivës”, për vendet e tjera arabe por, sigurisht që, krahas Arabisë Saudite dhe Iranit, është ende një nga qendrat e fuqisë së botës arabe.

Pikërisht, Presidenti i këtij vendi, me një pozitë delikate gjeopolitike e gjeostrategjike në rajon, bëri një zgjidhje të paimagjinuar për “pleqtë” monarkë të vendeve arabe: largimin

“vullnetar”. Ky largim i Mubarakut nga drejtimi i shtetit krijoi dyshime të forta për sigurinë që pati sunduar botën arabe për dhjetëvjeçarë të tërë.

Në tre dhjetëvjeçarë të sundimit të tij, Mubarak kishte përhapur mbi të gjitha stabilitetin. Nga “gjyshërit” e vendeve të tjera arabe, Mubarak pati meritën të udhëheqë vendin e tij për të ruajtur një rol qendror. Ai e rreshtoi Egjiptin në krah të koalicionit, për të nxjerrë Saddam Husseinin jashtë nga Kuvajti më 1991. Ai modeloi me kujdes përfaqshen ndaj Izraelit, për të ruajtur balancat lidhur me ecurinë e çështjes palestineze.

Largimi i papritur i Mubarakut krijon një zbrazëti në skenën gjeopolitike, e cila nuk dihet se si dhe nga kush do të mbushet dhe është pikërisht ky fakt të cilit i tremben arabët. Kursi që do të ndjekë politika egjiptiane do të thotë shumë për ridimensionimin e tërë mjedisit gjeopolitik të rajonit. Do të kemi një riorientim marrëdhëniesh ku hyjnë në lojë shumë aktorë me peshë gjeopolitike, botërore e rajonale: SHBA, Kina, Franca, Britania, Izraeli, Irani e ndonjë tjetër. Në qoftë se Egjipti pas-Mubarak do të ushqejë p.sh. radikalizëm, atëherë radikalizmi do të përhapet lehtësisht në të gjithë rajonin, veçanërisht në vendet e orbitës egjiptiane. Në të kundërtën, një mënjanim i Egjiptit nga skena politike rajonale do t'i frikësonte tej mase p.sh. vendet e Gjirit Persik, sepse do të ndjeheshin më të ekspozuara ndaj Iranit.

Përfundimisht, drejtimi nga do të ecë Egjipti, 80 milionë banorësh, është një ankth për tërë rajonin. Gjendja ekonomike e Egjiptit është në prag krize dhe kjo mund të thellohet veçanërisht gjatë verës, kur do të zhvillohen zgjedhjet parlamentare. Ata që aspirojnë për një Egjipt të moderuar, duhet të krijojnë një të tillë. Por instrumentet për ta realizuar këtë janë të ndryshme. Të gjithë analistët e çështjeve arabe, kur vjen çështja tek Egjipti, bashkohen në një pikë: për ta shpëtuar Egjiptin do të duheshin miliarda dollarë, por për ta humbur atë, do të duheshin akoma më shumë!

Shpërthimi i luftës civile që vijoi në Libi nuk la kohë për komoditetin e kuriozitetit, as për frikën e “tërmetit”, por vetëm për alarmin për të vepruar. Këtej e tutje, përgjegjësia nuk ishte vetëm arabe, por mbarëbotërore.

Libia, me një trashëgimi të ngrirë nga pushtimi i gjatë otoman e ai mbi tridhjetëvjeçar italian; me një diktaturë ushtarake prej mbi 40 vjetësh; me një regjim që ka subvencionuar, mbështetur e ushtruar terrorizëm brenda e jashtë vendit; me orekse ekspansioniste ndaj fqinjëve të tjerë afrikanë, etj, natyrisht që përbente një potencial krizash. Ekonomia libiane e cila ushtrohet më së shumti sipas praktikave fisnore, e varur thajse tërësisht nga të ardhurat që nxjerr nga eksportet e naftës që përbëjnë rreth 95 % të të gjitha të ardhurave nga eksporti, 25% të GDP dhe 80% të të ardhurave qeveritare, me shpërndarje thellësisht të pabarabartë, kryesisht në dobi të fiseve proqeveritare, etj, përbën gjithashtu një nga potencialet e krizës.

Vende si Libia, etj, të copëtuara nga ndarje fisnore, etnike e fetare, kanë kaq shumë grindje të rënda midis komuniteteve fetare e fisnore (disa nga të cilat kanë përfituar e janë pasuruar nga diktaturat e tyre, ndërsa të tjerat janë shtypur brutalisht prej tyre), sa që është thajse e pamundur që lëvizjet, qofshin edhe për qëllime të larta, të mos përfundojnë në luftë civile. Për këtë arsye ndodhën ato që pamë: u lëshua ushtria dhe armët kundër “rebelëve”-qytetarëve të vendit, sipas logjikës së fisit: “o sundon sekti im, ose vdekje”.

Sigurisht, shkaqet e krizës në Libi, nuk mund të kufizohen vetëm me potencialet që përmban vetë Libia për të prodhuar krizë. Kriza në këtë vend ishte një nga pasqyrat e fillimit të zhvillimeve afatgjata që iu ka ardhur koha të ndodhin në botën arabe ku ndërmjetohej edhe aktorë të tjerë të komunitetit ndërkombëtar, të cilët, për këtë arsye, kanë edhe përgjegjësinë për ta menaxhuar atë.

Përgjegjësitë në rritje të komunitetit ndërkombëtar

“Ne nuk duhet t’i harrojmë kurrë arsyet pse komuniteti ndërkombëtar u detyrua të veprojë. Ndërsa Libia rrëshqiti në kaos dhe Kolonel Muammar el-Gadhafi sulmoi popullin e vendit të vet, Liga Arabe bëri thirrje për veprim. Opozita libiane thirri për ndihmë. Populli i Libisë i hodhi sytë nga bota në këtë orë nevoje. Me një rezolutë historike, Këshilli i Sigurimit i Kombeve të Bashkuara autorizoi të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur popullin libian. Koalicioni ndërkombëtar ndaloj përparimin e forcave të Gadhafit dhe parandaloi një *banjo gjaku* që ai kishte premtuar të shkaktonte mbi qytetarët e rrethuar, në qytetin e Bengazit.” (1)

Gadhafi kishte kërcënuar të sulmonte “pa mëshirë” të ashtuquajturit rebelë që vepronin në Lindje të vendit. Në gjuhën e çdo diktatori, për më tepër të një ushtaraku si ai, kjo do të thoshte përgjakje me forcën e të gjitha armëve, sikurse edhe ndodhi. I mbështetur nga fise që mbisundojnë edhe në ushtri dhe që do të humbisnin shumë, në rast përmbyseje të regjimit, Gadhafi gjeti forcë për të goditur keqazi një popullsi të tërë opozitare dhe vuri deri edhe në pikëpyetje egzistencën e saj. Mosmarrja nën mbrojtje e mijëra njerëzve nga ky sulm barbar do të ishte-sikurse është theksuar edhe në mesazhin e përbashkët të tre burrave të shtetit të fuqive të mëdha-“një tradhëti” ndaj jetës së një populli të tërë, të kërcënuar nga hakmarrja e autokratit të tyre. “Qytetarët trima të këtyre qyteteve që i kundërqëndruan forcave që i kishin shënjestruar e goditur pa mëshirë, do të përballeshin me një hakmarrje të frikshme, në qoftë se bota do ta pranonte një zhvillim të tillë. Kjo do të ishte një tradhëti që s’do ta mbante dot ndërgjegja”. (2)

Nga çka mund të lexohet, nuk bëhet fjalë për “ndryshim regjimi” që nënkupton lënien në duart e popullit libian për ta zgjidhur. Çfarë është jo aq e qartë, jo aq e njohur dhe që mbeti për pak kohë objekt diskutimesh të pafund, ishin qëllimet e Aleancës dhe njëmendësia e antarësisë së saj për mënyrat, mjetet e përzgjedhura, në funksion të këtyre qëllimeve. A do të ishte vetëm ndalimi i fluturimeve boshti rreth të cilit do të vërtiteshin mjetet e tjera? Apo ndalimi i fluturimeve do të ishte vetëm njeri nga mjetet që do të vërtitej rreth mjetesh e qëllimesh të tjera?

E lexuar në gjerësinë e vet, Rezoluta e Këshillit të Sigurimit ishte dhe mbetet historike pikërisht për faktin se i le të gjitha alternativat të hapura, edhe pse zyrtarisht shprehet me kufizime. Ajo shprehet se: “Autorizon shtetet anëtare që kanë bërë me dijeni Sekretarin e Përgjithshëm se, duke vepruar si shtet më vehte, apo përmes organizatave/organizmave rajonalë dhe në bashkëpunim me Sekretarin e Përgjithshëm, për të marrë të gjitha masat e nevojshme për të mbrojtur civilët dhe zonat e populluara nga civilë të kërcënuara nga sulmi në Jamahiriya, duke përfshirë Benghazi, por duke përjashtuar ndërkohë një forcë të huaj pushtimi, të çfarëdo forme, në ndonjë pjesë të territorit libian.” (3) Detyrimi i marrjes nën mbrojtje të civilëve, të kërcënuar nga qeveritari i tyre, duket se krijon hapësirat e nevojshme për një sërë interpretimesh, alternativash e mjetesh të tjera. Në këto kushte

dhe me këtë lexim, nuk përjashtohet edhe prania e forcave tokësore, edhe pse Rezoluta shprehet për “jo forcë të huaj pushtimi”. Më tej, leximi të çon në logjikën se këto forca do të mund të ndërhyjnë në Libi, por nuk mund të mbeteshin atje pas ndërhyrjes.

Natyrisht, zhvillimet në Libi duhen përfshirë në një kuadër më të gjerë se çfarë ndodhi e po ndodh në të gjithë botën arabe, duke filluar nga Tunizia, Egjypti e që ka përfshirë në valë thaujse të gjitha vendet në lindje të Afrikës, d.m.th. të Gadishullit Arabik. Motivimi i këtyre ngjarjeve është akoma më i rëndësishëm. Kjo lëvizje është një opozitë, me bazë të gjerë popullore, kundër qeverive egzistuese, jo thjesht apo vetëm ndonjë pakënaqësi e fragmentarizuar. Më tej, synimi i përbashkët i këtyre lëvizjeve ishte instalimi i shoqërive demokratike dhe se këto shoqëri do të duhet të ngjajnë me institucionet dhe vlerat e demokracive perëndimore.

Në këto kushte, vlerave dhe institucioneve të Perëndimit, së brendshmi, nuk iu lejohet dhe as mund të pranohet të jenë të shurdhëra për të mbrojtur të njëjtat vlera dhe aspirata institucionesh demokratike kundër regjimeve shtypëse. Të mos iu përgjigjesh, apo të dështosh në mbështetjen që duhet dhënë për këto vlera e aspirata, do të ishte një tradhëti ndaj parimeve themelore morale mbi të cilat janë ngritur shoqëritë perëndimore. Dhe Libia ishte një rast i tillë.

Natyrisht që ka edhe interesa të tjera që nuk janë gjithnjë konvergjente. Italia, p.sh. ka interesa në Libi. Roma ishte në kulmin e negociatave për një miliard dollarë investime, pikërisht përpara turbullirës. Mediat britanike bëjnë fjalë ndërkohë se qeveria e mëparshme akuzohet se ka lëshuar Abdel Basset Ali al-Megrahi, Libianin e mbajtur për rastin e vendosjes së bombës në Pan Am Flight 103. Flitet se muajt e fundit Franca ka qenë në bisedime e sipër me Libinë për shitjen e 14 aeroplanëve luftarakë *Mirage*, të firmës Dassault si dhe modernizimin e disa aeroplanëve të Tripolit.

Këto e të tjera rrethana “e ndollën” Francën, p.sh., të afrohej më shumë me pozitën amerikane, madje të deklaronte e para gjuhën e ashpër që shkoi deri në njohjen *de jure* të opozitës libaneze. Ishin aeroplanët luftarakë francezë që goditën të parët trupat tokësore të Libisë. Goditja, e pabashkërenduar qysh në fillim me pjesën tjetër të koalicionit, nënkuptonte sinjalin se Franca do të vihej në krye të kësaj “ndërmarrjeje”. Një veprim i tillë, i kryer nga një Francë tradicionalisht “pacifiste”, jepte gjithashtu mesazhin se ndërhyrja do të ishte më e gjerë sesa linte përshtypje mandati i Këshillit të Sigurimit.

Pikërisht, kalimi i këtij “caku”, krijoji të çara midis Europianëve, duke vënë në pikëpyetje kësaj mbështetjen politike të ndërhyrjes. Gjermania, e cila u nda nga aleatët, madje edhe duke abstenuar në Këshillin e Sigurimit të OKB-së, iu “frikësua” një lufte të tejzgjatur, e cila do të kishte kosto të reja të paparashikueshme. Qeveritë e vendeve të Europës Qendrore e Lindore, me Poloninë në qendër, u treguan të kujdesshme e të matura për të dhënë mbështetje sepse, sipas tyre, kjo ndërmarrje e re do ta mënjanonte NATO-n nga misioni i saj themelor i mbrojtjes territoriale të Europës dhe sidomos i mbrojtjes së teatrit ku ata ndjehen më të shqetësuar: në sferën Ruse të influencës. Italia, një vend me pozicion kyç për shkak të afërsisë së bazave të saj me teatrin libian, pati sugjeruar madje që, në qoftë se nuk arrihej një farë konsensusi, lidhur me përfshirjen e NATO-s, ajo do të tërhiqej së ofruari bazat e saj. Në të vërtetë, Roma duket se është më e shqetësuar nga aleanca Franko-Britanike me perceptimin se po çylyftëson interesat e Italisë në Libinë e pas Ghadafit. Për më tepër, nëse Aleanca do të dështonte së përfunduari operacionin e filluar, atëherë frika

ishite se mos Italia mbetet e vetme në përballimin e kaosit, pikërisht jo shumë larg brigjeve të saj jugore.

Pikëpyetjet e Luftës

E para është çështja e raportit “qëllim politik” me “mjetet e mënyrat” për arritjen e tij. Sipas vlerësimeve, synimi, edhe pse i pashpallur, është ndryshimi i regjimit autokratik me një regjim demokratik. Në këtë kuptim, misioni apo qëllimi politik është i qartë.

Ajo që është komentuar gjatë nga analistë, institute analitike, etj., është strategjia e ndjekur për të realizuar këtë mision, d.m.th. shkalla e përgatitjes së koalicionit, burimet dhe koha në dispozicion. Më tej akoma, nëse do të duhej vepruar me forca tokësore, do të duhej saktësuar se çfarë lloj forcash duheshin vënë në gatishmëri, cilat shtete do të ofronin forca të tilla, si do të vendoseshin kanalet e komunikimit me opozitën (në të cilën, të gjitha fraksionet kishin nga një mbret!), si do të menaxhoheshin ndryshimet për kuadrin politik, pas përfundimit të luftës, etj, etj.

Sfida thelbësore strategjike e çdo lufte është se si të përdoren mjetet ushtarake për të arritur qëllimet politike. Dështimet, ngecja në kurthin e luftës së gjatë e pa perspektivë, “pa dritë në tunel”, kanë patur si shkak, kudo dhe kurdo që kanë ndodhur, pikërisht dështimin në përcaktimin e drejtpeshimit “të artë” midis mjeteve e mënyrave me qëllimet e objektivat.

Përpara se të ndërmerret një veprim ushtarak, siç është lufta, mendimi ushtarak ka përcaktuar plot rregulla të arta, por disa prej këtyre rregullave janë më të arta se të artat: përcakto një vizion se si do të jetë situata politike paslufte, zhvillo një plan se si do të arrish atje, përcakto synime dhe objektiva të qarta, të matshme dhe të lidhura me terrenin politik e ushtarak, përgatit edhe Planin “B” nëse gjërat shkojnë keq dhe planin “C” nëse gjërat shkojnë ndryshe nga çfarë është planifikuar, etj.

A pati një vizion të tillë të qartë fillimi i luftës në Libi? A ishin ndërtuar skemat e të nesërmeve pas përfundimit të luftës? Fakti që Gaddafi u vërtetua si një kërcënim serioz në një etapë të caktuar të zhvillimit të luftës, veçanërisht ndaj forcave “rebele” në Lindje të vendit, flet se jo gjithçka ishte planifikuar siç duhet.

Nisur nga shkalla e angazhimit të forcave dhe mjeteve si dhe nga objektivat që u arritën, mund të vlerësohet se veprimet ushtarake që u kryen, nuk u rritën në nivel “lufte”, në kuptimin klasik. Rrjedhimisht, duket sikur justifikohet se nuk ishte e nevojshme të respektoheshin të gjitha parimet e rregullat e mendimit strategjik. Mbase, për këtë arsye, studiues e analistë e kanë cilësuar veprimin ushtarak në Libi si “Luftë Aksidentale”. (4)

Por nëse imagjinojmë dhe pranojmë se Ghadafi nuk do të kishte mëshirë për mijëra e mijëra njerëz-qytetarë të vendit të vet, për t'i larë në banjo gjaku, për shkak të kundërshtimit politik, atëherë edhe qëllimi i ndërhyrjes duhet të shprehej qartazi se ishte një çështje politike, jo thjesht humanitare. Në të kundërt, do të lindte natyrshëm pyetja: Ta zemë se u zgjidh problemi humanitar, po më tej? Kush do ta qeverisë nesër Libinë?

Së dyti, çështja e udhëheqjes. Në çdo kohë Aleancat kanë patur një “lokomotivë”. Shtetet Europiane, të mësuara me ndarje pune brenda për brenda NATO-s, ku SHBA gjithnjë ka udhëhequr dhe ka mbajtur barrën kryesore të luftimit, nuk mundën të siguronin kapacitetet drejtuese në këtë luftë. Mosmarrja përsipër e udhëheqësisë amerikane, veç të tjerash, duket

se është edhe një mesazh i SHBA-së për t'i vënë Europeanët në pozita të tilla që të vërtetojnë vehten se çfarë mund të bëjnë tashmë vetëm, ose të paktën pa amerikanët në krye. (Sikurse është e njohur, 27 aleatët jo amerikanë të NATO-s, ofrojnë, së bashku, vetëm 25 përqind të shpenzimeve të mbrojtjes së Aleancës.)

Shkurt, europianët duket se nuk ndajnë të njëjtën mendje, si për synimet dhe objektivat e operacionit, ashtu edhe për mënyrat e mjetet se si do të zhvillohet e do të drejtohet ky operacion. Të vetmen gjë të përbashkët që kanë europianët është mosprojektimi i një strategjie të plotë e imponuese për zhvillimin dhe përfundimin e kësaj lufte.

Pse-ja që lidhet me gjeopolitikën e botës arabe

Gjeopolitika e botës arabe vërtitet përreth disa elementeve gjeografikë konstantë. Kjo botë i përket një zone me një rëndësi tepër të madhe strategjike sepse është vendi i rrugëkalimeve më të shumta që kalojnë kryq e tërthor botës. E gjithë zona arabe përbën një unitet gjeografik, edhe pse e ndarë në dy kontinente. Në formë gjysmëhëne, (prej nga edhe është simbolizuar qysh nga flamuri i Perandorisë Turke), me dalje të gjerë në Detin e Bekuar të Mesdheut, sunduese e Kanalit të Suezit që lidh, në rrugën më të shkurtër, Oqeanin Atlantik-përkatësisht botën Perëndimore me Oqeanin Indian-përkatësisht Lindjen e Mesme dhe Azinë Jugore.

Bota Arabe përbëhet nga 21 vende e territore që shtrihen nga Afrika e Veriut deri në Azinë Perëndimore e Jugore, të cilat përfshijnë një popullsi prej rreth 360 milionë banorësh. Megjithëse ka një bashkësi "arabe", me bazë kryesisht gjuhën e fenë, identitetet arabe janë, gjithsesi, të ndryshme dhe shpesh shumë më armiqësore midis tyre, sesa me kombet e tjera, jo arabe. Shumica e vendeve arabe ndjekin Islamin Sunnit, pjesa tjetër atë të shtetit Shiit, një pjesë relativisht e vogël janë kristianë dhe akoma më pak çifutë. Problemi është se, në vende të ndryshme, ka shumica të cilësuar sektesh të ndryshme. Ndërkohë, le të sjellim ndërmend se në "Pranaverën e trazuar Europiane" të vitit 1989, çdo shtet ishte një komb homogjen-përveç Jugosllavisë. Bota Arabe është krejtësisht e kundërta: Pothuajse të gjitha vendet janë si Jugosllavia: një kaos grupesh etnike, fetare e fisnore, të përfshira brenda shtetesh-përveç Egjiptit, Tunizisë e Marokut, të cilat kanë shumica të mëdha homogjene. Shtetet e atëhershme të Europës Lindore, edhe pse nën thundrën komuniste, ruanin, gjithsesi, tradita në shoqërinë civile, kishin tradita qeverisëse, përveç Jugosllavisë, një vend shumëkombësh e shumëfetar, i cili, në rastin më të parë, do të shpërthente për t'u copëtuar në pjesë të vogla.

Kjo është arsyeja pse demokratizimi i vendeve arabe, si rregull, do të shoqërohet, më së shumti, me luftë civile.

Me përfundimin e Luftës së Parë Botërore dhe shkatërrimin e Perandorisë Otomane, pjesa dërmuese e vendeve arabe u vu nën kontrollin e ish fuqive koloniale europiane, kryesisht të Mbretërisë së Bashkuar, Francës dhe Italisë. Ato e fituan pavarësinë vetëm gjatë dhe pas Luftës së Dytë Botërore. Për të fituar një lloj peshe politike botërore dhe për të përfaqësuar interesat e tyre, në vitin 1945, ato themeluan Ligën Arabe, me seli në Kajro, Egjipt.

Krijimi i shtetit Izraelit në vitin 1947 e acaroi konfliktin Arabo-Izraelit -një nga konfliktet

më të mëdha gjeopolitike të kohës. Në këto kushte, bota Arabe është zhytur shpesh në luftra ciklike, si ato me Izraelin në 1948, 1967 e 1973. Vetëm në vitin 1979 u nënshkrua një Traktat Paqeje Egjypt- Izrael.

Dy zhvillime e ngritën në kulm interesin për botën arabe: Kanali i Suezit, si rruga më e shkurtër për në Indi dhe, sidomos, zbulimi i depozitave të mëdha të naftës në vitin 1930, gjë që përkoi me Revolucionin e Dytë Industrial të Perëndimit, rrjedhimisht me nevojën e madhe për naftë. Në këtë kuadër, vendet e Gjirit Persik, së bashku, përbëjnë një nga 10 grupimet kryesore botërore për eksportin e kësaj lënde strategjike. Për më tepër, ajo zotëron 70% të rezervave botërore të naftës dhe 30% të rezervave të gazit natyror, megjithëse për momentin, prodhimi i saj përfaqëson më pak se një të tretën e atij botëror.

Sot, vendet arabe karakterizohen nga regjime të shkallëve të ndryshme të autokratizmit, të mungesës së kontrollit demokratik, korrupsionit politik dhe shtypjes së lirie dhe të drejtave demokratike. Popullsia në to rritet me ritme relativisht të larta, rreth 2.3%, nga më të lartat në botë. Popullsia nën 25 vjeç zë rreth 50% të popullsisë. Sjellim në vëmendje, me këtë rast, se 80 përqind e konflikteve civile të shkallëve të mëdha të viteve 1970, 1980 dhe 1990 kanë ndodhur në vende ku, së paku, 60 përqind e popullsisë ka qenë nën moshën 30 vjeç. Ndërkohë, të ardhurat për frymë të popullsisë në këto vende renditen ndër më ulëtat në botë: Jemeni e Palestina 2.9 dollarë (çka do të thotë që pothuajse një popull i tërë gjendet në kufijtë e varfërisë absolute), Iraku 4 dollarë, Siria e Maroku 4.7 dollarë, Jordania dhe Egjypti përkatësisht 5.2 e 5.9 dollarë, etj. Treguesit e demokracisë renditen ndër shkallët më të ulëta në botë (Siria e Libia në renditjen më të skajshme me përkatësisht 152 e 146). Në këto renditje janë edhe treguesit për korrupsionin, lirinë e shtypit, etj. (5)

Në këto kushte, të gjitha potencialet janë për një prag krize. Por këtyre potencialeve iu shtohen edhe të tjera. Prej disa vitesh, një varg zhvillimesh kanë ndodhur. Komunikimi me internet, ku mbi 75% e arabëve kanë akses, mund të thuhet se është bërë një lloj fuqie e tretë, krahas pan-Arabizmit dhe pan-Islamizmit. Aktualisht, në botën Arabe shikohen mbi 700 kanale televizive, çka do të thotë se ajo që ndalohej “off line”, (d.m.th. liritë e të drejtat për komunikim dhe shprehje në rrugë), nuk mund të ndalohej “on line” (d.m.th. përmes internetit).

Koha për mësim?

Ndoshta është pak herët për të nxjerrë dikush mësim. Nuk është vonë, gjithsesi. Ndoshta edhe vetë ky proces, i quajtur “Lessons learned” duhet të dalë nga klasicizmi, sipas të cilit duhet të përfundojnë ngjarjet dhe pastaj të nxirren mësim. Sot ngjarjet zhvillohen me intensitet të tillë, sa që koha nuk pret të ndahen fazat në faza “pësimi” dhe në faza “mësimi”.

Bombardimi i Libisë u ideua, midis të tjerash, për t’iu dhënë autokratëve të rajonit mësimin se komuniteti ndërkombëtar nuk do të qëndrojë mënjanë e të bëjë “sehir” kur masakrohen qytetarë paqësorë. Gadhafi ia doli që, duke mbledhur mercenarë nga e gjithë bota, të mund t’iu rezistonte deri edhe goditjeve ajrore të shteteve nga më të fuqishmet e botës. Ai mund të përdorë edhe taktikën e stërzgjatjes së kryengritjes, d.m.th. provokimin përmes taktikave guerile-një instrument “që ka pirë ujë” në konflikte të tjera. Kjo nuk do ta përjashtojë gjithsesi ndërhyrjen e Perëndimit, pasi krimi tanimë është kryer dhe bota e qytetëruar nuk mund të falë. Autokratët mund të fitojnë edhe një farë përkrahjeje, duke luajtur me përrallën e “soveranitetit” apo të së drejtës “hyjnore”. Por bota moderne ka

ardhur tanimë në një çast historik kur nuk mund të falë e tolerojë që, nën këto “ombrella”, të mbulohen krime kundër njerëzimit. Nga ana tjetër, edhe vetë komuniteti ndërkombëtar mund të mësojë gjithashtu.

Ndërhyrjet e komunitetit ndërkombëtar në Serbi, Irak dhe Libi treguan se edhe autokratët më antipopullorë përpiqen të krijojnë baza të gjera mbështetjeje logjistike e morale, duke luajtur edhe viktimën. Këto iu japin atyre një farë kurajoje për të kundërqëndruar edhe ndaj forcës së Aleancës. Koalicioni, në çdo rast, duhet të verë pikën mbi “i”, duke u deklaruar qysh në fillim për ta goditur të keqen në kokë, politikisht: largimin e një autokrati që ushtron dhunë kundër një populli të tërë, d.m.th. zgjidhjen që kushtëzon të shumtën e zgjidhjeve, zgjidhjet themelore, jo zgjidhje të pjesshme e dytësore.

Një mësim tjetër është se në NATO barazia në përgjegjësi dhe kosto nuk duhet të jetë vetëm një parullë apo deklaratë. Natyrisht, ka diferenca në fuqi e mundësi. Por nuk duhet të ketë diferenca në përgjegjësi. Operacioni në Libi është operacioni i parë, që prej krijimit të NATO-s, që nuk udhëhiqet, të paktën formalisht, nga SHBA. Mesazhi për europianët, në rastin e Libisë, duket se është që SHBA do të jenë bashkë me ta në përballimin e çdo rreziku e kërcënimi por, kur këto janë në pragderën europiane, kontinenti i vjetër duhet të mësohet të merret edhe vetë me to! E vërteta është që edhe si organizatë, Bashkimi Europian-përkatësisht Politika e Jashtme dhe e Sigurisë së Përbashkët u provua se nuk i ndjek dot ngjarjet dhe detyrimet e këtij niveli dhe të kësaj gjeografie. “Operacioni në Libi tregoi se SHBA pret që Europa të kujdeset vetë tanimë për oborrin e vet të prapëm. Vendet europiane-sidomos BE-duhet të jenë më të përgatitura për herën tjetër që do t’iu duhet të menxhojnë një operacion ushtarak, pa përfshirjen e plotë të NATO-s.” (6)

Varësia për sigurinë, dje apo sot dhe për një kohë relativisht të gjatë, krijon edhe varësinë për më tej. Europa nuk e ka mësuar, ndërkohë që Amerika duket se e ka nxjerrë këtë mësim!

Por mësimi më i madh është: Ndërhyrja në kohën më të shpejtë të mundshme është një domosdoshmëri, në qoftë se ndërhyrja është zgjidhja. Ndërhyrja në kohë parandalon genocidin, në të kundërtën shfajësimet “pas të vjelave” nuk vlejné.

Një mësim tjetër, ndoshta më pak sesa politik, por gjithsesi po aq politik, është ai i mjeteve të ndërhyrjes. Është folur shumë për forcën ajrore, duke i atribuar asaj fuqi të “mbinatyreshme”. Përvoja - ajo e Libisë, tregon se forca ajrore nuk mund ta përfundojë luftën, nëse nuk mbështetet, apo nuk zhvillohet, së paku, nën kërcënimin e mbështetjes nga toka. Por jo vetëm kaq. Mbështetje nga toka në luftën e sotme të ashtuquajtur të brezit të tretë, nuk janë vetëm njësitë e mëdha të këmbësorisë apo të tankeve, madje mund të mos jenë fare këto. Mbështetje nga toka mund të jenë - madje duhet të jenë fare mirë grupet e specializuara dhe shumë të specializuara, për të goditur ato pika që mbajnë gjallë terrorizmin shtetëror, kreun e terrorit shtetëror apo jo shtetëror.

E kemi një provë tashmë: Vetëm një grusht dhjetra forcash speciale amerikane, një nërepart në nivel më pak se kompani, kreu një operacion dhe arriti një sukses të nivelit strategjik, duke asgjësuar Bin Ladenin, ndërkohë që qindra mijëra forca tokësore të angazhuara në Afganistan prej vitësh, nuk kanë arritur më shumë se suksese operative. Kjo nuk do të thotë që kërcënimin për përdorimin e forcave, sipas Doktrinës *Powell*, të mos jetë në gatishmëri.

Po më tej?

Si do të vijojë e ashtuquajtura “Pranverë Arabe”? A është ajo një rastësi, apo pjesë e një cikli të tërë historik, të cilit i ka ardhur koha të ndodhë edhe në vendet arabe? Mos ndoshta edhe i madhi Huntington duhet marrë me rezerva kur mendonte se kultura arabe nuk është aq mikpritëse ndaj disa ideve liberale si: pluralizmi, individualizmi dhe demokracia dhe se njerëzit në tokat arabe nuk janë së brendshmi nacionalistë e se ata nuk kanë uri për pluralizëm dhe demokraci, në mënyrën se si kuptohen në Perëndim këto gjëra?

Lidhur me këtë pikëpyetje, Klara Bilgin, profesore e shkencave politike në Kolegjin *St. Mary's of Maryland* vlerëson: “Revolucionet e vitit 1989, në ish bllokun komunist, si dhe vala e dytë e revolucioneve elektorale në Serbi, Gjeorgji dhe Ukrainë, në fillim të viteve 2000, na japin dy shembuj se si një valë revolucionare rajonale mund të përhapet dhe shpaloset më tej në formën e efektit domino Vala që ka përfshirë Afrikën e Veriut dhe Lindjen e Mesme i ngjan më shumë asaj të parës së vitit 1989, d.m.th. një valë demokratizimi rajonal një pamje thujtë e pandalshme. Perspektivat aktuale për sukses do të mund të vlerësohen më mirë pas zhvillimit të zgjedhjeve pas-revolucionare Tani për tani, ne mund të jemi vetëm optimistë të matur”. (7)

Në javët që kaluan ne pamë që Arabët u bashkëlidhën me identitetet e tyre tashmë shtetërore (d.m.th. jo me identitetin arab në tërësi, por si qytetarë të një vendi, të një qeverie-Shënim i autorit). Pamë që ata të ishin të gatshëm për të rrezikuar jetën e tyre për pluralizëm, hapje dhe demokraci. Ndoshta Huntington e minimizoi fuqinë e vlerave universale politike dhe e egzageroi ndikimin e vlerave të dallueshme kulturore në atë që ai e quajti “Përplasja Qytetërimesh”.

Në dallim, masa të mëdha njerëzish, popuj të tërë të vendeve arabe shprehën një uri universale për liri. Ata e ndjenë praninë e të drejtave njerëzore universale dhe u ndjenë të fyer kur ato nuk zbatoheshin përshtatshëm për ta. Kultura është e rëndësishme, por në nënshtresën e diferencave kulturore, “frenë”, gjithsesi, aspiratat universale për dinjitet, për sisteme politike që i dëgjojnë, që iu përgjigjen dhe respektojnë vullnetin e tyre.

Për këto arsye, në botën arabe do të shohim, ndoshta më shumë nacionalizëm sesa arabizëm, më shumë demokraci, sesa autokraci. Duket se një revolucion gjeopolitik ka nisur, një revolucion që nuk dihet me saktësi se ku e kur do të shkojë, ku e kur do të ndalojë, por vetëm një gjë duket qartazi: zor se do të kthehet atje ku u nis.

Prej më shumë se 10 vjetësh, iniciativën historike e mbajti terrorizmi. Tanimë, edhe atij mbase po i ikën koha, si çdo “arme” apo ideologjie tjetër, ndoshta për t’i lënë vend kundërshtive apo balancave të reja gjeopolitike. Statuquo-ja është prishur. Do të shohim aktorë të rinj në fushën e shahut, ndërkohë që të vjetrit do të ripozicionohen ndryshe.

Nuk ka ushtri në botë të ndalë një ide që i ka ardhur koha. “Pranvera” Arabe, edhe pse e trazuar, duket se mund të sjellë një “behar” të tillë.

Referencat:

1. The New York Times, 14 Prill 2011, Mesazh i përbashkët i Presidentit Amerikan Barack Obama, Kryeministrit të Britanisë David Cameron dhe Presidentit të Francës, Nicolas Sarkozy.

2. Po aty.
3. Rezoluta Nr. 1973 e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Neni 4.
4. World Politics Review, “Libya, Accidental War”, Special Report, fq.1.
5. Arleigh A. Burke Chair in Strategy, Briefing: Center for Strategic and International Studies, “Stability in the Middle East: The Other Side of Security”, 11 Prill 2011.
6. World Politics Review, “Libya, Accidental War”, Special Report, fq.31.
7. Klara Bilgin, Briefing, www.worldpoliticsreview, 12 May, 2011, “Reflections on the Future of the Arab Spring”.

Integrimi i perspektivës gjinore si një pjesë natyrale e organizatave ushtarake dhe operacioneve ndërkombëtare

Kolonele Suzana Jahollari
Komandante e Akademisë së Nënoficerëve “Thomson”

Abstrakt: Rezoluta Nr. 1325 “Për gratë, paqen dhe sigurinë” e Këshillit të Sigurimit të OKB përcakton rolin e madh të grave në shoqëritë konfliktuale, post konfliktuale, në ndërtimin e paqes dhe rritjen e pjesëmarrjes së grave në vendimmarrje.

Republika e Shqipërisë është në procesin kur po rishkruhet Strategjia e Sigurisë Kombëtare, do të rishkruhet Strategjia Ushtarake, duke reflektuar në Konceptin e ri Strategjik të Aleancës. Çështja shtrohet që, meqë ne jemi vend anëtar i NATO-s, në programin 10 vjeçar 2011-2020 të transformimit të Forcave të Armatosura të përfshihen standardet e NATO-s edhe në aspekt të integrimit të perspektivës gjinore, si një element i transformimit të FA.

Nga Koncepti Strategjik i Aleancës mund të kuptohet qartë domosdoshmëria e reformimit dhe transformimit të FA. Ndër të tjera, ajo ka të bëjë me rishikimin e mekanizmave, hartimin e politikave e ndërtimin e strategjive, në përputhje me kërcënimet e rreziqet që paraqiten për sigurinë në Shekullin 21-të.

Transformimi ka të bëjë me përmbajtjen. Duhet ndryshuar shumë gjëra, pikëpamje, koncepte e politika tradicionale.

Forcat e Armatosura të RSH, që nga 1 Janari 2010, janë FA tërësisht profesioniste. Kjo do të thotë që duhet kultivuar koncepte, kulturë e mentalitet i forcës profesioniste. FA janë pjesë e misioneve jashtë vendit.

Pikëpamja për perspektivën gjinore në Forcat e Armatosura dhe se si reformat në sektorin e sigurisë të ndikojnë për më efektivitet të operacioneve ndërkombëtare, është një çështje kyc që diskutohet sot në programet e planet për reformimin e mbrojtjes. Një aspekt i rëndësishëm është si të integrohen problemet gjinore në zbatim të Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për gratë, paqen e sigurinë, 1325, 1820, 1888, 1889, 1960 dhe rregullat për angazhimin e Forcave të Armatosura. **Rezoluta e Këshillit të Sigurimit Nr. 1325, lidhur me gratë, paqen dhe sigurinë është adoptuar nga Kombet e Bashkuara, që nga tetori i vitit 2000. Ajo njeht efektet lidhur me konfliktet te gratë dhe nënvizon rolin shumë të rëndësishëm të gruas lidhur me parandalimin e konfliktit, ashtu si dhe në periudhat post konfliktuale në ndërtimin e paqes dhe përpjekjet për rikonstruktivim.** Rezoluta ka si qëllim integrimin gjinor në të gjitha aspektet e punës

lidhur me sigurinë. Gjithashtu ajo ka si qëllim rritjen e përfaqësimit të gruas në të gjitha nivelet e vendim marrjes në institucionet kombëtare, rajonale dhe ato ndërkombëtare ashtu si dhe konsultimin me grupet e grave kombëtare dhe ndërkombëtare.

Zbatimi i Rezolutës 1325 është mbështetur nëpërmjet planeve kombëtare nga rreth njëzetë e dy anëtarë dhe disa të tjerë janë në proces. Shqipëria në rang kombëtar është në proces të përgatitjes së Planit të Veprimit për zbatimin e kësaj Rezolute. Kjo është diktuar dhe nga detyrimi i plotësismit të kushteve e kritereve për realizimin e aspiratës së vendit tonë për integrimin europian. Gjithashtu në Samitin e Lisbonës në nëntor 2010, Kryetarët e shteteve të vendeve anëtare të NATO-s përcaktuan domosdoshmërinë e Planit të Veprimit për perspektivën gjinore dhe zbatimin e UNSCR 1325 në çdo vend, për menaxhimin e krizave të tanishme e të ardhme dhe planëzimin operacional. Ky është një angazhim i madh që kërkon një vlerësim tërësor të praktikave të mira, shembujve, kufizimet dhe mundësitë.

Nisur nga rëndësia që ka ky koncept, në Stokholm, në prill 2011, është zhvilluar seminari me temë “Gender dhe transformimi i mbrojtjes: transformimi i strukturave kombëtare, mbështetja e operacioneve ndërkombëtare”.

Në këtë seminar, unë si përfaqësuese e shoqatës “Gratë në Forcat e Armatosura të Republikës të Shqipërisë” në zbatim të rezolutës 1325 të Këshillit të Sigurimit të OKB-së për Gratë, Paqen e Sigurinë, paraqita idenë e perspektivën e integritit gjinor në FA të RSH. Gjinia në përgjithësi shihet si një strukturë e marrëdhënieve sociale dhe si një tërësi e praktikave në kuadër të këtyre marrëdhënieve. Hartimi e zbatimi i politikave gjinore sidomos në sektorë të dominuar historikisht nga meshkujt, si në forcat e armatosura përbën një sfidë. Ka modele të ndryshme dhe praktika të mira të pjesëmarrjes së femrave në forcat e armatosura si dhe ndikimin e integritit më të madh të femrave në fushën, që është tradicionale mashkullore. Ushtria përbën një simbolikë prototipe të maskilizmit e karakterizuar nga forca fizike dhe agresiviteti. Në vendin tonë, por dhe në botë, efektet e barazisë gjinore gjenden në sfidat që hasen midis punës dhe jetës së përditshme.

Politikat e përkatësisë gjinore në ditët e sotme mund të analizohen nën dy perspektiva: kriteri numerik i shoqëruar me prezencën e grave në një kontekst të përcaktuar që është balanca gjinore dhe kriteri cilësor që ka të bëjë me nevojën për të angazhuar gratë dhe burrat në proceset politike, ekonomike, ushtarake e sociale. Vërehet tendenca se incidentet që vështirësojnë aftësitë e grave, fshihen në diskriminimin e brendshëm dhe në pengesat që femrat duhet të përballen në procesin e rritjes në detyrë e gradë gjatë një periudhë kohe.

Ka pengesa me të cilat vazhdojnë të ballafaqohen ushtaraket në të gjitha fazat e karrierës ushtarake. Këtu kanë rëndësi ngritja e mekanizmave, e politikave për mbrojtjen dhe zbatimin e të drejtave njerëzore të femrave.

Paraqitja si grup interesi në tavolinat e rrumbullakëta, apo në hartimin e politikave e strategjive të menaxhimit të burimeve njerëzore, të sigurisë kombëtare, strategjive e politikave të rekrutimit, arsimimit e trajnimit, do të ndikonte fuqishëm për realizimin real e faktik të barazisë gjinore. Në Forcat të Armatosura të Shqipërisë, në zbatim të kësaj Direktive të NATO-s është ngritur shoqata “Gratë në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Me Vendim të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Nr. 3000 datë 04.02.2011 kjo shoqatë është regjistruar e funksionon në bazë të ligjeve në fuqi. Objekti i saj është promovimi i barazisë

gjinore në Forcat e Armatosura, përfshirja e plotë e grave dhe rritja e rolit e përfaqësimit në të gjitha nivelet e vendim marrjes si dhe mbështetja e familjeve të ushtarakëve që janë në misione paqeruajtëse jashtë vendit.

Qëllimi i kësaj shoqate është:

- Të promovojë të drejtat e liritë e njeriut dhe zbatimin e ligjit, në mbështetje të parimeve të Kartës së Kombeve të Bashkuara, të Rezolutës 1325 për “Gratë, Paqen e Sigurinë” të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.
- Të adoptohen perspektiva gjinore dhe masat speciale për mbrojtjen kundër violencës e dhunës në problemet gjinore.
- Të rrisë trajnimin në të drejtat e grave e fëmijëve të ushtarakëve, në problemet gjinore në Forcat e Armatosura.
- Të këshillojë lidhshimin e forcave të Armatosura për çështje kritike që ndikojnë te gratë në ushtri.
- Të inkurajojë pjesëmarrjen e grave në të gjitha nivelet e vendim marrjes për të përfshirë kontributin unik të grave në Forcat e Armatosura.
- Të inkurajojë pjesëmarrjen e grave në operacionet në mbështetje të paqes.
- T’i shërbejë mbrojtjes së të drejtave të grave e vajzave në Forcat e Armatosura, nëpërmjet vendosjes së standardeve.
- Nëpërmjet zinxhirit të komandimit të sigurojë sensibilizimin e problemeve gjinore në të gjitha fazat e misioneve e operacioneve paqeruajtëse.
- Të synohet integrimi i perspektivës gjinore në Forcat e Armatosura nëpërmjet hartimit të një strategjie gjithëpërfshirëse, duke përfshirë planifikimin operacional dhe procesin ekzekutues.
- Promovimi i mundësive të barabarta për burrat e gratë në promovimin e gradave, përgjegjësinë, arsimimin e kualifikimin.
- Përmirësimi i legjislacionit shqiptar për sa i përket lehtësimit të procedurave që ndiqen në Forcat e Armatosura për rekrutim, arsimim e kualifikim.

Hartimi i strategjive në fushën e perspektivës gjinore është domosdoshmëri, për të siguruar realizimin në praktikë të përfaqësimit gjinore në të gjitha fushat. Një strategji e mundshme, është të sigurohen marrëdhëniet e pushtetit gjinor si rezultat kryesisht dhe në radhë të parë i shpërndarjes kualitative të burrave e grave. Një tjetër shembull është strategjia e neutralitetit të përkatësisë gjinore, që e bën përkatësinë gjinore të pavend, të padukshëm dhe jo problematike. Sidoqoftë në shoqëritë që tradicionalisht janë dominuar nga meshkujt duhet parë në thellësi problemi. Ekziston përfshirja e grave në këto institucione, nën logon e barazisë gjinore gratë lejohen të marrin pjesë, por progresi dhe promovimi i tyre ruhet me konservatorizëm, ose nuk ndiqet me transparencë.

Çështja e femrave në forcat e armatosura është një çështje e menaxhimit të shumëllojshmërisë, përkatësisht rekrutimit dhe mbajtjes të të punësuarve me prapavijë të ndryshme demografike, sidomos shfrytëzimi i kualiteteve të tyre në mënyrë optimale. Vëmendje duhet t’i kushtohet kapacitetit të femrave për të dhënë kontribut pozitiv në siguri, veçanërisht në aspekt të roleve të shumta, të cilat i kanë forcat e armatosura

bashkëkohore, që nga misionet vëzhguese dhe shpërndarja e ndihmës humanitare, deri te misionet paqeruajtëse dhe për ndërtimin e paqes.

Seminari i organizuar nga grupi i Punës i Reformës në Sektorin e Sigurisë i Pfp Consortium i Akademive të Mbrojtjes dhe Instituteve të Studimeve të Sigurisë në Garmish, Gjermani, Qendra e Gjenezës për Kontrollin Demokratik të Forcave të Armatosura, Kolegji i Mbrojtjes Kombëtar i Suedisë dhe Forcat e Armatosura të Suedisë, trajtoi çështje për një kuptim më të thelluar dhe lidhjet midis perspektivës gjinore në Forcat e Armatosura në nivel kombëtar dhe në Operacione ndërkombëtare.

Iu kushtua rëndësi rishikimit të politikave të NATO-s dhe standardeve në trajnimin “ Gender” dhe impaktin e tij në vendet e NATO-s dhe ato Pfp.

Mbështetja e sugjerimeve dhe lehtësimi për kërkimet në integrimin e Gender në operacionet ndërkombëtare, dhe lidhja midis kërkimeve, mësimave të nxjerra dhe operacioneve, ishte një tjetër ndër objektivat e seminarit.

Trajtimi i eksperiencave të Forcave të Armatosura të Suedisë për integrimin e perspektivës gjinore është një aftësi domethënëse. Konsiderohet si një nga modelet rol për mbështetjen e transformimit të sektorit dhe efektivitetin e operacioneve ndërkombëtare.

Kjo eksperiencë është një qasje e rëndësishme së integrimit të perspektivës gjinore për reformimin e Forcave të Armatosura si një forcë efektive veçanërisht në operacionet ndërkombëtare, por gjithashtu dhe në kontekstin kombëtar. Sfidat e reja, misionet e reja, kërcënimet e reja kërkojnë transformim. Suedia është në ballë të integrimit të perspektivës gjinore si një element në transformimin e Forcave të Armatosura në një mbështetës efikas i sigurisë dhe të suksesshëm.

Mësimet e identifikuara dhe mësimet e nxjerra në drejtim të perspektivës gjinore në planëzim, zbatim dhe vlerësim të operacioneve ndërkombëtare është shembull dhe shërben si bazë për zhvillim të mëtejshëm.

- Dezinjimi institucional: pozicione të reja dhe reparte në organizimin bazik dhe kontingjentet e trupave pjesëmarrëse në mision.
- Operacionaliteti i integrimit të perspektivës gjinore në nivel taktik. Mësimet e nxjerra nga këshilltarët e problemeve gjinore dhe komandantët.
- Avantazhet në lidhje me integrimin e perspektivës gjinore për arritjen e objektivave dhe qëllimeve të operacioneve.
- Arsimim, trajnim dhe ushtrim praktik.
- Politikat e burimeve njerëzore, duke përfshirë rekrutimin, ruajtjen e personelit dhe përpunimin e avancimin në gradë e detyrë dhe strukturat mbështetëse.

Drejt një shërbimi të balancuar Gender: Përshtatja e politikave të burimeve njerëzore (përfshirë rekrutimin, ruajtjen e personelit dhe avancimin) në Forcat e Armatosura.

Shtrohen pyetjet:

- Si politikat e burimeve njerëzore zhvillohen, përshtaten dhe nga kush ?
- A janë gratë dhe burrat të përfshirë në këtë proces ?
- Kush është ndikimi i tyre? Si ka ecur ?

Integrimi i perspektivës gjinore si një pjesë natyrale e organizatave ushtarake dhe operacioneve ndërkombëtare

Shtrohen pyetjet:

- Në çfarë mënyre problemet e integrimit të perspektivës gjinore të jenë të integruara në strukturat operacionale ?
- Si politikat e burimeve njerëzore ndihmojnë shkuarjen e grave në misionet në mbështetje të paqes?
- Çfarë strukturash, institucionalizime nevojiten ?

Një arritje e konsiderueshme në vendet anëtare të NATO-s, por dhe në ato Pfp konsiderohet arsimimi, kualifikimi, praktikimi i problemeve Gender

Shtrohen pyetjet:

- Çfarë lloj trajnimit e arsimimi nevojitet?
- Çfarë standardesh ndërkombëtare ekzistojnë? Kush duhet të mbështesë trajnimin? Sa duhet të jetë zgjatja e trajnimit?
- Çfarë përmbajtje duhet ti adresohet nga perspektiva operacionale dhe taktike?

Zhvillimi i standardeve trajnuese ndërkombëtare: Ku qëndrojnë vendet Pfp dhe ato të NATO-s?

Stërvitja dhe arsimimi për problemet gjinore ka shtuar rëndësinë këto vite. Megjithatë, përpjekjet për institucionalizimin dhe standardizimin e përmbajtjes së Gender, termat e reformave, kurrikulat e arsimit dhe stërvitjes janë rritur. Megjithatë, NATO dhe vendet Pfp kanë nivele shumë të ndryshme të ndërgjegjësimit dhe të kuptuarit e “Gender” dhe llogaritja e sfidave të ndryshme në zhvillimin e stërvitjes “Gender”.

Në 10- vjetorin e adaptimit të UNSCR 1325 në vitin 2010, NATO ka publikuar një përmbledhje të aktiviteteve që lidhen me problemet “Gender” dhe ngriti problemin “Gender” në kuadrin e diskutimeve për Konceptin e Ri strategjik të NATO-s.

Paralelisht, Komiteti për Perspektivën Gjinore në NATO i ka parashtruar principet që tashmë janë aplikuar në disa shtete për zhvillimin e standardeve të përgjithshme për stërvitjen “Gender”. Në lidhje me këtë, NATO ka bërë me vendet Pfp zhvillimin e kurrikulumeve standard për ndërtimin e institucioneve të mbrojtjes dhe arsimimin ushtarak profesional. Natyra e hapave të marra për çuarjen më tej të trajnimit dhe arsimimit “Gender” në nivel kombëtar e ndërkombëtar në NATO si një organizatë dhe në çdo vend anëtar ose partner.

- Modeli i NATO-s, për pjesëmarrjen në misione dhe të trajnimit “Gender” si dhe miratimi i Komandës së Transformimit të NATO-s për integrimin e Gender në kurrikulat e trajnimit.
- Kush janë standardet, kush proces udhëheq zhvillimin e tyre
- Çfarë pret NATO nga vendet për të adoptuar ato? Si standardet, kurrikulat janë të përdorshme dhe nga kush ?

Iniciativa e trajnimit Hollandë - Spanjë si një iniciativë bilaterale për zhvillimin e konceptit “Gender” në Forcat e Armatosura, e përfshirjes në kurrikulat e stërvitjes të Gender, është një eksperiencë e rëndësishme.

Gjithashtu përfshirja e disa instituteve të studimeve të sigurisë dhe të akademive të mbrojtjes, organizatave ndërkombëtare, organizatave të shoqërisë civile për gratë, që janë angazhuar në kërkime e studime për integrimin e Gender dhe importin që ajo ka në efektivitetin e operacioneve ndërkombëtare është domethënëse për rëndësinë e sotme të këtij koncepti. Ato kanë shtruar një sërë pyetjesh si: problemet gjinore dhe reforma e sektorit të sigurisë kërkon vlerësim në Forcat e Armatosura të vendeve të NATO-s, e si të tilla bëhet imediate dhe për FA të Republikës së Shqipërisë. Studimi i integritit të “Gender” në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë është një shembull që u bë prezent në aktivitetin e organizuar në Stokholm.

Gender dhe roli i saj në transformimin e mbrojtjes merr një peshë të veçantë sot. Me rritjen e konsensusit ndërkombëtar për zgjerimin e definicionit për sigurinë kombëtare dhe avancimin e paradigmave të reja të sigurisë, sektori i mbrojtjes është klasifikuar si pjesë e qenësishme e “familjes së gjerë të sigurisë”. Është komponent kryesor i gjuhës së reformës së sektorit të sigurisë.

Reforma e mbrojtjes, në kundërshtimin tradicional është transformimi i sektorit të mbrojtjes së çdo shteti, i vënë nën kontrollin civil; i nënshtruar ndaj parimeve të llogarisë dhe qeverisë së mirë; mirëmban një forcë në numër të konsiderueshëm e të duhur; ka përfaqësues në termat e Gender, etnitet dhe faktorët e tjerë; janë të trajnuar dhe të pajisur për t’ju përshtatur kushteve strategjike (të cilat mund të përfshijnë kontributin për paqeruajtjen dhe organizatat e sigurisë rajonale) dhe i nënshtrohen ligjeve ndërkombëtare, duke kontribuar tek objektivat kombëtare e ndërkombëtare për paqen e sigurinë. Transformimi i mbrojtjes kërkon një përfaqëse gjithëpërfshirëse, i cili kërkon të gjejë një forcë optimale të dizenuar dhe efektivitet të përmirësuar, ndërsa gjithashtu zhvillon dhe ruan një forcë kombëtare mbrojtëse të balancuar, moderne e profesionale, që përfaqëson të gjitha grupimet brenda një vendi. Për më shumë transformimi i mbrojtjes, duhet të japë efektet e politikave të mbrojtjes kombëtare dhe parimet e marrëdhënieve civilo-ushtarake.

Duke vepruar kështu, Forcat e Armatosura duhet të fitojnë respekt kombëtar e ndërkombëtar si institucion profesional dhe të besueshëm.

Mësimet e nxjerra nga vendet si Suedia shënojnë që drejtimi, perspektiva, trendy gjinor, Gender, është gur themeli i transformimit të sektorit të mbrojtjes dhe shumë i rëndësishëm për suksesin e saj.

Ndërsa rriten në sasi numri i pjesëmarrjes e prezencës së grave në sektorin e mbrojtjes është kritike të krijohet një balancë gjinore. Vetëm se kjo nuk garanton që transformimi i mbrojtjes ose i forcave të mbrojtjes do të jetë përgjigje për perspektivën gjinore. Një proces dhe aktivitet që lidhet me transformimin duhet në mënyrë kritike të shtrojë pyetjet : Siguri për kë dhe si ? Ndërhyrja në situata konfliktuale dhe në operacione stabiliteti përballet me sfida njerëzore të paprecedente dhe të vështira dhe rajoni i sigurisë me një diversitet të roleve Gender. Është e domosdoshme të ekzaminojnë lidhjen midis “gender” dhe strukturave kombëtare e ndërkombëtare dhe si ato ndikojnë dhe ndihmojnë mbështetjen e operacioneve.

Rëndësia e Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së.

Adaptimi i Rezolutave të Këshillit të Sigurimit të OKB-së 1325, 1820, 1888, 1390, 1960, nënvizojnë rritjen e vëmendjes dhe mbështetjen për parandalimin e dhunës kundër grave

dhe vajzave, mbrojtjes së tyre efektive dhe promovim për më shumë pjesëmarrje të barabartë të grave në çdo nivel të vendimmarrjes, veçanërisht në fushën e sigurisë.

Rezolutat për gratë, paqen e sigurinë theksojnë vëmendjen e veçantë se si shtetet të përgatisin personelin e tyre për pjesëmarrje në operacionet e paqes e stabilitetit.

Ato tërheqin vëmendjen për shtetet që:

- Të përfshijnë çështjet “Gender”, në programet trajnuese para shkuarjes në mi-sione për ushtarakët dhe personelin polic.
- Të ndërmarrë hapa për parandalimin e dhunës seksuale dhe abuzimet.
- Të marrë masa për përfshirjen e më shumë grave si paqeruajtëse dhe në po-zicione të tjera operationale.
- Të mbështesë pjesëmarrjen e grave të zonës lokale në të gjitha hapat e zgjidhjes së konfliktit.

Rezolutat gjithashtu bëjnë disa sugjerime specifike në lidhje me çështjet që duhet të jenë të përfshira në parashkuarjen në misione për trajnimet e personelit civil, polic e ushtarak.

- Rëndësia e përfshirjes së grave në të gjitha masat, në të gjitha nivelet e paqeruajtjes dhe ndërtimit të paqes.
- Mbrojtja, të drejtat dhe në veçanti nevojat e grave.
- Mbrojtja e civilëve, përfshi gratë e vajzat.
- Zero tolerancë ndaj dhunës e abuzimet seksuale.
- Parandalimi i dhunës seksuale kundër grave e vajzave në situatat konfliktuale e pas konflikteve.
- Ndërgjegjësimi kundër HIV/ AIDS.

Sot kërkohet të eksplorohehen aspekte të ndryshme të transformimit dhe të përshtatjes së Forcave të Armatosura ndaj kërcënimeve të sotme të sigurisë dhe në misionet ndërkombëtare. Forcat e Armatosura Suedeze ndajnë eksperiencën e tyre në politikat e besimeve njerëzore, implementim operacional i perspektivës gjinore dhe i arsimimit, trajnimit e ushtrimit, mbështetur nga shembujt nga procesi i transformimit. Veç të tjerash, ajo ekzaminon si kontingjentet në misione mund të kontribuojnë me më shumë efektivitet të operationeve të paqes e stabilitetit dhe si politikat e burimeve njerëzore ndihmojnë pjesëmarrjen e grave në operatione të tilla.

Gjithashtu sot adresohen përpjekjet e fundit të NATO-s për të rritur masat për integrimin e Gender në punën e saj, në nivel politik e ushtarak. Këto masa janë paraqitur dhe ndjekur nga plane të diskutuara, veçanërisht, në përpjekje të trajnimit e arsimimit.

Këtu e rëndësishme është fokusimi në kërkimet, punën studiuese. Ajo ekzaminon çfarë lloj kërkimesh e studimesh është e nevojshme të pajisen vendimmarrësit me argumentet si të implementohet politikat ekzistuese.

Referencat:

1. “The Alliance’s Strategic Concept”, approved in Lisbon, on 20 November 2010.
2. Strategjia e sigurisë kombëtare e RSH, botim i vitit 2005.
3. Strategjia ushtarake e RSH, botim i vitit 2008.
4. UNBCR 1325, 31.10.2000.

Një luftë e re me themele të vjetra. Debatet e politikës së sigurimit mbi “Luftën asimetrike”

Kapiten Dipl. Pol. Genti Bardhi
Specialist në Drejtorinë e Planifikimit të Mbrojtjes, SHP

Abstrakt: *Mbas 11 Shtatorit 2001, shtypi akademik botëror u përmyt nga botime të ndryshme mbi “Luftën asimetrike”. Ky term i sapogjetur në këtë kohë përmblihte shpesh në vetvete terma të tjerë si “Lufta kundër terrorizmit” dhe jo rrallë u përdor termi “Luftëra të reja”. Nga përdorimi i këtyre termave u krijua ideja që “Lufta asimetrike” nuk ishte asgjë tjetër veçse “Lufta kundër terrorizmit” e cila jo rrallë trajtohej si një luftë e lindur mbas 11 Shtatorit. A nënkupton “Lufta asimetrike” thjesht dhe vetëm “Luftën kundër terrorizmit”? Janë këto luftëra (luftërat asimetrike) me të vërtetë kaq të reja?*

Duke u bazuar në një analizë të tri fenomeneve kryesore si; armatimi bërthamor, lufta partizane, dhe terrorizmi, do të bëhet një përpjekje për t'i dhënë një përgjigje këtyre pyetjeve. Sigurisht që këto tri fenomene nuk e mbulojnë tërë spektrin e këtyre luftërave, por ndihmojnë lexuesin të shohin luftërat asimetrike nga një këndvështrim i ndryshëm me atë çka shpesh është perceptohet si një luftë e filluar nga SHBA pas 11 Shtatorit ekskluzivisht për të luftuar terrorizmin.

Hyrje

Problemi i “Luftës asimetrike” sot është më aktual se kurrë. Sidomos mbas sulmeve terroriste të 11 Shtatorit 2001, ky term u bë tepër i njohur. Goditjet mbi „World Trade Center” çuan në një ndryshim radikal të politikës së sigurimit, jo vetëm në SHBA por në të gjithë botën. Terma si “Lufta asimetrike” dhe “Lufta kundër terrorizmit” përmenden gjithnjë e më tepër. Tërë bota papritur u ndje e rrezikuar nga ky rrezik i ri. Që nga kjo goditje SHBA e pa veten në luftë, dhe NATO për pasojë u fut në luftë në bazë të artikullit 5 të Konventës.¹

Të gjitha këto të bëjnë të mendosh që fenomeni i “Luftës Asimetrike” është relativisht i ri. Në literaturë hasim shpesh si sinonim të termit “Luftë Asimetrike”, termin “luftërat e

¹Krahaso: Wiefelspütz, Dieter: *Sicherheit vor den Gefahren des internationalen Terrorismus durch den Einsatz der Streitkräfte?*, Në: Dou, Klaus/A.Steinkam, Armin (Pub.): *Neue Zeitschrift für Wehrrecht*, Volum 45, Berlin, Fq. 45

reja”². Lind pyetja: *Janë këto luftëra (luftërat asimetrike) me të vërtetë kaq të reja?! Në këtë artikull do t’i jepet një përgjigje kësaj pyetje duke u bazuar kryesisht mbi debatet e politikës së sigurimit të viteve 70 dhe duke i analizuar ato.*

Në këtë kohë debatet e politikës së sigurimit dominoheshin nga diskutimet mbi luftën e ftohtë dhe armët bërthamore. Në pamje të parë duket që debatet e sotme mbi „Luftën Asimetrike” nuk kanë asgjë të përbashkët me diskutimet e kësaj kohe. Megjithatë gjatë analizës që do të bëhet mund të ndryshohet ky mendim. Me qëllim që të shohim çfarë fshihet mbas termit të „Luftës Asimetrike” është fillimisht e nevojshme një analizë e termit në fjalë. Për këtë arsye, në kapitullin e dytë të këtij artikulli, do të sqarohet teorikisht përmbajtja e termit „Luftë Asimetrike”. Më pas në pjesën kryesore të artikullit, do të paraqiten diskutimet e politikës së sigurimit të cilat kanë lidhje me temat e luftës asimetrike (armatimi bërthamor, lufta partizane, dhe terrorizmi).

Megjithëse në këtë artikull do të paraqiten diskutimet e politikës së sigurimit të viteve 70 të shekullit të 20, diskursi i „Luftës Asimetrike” është sot tepër aktual. Qëllimi i analizës së historisë është të mësosh nga e kaluara dhe atë ç’ka ke mësuar ta përdorësh për të tashmen. Kjo do të thotë që pavarësisht se në këtë artikull analizohet e kaluara, ajo do të shërbejë për të parë luftën asimetrike pak më gjerë. Qëllimi është të përçohet tek lexuesi që „Lufta Asimetrike” nuk është vetëm lufta kundër terrorizmit siç nënkuptohet rëndom nga ese të ndryshme, por këto luftëra janë shumë më të vjetra nga ç’ diskutohet rëndom.

Termi “Luftë Asimetrike”

Termi “Luftë Asimetrike” është relativisht i ri. Shpesh herë mendohet që datëlindja e termit “Luftë Asimetrike” është 11 Shtator 2001. Kjo mund të jetë e vërtetë në lidhje me terminologjinë, por kjo nuk do të thotë që fenomeni “Luftë Asimetrike” nuk ka ekzistuar para 11 Shtatorit. Për këtë arsye në këtë pjesë do të trajtohen disa teori dhe ide të cilat flasin mbi këtë lloj lufte. Përpara se të analizohen debatet e viteve 70 të shekullit 20, duhet të trajtohet paraprakisht termi “Luftë Asimetrike” dhe analizohet problematika që fshihet pas tij.

Lufta asimetrike pas 11 Shtatorit

Siç u përmend më lart 11 Shtatori 2001 është një datë simbol porsa i përket luftës asimetrike. Sulmet terroriste mbi “World Trade Center” lanë vend për një formë “të re” të luftës. Në këtë kohë termi i sapo gjetur i “luftës asimetrike” u huazua nga fusha e ekonomisë³ dhe shpreh një marrëdhënie jo të barabartë mes palëve. Pas 11 Shtatorit mbizotëroi

²Krahaso: Schlichte, Klaus: *Neue Kriege oder alte Thesen? Wirklichkeit und Repräsentation kriegerischer Gewalt in der Politikwissenschaft*, Në: Geis, Anna (Pub.): *Den Krieg überdenken. Kriegsbegriffe und Kriegstheorien in der Kontroverse*, Schriftreihe der Sektion Politische Theorien und Ideengeschichte in der deutschen Vereinigung für Politische Wissenschaft, Bd. 6, Nomos Verlag, Baden – Baden 2006, Fq. 111

³Krahaso: A. Schmidl, Erw Në: „Asymmetrische Kriege”-Alte Wein in neuen Schläuchen? Në Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): *Asymmetrische Kriegsführung-ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden-Baden 2004 FQ. 121*

këndvështrimi amerikan i luftës asimetrike. Sipas këtij këndvështrimi kjo formë e luftës përkufizohet si më poshtë.

Termat “*Asymmetric Warfare*” dhe “*Asymmetric Threats*” përdoren për atë lloj kërcënimi për politikën e sigurimit, të cilat drejtohen kundër strukturave politike, strategjike, ushtarake dhe ekonomike, një formë të tillë, që nuk i përgjigjet skenarëve tipikë të kërcënimit konvencional.⁴

Nëse analizohet me kujdes, ky përkufizim nuk është shumë i qartë. Lind pyetja; Çfarë janë “*skenarët tipikë të kërcënimit konvencional*”? A nuk mund të quhet një luftë “*asimetrike*” dhe në rast se përdoren mjete konvencionale?

Që pas 11 Shtatorit përçohet përshtypja që lufta asimetrike nuk është asgjë tjetër, veçse lufta kundër terrorizmit? Në disa përkufizime të tjera në SHBA mbi luftën asimetrike, këto lloj luftërash përkufizohen si “...*battles between dissimilar forces...*”, dhe armiku përdor “...*methods that differ significantly from United States expected method of operations...*”. Ky përkufizim nuk përjashton mjetet konvencionale, megjithatë mund të shohim që në këto lloj luftërash konfliktet e armatosura kryhen në shumicën e rasteve në kohë paqeje, dhe rrallë të dyja palët në luftim janë forca të rregullta ushtarake. Mund të vëmë re që gjatë këtyre konflikteve, nuk ka një ndarje të qartë midis luftës dhe paqes. Konfliktet, lufta dhe dhuna vazhdojnë për një kohë tepër të gjatë dhe synojnë lodhjen e armikut.⁵

Mund të mendohet që për SHBA “Lufta kundër terrorizmit” zë pjesën më të madhe të “Luftës asimetrike”, por dhe kërcënime të tjera si p.sh. përdorimi i armëve të dëmtimit në masë kundër objektivave amerikane brenda dhe jashtë vendit, paraqesin një rol të rëndësishëm. Dita e 11 Shtatorit përbën pa dyshim fillimin e një epoke të re të luftës asimetrike. Por a ishte 11 Shtatori fillimi i lufte asimetrike? A ka pasur dhe para kësaj date diskutime mbi një luftë e cila sot mban emrin “Luftë asimetrike”? Në kapitujt e ardhshëm do të bëhet një përpjekje për t'i dhënë një përgjigje këtyre pyetjeve.

Një vështrim mbi idetë dhe teoritë mbi luftën asimetrike para 11 Shtatorit

Në literaturën historike mbi teoritë e luftërave, ndeshesh shpesh me një sërë mendimtarësh të cilët flasin për luftëra të cilat sipas përkufizimeve të lartpërmendura mund të quhen fort mirë “Luftëra asimetrike”. Shumë teoricienë duke filluar nga Aristoteli, Mao Tse-Tung, Lenini, Che Guevara etj. janë marrë me këtë lloj lufte.

Aristoteli me teorinë e tij mbi relacionin cilësi-sasi përcakton disa baza strukturore për luftërat asimetrike. Sipas Aristotelit fuqitë e mëdha janë vetëm atëherë të fuqishme, kur forcat e tyre kanë sasinë numerike të personelit dhe janë gjithashtu të një cilësie të mirë. Gjatë shtjellimit të idesë së tij Aristoteli flet shpesh herë për konflikte asimetrike të fuqive të asaj kohe, me popuj të ndryshëm të vegjël.⁶

⁴Cituar sipas: W. Korkisch, Friedrich: *Die amerikanische Sicht: Asymmetric Warfare*. Në: Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): *Asymmetrische Kriegsführung-ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden-Baden 2004 FQ. 145*

⁵Krahaso: Po aty, Fq. 146 - 147

⁶Kombinimi midis cilësisë dhe sasisë

Nëse do të merresh me tematikën e luftës asimetrike, ndeshesh shpesh me Mao Tse Tung-un. Ai nuk është marrë me luftën asimetrike vetëm nga ana teorike, por dhe nga ajo praktike. Partia Komuniste e Kinës nën drejtimin e Mao Tse Tung-ut do të çlironte Kinën nga pushtimi i huaj.⁷ Mao ishte në disavantazh të madh me kundërshtarin e tij, si nga ana e forcave, ashtu dhe për nga pajisjet. Në këtë mënyrë kjo luftë karakterizohej nga mosbarazimi që karakterizon luftërat asimetrike. Mao zhvilloi teorinë e luftës revolucionare. Ai zhvilloi një taktikë e cila synonte motivimin ideologjik të forcave, arritjen e mbështetjes nga populli si dhe largimin e armikut në një formë e cila nëpërmjet akteve të sabotazhit dhe goditjeve të kufizuara në hapësirë dhe kohë, shmang përballjen e drejtpërdrejtë (luftë guerile) me të.⁸ Lufta e Maos në kundërshtim me idetë e Leninit drejtohet kundër pushtuesit të huaj.

Lenini sheh si luftë që sot mund të quhet luftë asimetrike, luftën civile. Ai i qëndron besnik ideve komuniste të luftës së klasave dhe në këtë mënyrë ai do të organizojë luftën brenda shoqërisë (një pjesë e popullit kundër tjetrës).⁹ Megjithëse në shkrimet e Leninit kundërshtarët quhen “Parti” dhe “Sundues” apo “Borgjezë”, dhe tek Mao “Udhëheqja e qëndresës” dhe “agresor”, në bazë kemi të bëjmë me të njëjtën taktikë luftimi. Tek të dyja këto lloje luftërash mund të shohim një ideologjizim të luftës dhe një asimetri të dallueshme.

Për ta përmbledhur këtë kapitull mund të themi që me luftë asimetrike nuk nënkuptohet vetëm lufta kundër terrorizmit. Në këto luftëra palët në konflikt ose janë që në fillim të pabarabarta, si në rastin kur grupe të ndryshme të popullatës luftojnë kundër ushtrish profesioniste (lufta kundër terrorizmit), ose pala më e dobët e një konflikti e kryen një luftë me metoda asimetrike, si në rastine një lufte partizane pas humbjes së ushtrisë së rregullt në fushën e betejës.¹⁰ Asimetritë – pabarazitë e metodave, pajimeve, dhe forcave, përcaktojnë luftën asimetrike.

Debatet e politikës së sigurisë në vitet 70 të shekullit të 20

Situata e politikës së sigurimit në vitet 70 të shekullit të 20 ishte tepër e tensionuar. Nga njëra anë kjo situatë mbizotërohej nga dualizmi i luftës së ftohtë dhe diskutimet mbi armët bërthamore, ndërsa nga ana tjetër zhvilloheshin në të tërë botën organizata terroriste të çdo lloji. Në Evropë u formuan kryesisht organizata komunisto-terroriste, siç ishte Fraksioni i Ushtrisë së Kuqe (RAF) në Gjermani, Brigadat e Kuqe në Itali, ndërsa në Lindjen e Mesme vazhdonte zhvillimi i organizatave islamiko-terroriste. Organizata të tjera me sfond terrorist siç ishin IRA dhe ETA në këtë kohë ishin më të forta se kurrë.¹¹

⁷ Krahaso: Von Weizsäcker, Carl Fridrich: *Wege in der Gefahr. Eine Studie über Wirtschaft, Gesellschaft und Kriegsverhütung*, Carl Hanser Verlag, Mynih 1976, Fq. 96

⁸ Krahaso: Stupka Andreas: *Kriegsgeschichte und klassische kriegstheoretische Betrachtungen zur asymmetrischen Kriegsführung*, Në: Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): *Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? botimi 1*, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004 Fq. 55

⁹ Krahaso: Spannocchi, Emil/ Von Weizsäcker, Carl Fridrich, Brossollet, Guy: *Verteidigung ohne Schlacht*, Carl Hanser Verlag, Mynih 1976, Fq.44 – 45

¹⁰ Krahaso: Münkler, Herfried: *Krieg*. Në: Göhler, Gehrhard/Iser, Mathias/Kerner, Ina (Pub.): *Politische Theorie. 22 unkämpfte Begriffe zur Einführung*, Wiesbaden 2004 Fq. 235

¹¹ Krahaso: Waldmann, Peter: *Terrorismus. Provokation der macht*. Gerling Akademie Verlag, Mynih 1998, Fq. 53

Në këtë pjesë të artikullit do të trajtohen tre probleme të luftës asimetrike, të cilat në debatet e viteve 70 kanë luajtur një rol të rëndësishëm.

Së pari do të trajtohet një lloj asimetrie e cila u krijua nga pajisja me armë bërthamore, së dyti do të shihet taktika “asimetrike” e disa vendeve të cilët ishin neutralë dhe në rast të një sulmi të mundshëm nga njëri prej blloqeve, nuk kishin mundësi të mbroheshin. Këtu do të merret si shembull taktika e përdorur nga Austria. Kjo taktikë është për shumicën e studiuesve shqiptarë tepër e njohur për arsye të ngjashmërisë së saj me taktikën e zhvilluar në ushtrinë shqiptare. Së treti do të sqarohet fenomeni i terrorizmit në këtë kohë.

Armët bërthamore dhe asimetria

Teknologjia bërthamore e çoi botën në një kapitull të ri në historinë e luftërave. Në sistemin bipolar të luftës së ftohtë zotërimi i armëve bërthamore paraqiste një kërcënim të jashtëzakonshëm për shtetet të cilat nuk zotëronin kapacitete bërthamore. Edhe fuqitë bërthamore gjithashtu ishin të detyruara të ndryshonin strategjitë e tyre, pasi armët bërthamore kanë një potencial të lartë shkatërrues.

Studimet e viteve 70, tregojnë që përdorimi i këtyre armëve mund të vrasë 5–15 milionë njerëz. Ky potencial shkatërrues çon në frikësimin e kundërshtarit dhe në këtë mënyrë i jep zotëruesit të kësaj arme jo vetëm fuqi politike përkundrejt armiqve, por çon dhe në dominancë të këtyre shteteve brenda strukturave të aleancave të krijuara.¹² Strategjia e frikësimit të armikut do të jetë e rëndësishme dhe gjatë analizës që do ti bëhet ndryshimit të strategjive nga të dy polet (përfundim dhe lindje).

Nëpërmjet zotërimit të armëve bërthamore del në pah një asimetri e dukshme midis palëve. Përdorimi i armëve bërthamore nga SHBA në Japoni tregoi qartë se këto armë mund të kenë një ndikim vendimtar në vazhdimësinë e luftës. Pas të dyja goditjeve në Hiroshima dhe Nagasaki, Japonia pati humbje të jashtëzakonshme si në ushtri, ashtu dhe në popullsinë civile. Përdorimi i këtyre armëve çoi në kapitullimin e Japonisë e cila çoi në përfundimin e luftës dhe një fitore të forcave aleate. Ky shembull u përdor shpesh në vitet 70 për të argumentuar mendimin pro apo kundër pajisjes me armatim bërthamor.

Në këtë kohë, zotërimi i armëve bërthamore bënte ndarjen midis fuqive të mëdha dhe te vogla, midis të fortit dhe të dobët. Në bazë të përkufizimit të përmendur në pjesën e parë, një konflikt mund të jetë asimetrik nëse njëra nga palët zotëron armë bërthamore.¹³ Në sistemin bipolar të shekullit të 20 përshtatja në epokën e re të armëve bërthamore ishte e domosdoshme. Për këtë qëllim, nga ana e shteteve dhe kampeve të ndryshme, nevojitej krijimi i strategjive dhe taktikave të reja luftarake. Për këtë arsye NATO, e cila në

¹² Krahaso: Afheldt, Hors/Sonntag, Philipp: *Stabilität und Abschreckung durch strategische Kernwaffen-eine Systemanalyse*. Në: von Weizsäcker, Carl Friedrich (Pub.): *Kriegsfolgen und Kriegsverhütung*, Carl Hanser Verlag, Mynih 1971, Fq. 303-416

¹³ Krahaso: Kasper, Christian: *Neue Funktionen für Nuklearwaffen – Die Nuklearwaffe im asymmetrischen Konflikt*. Në: Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): *Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden-Baden 2004, Fq.265*

krahasim me shtetet e Traktatit të Varshavës ishte pajisur më keq në fushën bërthamore¹⁴, kaloi nga strategjia e „Masive Retaliation” në strategjinë „Flexible Response”. Kjo do të bënte të mundur një përshtetshmëri të luftimeve.

Nëpërmjet strategjisë së re një sulm apo kundërsulm bërthamor do të mund të shtyhej në kohë apo të anashkalohej, duke çuar si fillim në luftime vetëm me armë konvencionale. Përdorimi i armëve bërthamore parashikohej vetëm si “Ultima Ratio¹⁵”. Strategjia „Flexible Response” synonte parandalimin e luftës me armë bërthamore, me qëllim anashkalimin e asimetrisë që ekzistonte midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës.

Austria dhe zhvillimi i një taktike të re

Në kapitujt e parë u paraqit asimetria e cila ekzistonte mes dy kampeve. Por si dukej situata në vendet neutrale¹⁶, në një kohë në të cilën dy polet sa vinin e fuqizoheshin? Vende të tilla ishin të detyruara të zhvillonin taktika të luftës asimetrike, nëpërmjet të cilave synohej përbalimi i një armiku (si psh. njërit prej dy kampeve), fuqia e të cilit nuk ishte proporcionalisht e barabartë me fuqinë e këtyre shteteve.

Siç u përmend më lart kemi të bëjmë me luftë asimetrike kur në mes të palëve në konflikt ekziston një pabarazi që në momentet e para të konfliktit, si psh. në rastet kur grupe të ndryshme të popullatës luftojnë kundër ushtrive profesionale (lufta kundër terrorizmit), apo pala më e dobët në një konflikt simetrik përdor metoda asimetrike, si psh hapja e një lufte partizane mbas shkatërrimit të ushtrisë së rregullt në fushën e betejës.¹⁷ Modeli i dytë (përdorimi i metodave asimetrike në një konflikt simetrik) i kësaj lufte u pa si modeli më i përshtatshëm për vende neutrale të tilla si Shqipëria apo Austria. Në këtë kapitull do të sqarohet nën shembullin e Austrisë¹⁸ një taktikë deri atëherë, nëpërmjet së cilës shtetet neutrale duhej të siguronin mbrojtje kundër armiqve në një kohë e cila mbizotërohej nga bipolariteti.

Situata e politikës së sigurimit në Austri në vitet 70

Zhvillimi i debateve të politikës së sigurimit mbi mënyrën e mbrojtjes së Austrisë u ndikua nga historia dhe neutraliteti i këtij vendi. Pas fundit të Luftës së Dytë Botërore, u përcaktuan zonat e influencës nga Fuqitë e Mëdha. Politika e jashtme e Austrisë nga viti 1946 deri më 1955 u mbizotërua nga diskutimet mbi drejtimin politik të Austrisë. Qëllimi ishte arritja e sovranitetit të plotë të saj dhe tërheqja sa më e shpejtë e trupave pushtuese. Këto diskutime u karakterizuan nga një zgjatje e tejskajshme dhe shumë problematike deri në 1955.

Të katër Fuqitë e Mëdha donin të realizonin interesat e tyre, gjë e cila çonte shpesh herë në ndërprerjen e bisedimeve. Fuqitë perëndimore donin që Austria t'i përshtatej logjikës

¹⁴ Krahaso: Dr. Stratmann K-Peter: *Schriftliche Stellungnahme, Në: Biehle Alfred (Pub.), Alternative Strategien, Shtëpia Botuese Bernard & Graefe, Koblenz 1986, Fq.57-63*

¹⁵ Mundësia e fundit

¹⁶ Shtete të tilla ishin Shqipëria, Austria, Zvicra etj.

¹⁷ Krahaso: Münkler, Herfried: *Krieg. Në: Göhler, Gehrhard/Iser, Mathias/Kerner, Ina (Pub.): Politische Theorie. 22 umkämpfte Begriffe zur Einführung, Wiesbaden 2004 Fq. 235*

¹⁸ Si shembull është zgjedhur Austria pasi Shqipëria është tepër e njohur.

perëndimore të demokracisë, ndërsa sovjetikët donin të rrënjosnin në Austri demokracinë popullore, sipas modelit të tyre. Këto diskutime ishin tepër të rëndësishme për pavarësinë e Austrisë. Nga këto diskutime lindi një nga parimet bazë më të rëndësishme të Kushtetutës Austriake të vitit 1955¹⁹. Pavarësia e Austrisë u njoh nga të dy kampet por vetëm në rast se ky shtet do të ishte neutral. Kështu në 26 tetor 1955 Parlamenti austriak miratoi ligjin e neutralitetit të përhershëm të Austrisë. Ky ligj do të luante më vonë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e taktikave të reja.

E parë nga ana strategjike Austria deri në vitin 1968 nuk ishte një vend i rëndësishëm. Me të vërtetë Austria shtrihej në vijën e demarkacionit midis lindjes dhe perëndimit, por pozicioni i Austrisë nuk përbënte një interes të veçantë në planet e të dyja palëve. Austria mori rëndësi vetëm mbas së ashtuquajturës “Pranvera e Pragës” (pushtimi i Çekisë nga trupat e Traktatit të Varshavës).

Në këtë kohë Austria papritur u ndodh për NATO-n në një krah i cili kërcënohej, ndërsa për forcat e Traktatit të Varshavës në një zonë e cila përbënte një mundësi të mirë sulmi.²⁰ Në këtë situatë të ndryshuar të sigurisë në vend, Austrisë i duhej të përgatiste një koncept të ri të strategjisë së mbrojtjes, e cila duhej të merrte parasysh neutralitetin e saj. Në vitet 70 në Austri mbizotëronin debatet mbi mbrojtjen e vendit nga një armik, përmasat e të cilit nuk ishin në proporcion me forcat që ky vend kishte në dispozicion (psh. Traktati i Varshavës).

Taktika e re e luftimit

Sic u ilustrua më lart, Austria në vitet 70 ndodhej në një situatë tepër të tensionuar. Në një kohë e cila mbizotërohej nga dualizmi dhe fuqitë bërthamore, asaj i duhej të ruante neutralitetin dhe njëkohësisht të ishte në gjendje me forcat e pakta që kishte në dispozicion, të mbronte kufijtë territoriale kundër një armiku të fuqishëm, i cili kishte dhe mundësinë e përdorimit të armëve bërthamore.²¹ Në Austri ekzistonte mosbesim për një forcë statike, prandaj në politikën e sigurimit të Austrisë së vitetve 70 ishte i detyrueshëm një ndryshim rrënjësor. Kjo vinte ndër të tjera dhe për arsye të zhvillimeve historike Ky ndryshim duhej të parashikonte një zgjidhje në lidhje me mbrojtjen e vendit si nga ana ideologjike dhe kushtetuese por duhet të ishte dhe i aplikueshëm. Çfarë mund të ishte më e përshtatshme në këto kushte se një luftë partizane.²²?! Kjo luftë (siç është parashikuar nga Mao Tse-tung) nuk ka nevojë për shumë burime në personel dhe teknikë dhe është e vetmja zgjidhje për një armik tepër të madh.²³

¹⁹ Krahaso: König, Ernst: Österreich – ein Beispiel? Në: Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? botimi 1, Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden 2004, Fq. 134

²⁰ Krahaso: Po aty Fq. 135-136

²¹ Krahaso: Spannocchi, Emil/Von Weizsäcker, Carl Fridrich/Brossollet, Guy: Verteidigung ohne Schlacht, Carl Hanser Verlag, Mynih 1976, FQ. 39

²² Megjithë se thuhej shpesh që taktika e re nuk ishte luftë partizane, gjithcka tregon se kjo lloj taktike të paktën është shumë e ngjashme me luftën partizane.

²³ Shih pjesën 2.2

Taktika e re e mbrojtjes në hapësirë²⁴ synonte në shfrytëzimin e elementëve që armiku nuk i zotëron (psh. mbështetjen nga popullsia, kohën, shfrytëzimin e terrenit etj.).²⁵ Nëpërmjet një luftime me tre faza, FA Austriake me shumë njësi tepër të vogla si fillim synonin mbijetesën e njësisve. Në fazën e dytë synohej pozicionimi dhe mbrojtja e njësisve duke shmangur një betejë vendimtare, dhe në fazën e tretë do të vendosej baraspeshimi i forcave dhe përgatitja për një kundërofensivë. Lufta me njësi tepër të vogla i bënte jo ekonomike sulmet me Forca Ajrore apo me armë bërthamore. Njësitë e vogla nuk janë një objektiv i përshtatshëm për Forcat Ajrore nëse bëhet një llogari mbi dobinë dhe koston e këtyre sulmeve. Qëllimi i kësaj luftime nuk është të qënit kudo prezent në mënyrë të fuqishme. Mbrojtja e tërë territorit, do të ishte e pamundur duke parë forcat dhe teknikën që Austria kishte në dispozicion. Një zgjidhje të këtij problemi ofronin të ashtuquajturat “zonat kyçe”. Austria u nda në 11 “zona kyçe” secila prej të cilave kishte një thellësi prej 1500 – 3000 km. Krijimi i këtyre zonave kishte për qëllim krijimin e hapësirave në të cilat mund të lëvizeshin duke lëshuar dhe marrë territor, duke parashikuar kështu një luftë të lëvizshme në hapësirë. Në ndryshim nga lufta partizane, në betejat e bëra në këtë kuadër duhet të zbatoheshin parimet e të drejtës së popujve.

Nëse përmbledhen të gjitha veçantitë e kësaj lloji luftime mund të arrijmë në përfundim se ajo mund të futet në llojet e “Luftës Asimetrike”. Tipare si; *Grupe të vogla luftarake, sigurimi i mbështetjes nga populli, mungesa e betejave frontale dhe përdorimi në mënyrë masive i hapësirës, të çojnë në përfundimin që kjo luftë është “Luftë Asimetrike”*. I vetmi ndryshim nga lufta partizane, është njohja dhe zbatimi i parimeve të së drejtës së popujve.²⁶

Problemi i terrorizmit (nën shembullin e Gjermanisë)

Pas 11 Shtatorit 2001 terrorizmi u bë forma më e diskutuar e luftës asimetrike. Sigurisht që nuk mund të themi që nuk ka pasur terrorizëm para 11 Shtatorit. Por si u luftua terrorizmi para 11 shtatorit 2001 dhe a i përket lufta kundër terrorizmit para 11 shtatorit “Luftës Asimetrike? Këto janë çështje të cilat do të trajtohen në këtë pjesë të artikullit. Një rast i veçantë i cili mund të shqyrtohet në këtë kuadër është Gjermania. Një grup terrorist i cili operonte në Gjermani ishte Fraksioni i Ushtrisë së Kuqe (RAF). Lufta kundër kësaj organizate do të trajtohet në këtë pjesë.

Lufta kundër terrorizmit në Gjermani (një vështrim juridik)

Para se të trajtohen diskutimet e viteve 70 në Gjermani në lidhje me terrorizmin është e nevojshme trajtimi i “luftës kundër terrorizmit” nga ana ligjore. A mund të ndërhyjnë FA brenda vendit për të luftuar terrorizmin? Kjo pyetje ka luajtur dhe luan ende në gjermani një rol të rëndësishëm.

E drejta dhe terrorizmi në Gjermani

Siç u përmend më lart, me luftën asimetrike përveç të tjerave kuptohet dhe lufta në të

²⁵ Krahaso: König, Ernst: *Österreich-ein Beispiel? Nö Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung- ein neues Phänomen der Internationalen Politik? botimi 1, Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden 2004, Fq. 136-137*

²⁶ Krahaso: König, Ernst: *Österreich – ein Beispiel? N Schröfl, Josef/ Pankratz, Thomas(Pub.): Asymmetrische Kriegsführung -ein neues Phänomen der Internationalen Politik? botimi 1, Nomos Verlagsgesellschaft, Baden-Baden 2004, Fq. 141*

cilën palët në konflikt janë që në fillim jo të barabarta, si psh, kur grupe të ndryshme të popullatës luftojnë kundër ushtrive profesioniste (lufta kundër terrorizmit).²⁷ Në këtë kontekst një nga shtetet të cilit ka pasur probleme me grupe terroriste në vitet 70 është Gjermania. Në debatet e viteve 70 diskutohej mbi mundësinë e luftimit të këtyre grupeve duke përdorur FA, gjë e cila do të çonte në të ashtuquajturën luftë asimetrike. Por a ishte e mundur ndërhyrja e FA për të luftuar terrorizmin nga ana ligjore në këtë shtet dhe nëse jo përse?

Çuditërisht në literaturën gjermane nuk mund të gjesh një përkufizim preciz mbi terrorizmin. Më tepër në të gjen karakteristika nëpërmjet të cilave ai dallohet si psh; vrasje, vepra që kufizojnë lirinë dhe që rrezikojnë jetën e njeriut etj.²⁸ Këto elementë gjenden në § 129a und 129b të kodit penal të Gjermanisë. Në këtë mënyrë terrorizmi në të drejtën gjermane përkufizohet nëpërmjet veprave penale që ë karakterizojnë atë, por jo nëpërmjet mënyrës së veprimit të terroristëve apo nëpërmjet qëllimeve të tyre. Sigurisht që përcaktime të tilla nuk janë të mjaftueshëm për arsye se është tepër ë vështirë që në këtë mënyrë ta ndash terrorizmin nga vepra të tjera penale.²⁹

Megjithatë ky argumentim mbi terrorizmin na bën të kuptojmë, që një akt terrorist shihet në të drejtën gjermane si një formë e kriminalitetit të brendshëm dhe si e tillë bie nën përgjegjësinë e policisë dhe jo të forcave të armatosura.

Historia e misioneve të FA gjermane brenda vendit

Historia e Gjermanisë dhe sidomos Lufta e Dytë Botërore kanë lënë gjurmë të fuqishme në krijimin e kushtetutës së Republikës Federale Gjermane të krijuar pas 1945. Sidomos gjatë republikës së Weimar-it si dhe të Reich-ut të tretë Forcat e Armatosura u keqpërdorën, për të përmbushur interesat politike të partive dhe personave të veçantë. Në perandorinë e Wilhelm-it, Forcat e Armatosura u përdorën shpesh për të shtypur grevat e punëtorëve. Paria ushtarake që ishte rekrutuar nga ish ushtarakët e Prusisë dhe për rrjedhojë kishte marrë një pjesë të mirë të traditave të saj, luante dhe në politikën e brendshme dhe të jashtme të Gjermanisë, një rrol të jashtëzakonshëm. Kjo ishte njëra nga arsyet të cilat çuan në reduktimin masiv të Forcave të Armatosura gjermane nga fuqitë fituese mbas Luftës së Parë Botërore.

Trupat SA dhe SS të Hitlerit kishin lidhje të forta me politikën dhe aparatin ushtarak. Ata arritën nëpërmjet terrorit dhe dhunës të kontrollonin tërë jetën publike në Gjermani. Mbas 2. gushtit 1934 Wehrmacht-i filloi të betohej mbi Hitlerin, kohë kjo e cila shënoi militarizimin e plotë të Gjermanisë. Shteti nazist arriti të forcohej dhe të shkatërronte

²⁴ Në fakt kjo ishte luftë asimetrike.

²⁷ Krahaso: Münkler, Herfried: *Krieg. Nē: Göhler, Gehrhard/Iser, Mathias/Kerner, Ina (Pub.): Politische Theorie. 22 unkämpfte Begriffe zur Einführung, Wiesbaden 2004 Fq. 235*

²⁸ Krahaso: Pieper, Stephan Nicolaus: *Aspekte të së drejtës ndërkombëtare në kuadër të luftës kundër Terrorizmit, Mynih.2004 (Dissertation graden akademike Dr.rer.pol, prane Universitetit te Bundeswehrit Mynih), Fq. 25*

²⁹ Krahaso: Mager, Christoph: *Lufta kundër Terrorizmit mes lirisë dhe sigurisë, (Instituti Lorenz-von-Stein për shkencat e administratës prane Universitetit Christian-Albrecht Kiel), Dokumenti Nr. 73, Kiel 2005, Fq. 19-20*

lëvizjet punëtore vetëm nëpërmjet përdorimit të dhunës ushtarake brenda vendit. Për arsye të keqpërdorimit të FA në historinë gjermane, u pa ndërhyrja e FA brenda vendit si dhe rritja e pushtetit të tyre, si një rrezik për demokracinë gjermane pas vitit 1945. Përsëritja e situatave të tilla duhej të shmangej me çdo kusht.³⁰ Për këtë arsye u krijuan në kushtetutën gjermane kufij të fortë ligjor, që lejojnë përdorimin e FA brenda vendit vetëm në raste të caktuara. Gjithashtu duhet thënë që kushtetuta gjermane përcakton një ndarje strikte ndërmjet pushtetit dhe kompetencave të FA dhe pushtetit e kompetencave të policisë,³¹ e cila ekziston ende.

Fraksioni i Ushtrisë së Kuqe (RAF)

Fraksioni i Ushtrisë së Kuqe u krijua më 1970 si rezultat i ideologjisë komuniste – Leniniste dhe revolucionare. Siç u përmend më lart³² në një luftë e cila prej nesh mund të përkufizohet si luftë asimetrike, Lenini sheh luftën civile. Ai i qëndron besnik ideve të luftës së klasave dhe në këtë mënyrë dëshiron organizimin e luftës brenda shoqërisë.³³

Nëpërmjet goditjeve terroriste dhe luftës së klasave, RAF përpiket ti drejtojë njerëzit drejt një revolucioni. Kjo organizatë e sheh veten në drejtim të kësaj lëvizje. Nëpërmjet goditjeve të shumta në pika të veçanta, RAF synonte të sulmonte aparatit shtetëror duke u përpjekur ta shkatërronte atë. Taktikat e përdorura ishin taktikat e luftës guerile.³⁴ Në vitet 70 kjo organizatë ka kryer goditje të ndryshme ku ja vlen të përmendet këtu vrasja e kryeprokurorit Buback më 7 prill 1977. Një ndër qëllimet kryesore të kësaj organizate ishte konfrontimi me FA. Ulrike Meinhof, e cila i përkiste krahut radikal të RAF, shprehej në një inçizim të këtyre viteve mbi nevojën e konfrontimit të armatosur, jo vetëm me policinë por me të gjithë njerëzit në uniformë, pra dhe me FA gjermane.

„Sigurisht që ne themi që policët janë derra, ne themi gjithashtu që çdo njeri që mban uniformë është i tillë, ai nuk është njeri dhe për këtë arsye ne duhet ta luftojmë atë. Kjo do të thotë që ne nuk diskutojmë me këta njerëz, dhe diskutimi me këta njerëz është i gabuar. Për pasojë e vetnija mundësi të merremi vesh me këta tipa është të qëllojmë mbi ta.”³⁵

Reaksionet e RFGJ

Pyetja e cila lind në këtë kontekst është:-A hyri RFGJ në një luftë asimetrike me këtë grup, apo grupe të tillë?

³⁰ Krahaso: Wieland, Joachim: Parime kushtetuese të ndërhyrjeve policore nga FA, në: Dieter Flek (Hrsg), Probleme juridike të FA në kuadër të luftës kundër terrorizmit, Forumi i Drejtimit të Brendshëm, Nr. 24, Nomos Verlagsgesellschaft, Baden Baden, 2004, fq 171-172

³¹ Krahaso: Wiefelspütz, Dieter: Siguria nga rrezikët e terrorizmit internacional nëpërmjet misionëve të FA, në: Dou, Klaus; A.Steinkan, Amin (Hrsg): Revista e re e së drejtës ushtarake, Nr 45, Berlin 2003, fq. 57

³² Krahaso: pjesën 2.2

³³ Krahaso: Spannouchi, Emil/Von Weizsäcker, Carl Fridrich, Brossollet, Guy: Ver teidigung ohne Schlacht, Carl Hanser Verlag, Mynih 1976, Fq.44-45

³⁴ Krahaso: Laqueur, Walter(Pub.): Zeugnisse politischer Gewalt. Dokumente zur Geschichte des Terrorismus, Athenäum Verlag, Frankfurt/M 1978, Fq. 141-143

³⁵ Cituar sipas: Lehman, Hans Georg: Deutschland- Chronik 1945-2000, Qendra Federale për Formim Politik, Bonn 2002, Fq. 229

Siç u përmend në pjesën 3.3.1 të kësaj artikulli, për RFGJ përdorimi i FA brenda vendit nuk ishte aspak i mundur. Nga ana juridike përdorimi i FA brenda vendit përveç rasteve të mbrojtjes së vendit në kuadër të nenit. 35. §2 fjalja 2 dhe 35. §3 i kushtetutës nuk ishte i mundur. Në këtë artikull nuk ishte parashikuar ndonjë mision me armë ushtarake. Përveç kësaj terrorizmi në gjermani është çështje e policisë.³⁶ Nga këto kufizime ligjore për RFGJ nuk ishte e mundur futja në një luftë asimetrike brenda vendit. Për këtë arsye me qëllim luftimin e kësaj organizate RFGJ përforcoi legjislacionin, ligjet kundër terrorizmit, si dhe bëri ndryshime në të drejtën penale, gjë e cila çoi në luftimin me sukses të kësaj organizate, pa pasur nevojë për ndërhyrjen e FA.

Përmbledhje

Siç është përmendur shpesh tashmë, lufta asimetrike është sot një ndër temat më të diskutuara në kuadër të sigurisë kombëtare. Strategjitë e sigurimit kombëtar siç përmendet shpesh herë në literaturë do ti përshtaten mbas 11 Shtatorit 2001, mjedisit të ashtuquajtur “të ri” të sigurisë të krijuar nga lufta asimetrike. Pyetja e cila duhej të analizohej gjatë këtij artikulli, është:

A janë këto luftëra (luftërat asimetrike) me të vërtetë kaq të reja siç thuhet në një pjesë të literaturës?!

Me qëllim përgjigjen e kësaj pyetje u shtjellua si fillim termi “luftë asimetrike”. Duke qenë se data 11 shtator 2001 është një datë simbol në këtë kuadër është bërë një ndarje midis luftës asimetrike para dhe pas kësaj date. Si përfundim mundëm të përcaktonim që me termin “luftë asimetrike” nuk nënkuptohet vetëm lufta kundër terrorizmit. Kemi të bëjmë me luftë asimetrike kur në mes të palëve në konflikt ekziston një pabarazi që në momentet e para të konfliktit, si psh. në rastet kur grupe të ndryshme të popullatës luftojnë kundër ushtrive profesioniste, apo pala më e dobët në një konflikt simetrik përdor metoda asimetrike, si psh hapja e një lufte partizane mbas shkatërrimit të ushtrisë së rregullt në fushën e betejës.³⁷

Mbi këtë bazë teorike, mundën të analizoheshin diskutimet mbi tre fenomene të përfshira nën këtë term.

Zhvillimi i armëve bërthamore sipas kuptimit të sotshëm duket se nuk ka të bëjë aspak me luftën asimetrike. Por në një kohë në të cilën armët bërthamore përbënin ndryshimin mes fuqive si dhe detyronin përdorimin e taktikave të reja për shmangien e një sulmi bërthamor, lufta bërthamore të paktën përbën një bazë diskutimi për përfshirjen e saj në luftën asimetrike. Në këtë kuptim, një konflikt mund të jetë asimetrik, nëse njëra nga palët zotëron armë bërthamore. Ekzistenca e këtyre armëve ka çuar dhe në ndryshimin e strategjive të sigurimit të kampeve (si psh „Flexible Response” në vend të „Massive Retaliation”) dhe të shteteve të veçantë (si psh. Austria).

Në kampin perëndimor monopoli i armëve bërthamore zotërohej nga SHBA. Megjithëse SHBA i dha vendeve të tjera garancinë bërthamore, kjo garanci nuk mjaftonte. Nuk mund të trembësh një kundërshtar me një armë që nuk e disponon.

³⁶ Krahaso: Pjesa 3.3.1.1

³⁷ Krahaso: Münkler, Herfried: *Krieg. Nö: Göhler, Gehrhard/Iser, Mathias/Kerner, Ina (Pub.): Politische Theorie. 22 umkämpfte Begriffe zur Einführung, Wiesbaden 2004 Fq. 235*

Koncepti “Flexible Response” bazohej mbi një strategji të luftës asimetrike. Synimi ishte mospërdorimi i armëve bërthamore duke u përpjekur të shmangej asimetria e cila ekzistonte në lidhje me armët bërthamore midis NATO-s dhe Traktatit të Varshavës.

Moszotërimi i armëve bërthamore dhe pamundësia e Austrisë për të mbrojtur kufijtë e saj territorial në një luftë klasike, e detyroi këtë vend të përgatiste një doktrinë të mbrojtjes, të ndryshme nga ajo e luftës klasike. Për arsye të neutralitetit të saj, Austria nuk mund të kishte ndihmën e asnjërit prej kampeve, në rast të një invazioni të mundshëm. A mund të futej taktika e re e krijuar nga ky shtet në bllokun e “luftërave asimetrike”?! Dallime të tilla si; përdorimi i grupeve të vogla luftarake, mbështetje nga popullsia, shmangja e betejave frontale dhe përdorimi në mënyrë masive i hapësirës, të bëjnë të mendosh për një luftë asimetrike. I vetmi ndryshim nga një luftë partizane, është njohja dhe ruajtja e parimeve të së drejtës së popujve.³⁸

Problemi i terrorizmit u trajtua duke marrë si shembull diskutimet në Republikën Federale Gjermane. Një nga grupet e njohura terroriste ishte RAF (Fronti i Ushtrisë së Kuqe). Synimi i RAF ishte rrëzimi i regjimit kapitalist në gjermani dhe futja e sistemit komunist. Kjo duhej të arrihej nëpërmjet goditjeve terroriste dhe nxitja për një luftë klasash dhe një revolucion (të llojit Leninist), duke u përpjekur për arritjen e konfrontimit edhe me FA. Megjithatë duhet thënë që Gjermania nuk u përfshi në një luftë asimetrike, për arsye kushtetuese.

Referenca:

1. Schlichte, Klaus: Neue Kriege oder alte Thesen? Wirklichkeit und Repräsentation kriegerischer Gewalt in der Politikwissenschaft, Në: Geis, Anna (Pub.): Den Krieg überdenken. Kriegsbegriffe und Kriegstheorien in der Kontroverse, Schriftreihe der Sektion Politische Theorien und Ideengeschichte in der deutschen Vereinigung für Politische Wissenschaft, Bd. 6, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2006.
2. Mager, Christoph: Terrorismusbekämpfung zwischen Freiheit und Sicherheit, Arbeitspapier Nr. 73, Lorenz – von-Stein-Institut für Verwaltungswissenschaften an der Christian-Albrecht-Universität zu Kiel, 2005.
3. Münkler, Herfried: Krieg. Në: Göhler, Gehrhard/Iser, Mathias/Kerner, Ina (Pub.): Politische Theorie. 22 umkämpfte Begriffe zur Einführung, Wiesbaden 2004.
4. Pieper, Stephan Nicolaus: Völkerrechtliche Aspekte der internationalen Terrorismusbekämpfung, Dissertation zur Erlangung des akademischen Grades eines Dr.rer.pol, Universiteti i Bundeswehrit Mynih, 28.07.2004.
5. Wieland, Joachim: Verfassungsrechtliche Grundlagen polizeiähnlicher Einsätze der Bundeswehr, Në: Dieter Flek (Pub.), Rechtsfragen der Terrorismusbekämpfung durch Streitkräfte, Forum Innere Führung, Volum 24, Shtëpia botuese Nomos, Baden Baden, 2004.
6. A. Schmidl, Erwin: „Asymmetrische Kriege“ – Alte Wein in neuen Schläuchen? Në: Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues

³⁸ Krahaso: König, Ernst: Österreich-ein Beispiel? Në Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung-ein neues Phänomen der Internationalen Politik botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004, Fq. 141

- Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004.
7. W. Korkisch, Friedrich: Die amerikanische Sicht: Asymmetric Warfare. Në. Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004.
 8. Kasper, Christian: Neue Funktionen für Nuklearwaffen – Die Nuklearwaffe im asymmetrischen Konflikt. Në. Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004.
 9. Lohmann, Klaus-Peter: Zur Entwicklung der modernen Kriegsführung. Grundlegende Asymmetrien und eine mögliche Strategie. Në. Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004.
 10. Stupka Andreas: Kriegsgeschichte und klassische kriegstheoretische Betrachtungen zur asymmetrischen Kriegsführung. Në. Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Pub.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004.
 11. König, Ernst: Österreich – ein Beispiel? Në. Schröfl, Josef/Pankratz, Thomas (Hrsg.): Asymmetrische Kriegsführung – ein neues Phänomen der Internationalen Politik? Botimi 1, Shtëpia botuese Nomos, Baden – Baden 2004.
 12. Wiefelspütz, Dieter: Sicherheit vor den Gefahren des internationalen Terrorismus durch den Einsatz der Streitkräfte?, Në: Dou, Klaus/A.Steinkam, Armin (Pub.): Neue Zeitschrift für Wehrrecht, Volum 45, Berlin, 2003.
 13. Lehman, Hans Georg: Deutschland- Chronik 1945 – 2000, Bundeszentrale für politische Bildung, Bonn 2002.
 14. Dr. Stratmann K-Peter: Schriftliche Stellungnahme, Në: Biehle Alfred (Hrsg.), Alternative Strategien, Shtëpia Botuese Bernard & Graefe, Koblenz 1986.
 15. Waldmann, Peter: Terrorismus. Provokation der macht. Gerling Akademie Verlag, Mynih 1998.
 16. Haftendorn, Helga: Sicherheit und Entspannung. Zur Außenpolitik der Bundesrepublik Deutschland 1955 – 1982. 2. Auflage, Shtëpia Botuese Nomos, Baden – Baden 1986.
 17. Laqueur, Walter (Pub.): Zeugnisse politischer Gewalt. Dokumente zur Geschichte des Terrorismus, Shtëpia Botuese Athenäum, Frankfurt/M 1978.
 18. Von Weizsäcker, Carl Fridrich: Wege in der Gefahr. Eine Studie über Wirtschaft, Gesellschaft und Kriegsverhütung, Shtëpia Botuese Carl Hanser, Mynih 1976.

“Doktrina Bush”, parimet e politikës së re amerikane të sigurisë, pas 11 shtatorit 2001

Granit Zela
Pedagog/Përkthyes i Sektorit me Shkrim,
QGJH, Akademia e Mbrojtjes

Abstrakt: *Pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001 ndaj Shteteve të Bashkuara të Amerikës, presidenti Xhorxh W. Bush u angazhua në krijimin e një “arkitekture sigurie” dhe riformësimit të marrëdhënies së hiperfuqisë amerikane me aktorët global në skenën e marrëdhënies ndërkombëtare. Kjo arkitekturë e re sigurie do të mishërohej në “Strategjinë Kombëtare të Sigurisë së Shteteve të Bashkuara” (2000).*

Kjo strategji e sigurisë ngjalli një debat të madh në shkallë planetare rreth projektimit të fuqisë amerikane dhe ripërcaktimit të rolit të saj në botë. Ajo do të mishërohej në katër parimet kryesore të “Doktrinës Bush”: lufta parandaluese, lufta paraprake, unilateralizmi dhe parimi i përhapjes së demokracisë me anë të ndryshimit të regjimit, parime të cilat paralajmëruan luftën në Afganistan dhe Irak, si dhe qëndrimin unilateral të SHBA ndaj organizatave ndërkombëtare dhe një politikë të re të sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës.

Hyrje

Sulmet terroriste të 11 Shtatorit në mënyrë të padiskutueshme krijuan një erë të re në çështjet ndërkombëtare të sigurisë. Megjithëse terrorizmi ka qenë një tipar i dukshëm i kushteve globale të pjesës më të madhe të gjysmës së dytë të shekullit të kaluar, këto operacione (sulmet e 11 Shtatorit) ishin të ndryshme nga ana sasiore dhe cilësore nga ato të së kaluarës.¹ Presidenti Bush u përball me një sulm konkret, jo hipotetik, në tokën amerikane që përfshinte vrasjen në masë në një shkallë të paprecedent, tetë muaj pas inaugurimit të tij si presidenti i 43 i Shteteve të Bashkuara të Amerikës. Si asnjë prej paraardhësve të vet, Presidenti Bush u përball jo me sulmin e një shteti por të një armiku me koka hidre, vetëm në mënyrë rudimentare me bazë territoriale-një organizim hierarkik gjysmëkorporate me struktura celulash të shpërndara dhe financa të lëvizshme-një” mishërim i përsosur i globalizimit.”²

Pas 11 Shtatorit, mendimi strategjik amerikan u mishërua në *Doktrinën Bush*, e cila ishte kundërpërgjigje ndaj sulmeve terroriste dhe ngjalli debatet më të mëdha pas Luftës së Ftohtë. Për një komb që pati suksese pothuajse të përhershme ekonomike dhe ushtarake

që nga vitit 1991 deri në 2001, tronditja e 11 shtatorit ishte e madhe. Sulmet ishin më të rëndat që prej vitit 1812, shumë më të fuqishme në sytë e publikut, për shkak të "Efektit CNN".³ Ndikimi psikologjik dhe politik i sulmeve çoi në deklarimin e menjëhershëm të luftës ndaj terrorizmit si shtylla kryesore e politikës amerikane të sigurisë.

Në 20 shtator 2001, në fjalën e mbajtur para dy dhomave të Kongresit, presidenti Bush e formuloi një parim të rëndësishëm të doktrinës së tij duke deklaruar që "*çdo vend, në çdo rajon, tani duhet të marrë në vendim, ose të jenë me ne, ose të jenë me terroristët. Duke nisur nga kjo ditë dhe më pas, çdo komb që vazhdon të strehojë ose të mbështesë terrorizmin do të konsiderohet nga Shtetet e Bashkuara si një regjim armiqësor.*"⁴ Në agun e një mijëvjeçari të ri, Presidenti kishte shpallur, që Shtetet e Bashkuara e kishin rigjetur edhe një herë qëllimin e saj në marrëdhëniet ndërkombëtare.⁵

Deklarimi vjetor i strategjisë së sigurisë kombëtare amerikane nga presidenti dhe ekipi i tij i Sigurisë Kombëtare është pika orientuese studimore e cila përvijon bazat e strategjisë madhore amerikane e cila përcakton zhvillimet e rëndësishme të brendshme dhe ndërkombëtare të mëpasme të politikës që ndjek administrata amerikane. Parimet e politikës së re të sigurisë së SHBA-së pas sulmeve të 11 shtatorit u artikulojnë të plota në dokumentin "Strategjia Kombëtare e Sigurisë së Shteteve të Bashkuara të Amerikës" (më pas e referuar si "SKS" 2002) e cila shkaktoi kundërshti jashtëzakonisht të mëdha.

Dokumenti ndahet në nëntë kapituj, të cilët janë organizuar sipas temës më shumë sesa sipas kronologjisë. "SKS" fillon me një përmbledhje të sigurisë ndërkombëtare të SHBA-s. Kapitujt e tjerë trajtojnë promovimin e demokracisë (kapitulli VII), përmirësimin e rritjes ekonomike nëpërmjet tregut të lirë (VI) aspiratat për dinjtet njerëzor (III). Kapitujt IV (Puna me të tjerët për të përfunduar konfliktet rajonale) dhe kapitulli VIII (Zhvillimi i agjendës për veprim bashkëpunues me qendrat e tjera kryesore të fuqisë globale) theksojnë vlerën e bashkëpunimit në shpërndarjen e përgjegjësive të përbashkëta, sikurse rëndësinë e ndërtimit ose përforcimit të koalicioneve, në veçanti me NATO-n. Kapitulli i fundit (IX) trajton transformimin e institucioneve kombëtare të Amerikës për t'u përballur me kërcënimet e shekullit të 21.

Kapitujt më të rëndësishëm të SSK-së janë kapitujt III dhe V të titulluar "Forcimi i aleancave për të mposhtur terrorizmin global" dhe "Parandalimi i armiqve prej kërcënimit ndaj nesh, aleatëve dhe miqve tanë me armët e shkatërrimit në masë". Mes vendimeve të tjera të rëndësishme të politikës së jashtme, kapitujt e SSK-së, në kapitujt III dhe V, promovonin veprimin unilateral sikurse përdorimin paraprak të forcës për t'u përballur me këto dhe kërcënime të tjera ndaj sigurisë kombëtare. Kapitulli III i SSK-së është mbështetur në një fjalim që presidenti Bush e mbajti në Uashington D.C. në 14 shtator 2001.

Ndërsa pjesa e parë e Kapitullit III duket thjesht të ripërforcojë me vendosmëri politikën tradicionale të jashtme amerikane, pjesa tjetër, e cila merret me mjetet me të cilat organizatat terroriste si Al Qaeda të cilat duhet të zduken, shpërfaq një zhvendosje domethënëse nga politikat e mëparshme të frenimit dhe përmbajtjes. Duke iu referuar të drejtës së vetëmbrojtjes, Presidenti Bush mbronte pikëpamjen se një mbrojtje efektive të SHBA-së, njerëzve të saj dhe interesave kombëtare dhe ndërkombëtare, kërkonte identifikimin e kërcënimeve dhe shkatërrimin e tyre "para se ato të arrijnë kufijtë tanë". Kapitulli V, i cili merret kryesisht me kërcënimin prej *Armëve të Shkatërrimit në Masë*, kërcënimet gjatë

Luftës së Ftohtë dhe strategjitë e përbajtjes dhe “Shkatërrimit Reciprok të Sigurtë” strategji e përdorur dikur si mjet për t’u përballur me kërcënimin socialist.

“SKS (2002) ishte dokumenti më i rëndësishëm i sigurisë gjatë presidencës së Xhorxh W. Bushit, një koleksion i gjashtë fjalimeve të mbajtura nga presidenti ndërmjet datave 14 shtator 2001 dhe 1 korrik 2002. SKS (2002) paraqet në mënyrë të përmbledhur dhe të qartë një shprehje të *Doktrinës* në dimensionet e saj të shumëfishta ai asnjë botim i qeverisë amerikane që ka dashur të kodifikojë një qasje të gjerë të politikës së jashtme në një dokument të vetëm. Strategjia dukej të përbënte një ndarje të madhe me politikën që kishte përcaktuar qasjen e Amerikës ndaj çështjeve botërore përgjatë Luftës së Ftohtë dhe më pas.⁶

Parimi i parë: lufta parandaluese

Luftërat parandaluese mbështeten në përlogaritje afatgjata që lidhem me marrëdhëniet e fuqisë dhe janë tërheqëse për vende që janë në një pozitë dominuese dhe kërkojnë të ndalojnë ngritjen e një kundërshtari. Ajo ndërmerret për të ndalur një ngritje afat-gjatë në fuqinë e një armiku potencial.⁷ Lufta parandaluese është artikulluar së pari në vitet 1990-të nga Sekretari i Mbrojtjes, Uilliam J. Perri, dhe asistenti i atëhershëm i Sekretarit të Mbrojtjes për Politikën Ndërkombëtare të Sigurisë, Eshtën B. Karter. Sipas Karterit dhe Perri⁸, në librin e tyre “Mbrojtja Parandaluese: strategjia e mbrojtjes parandaluese” përvijohen në mënyrë hierarkike lloje të ndryshme kërcënimesh ndaj sigurisë së SHBA-së.

Kërcënimet e listës-A përshkruhen si kërcënimet të dukshme ushtarake, në shkallën e rrezikut që vinte prej ish-Bashkimit Sovjetik, që do të kërcënonte mbijetesën e Shteteve të Bashkuara. Strategjia e mbrojtjes parandaluese njeh pesë rreziqe që nëse shpërfillen ose keq-menaxhohen kanë potencialin për t’u bërë kërcënimet të listës-A: një Rusi kaotike, e paqëndrueshme, dhe potencialisht agresive; dalja jashtë kontrolli e arsenalit nuklear të Rusisë dhe shteteve të ish-Bashkimit Sovjetik gjë që do të çonte në përhapjen e arsenalit nuklear tek shtetet kriminal dhe ndër terroristë; një Kinë që ngrihet dhe potencialisht kundërshtar; përhapja e armëve të shkatërrimit në masë; dhe terrorizmit “katastrofik”. Kërcënimet ndaj interesave të SHBA-së, por jo domosdo ndaj mbijetesës së Amerikës, përbëjnë *rreziqe të listës -B* dhe përfshijnë rreziqe si në rastin e Gjirit Persik dhe Koresë së Veriut. *Lista e rreziqeve—C* përfshin kërcënimet që në mënyrë indirekte ndikojnë në sigurinë kombëtare të SHBA-së por që nuk kërcënojnë direkt interesat amerikane. *Kërcënimet e nivelit të tretë* përfshijnë konflikte si ai i Kosovës, Bosnjës, Somalisë, Ruandës dhe Haitit.

Mbrojtja parandaluese bën thirrje për të mbajtur një ushtri të fortë për t’u përballur me këto rreziqe të nivelit-B dhe-C ndërkohë që fokusohet kryesisht në nivelet e rreziqeve-A. Strategjia e mbrojtjes parandaluese mbështetet në një marrëdhënie të fortë ndërpersonale ndërmjet liderëve politikë dhe ushtarak dhe shfrytëzon dialogun jo-qeveritar të dyanshëm për të promovuar bashkëpunim ndërkombëtar dhe partnership sigurie. Kjo logjikë është e ngjashme me arsyetimin e përdorur për sulmin e SHBA-së në vitin 2003 ndaj Irakut. Administrata e Bushit deklaroi që programi i rifilluar nuklear i Irakut do ta kishte kërcënuar interesat e SHBA-së në Lindjen e Mesme dhe që Iraku do të sulmonte eventualisht territorin e SHBA-së. Shtetet e Bashkuara gjithashtu deklaruan që Iraku ishte në prag të përdorimit të armëve kimike dhe biologjike. Në bazë të këtyre kërcënimeve të afërta, Shtetet e Bashkuara sulmuan Irakun me një sulm paraprak në Mars 2003. Pas përmbysjes së regjimit

të diktatorit Sadam Husein, presidenti Bush më vonë mbronte idenë që lufta në Irak përligjej me faktin që Sadam Huseini mund të ishte vënë një ditë në gjendje të zhvillonte armë bërthamore. Mbështetur në këtë justifikim, pushtimi do të përbënte një luftë parandaluese.

Parimi i dytë: lufta paraprake

Sulmi paraprak ndërmerret për të parandaluar një kërcënim të dukshëm nga një forcë armiqësore.⁹ Lufta paraprake nënkupton një sulm të filluar në bazë të të fakteve të pakontestueshme që sulmi prej një armiku është i afërt me qëllim shmangien e sulmit dhe fitimin e një avantazhi strategjik kundrejt kërcënimit të afërt. Qëllimi kryesor i një sulmi paraprak është të fituarit e përparësisë së iniciativës së përdorimit në befasi të forcës ushtarake para se këtë ta bëjë kundërshtari. Një shembull tipik të sulmit paraprak përbën një sulm ndaj trupave armike të grumbulluara në kufirin e një shteti të gatshme për të vepruar.

Shembujt nga historia përfshijnë atë të vitit 1587, kur pirati anglez Sër Frensis Drejk, me urdhër të Mbretëreshës Elizabeta I, ndërmori një sulm paraprak për të shkatërruar armatën spanjolle të Mbretit Filipi II—të ndërkohë që ajo ishte akoma e ankoruar në portin spanjoll të Cádiz-it. Pushtimi i Prusisë prej Saksonisë dhe Bohemisë në vitin 1756-të ndërkohë që trupat austriake, ruse franceze po komplotonin për të sulmuar konsiderohet gjithashtu si sulm paraprak. Sulmi paraprak ishte gjithashtu një motiv i fortë që qëndronte pas nxitimit për të hyrë në luftë Gjermania, Rusia dhe Franca me shpërthimin e Luftës së Parë Botërore në vitin 1914-të, ndërhyrja kineze në Kore në vitin 1951, dhe sulmi i izraelit kundër Egjiptit,¹⁰ Sirisë, dhe forcave jordaneze që po grumbulloheshin në kufijtë e Izraelit në vitin 1967-të.

Sulmi paraprak është zhvilluar si koncept në politikën e jashtme amerikane gjatë presidencës së Xhorxh W. Bush. Ai foli për herë të parë për sulm paraprak në fjalimin e mbajtur në Akademinë Ushtarake Amerikane në Uest Point më 1, korrik 2002. Presidenti Bush në fjalimin e mbajtur në Uest Point në 1 Janar 2002 shpalli që doktrinat e Luftës së Ftohtë të frenimit dhe përmbajtjes ishin jashtë kohe dhe jo efektive pas sulmeve terroriste të 11 shtatorit 2001, në Qendrën Tregtare të Tregtisë dhe Pentagonon.

Bushi përshkroi një mjedis të ndryshuar ndërkombëtar ku kërcënimet duhej të eliminoheshin para se ato të kishin mundësinë të përbënin në mënyrë efektive një kërcënim. Para se të vihej në jetë SHBA (200) SHBA nuk ishte përfshirë më parë në një sulm paraprak ushtarak. Ajo nuk kishte sulmuar një vend tjetër para se të sulmohej më parë ose para se të sulmoheshin qytetarët amerikanë—vetëm me përjashtim të një rasti të vetëm. Lufta spanjolle-amerikane përfaqëson shembullin e vetëm kur SHBA nisi e para armiqësitë kundër Spanjës në vitin 1898-të me qëllim që të detyronte Spanjën t'i jepte pavarësinë Kubës. Ka studiues që argumentojnë që kriza e raketave në Kubë në vitin 1962 kishte gjithashtu elementë të sulmit paraprak, por që nuk përfshin aktualisht një sulm paraprak ushtarak nga SHBA.

SSK(2002) përvijonte një strategji të sulmit paraprak për të luftuar armët e shkatërrimit në masë, një kërcënim kundrejt të cilit presidenti binte dakord se duhej mbrojtur para se të ndodhte. Në këtë raport, presidenti shpalli që SHBA do të vepronte paraprakisht nëse perceptonte një kërcënim të dukshëm. Politika e luftës paraprake, do të thoshte që SHBA ose aleatët e saj mund të kërcënoheshin nga terroristët ose shtetet kriminale që janë të

angazhuar në prodhimin e armëve të shkatërrimit në masë. Pikëpamja që kërcënime të mëdha mund të pësojnë disfatë me anë të politikave të fuqishme, pjesë e të cilave lufta paraprake përbën një komponent të rëndësishëm të politikave të tilla mbrohej prej kësaj lufte.

Përkufizimi i sulmit paraprak në SKS është shumë i gjerë: Shtetet e Bashkuara nuk e ka përdorur për shumë kohë opsionin e aksionit paraprak për të luftuar një kërcënim real të sigurisë tonë kombëtare,¹¹ dhe duke pasur parasysh pasojat e rënda të mundshme të një politike iniciative kundër armiqve që përgatiten për të goditur të parët, “Shtetet e Bashkuara do të veprojnë, nëse është e nevojshme, paraprakisht.” “Duke pasur parasysh objektivat e shteteve kriminale dhe terroristëve, Shtetet e Bashkuara nuk mund të mbështeten më në një qëndrim reagues sikur në të kaluarën. Pamundësia për të frenuar një sulmues potencial, menjëhershmeria e kërcënimeve të sotme, dhe rëndësia e dëmit të mundshëm që mund të shkaktohet nga armët që zgjedhin të përdorin kundërshtarët tanë, nuk e lejojnë këtë opsion. Ne nuk mund të lejojmë që armiq të tanë të godasin të parët.”-shpallte SSK-ja.

Administrata e Bushit e vuri në zbatim doktrinën e sulmit paraprak në Irak pasi kishte deklaruar që Sadami kishte grumbulluar armë të shkatërrimit në masë dhe po zhvillonte programe të armëve bërthamore. Sekretari i Shtetit Pauell paraqiti provat për nevojën e çarmatimit të Sadam Huseinit para Këshillit të Sigurisë së Kombeve të Bashkuara në shkurt të vitit 2003. Sekretari i Shtetit e përshkroi Irakun si një kërcënim imediat për fqinjët e saj dhe SHBA-në.

Dallimi mes luftës parandaluese dhe sulmit paraprak

Lufta parandaluese dhe paraprake ndryshojnë në sigurinë e një sulmi. Ndërkohë që një luftë paraprake lidhet me rrezikun e një sulmi të dukshëm, lufta parandaluese ndodh pa ndonjë provokim ushtarak. Shtetet zakonisht e përligjin luftën parandaluese duke pretenduar që armiku mund të sulmojë në të ardhmen. Rrjedhimisht, një sulm parandalues është i nevojshëm në mënyrë që të parandalojë një pasojë më të rëndë në të ardhmen. Izraeli ndërmoi në sulm parandalues në një ndërtesë që mbante materiale bërthamore në Osirak të Irakut në vitin 1981 në një përpjekje për të parandaluar Irakun nga zhvillimi i kapaciteteve nukleare dhe kërcënimit të Izraelit në të ardhmen.

Gjatë Luftës së Ftohtë, zyrtarët e SHBA-së parashikuan sulme ndaj BS-së dhe Kinës para se ato të mund të zhvillonin kapacitete të fuqishme bërthamore. Lufta paraprake shpesh ngatërrohet me luftën parandaluese, dhe, në fakt, një vijë e hollë i ndan të dyja. Akademikët përkufizojnë ndryshimin mes luftës paraprake dhe parandaluese vetëm në varësi të kohës. Studiuesi Robert Xhervis, për shembull, e përkufizon sulmin paraprak si “një sulm kundër një kundërshtari që është në prag të sulmimit,” ndërsa sulmin parandalues si “një lëvizje për të parandaluar një kërcënim prej realizimit (formimit) të tij të plotë.”¹²

Sulmi parandalues zakonisht konsiderohet se dhuron të drejtën ndërkombëtare dhe nuk respekton kushtet e një lufte të drejtë, lufta paraprake rëndom mendohet që është më e pranueshme. Megjithatë disa vëzhgues *doktrina Bush* bën thirrje për sulme parandaluese më shumë se sa paraprake, rezultati final nuk ndryshon: Shtetet e Bashkuara do të veprojnë kundër rreziqeve që shfaqen para se ato të jenë formuar plotësisht. Sipas kësaj qasjeje, një

kundërshtar që nuk mund të frenohet dhe prej sulmeve të të cilit nuk mund të ketë mbrojtje duhet të ndalohet para se të fitojë kapacitetin për të dëmtuar.

Kjo është mënyra se si presidenti Bush e përkufizonte sulmin paraprak, i cili konsiderohet si mënyra e vetme e të qenit reagues përballë dy rreziqeve të reja serioze-terrorizmi dhe shtetet batakçinj. Ndërsa lufta e sulmit paraprak është legjitime në kuadrin e të drejtës ndërkombëtare, lufta parandaluese nuk është e tillë. Arsyet janë të dukshme: balanca mes shteteve ndryshon vazhdimisht dhe kësaj të lejosh luftën parandaluese do të krijonte mundësi për luftë të vazhdueshme. Për shembull, ekonomia kineze është aktualisht duke njohur një ngritje të shpejtë dhe kjo do të sjell edhe shtimin e fuqisë ushtarake të vendit. Në një fazë të caktuar në të ardhmen, Kina mund të ndjehet e fortë sa të kundërshtoj interesat e SHBA-së, por kjo nuk i jep të drejtën Uashingtonit për të sulmuar i pari Kinën.

Nga ana tjetër, një shtet nuk mund të rrijë të pres kot kur është në dijeni që forca armiqësore janë duke u përgatitur për të ndërmarrë një sulm brenda pak orësh ose ditësh.¹³ Megjithatë, administrata e Bushit argumentoi përhapja e armëve të shkatërrimit në masë e bën të nevojshme për Shtetet e Bashkuara të ndërmarr luftëra parandaluese dhe paraprake. Ajo çka Doktrina Bush quan sulm paraprak, megjithatë, në të vërtetë është sulm parandalues sepse kërkon që SHBA të veprojnë para se një kërcënim të jetë formuar plotësisht.

Parimi i unilateralizmit

Unilateralizmi është strategjia e politikës së jashtme sipas së cilës një shtet sovran zgjedh të ndjek interesat dhe objektivat e tij në rrafshin ndërkombëtar rreptësisht më vete dhe jo në bashkëpunim me shtete të tjera sovraane, organizatat ndërkombëtare, ose organizata jo-qeveritare. Unilateralizmi është një nga opsionet më të lehta të politikës së jashtme, sepse nuk kërkon diplomaci, nuk është e nevojshme të ndërtohet konsensus, apo mbështetjen multilaterale¹⁴. Në të njëjtën kohë, megjithatë, veprimet unilaterale shpesh ngjallin reagime të ashpra, zemërim ndërkombëtar, dhe akuza për iligjimitet.

Pas 11 shtatorit, 2001, administrata e Presidentit Xhorxh W. Bushit shpalli një zhvendosje të madhe në politikën e jashtme kur deklaronte që SHBA kishte të drejtën për të ndërmarrë veprime unilaterale kundër terrorizmit kur alternativa të pranueshme multilaterale nuk mund të gjenden. Bushi përqafoi strategji të hegjemonisë globale “jeni me ne ose me terroristët” që përbante parapëlqimin e Bushit për unilateralizmin.

Unilateralizmi i “Doktrinës Bush” u reflektua edhe në braktisjen e “Traktatit të Raketave Antibalistike” në vitin 1972, largimin nga Traktati i Kyoto-s, Gjykata Ndërkombëtare e Krimeve, largimin nga protokollin që vë në zbatim ndalimin e armëve biologjike dhe mosratifikimin e “Traktatit të Minave Tokësore të Otavas” (1999), dhe vendimin e saj për të rrëzuar regjimin e Sadam Huseinit në Irak në 2003 pavarësisht nga kundërshtimi i gjerë ndërkombëtar. Mbështetësit e unilateralizmit amerikan këmbëngulnin që SHBA kishte autoritetin legjitim të ndërmerrte çfarëdo veprimi që lidhej me mbrojtjen e sigurisë së saj.

Politika sipas së cilës “SHBA ka, dhe synon të mbajë forcën ushtarake të pasfidueshme”, e shprehur në SKS tregon që SHBA synonte të ndërmerrte veprime të nevojshme për të ruajtur statusin e saj si superfuqia e vetme ushtarake e botës. Sipas këtij dokumenti të sigurisë kombëtare amerikane, SHBA, si një fuqi hegjemonike, ka të drejtën të sillen ndryshe nga shtetet e tjera duke mbajtur një nivel të lartë shpenzimesh ushtarake që do të garantojë

supremacinë ushtarake amerikane. Ajo duhet mbrojtur supremacinë në politikën botërore në mënyrë që të ruaj paqen dhe stabilitetin në botë.

Parimi i përhapjes së demokracisë

Çdo administratë amerikane është motivuar në politikën e saj të jashtme nga bindja ideologjike se demokracia liberale është e vetmja formë legjitime e qeverisjes dhe se forma të tjera qeverisjeje nuk janë veçse tranzitore. Kjo ka bërë që Shtetet e Bashkuara të kenë qenë dhe të jenë gjithnjë të gatshme për të “mbështetur popujt e lirë që i rezistojnë shtypjes dhe nënshtrimit” (Herri Truman), “për të paguar çdo çmim dhe për të përballuar çdo barrë” në mbrojtje të lirisë (Xhon F. Kenedi), për të kërkuar “zgjerimin e demokracisë” në botë (Bill Klinton) dhe për të luftuar për t’i “dhënë fund tiranisë” (Xhorxh W. Bush).¹⁵

Mbështetja e këtyre vlerave është rrënjësore në traditën amerikane të paqes demokratike të presidentit Udrou Uillson, e cila gjeti jehonë edhe në dy dokumentet e sigurisë kombëtare së presidentit Klinton. Disa studiues e shohin këtë si elementin thelbësor të “Doktrinës Bush”. Ky koncept nënkupton që demokracia nuk është produkt i rrethanave të caktuara historike, por që mund të përhapet me anë të përmbysjes me forcë të diktatorëve. Kështu, mund të argumentohet që objektivi dhe synimi final i “Doktrinës Bush” ishte t’i bënte amerikanët më të sigurtë duke promovuar parimet demokratike në botë dhe duke përdorur forcën ushtarake nëse ishte e nevojshme.

Përpos përpjekjeve të demokratizimit në Irak dhe zonave të tjera të nxehta terroriste nëpër glob, administrata e Bushit i realizoi politikat e veta duke qenë pjesë integrale e Komunitetit të Demokracive (CD), një lëvizje transnacionale që nxit zhvillimin e demokracive me anë të Llogarisë së Sfidës së Mijëvjeçarit (MCA), një program në të cilin fondet e huaja të ndihmës lidhen direkt me përpjekjet e kombeve përfituese në fushat e qeverisjes demokratike, të drejtave të njeriut, dhe zhvillimit ekonomik.

Doktrina Bush synonte të promovonte demokracinë dhe lirinë kudo në glob si një mënyrë për të pasur një botë më paqësore. Sikurse presidenti Bush shprehet në fjalimin e tij në Uest Point, “ne dëshirojmë për të tjerët atë që dëshirojmë për vete-sigurinë nga dhuna, të mirat e lirisë, dhe shpresën për një jetë më të mirë.” Më shumë se asnjë President tjetër pas Luftës së Ftohtë, Presidenti Bush e ka përkufizuar sigurinë e kombit amerikan në termat e promovimit të lirisë nëpër botë. “Mbijetesa e lirisë në vendin tonë,” deklaroi ai në fjalimin e dytë inaugurues, “mbështetet gjithnjë e më shumë në suksesin e lirisë në vendet e tjera. Shpresa më e mirë në botën tonë është përhapja e lirisë në të gjithë botën.”¹⁶

Përfundime

11 shtatori paraqiti për neokonservatorët një seri mundësish për të çuar përpara objektivat e tyre, prioritetet, strategjitë dhe taktika që ato kishin mbrojtur për një kohë të gjatë. Duke e perceptuar veten si pasrendës të administratës së Trumanit në fillim të Luftës së Ftohtë, aktorët kryesorë të politikës së jashtme në administratën e Xhorxh Bushit të Ri e konsideruan botën e pas-11 shtatorit dhe rolin e Amerikës të jetë një pikë historike kthese e përmasave epokale.¹⁷

Ky ndryshim madhor në politikën e jashtme amerikane të pas 11 shtatorit, iu paraqit Kongresit si “Strategjia Kombëtare e Sigurisë” dokument që përmbante fjalimet e Presidentit Bush pas sulmeve terroriste dhe njihet si “Doktrina Bush”. Leximi që neokonservatorët

i bënë historisë amerikane përkrahte fort luftën parandaluese, sulmin paraprak, unilateralizmin dhe përhapjen e demokracive duke përmbysur regjimet tiranike.

Politika e re amerikane e sigurisë pas 11 shtatorit, zë fill në realitetin gjeopolitik të krijuar pas përfundimit të Luftës së Ftohtë, luftë pas së cilës SHBA doli superfuqia fituese e cila nuk mund të krahasohej me asnjë fuqi tjetër në rang global, dhe ishte rezultat i ardhjes në pushtet në neokonservatorëve republikanë të cilët kishin një qasje të re ndaj rolit të SHBA-së në botë. Neokonservatorët u angazhuan në krijimin e një “arkitekture sigurie” e cila u mishërua në dokumentin “Strategjia e Sigurisë Kombëtare të Shteteve të Bashkuara të Amerikës” (2002) e njohur si “Doktrina Bush” mbronte një politikë të sigurisë dhe të fuqisë ushtarake që kërkonte të siguronte epërsinë e SHBA-së si fuqia kryesore globale në shekullin XXI.

Referenca:

1. Michael M. Schmit, Counter-terrorism and the Use of Force in International Law, The Marshall Center Papers, No 5, 2003, fq.4, cituar nga Pajtim Ribaj “Terrorizmi sfidë e kohës, ndikimet e tij në mjediset e sigurimit, (Janar 2004, leksion).
2. John Gray, “Why Terrorism is Unbeatable”, New Statesman, fq. 50. 25, shkurt 2002.
3. Po aty fq.16.
4. <http://www.whitehouse.gov/news/releases/2005/01/20050120-1.html>.
5. Hal Brands: From Berlin to Baghdad: America's Search for Purpose in the Post-Cold War World, The University Press of Kentucky. 2008.
6. Melvyn P. Leffler dhe Jeffrey W. Legro, To lead the way: American strategy after Bush. Pëmbledhje me ese botuar nga Oxford University Press, fq. 2, 2008.
7. Robert J. Jackson Fletcher Jones dhe Philip Towle, Temptations of Power, The United States in Global Politics after 9/11. fq 104. Palgrave McMillian 2006.
8. Shih Ashton B. Carter, William J.Perry, Preventive Defense: A New Security Strategy for America, Stanford University, 1999.
9. Robert J. Jackson Fletcher Jones dhe Philip Towle Temptations of Power, The United States in Global Politics after 9/11., fq 104. Palgrave McMillian 2006.
10. Sulmi i Izraelit kundër forcave ajrore egjiptiane që filloi në vitin 1967 në luftën gjashtë-ditëshe ishte në mënyrë të përligjur sulm paraprak. Izraeli kishte arsye të kishte frikë që egjiptianët po përgatiteshin të sulmonin, duke e bërë sulmin e tyre një akt të nevojshëm vetë-mbrojtjeje. Bombardimi nga Izraeli i reaktorit nuklear të Irakut në Osirak në vitin 1981, megjithatë, nuk konsiderohet një sulm paraprak, sepse reaktori ishte në ndërtim e sipër dhe nuk përbënte një kërcënim të dukshëm.
11. http://www.au.af.mil/au/awc/awcgate/nss/nss_sep2002.pdf
12. Robert Jervis, Foreign Policy, Nëntor-Dhjetor 2002.
13. Robert J. Jackson Fletcher Jones dhe Philip Towle, “Temptations of Power, The United States in Global Politics after 9/11”. fq. 104. Palgrave McMillian 2006.
14. SHBA ka qenë një kontribues madhor në përpjekjet multilaterale dhe bilaterale (për shembull, ishte anëtar i Kartës së Kombeve të Bashkuara), megjithatë SHBA ka një histori të gjatë të angazhimit. Shembujt e Pas-Luftës së Dytë Botërore të unilateralizmit amerikan jashtë vendit përfshijnë invazionin e Gjirit të Derrave në Kubë (1961), të ashtuquajturën Luftën Sekrete në Laos (1960), ndërhyrjen në Granadë (1983), dhe ndërhyrjen në Panama (1989).

15. Fatos Tarifa, "Fati i një shekulli: hegjemonia amerikane, dilemat e Europës dhe sfidat e Azisë Lindore" fq. 73, Ombra GVG, Tiranë 2010.
16. <http://www.whitehouse.gov/news/releases/2005/01/20050120-1.html>.
17. Mary Buckley and Robert Singh, The Bush Doctrine and the War on Terrorism, Global responses, global consequences. fq. 16. 2006.

RUBRIKA E TRETË

ÇËSHITJE DIDAKTIKE, MËSIMORE DHE KULTURORE

Kjo rubrikë merret me trajtimin e çështjeve të veçanta në fushën e didaktikës, mësimdhënies dhe kulturës në mjediset ushtarake. Autorët e saj janë analistë, studiues dhe pedagogë të fushave përkatëse, të cilët shprehin aspekte të veçanta të ekspertizës së tyre.

Krahas disiplinës, rregullit dhe aspekteve të tjera që lidhen me rigozitetin e forcës tradicionale ushtarake, një nga aspektet kryesore të ushtrive të kohëve moderne, është edhe ndryshimi i mentalitetit për shumë çështje themelore të drejtimit, të mësimdhënies, të kulturës, etj.

Zhvillimi dhe konsolidimi i një force profesioniste, të bazuar më shumë në cilësitë se sa në numrat e saj, do të jetë një çështje qendrore e Revistës Ushtarake. Kjo forcë do të ketë një mentalitet, kulturë dhe performancë më të lartë se ajo e viteve më parë.

Si e tillë, revista mirëpret shkrime në interes të vlerave dhe një cilësie të re të forcës profesioniste dhe të konsolidimit të saj në periudhën afatmesme.

Integrimi i punës studimore në procesin mësimor, kërkesë e kohës

Nënkolonel ® Prof. As. Dr. Agron Agolli,
Punonjës pedagogjik e kërkimor në Akademinë e Mbrojtjes

Abstrakt: *Akademia e Mbrojtjes është një institucion më shumë se 50 vjeçar. Në harkun kohor të gjysmë shekullit, puna shkencore ka qenë pjesë përbërëse e misionit të saj. Por si ka ecur ajo në funksion të misioneve të reja, të evoluimit të strukturave akademike, të ndryshimit dhe transformimit të programeve të studimit, të përsosjes së formave të mësimdhënies, standardizimit të formave të kontrollit të dijeve, kërkesave të reja të integrimit për kualifikimin shkencor dhe klasifikimin e punonjësve pedagogjikë e kërkimorë, të kulturës së re të brendshme të cilësisë, të procesit të akreditimit?*

Le të përpiqemi të shpjegojmë, nëpërmjet këtij artikulli, këto e të tjera çështje që diskutohen e janë të pranishme në botën akademike ushtarake. Së pari, duke ngacmuar kujtesën historike të lidhshpimit ushtarak e më pas, nga këndvështrime analitike të realitetit, të ofrojmë përvijonin më të mirë për një konturim më cilësor të këtij problemi, në interes të detyrave dhe përgjegjësisë që ka Akademia për të qenë vizionare, eksperte e fushave që mbulon dhe në ballë të mendimit më të përparuar ushtarak të institucionit të Mbrojtjes.

Pak histori mbi kualifikimin shkencor

Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, qysh nga krijimi i saj si Akademi Ushtarake me *Vendim Nr. 381, datë 28.10.1961 të Këshillit të Ministrave*¹, mbi bazën e Shkollës së Lartë Ushtarake të 10 Majit 1958 dhe gjatë gjithë riorganizimeve në vijimësi, mësimdhënien e ka parë të lidhur me punën kërkimore. Është kjo arsyeja që puna shkencore qysh në fillimet e saj, ka qenë pjesë e misionit të Akademisë. Natyrisht, për periudhën 1958-1966, kur filluan të zbatoheshin programet e para 3 vjeçare, ajo që në hapat e saj të para, me kufizimet dhe vështirësitë e kohës. Vitet 1969 shënojnë për herë të parë organizimin edhe të veprimtarive me karakter kërkimor-shkencor, si diskutime e sesione shkencore.

Gjatë viteve 1970, puna shkencore mbështeti ndryshimet strukturore akademike që synonin rritjen e cilësisë së procesit mësimor, përmes kualifikimit të trupës mësimore si dhe të forcimit të kërkesave të përzgjedhjes e pranimit në Akademi. Përfshirja në programet e taktikës i temave të njësisë taktike, gërshetuar me stërvitjet e shtabit e të komando-shtabit

¹ *Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 381, datë 28.10.1961.*

apo edhe të stërvitjeve me trupa në terrene të ndryshme, rritën kërkesat për informacion dhe punë shkencore të pedagogëve që mbulonin këto lëndë. Në kohën e sistemit të ri më racional kohor (2 vjeçar), me veçoritë e viteve 1970, 1980 dhe 1990, kur u rrit në mënyrë të ndjeshme cilësia e programeve, planeve mësimore, metodologjia e mësimdhënies, kontrolli i sistemit të dijeve, kërkesat për një punë më të pavarur në zgjidhjen e situatave komplekse taktiko-operative e operative-strategjike në mjedise të ndryshme terreni, kërkonin të tjera konceptime e ritme edhe për punën kërkimore-shkencore.

Kërkesa të reja dhe nivele më të larta arriti integrimi i saj në procesin mësimor e më gjerë në nivel ushtrie, pas viteve 1979 e deri në vitet 2005, kur funksiononin kurset dyvjeçare të karrierës. Por duhet të themi se konfirmimi zyrtar i pranisë së punës shkencore, si pjesë e pandarë e veprimtarisë së Akademisë Ushtarake, u bë në fillim të vitit 1975, kohë në të cilën u krijua edhe *Dega Shkencore*². Më vonë, mbi këtë bazë, u ngrit edhe *Spektori i Studimeve Shkencore Ushtarake*, si strukturë më vete në këtë Institucion. Ky sektor, me një përbërje të plotë, ndërmori studime të mirëfillta në fushën e historisë ushtarake të popullit shqiptar si dhe punime të tjera për artin ushtarak të kohës.

Një pjesë e këtyre punimeve u botuan dhe u publikuan edhe në shkallë kombëtare. Kështu Spektori, jo vetëm krijoi një përvojë të mirë për punën studimore-shkencore, por u bë bazë edhe për një brez punonjësish kërkimorë, të vjetër e të rinj, të institucioneve të mbrojtjes, që tashmë janë shtuar e njihen nga të gjithë³. Natyrisht duke renditur këtë plejadë studiuesish ushtarakë, me grada e tituj akademikë apo edhe të tjerë që gjatë vitit 2010-2011, janë promovuar me titullin akademik “Docent”, si Ismet Tola, Agim Gjini, Kosta Jano, Shqiponjë Gjoliku, Selim Shiroka, Sami Neziri, Zija Bahja, Besnik Dobi, Jup Zenuni, nuk mund të lëmë pa përmendur me respekt punën kërkimore dhe arritjet e mjaft punonjësve shkencorë të Akademisë së asaj kohe si Bejto Isufi, Malo Harshova, Filip Tusha, Kiço Janku, Qebir Zeneli, Rustem Toro, Engjëllushe Sulaj, etj. që rrezatojnë si gurë të çmuar në themelitë e godinës së Punës Kërkimore-Shkencore ushtarake e cila rritet e lartohet çdo ditë.

Mbas viteve 1969, format e punës kërkimore shkencore janë shtuar, janë bërë më të larmishme, më cilësore e funksionale si dhe më produktive, në interes të misionit të

² Gazeta “Ushtria”, viti 1998, faqe Nr. 5.

³ Dr. Refik Kucaj, Prof. Dr. Hasan Çipuri, Prof. Dr. Shahin Leka, Prof. Dr. Adem Çopani, Prof. Dr. Shamet Shabani, Prof. Dr. Proletar Hasani, Prof. Dr. Kostaq Karoli, Dr. Arjan Qirjako, Dr. Ilia Vasho, Dr. Vangjel Kasapi, Dr. Dajlan Omeri, Dr. Avni Hajro, Dr. Myzafer Bonaj, Dr. Virgijl Janku, Dr. Petrit Mamaj, Dr. Taqo Trajçe. Dr. Miti Gollosi, Prof. Dr. Pëllumb Danaj, Prof. Dr. Bektash Kolasi, Prof. Dr. Ruzhdi Gjataja, Prof. Naim Limaj, Prof. Elmas Leci, Prof. Asoc. Pjetër Hidri, Prof. Asoc. Kujtim Hasani, Dr. Shyqyri Kondi, Dr. Mehmet Musaj, Dr. Tigër Godo, Dr. Xhelal Martini, Prof. Asoc. Dr. Agron Agolli, Dr. Sihat Gjonmema, Dr. Bujar Rama, Prof. Asoc. Dr. Fuat Spahiu, Prof. Asoc. Dr. Kristaq Xharo, As. Prof. Dr. Elmas Zejnati, As. Prof. Dr. Lulzim Bllaka, Prof. Dr. Pajtim Ribaj, Dr. Kudret Mita, Dr. Flamur Skraparlliu, Dr. Vladimir Poçari, Dr. Pandeli Stoja, Dr. Veri Merko, Dr. Harallaq Stoja, Dr. Çapajev File, Dr. Fatmir Basholli, Prof. Asoc. Dr. Agim Lala, Prof. Asoc. Dr. Arshi Çela, Dr. Qetsor Orhani, Dr. Zana Xhuka, Dr. Halil Hyseni, Dr. Kudret Çela, Dr. Idriz Haxhiaj, Dr. Luan Hoxha, Prof. Asoc. Dr. Bernard Zotaj, Prof. Asoc. Dr. Mustafë Xhemali, Dr. Edmond Braneshi, Dr. Simon Gega, Dr. Abaz Lleshi, Dr. Gëzim Mustafaj, Prof. Asoc. Dr. Zaho Golemi, Dr. Ulsi Meta, Dr. Baki Bala, Dr. Hekuran Rrapi, Dr. Skënder Kadiu, Dr. Çlirim Toci, Prof. Asoc. Dava Vorfi, Dr. Gëzim Mustafaj, Dr. Abaz Lleshi, Dr. Bardhyl Kollçaku, Dr. Hysen Cekodhima, Dr. Kujtim Rustemi, Dr. Kristaq Gerverni e të tjerë.

Akademisë. Vlerësimi i parë që iu është bërë ushtarakëve, në fushën e shkencës, *me VKM Nr. 200, datë 30.07.1979*, ishte dhënia e titujve shkencorë për: Mendu Backa (xhenier), Profesor; Spiro Adhami (gjitharmësh), Profesor; Abedin Galanxhi (xhenier), Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor; Alfred Moisiu (xhenier), Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor; Arjan Qirjako (artiljer), Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor si dhe Gaqo Pojani (armatim-municion), Bashkëpunëtor i Vjetër Shkencor.

Këto kuadro janë dalluar për veprimtarinë shkencore, sipas fushave përkatëse, duke botuar artikuj dhe libra të ndryshëm, në interes të procesit mësimor dhe Forcave të Armatosura.

Nga fundi i viteve 1970, u bënë përpjekjet e para që edhe në Akademinë Ushtarake të bëheshin kualifikimet pasuniversitare. Duhej *Udhëzimi Nr. 07, datë 23.10.1973*⁴ “Mbi mënyrën e dhënies së gradave dhe titujve shkencorë”, i Këshillit të Ministrave, që Akademia Ushtarake “Mehmet Shehu” të përcaktohej dhe përfshihej nga Komisioni i Lartë i Atestimit, në radhën e Institucioneve të Larta Arsimore e të Kërkimit Shkencor, njëherazi edhe si qendra e vetme e ushtrisë ku do të realizohej Kualifikimi Pasuniversitar për mbrojtjen e disertacioneve për gradën “Kandidat i Shkencave” (sot “Doktor i Shkencave”). Më saktë, regjistrimi për kualifikimin shkencor pasuniversitar ka filluar qysh në vitin 1979 dhe mbrojtja e parë është bërë më 18.12.1982 nga Zoti Refik Kucaj. Gjithsej, nga 18.12.1982 e deri më 17.03.2003, janë mbrojtur 78 disertacione (vetëm në fushën e mbrojtjes), tematika e të cilave ka lidhje me rreth 18 specialitete⁵:

Me Ligjin Nr 9120, datë 28.7.2003⁶ “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin Nr. 8461, datë 25.2.1999, “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë” e në vazhdim, për mbrojtjen e doktoraturave u shtua edhe Fusha e Sigurisë, e cila vazhdon edhe sot. Neni 10, pika 1 e këtij ligji shprehet qartë se DSTHP, zëvendësohet me “Master” dhe pika 2, “Studimet për të marrë diplomën e shkollës pasuniversitare dhe për doktoraturë në fushën e mbrojtjes dhe të sigurisë kryhen në Akademinë e Mbrojtjes”. Për periudhën 2004-2011, vetëm me tematikë nga fusha e sigurisë, janë mbrojtur rreth 17 disertacione.

Nëse i llogaritim, për periudhën 1982-2011, në Akademinë e Mbrojtjes, në të dyja fushat e përcaktuara të Mbrojtjes dhe të Sigurisë, janë mbrojtur 108 disertacione. Në këtë numër nuk përfshihen ushtarakët e tjerë që kanë mbrojtur doktoraturat në fushën e mjekësisë apo fusha të tjera, pranë Institucioneve të Arsimit të Lartë të vendit. Ka rëndësi të theksohet se edhe më parë dëshira ka qene e madhe për kualifikime të tilla, por jo kushdo mund të regjistrohej e të fitonte të drejtën. Nisur nga fakti se edhe sot, shpesh, njerëzit që fillojnë të aplikojnë për të vazhduar këtë program studimi, i cili i përket ciklit të tretë, pyesin dhe duan të dinë më shumë kuriozitete e përvojë, le të sqarojmë disa prej tyre se mund t’iu shërbejnë:

⁴ *Udhëzimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 07, datë 23.10.1973.*

⁵ *Taktikën e këmbësorisë, Taktikën e Forcave Detare, Taktikën e Forcave Ajrore, Taktikën e përdorimit të tankeve, Përdorimin e artilerisë kundërajrore, Përdorimin e artilerisë tokësore, Përdorimin e armës së xhenios, Përdorimin e armës së kimisë, Problemet e terminologjisë ushtarake, Problemet e zbulimit dhe informacionit, Shërbimin e ndërlihdjes, Shërbimin e prapavijës, Shërbimin e topografisë, Përdorimin e FVVP, Përgatitjen fiziko-ushtarake, Historinë e Artit Ushtarak, të Ushtrive të Huaja, të Armatim-Mu nicionit.*

⁶ *Ligji Nr 9120, datë 28.7.2003 “Për disa shtesa dhe ndryshime” në ligjin Nr. 8461, datë 25.2.1999 “Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë”.*

Zakonisht temat studimore janë përzgjedhur nga Komandat Kryesore të llojit të Forcave, Drejtoritë e Shtabit të Përgjithshëm e struktura të tjera, sipas nevojave të tyre. Në Akademinë e Mbrojtjes, sugjerimet i bënin katedrat dhe më vonë departamentet. Prurjet e strukturës së vet, si rregull, Akademia, deri në vitin 2006, i ka diskutuar dhe vendosur në Këshillin Shkencor të saj. Pastaj kërkesat e komandave të forcave dhe institucioneve të tjera ushtarake dërgoheshin në Sektorin Shkencor të Shtabit të Përgjithshëm. Shtabi i Përgjithshëm i miratonte dhe iua dërgonte strukturave vartëse, me prioritet Akademinë e Mbrojtjes, ku edhe do të realizoheshin këto projekte studimi.

Kandidatët, që plotësonin kushtet ligjore, bënin kërkesë dhe përzgjidhnin temën studimore e cila, si rregull, pas miratimit (në Akademi nga Këshilli Shkencor), iu drejtohej departamenteve, në të cilët diskutohej përshtatja, vlera e temës, prirjet, cilësitë dhe garancia e punimit shkencor prej disertantit/kandidatit. Fituesit, e dalë nga përzgjedhja dhe klasifikimi i bërë, regjistroheshin në regjistrin themeltar të institucionit që kishte të drejtën e Kualifikimit Shkencor Pasuniversitar (SHPU). Fillimisht, temat, sipas problematikës, i udhëhiqte katedra, ndërsa më vonë u caktuan udhëheqës shkencorë. Periudha ishte 3 vjeçare dhe gjatë kësaj kohe, disertanti duhet të likuidonte edhe 4 provime të nivelit pasuniversitar si Filozofia Marksiste Leniniste (*deri në vitin 1989*), Arti Ushtarak Popullor (AUP), gjuha e huaj dhe lënda e ngushtë. Sipas detyrimeve të vëna nga katedrat/departamentet, kandidati mund të mbronte edhe pedagogji, psikologji, gjeografi, ekonomi, leksikologji, gramatikë, estetikë, etj., pranë Fakulteteve të UT.

Në vitin 1987, për herë të parë në Akademi, nga Komisioni i Kualifikimit Shkencor (KKSH), iu jepet titulli “Docent” kuadrove ushtarake të këtij Institucioni si Kostaq Karoli, Adem Çopani e Shahin Leka. Ndërkohë, Hasan Çipurit, i cili përbënte edhe një rast të veçantë, qysh gjatë mbrojtjes së Disertacionit, më 20.06.1987, iu dha grada “Doktor i Shkencave Filologjike”.

Duke parë vendin dhe rolin që zinte, në programet studimore pasuniversitare të Akademisë, puna studimore si dhe rrezatimin e saj, në interes të politikave mbrojtëse të shoqërisë, Komisioni i Kualifikimit Shkencor, pranë MASH, në *Vendimin Nr. 30, datë 04.08.1995 vendosi që “Akademinë e Mbrojtjes, ta konsiderojë SHPU (Shkollë Pasuniversitare) në fushën ushtarake të mbrojtjes”, praktikë kjo me “Çikël të plotë të Studimeve të Thelluara Pasuniversitare”, vetëm në fushën e mbrojtjes, e cila ka vazhduar deri në vitin 2003.*

Tashmë Akademia e Mbrojtjes kishte fituar një përvojë të mirë në drejtim të metodologjisë së punës krijuese kërkimore-shkencore që kishte në bazë studimin dhe punën e pavarur analitike, me produkte konkrete e të botuara në nivel ushtrie si tekstet e studiuesve Kostaq Karoli, Adem Çopani, Shamet Shabani, Shahin Leka, Proletar Hasani, të grupeve të autorëve të ndryshëm për problemet e Historisë Ushtarake, arritje këto që ia kishin rritur vlerën punës kërkimore, duke konsoliduar edhe programet e studimit. Është periudha e viteve 1989-1994, kur katedrat, grupet e studiuesve të veçantë të këtij institucioni, kishin vendosur kontakte të ngushta me komandat e njësive kryesore të Forcave të Armatosura për zhvillimin e aktiviteteve të përbashkëta shkencore si konferenca, seminare, sesione, diskutime apo cikle leksionesh, sipas kërkesave dhe nevojave të tyre.

Ishte privilegj i madh të bëheshe pjesë e këtyre ekipeve dhe të ligjëroje përpara profesorëve të nderuar të këtij Institucioni si Xhemil Çeli, Kostaq Karoli, Adem Çopani, Shahin Leka, Virgijil Janku, Proletar Hasani, Bektash Kolasi, Ilia Vasho, Shyqyri Kondi, Tigër Gogo,

Xhelal Martini, Petrit Manaj, etj. Ky brez studiuesish dhe pedagogësh, ndër më të suksesshmit në historinë e Akademisë, duke mbyllur ciklin e plotë të kualifikimit të tyre si punonjës pedagogjikë e kërkimorë, i bënë shërbim të vyer punës studimore dhe lartuan më shumë emrin e këtij Institucioni të Arsimit të Lartë Ushtarak.

Duke vlerësuar arritjet e Akademisë së Mbrojtjes, si në drejtim të konsolidimit të strukturës akademike, përmbajtjes shkencore të programeve, metodave të përparuar të mësimdhënies, sistemit të integruar të kontrollit të dijeve, infrastrukturës dhe rolit të personelit akademik në këtë drejtim, me të drejtë KKSJ, me *Vendimin Nr. 13, datë 06.01.1995*,⁷ miratoi, për herë të parë, dhënien e titujve më të lartë shkencorë si “Profesor” për Adem Çopanin, Shahin Lekën, Shamet Shabanin e Proletar Hasanin, “Drejtues Kërkimesh” për Hasan Çipurin e “Profesor i Asociuar” për Naim Limajn, të gjithë personel akademik i Akademisë së Mbrojtjes. Në Shkollën e Lartë të Oficerëve, po me këtë vendim, fituan titujt “Profesor i Asociuar” Fuat Spahiu, Kristaq Xharo dhe Elmaz Zejnati.

Mbas vitit 1995, ka fituar titullin “Profesor” Kolonel Bektash Kolasi, i cili për një farë kohe ka përfaqësuar MM dhe FA në KKSJ pranë MASH si dhe u bë “Profesor i Asociuar” Zoti Pajtim Ribaj. Gjatë vitit 2000, fituan titujt “Profesor” Gjeneral Kostaq Karoli dhe “Profesor i Asociuar” Kolonel Lulzim Bllaka. Në vitin 2001, iu dha titulli “Profesor i Asociuar” Zotërinjve Pëllumb Danaj dhe Gjergj Titani. Në vitin 2003, Nënkolonel Agron Agolli fiton titullin “Profesor i Asociuar” dhe Kolonel Pajtim Ribaj bëhet “Profesor Doktor”. Nënkolonelët Pjetër Hidri dhe Kujtim Hasani, fitojnë titullin “Profesor i Asociuar”, përkatësisht, në vitet 2004 dhe 2005. Kolonel® Elmaz Leci fiton titullin “Profesor” në vitin 2007, ndërsa Gjeneral® Ruzhdi Gjatoja, në vitin 2009. Po këtë vit (2009), kanë fituar titullin “Profesor” edhe Kolonelët® Pëllumb Danaj e Naim Limaj.

Në periudhën 1982-1990, zakonisht, disertantët drejtoheshin nga katedrat mësimore dhe, rrallë, nga udhëheqës të veçantë. Kjo, për kohën, kishte dy anë të mira: **E para**, gjatë përgatitjes së materialit kishe mbështetjen dhe ndihmën e personelit akademik të këtyre njësive mësimore-shkencore, tepër profesionist e kërkues pasi pedagogë zgjidheshin kuadrot më të zotë e më me përvojë të Forcave të Armatosura dhe kjo s’ishte gjë e pakët për studiuesin nga fillimi e deri në fund. **E dyta**, po të bindje katedrën në seriozitetin e punimit dhe përmbajtjen shkencore të tij, do ta kishe më të lehtë me jurinë dhe oponentin. Nga viti 1992 e deri më sot, disertantët i ka drejtuar në punën e tyre kërkimore-studimore (pavarësisht nga lloji i kërkimit shkencor bazë apo aplikativ), një udhëheqës shkencor. Në ndonjë rast ka patur edhe dy udhëheqës shkencorë, për të njëjtin disertacion.

Në periudhën 1982-1992, disertacionet mbroheshin para një Komisioni të Posaçëm të Mbrojtjes së Akademisë Ushtarake, ku merrnin pjesë drejtues të katedrave që udhëhiqnin disertantin, etj., kryetar i të cilit shpesh ishte Komandanti i Akademisë, i cili përfaqësonte Forcat e Armatosura në Komisionin e Lartë të Atestimit të vendit, anëtar i të cilit ishte zgjedhur. (Shtojmë se, më vonë, deri nga viti 2002, përfaqësimi i FA në Komisionin e Kualifikimit Shkencor, pranë MASH, u bë nga një ushtarak tjetër (mjeku Spiro Dede), me titull Profesor Doktor). Nga 2002 e këtej, me gjithë propozimet e bëra, në përbërje të KKSJ nuk ka patur përfaqësues të Strukturave të mbrojtjes dhe institucioneve të saj arsimore.

⁷ *Vendimi i KKSJ dhe MASH, Nr.13, date 06.01.1995.*

Deri në vitin 2001, si rregull, lista emërore e kandidatëve të regjistruar dhe tema e studimit dërgoheshin edhe në Komisionin e Kualifikimit Shkencor (MASH), pastaj kjo u la të administrohej nga institucioni që organizonte doktoraturën. Juritë e ngritura sipas udhëzimeve përkatëse të KSSH janë miratuar gjithmonë nga MASH, gjë e cila, me daljen e Ligjit të ri të Arsimit të Lartë në RSH Nr. 9741, datë 21.05.2007, neni 26, pika 1, kaloi në kompetencë të vetë Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu”⁸.

Komunikimi dhe korrespondenca për problemet e organizimit dhe mbrojtjes së doktoraturave si dhe të klasifikimit të punonjësve pedagogjikë e kërkimorë, ka qenë institucionale dhe e drejtpërdrejtë me KSSH e MASH, Agjencinë Publike të Akreditimit të Arsimit të Lartë (APAAL) dhe Këshillin e Akreditimit.

Numri i Disertacioneve për periudhën 1982-2011, sipas fushave përkatëse është si më poshtë:

Nr.	Fusha e studimit	Numri i temave të disertacioneve	Përqindja e çdo fushe në shumën e përgjithshme të disertacioneve
1	Taktika	24 tema	22,8 %
2	Historia e AU	25 tema	23,7 %
3	Artileria Tokësore	7 tema	6,3 %
4	Artileria K/Ajore	3 tema	2,7 %
5	Ushtri të Huaja	6 tema	5,4 %
6	Forcat Detare	3 tema	2,7 %
7	Tanket	3 tema	2,7 %
8	Zbulimi	3 tema	2,7 %
9	Prapavija	6 tema	5,4 %
10	Ndërlidhja	3 tema	2,7 %
11	Xhenio	2 tema	1,8 %
12	Topografi	2 tema	1,8 %
13	Armatinë-Municion	1 temë	0,9 %
14	Kinim (M/KK)	1 temë	0,9 %
15	Technologji Ushtarake	1 temë	0,9 %
16	FVVP	1 temë	0,9 %
17	Fusha e Sigurisë	16 tema	14,4 %

Gjithsej 17 disiplina të zgjedhura, për 108 disertacione të përgatitura.

Nga raportet e mësipërme, duket qartë se pjesa më e madhe e temave studimore janë lëvruar në fushën e përgatitjes taktiko-operative e historisë ushtarake dhe pastaj strategjisë e sigurisë kombëtare. Sot, projektet studimore, pothuajse, orientohen në dy fushat kryesore të sigurisë e të mbrojtjes, pasi edhe drejtimet e tjera derivojnë në fushat bazë të studimit.

Veçori të punës studimore në funksion të programeve të ciklit të dytë

⁸ Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007 “Për Arsimin e Lartë në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar.

Përpjekjet për të ndërtuar programet e këtij institucioni, në nivel “Masteri” për studime në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, janë bërë që më 12 nëntor të vitit 2004. Edhe pse MASH, nëpërmjet shkresës Nr. 3774, datë 03.06.2005, urdhëroi hapjen e programeve në Fushën e Mbrojtjes dhe të Sigurisë Kombëtare (Urdhër Nr. 153, datë 3.06.2005), edhe Ministri i Mbrojtjes nxori Urdhërin e tij Nr. 93, datë 30.01.2006 “Për hapjen e kursit “Master” për Sigurinë dhe Mbrojtjen”, pranë Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu”. Kjo gjë nuk u bë realitet, për arsye burokratike e nënvleftësuese të instancave eprore të cilat nuk e mbështetën dhe vlerësuan seriozisht këtë gjë. Të mos harrojmë se kjo gjë ndodhte në një kohë kur Shqipëria bënte përpjekje për t’u anëtarësuar në NATO si dhe kishte nënshkruar zyrtarisht Deklaratën e Bolonjës për një Hapësirë Europiane të Arsimit të Lartë, qysh më 18 Shtator 2003⁹.

Mbas daljes së Ligjit të Arsimit të Lartë Nr. 9741, datë 21.05.2007, (në pritje të një ligji të veçantë për arsimin e lartë ushtarak i cili nuk u bë kurrë), ne edhe pse të vonuar e nisëm përsëri punën për riorganizimin e programeve të studimit në Master të Nivelit të Parë dhe Master të Nivelit të Dytë, në fund të Janarit 2009. Periudha e përgatitjes, ballafaqimit me Ministrinë e Arsimit e të Shkencës, APAAL dhe Këshillin e Akreditimit, për njohje dhe vlerësim, zgjati 10 muaj deri sa doli Vendimi i Këshillit të Akreditimit Nr. 53, datë 09.11.2009, dhe zyrtarizmi nga Ministri i Arsimit me shkresën Nr. 6673/1, datë 23.11.2009. Duke guxuar të ballafaqohemi nëpërmjet programeve serioze, reale e institucionale të përafërta me standardet e Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL), ne u bëmë pjesëmarrës me të drejta të plota të këtij procesi arsimimi e vlerësimi që po ecte mbi bazën e standardeve të shpallura e të pranuarash tashmë edhe nga ne.

Duhet ta themi se kjo ishte koha kur edhe Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu” duhet të tregonte se ishte një Institucion i Arsimit më të Lartë Ushtarak (pse jo dhe i vetëm) me përvojë, eksperiencë, gjithnjë në ndryshim e transformim, që merrte përsipër të realizonte kërkesën ligjore të zbatimit të programeve të studimit të ciklit të dytë e të tretë¹⁰. Vendimi i Këshillit të Akreditimit Nr. 90, datë 03.09.2010, dha vlerësimin pozitiv për programin Master të Nivelit të Parë dhe Master të Nivelit të Dytë në “Studime në fushën e mbrojtjes e të sigurisë”. Por edhe pse programet u akredituan, Akademia nuk arriti të shpërndajë diplomat pasi MASH nuk nxori urdhrin për regjistrim të diplomave, sipas ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 42, pika 3.

Nga fundi i 6 mujorit të dytë të vitit 2010 e në vazhdim të vitit 2011 na u desh të punojmë për përshtatjen e programeve të studimit nga Master i Nivelit të Parë e Master i Nivelit të Dytë në Master Profesional dhe Master i Shkencave “Studime në fushën e mbrojtjes e të sigurisë”. Për t’i paraprirë kësaj pune, po aq serioze sa dhe riorganizimi i programeve fillestare, Këshilli Drejtues i Akademisë, në mbledhjen e tij të datës 26.10.2010, pasi dëgjoi platformën e përgatitur nga Komitetet Shkencore të secilit program, vendosi që, gjatë punës për përshtatjen e programeve, të mbahen parasysh kërkesat e ligjit Nr. 9741, datë 21.05.2007, neni 26, pika 1.2.

Kështu, duke respektuar standardet dhe kriteret shtetërore të arsimit të lartë, të përcaktuara në Urdhërin e MASH, Nr. 126, datë 17.03.2011, programin e studimit të Masterit Profesional “Studime në fushën e mbrojtjes e të sigurisë”, e përshtatëm në nivelin e 79

⁹ “Ndërtimi i Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë” (Bolonjë, 19 Qershor 1999).

¹⁰ Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 26, pika 1.2., 1.3.

krediteve (nga 60-90 kredite të detyrueshme) dhe kohëzgjatje normale 1,5 (një vit e gjashtë muaj) vit akademik ndërsa programin e studimit Master i Shkencave, në 120 kredite, brenda të cilëve përfshihen 30-40 kredite për projektin kërkimor dhe kohëzgjatje normale 2(dy) vite akademike.

Për të dy programet u përcaktua më drejt struktura lëndore, kreditet dhe struktura e krediteve, duke llogaritur deri 7 disiplina mësimore për vit të plotë akademik, sipas Udhëzimit të MASH Nr. 4, datë 22.01.2008 dhe udhëzimit Nr. 15, datë 04.04.2008, me një integrim më të mirë midis departamenteve.

U përmirësua madhësia e krediteve për modul, duke i rritur ato në 4 kredite e lart për çdo lëndë e deri në 8 kredite, gjë e cila shtoi sasinë e orëve për veprimtarinë mësimore të moduleve. Sanksionimi i 25 orëve akademike, për çdo kredit, ka shtuar dukshëm edhe nivelin e informacionit por, në të njëjtën kohë, ka krijuar hapësira më të mëdha për punë krijuese e shkencore të pavarur të akademistëve/aplikantëve, sidomos për aplikantët e programit Master i Shkencave.

Është bërë një përlogaritje më e saktë e vitit akademik, e ndarjes së tij në semestra (duke llogaritur 2 semestra në një vit), e ngarkesës javore e ditore, e balancimit të numrit të moduleve, të planëzuar në çdo semestër dhe integrimin të tyre ndërmjet 4 departamenteve mësimore.

Një angazhim më të madh ka marrë QGJH, drejtpërdrejt në procesin mësimor, duke arritur që të modulojë sasinë e orëve në dispozicion, me synim përvetësimin e shprehive të komunikimit operacionale, gjatë realizimit të detyrave në misionet e përbashkëta me vendet partnere. Në të njëjtën kohë, këto mësimore do të ndihmojnë akademistët/diplomantët e të dy niveleve të programit Master që, përpara diplomimit, të kenë mbrojtur edhe gjuhën angleze, sipas standardeve të njohura ndërkombëtare që kërkon Ligji i Arsimit të Lartë, neni 26, pika 1.2.2, germa c dhe pika 1.2.3, germa c. Shohim se përpjekjet e akademistëve për realizimin e këtij kriteri janë të mëdha, gjë që tregon se ata nuk duan ta humbasin shansin që, me përfundimin e kursit të karrierës, të përfitojnë edhe diplomën Master të nivelit universitar¹¹. Jo vetëm kaq por, për herë të parë, do të jepet edhe Suplementi i Diplomës, si një dokument që i bashkëngjitet diplomës së arsimit të lartë, praktikë dhe konceptim i ri në arsimimin kualifikues ushtarak shqiptar.

U bënë përpjekje që daljet në terren, vizitat mësimore në institucione, kontaktet njohëse me Komandat Kryesore Ushtarake e struktura të tjera të sigurisë kombëtare apo mbrojtjes së vendit, të organizohen e marrin trajtën e një moduli të praktikës profesionale, e domosdoshme për t'i dhënë jetë dhe një frymëmarrje më të gjerë përmbajtjes së programeve të studimit si dhe lidhjeve të teorisë me praktikën. Në këtë drejtim, mundësitë janë më të mëdha pasi terreni, komandat, shtabet, njësitë dhe repartet e ushtrisë janë laboratoritë e verifikimit të dijeve si dhe baza nga gjenerojnë argumentet analitike dhe të përgatitjes profesionale.

Duke qenë programe që konsolidohen dhe përmirësohen në vazhdimësi, duhet fiksuar e respektuar në mënyrë rigorozë e shkencore fakti që Masteri Profesional realizohet me 1975 orë akademike (për arsimim dhe trajnim të mirëfilltë profesional), ndërsa Masteri i

¹¹ Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 26 pika 1.2.2, germa c, pika 1.2.3 pika c.

Shkencave realizohet me 3000 orë akademike (për njohuri të thelluara teoriko-praktike si dhe trajnim për kërkim shkencor) pra, 41 kredite më shumë ose 1025 orë akademike më tepër.

Për të realizuar njohuritë e thelluara teoriko-praktike si dhe trajnimin për kërkim shkencor është parashikuar zhvillimi i modulit “Metodologjia e kërkimit shkencor”. Këtij moduli do t'i vijë në ndihmë edhe udhëzimi për procedurat e përgatitjes dhe të mbrojtjes së mikrotezës që iu është bërë e njohur të gjithë akademistëve/diplomantëve që vazhdojnë kurset Master.

Në pikëpamje shkencore, ka rëndësi edhe përcaktimi i raportit të krediteve të nevojshme që i duhen akademistit/studentit të çdo lloji masteri, për të përgatitur tezën studimore (mikrotezën apo provën finale), nga vlerësimi i së cilës ai do të meritojë ose jo diplomën Master të nivelit universitar. Vetë përzgjedhja dhe përgatitja e projektit kërkimor është objekt i drejtpërdrejtë i punës kërkimore-shkencore që do t'i përgatitë për ciklin e tretë të studimeve, me karakter plotësisht akademik e që kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtarinë krijuese.

Programet e studimit të ciklit të dytë që po zbatohen në akademi si dhe përvijimi i punës për konsolidimin e mëtejshëm të kurrikulave të tyre, me objektivat kryesore që kanë si dhe standardet që ofrojnë, janë në përputhje me misionin detyrat dhe përgjegjësitë e institucionit. Struktura aktuale akademike, në interes të programeve, po ve në veprim të gjitha kapacitetet infrastrukturore si dhe personelin mësimdhënës, ndihmës e mbështetës. Me kalimin në nivelin e programeve Master, personelit akademik i *sigurohet një harmonizim efektiv ndërmjet ngarkesës në mësimdhënie, punë kërkimore-shkencore dhe angazhimeve administrative*¹². Ato janë një vlerë dhe kontribut për punën kërkimore institucionale dhe ndikojnë në zhvillimin e elitës së mendimit ushtarak dhe kultivimit të zgjidhjeve racionale për sfidat e së ardhmes së FA, MM dhe SHP.

Programet Master, me temat studimore prioritare që lidhen me mjedisin e sigurisë në ndryshim, zhvillimin e marrëdhënieve rajonale e më gjerë, pozicionin e vendit tonë e të Forcave të Armatosura, trajtimin e sfidave të integritit në NATO e të anëtarësimit në BE, planin e reformimit të FA, zhvillimit të paketës së objektivave të saj afatmesëm e afatgjatë, zhvillimin e koncepteve doktrinale, shkallës së operacionalitetit, standardizimit, etj., kultivojnë një kulturë të re, të bazuar në dije shkencore dhe sistem funksional të punës kërkimore-shkencore.

Puna kërkimore-shkencore, në interes të programit të doktoratës

Tashmë, është e qartë se studimet e ciklit të tretë janë programe me karakter plotësisht akademik dhe kanë në bazë kërkimin shkencor dhe veprimtari krijuese¹³. Këto programe studimi zgjasin 3 vite akademike dhe përfshijnë 60 kredite për studime të organizuara teorike. Struktura modulare është sipërore dhe tepër konkurruese dhe ka në themel punën e pavarur për përzgjedhjen, zhvillimin e projekteve kërkimore si dhe përgatitjen dhe mbrojtjen e tezës së doktoratës. Kriteret e klasifikimit të kandidatëve, që kanë të drejtë të

¹² Urdhër i MASH Nr. 126, datë 17.03.2011, faqe 10

regjistruhen në këtë program, përcaktohen nga Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, mbi bazën e Standardeve Shtetërore, të përcaktuara në Urdhrin e MASH, Nr. 136, datë 21. 03. 2011¹⁴.

Bazuar në Strategjinë Kombëtare të Arsimit të Lartë dhe në Procesin e Bolonjës, programi i doktoratës do të realizojë formimin e doktorantëve me një kulturë ndërdisiplinore, në kuadër të një projekti shkencor koherent, i cili synon dhe ka për qëllim përgatitjen e tyre shkencore dhe profesionale, përmes punës kërkimore-shkencore. Moduli “Metodologjia e Punës kërkimore”, si pjesë e tërë strukturës lëndore, të përbërë gjithsej nga 7 lëndë mësimore, është bazë për të mësuar gjithë metodologjinë e punës kërkimore si dhe për të njohur elementët e studimit, kërkimit dhe krijimit shkencor. Edhe pse ka 30 vjet që Akademia e Mbrojtjes e realizon këtë shkallë kualifikimi shkencor, programi i studimit të doktoratës është tërësisht i ri, me vizion elitare, duke përbërë kështu një shkallë më të lartë në kulturën ushtarake të institucionit më të lartë të arsimit ushtarak dhe të vlerave kombëtare.

Duke qenë program individual për aftësim në kërkim shkencor të pavarur ka të përcaktuar fushën e studimit e të kërkimit **siguri e mbrojtje** dhe çdo gjë që lidhet me përmbajtjen dhe veprimtarinë studimore me to. Vendi i veçantë që do të zënë teoritë e strategjive të sigurisë kombëtare, rajonale e globale, koncepti i ri strategjik i NATO-s, natyra e konflikteve të kohës së sotme, mjedisi aktual dhe i ardhshëm i sigurisë, efektshmëria dhe rritja e operacionalitetit të Forcave të Armatosura, roli i shkencës dhe teknologjisë, etj. synojnë që të cekin fushat kryesore dhe projektet kërkimore të FA.

Ngritja e nivelit teorik të studimeve dhe nxitja e punës krijuese të akademistëve/diplomantëve, për t’iu dhënë përgjigje pyetjeve të shumta që shtrou koha, janë objektiva parësore të programit të doktoraturës. Jemi të bindur se kjo do të edukojë tek doktorantët kompetencën për të shkruar, në mënyrë të qartë dhe me një stil të përshtatshëm, përdorimin e argumenteve bindëse, artikulumin e qartë të ideve para auditorit të interesuar, zotësinë për të debatuar dhe mbështetur mendimin analitik të të tjerëve, përfshirjen aktive në mësimdhënie, format e kontrollit apo demonstrime të tjera publike.

Duke hartuar dhe zhvilluar programin e studimit të ciklit të tretë, i cili iu shtua Procesit të Bolonjës në Konferencën e Berlinit, të mbajtur më 18-19 shtator 2003¹⁵, ne përmirësojmë strukturën e përgjithshme të kualifikimit shkencor, konsolidojmë paraqitjen e sistemit të krediteve dhe të ndryshimeve të tyre, promovojmë dimensionet e standardeve shtetërore të cilësisë së Arsimit të Lartë, veçanërisht në lidhje me kurrikulën, zhvillimin dhe konsolidimin e saj si dhe na jepet një mundësi më tepër për të përcaktuar e vendosur prioritete më të avancuara, në interes të objektivave integruese të Forcave të Armatosura e Institucionit të Mbrojtjes. S’ka dyshim, se duke ecur në këtë rrugë, ne gradualisht do të sigurojmë edhe njohjen akademike të studimeve nga akademitë e ushtrive të vendeve të NATO-s, pasi edhe ato janë të përfshira brenda “Hapësirës Europiane të Arsimit të Lartë”¹⁶.

Sot, gjithkush mund të pyesë për kuptimin dhe përmbajtjen e kërkim-zhvillimit në FA, për rolin natyren, funksionin, karakterin e veprimtarisë, sasinë dhe realizimin konkret apo

¹³ Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 26, pika 1.3.

¹⁴ Urdhri i MASH Nr. 136, datë 21. 03. 2011, faqe 2.

¹⁵ Procesi i Bolonjës -Sfidë e Arsimit të Lartë shqiptar, 19 shtator 2003.

koston financiare për çdo projekt. Por që të mësojë e të kuptojë logjikën e funksionimit të këtij procesi e veprimtarie, kaq të nevojshme e të dobishme për reformimin e FA e standardizimin e aktivitetit të tyre, nuk e ka të lehtë, qoftë ky kërkim bazë apo edhe aplikativ.

Ndërsa në rastin e vendit, rolit, objektit, detyrave dhe synimeve të punës kërkimore në Akademi, e cila planëzohet dhe zhvillohet në përputhje me filozofinë e arsimimit e të kualifikimit, të interesave themelore të Institucionit, të stafit akademik, kurseve të karrierës, kapaciteteve njerëzore e financiare, problemi është më konkret e më i kuptueshëm. Programet e studimit Master si dhe programi i studimit të doktoratës, duke u inkuadruar në politikat shkencore të Akademisë së Mbrojtjes, departamenteve, qendrave, degëve, seksioneve e çdo pedagogu në botimet e tij, do t'i japin një kuptim të ri më cilësor e produktiv integritet të punës kërkimore-shkencore në procesin mësimor, pjesë përbërëse e të cilit është.

Referenca:

1. Vendim i Këshillit të Ministrave, Nr. 381, datë 28.10.1961.
2. Gazeta "Ushtria", viti 1998, faqe Nr. 5.
3. Udhëzimi i Këshillit të Ministrave, Nr. 07, datë 23.10.1973.
4. Vendim i KKSJ dhe MASH, Nr. 13, datë 06.01.1995.
5. Bolonjë, 19 Qershor 1999, "Ndërtimi i Hapësirës Evropiane të Arsimit të Lartë".
6. Ligji Nr 9120, datë 28.7.2003, "Për disa shtesa dhe ndryshime" në ligjin Nr. 8461, datë 25.2.1999 "Për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë".
7. Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 26, pika 1.2.,1.3.
8. Ligji Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 26 pika 1.2.2, germa c, pika 1.2.3, pika c.
9. Ligji i Arsimit të Lartë, Nr. 9741, datë 21.05.2007, i ndryshuar, neni 26, pika 1.3.
10. VKM Nr. 1509, datë 30.07.2008 "Standardet Kombëtare të Arsimit të Lartë".
11. Urdhër i MM Nr. 1042, datë 11.07.2008 "Për miratimin e politikave të arsimimit dhe trajnimit të personelit të forcave të armatosura të RSH", faqe 7-10.
12. Urdhër i MASH Nr. 126, datë 17.03.2011, faqe 10.
13. Urdhri i MASH Nr. 136, datë 21. 03. 2011, faqe 2.
14. Urdhri i MASH Nr. 136, datë 21. 03. 2011, faqe 2,3.
15. Procesi i Bolonjës-Sfidë e Arsimit të Lartë shqiptar, 19 shtator 2003, faqe 3.
16. Procesi i Bolonjës-Sfidë e Arsimit të Lartë shqiptar, 19 shtator 2003, faqe 4.

¹⁶ Procesi i Bolonjës -Sfidë e Arsimit të Lartë shqiptar, 19 shtator 2003,faqe

Gjuha Angleze - Gjuhë Parësore Operacionale e NATO-s

Doc. Shqiponjë Dautaj, Shefe e Qendrës së Gjuhëve të Huaja,
Msc. Eva Reveli, Shefe e Gjuhëve Operacionale

Abstrakt: *Anglishtja është gjuha parësore e Aleancës më të madhe, asaj të Atlantikut të Veriut. Me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO është rritur kërkesa për njohjen e gjuhës angleze si Gjuhë operacionale në strukturat e saj. Rritja e ndërveprueshmërisë me NATO-n kërkon konsolidim të sistemit të stërvitjes dhe arsimimit, përballim të dinamikave globale me ritme të shpejta, garantim të kurseve me metoda të reja bashkëkohore dhe përgatitje të kurrikulave të gjuhës angleze për nivele të ndryshme duke vënë në qendër vetë kursantët. Dokumenti mbështetës dhe referues për të gjitha vendet anëtare të NATO-s është STANAG 6001.*

Aftësimi profesional i pedagogëve është një çështje që kërkon vlerësim, pasi të gjithë janë të specializuar dhe kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve pasuniversitare. Pedagogu i nivelit të tretë ka njohuri bashkëkohore dhe aftësi të larta gjuhësore, teknike dhe diagnostikuese të koncepteve ushtarake. Me fjalë të tjera, roli i pedagogut të gjuhës angleze është moderatori i orës së mësimit, ndërmjetësi që përpiket të gjejë zgjidhje gjatë debateve, katalizatori që sjell ndryshime me fleksibilitetin e vet, monitoruesi dhe partneri i duhur në bashkëbisedime.

Gjuha angleze është gjuhë e përmasave botërore si dhe gjuha dominuese në Shtetet e Bashkuara të Amerikës, Britaninë e Madhe, Kanada, Irlandë, Australi, Zelandën e Re dhe në një numër vendesh tjera. Përgjithësisht përdoret si gjuhë e dytë dhe si gjuhë zyrtare në shumë shtete të botës. Është gjuha që mësohet dhe kuptohet më së shumti në botë, shpesh e njohur me epitelin “gjuha e tregtisë, arsimit, shkencës dhe diplomacisë”. Anglishtja është gjuha e bisedimeve politike, biznesit ndërkombëtar, komunikacionit ajror, shkencës dhe mjekësisë botërore.

Anglishtja i takon familjes së gjuhëve indo-evropiane. Rrjedh nga gjuha e vjetër e anglosaksonëve, paraardhësve të anglezëve, që u dyndën në Gadishullin Britanik në mesjetën e hershme. Mirëpo gjatë historisë është ndikuar nga një numër i madh i fjalëve latine e frënge dhe është thjeshtuar në gramatikë, duke dalluar nga gjuhët e tjera gjermane që fliten në Europën kontinentale. Aktualisht, sot më shumë njerëz në botë përpiqen të mësojnë gjuhën angleze dhe popullariteti i saj është bërë tepër dominant.

Pse është Anglishtja gjuha parësore e NATO-s dhe pse është rritur popullariteti i saj?

Anglishtja është gjuhë parësore e Aleancës më të madhe, asaj të Atlantikut të Veriut (NATO). Me anëtarësimin e Shqipërisë në NATO është shtuar edhe kërkesa për njohjen e gjuhës angleze si gjuhë operationale e NATO-s. Kërkesat kryesore për rritjen e ndërveprueshmërisë me NATO-n janë konsolidimi i sistemit të stërvitjes dhe arsimimit individual dhe kolektiv, duke aplikuar proceset e planëzimit operacional të NATO-s, në të gjithë hierarkinë e komandimit të FARSH, së bashku me standardet individuale, sistemet e vlerësimit të trupave dhe shtabeve. Të gjitha këto kërkesa, së pari, janë të lidhura me njohjen dhe përvetësimin e gjuhës angleze.

Vite më parë, kur Forcat tona të Armatosura kishin statusin e Pfp, mendohej se kurset në gjuhën angleze do t'iu shërbenin oficerëve dhe kursantëve vetëm për të kuptuar dhe komunikuar në gjuhën e përditshme angleze. Edhe kurset e organizuara, fillimisht, nuk kishin formën e sotme por ishin kurse spontane.

Por me ngritjen dhe funksionimin e Qendrës së Gjuhëve të Huaja e cila ka një personel mjaft të përgatitur, janë duke u kryer, për vite me radhë, kurse të niveleve të ndryshme, sipas STANAG 6001 të NATO-s. Këto kurse gjuhe vlejné shumë më tepër sesa thjesht të kuptuarit në nivel bazë. Asimilimi i katër aftësive gjuhësore: leximi, shkrimi, dëgjimi e të folurit dhe, veçanërisht, përvetësimi i gjuhës operationale, terminologjisë ushtarake dhe përgatitja e personelit ushtarak dhe civil për misione dhe për të kryer detyra në shtabe të NATO-s, janë standardet e reja të përcaktuara në Objektivat e Forcës.

Nëse do të mund të përshkruhej me një thënie përpjekja e oficerëve shqiptarë për asimilimin e gjuhës angleze të nivelit të tretë në Qendrën e Gjuhëve të Huaja në Tiranë, ajo do të mund të përshkruhej e tillë. Edhe pse ky nivel studimi fillon si maratonë, ai thjesht mbetet një kërcim. Por, çdo të thotë kjo? Rruga që duhet ndjekur nga oficerët për të arritur nivelin e kërkuar të gjuhës angleze nuk është e lehtë. Aktualisht ky është një proces i gjatë, i cili kërkon shumë përkushtim, këmbëngulje, sakrificë por edhe mjaft durim. Shumë dëshirojnë të hyjnë në këtë garë, por jo të gjithë e përfundojnë atë me sukses.

Cilat janë arsytet që e përcaktojnë këtë qëllim? Cili është qëllimi i kursit të nivelit të tretë dhe motivet e ndjekjes së tij nga oficerët shqiptarë? Cilat janë grupet e interesit që duhet ta ndjekin atë?

Arsytet e ndjekjes së këtij niveli janë të lidhura me kërkesat që dikton vendi i punës, karriera ushtarake dhe shkollimi që ata kryejné brenda apo jashtë shtetit. Gjithashtu, këto arsye janë të lidhura me pjesëmarrjen në misione të ndryshme, në strukturat e shtabeve të NATO-s si dhe me kryerjen e detyrave nga përfaqësuesit tanë ushtarakë në to.

Më konkretisht, ushtarakë dhe civilë përgatiten në këto kurse për të shkuar në misione të ndryshme. Forcat e Armatosura shqiptare vazhdojnë të kontribuojné në operacionin ISAF të drejtuar nga NATO, në Afganistan, në operacionin ALTHEA në Bosnjë-Hercegovinë të drejtuar nga BE si dhe kanë marrë pjesë në Operacionin "Liria e Irakut".

Në kuadër të Kartës së Adriatikut "A3", vazhdon angazhimi me katër vetë në rotacionin e Ekipit të Përbashkët Mjekësor në Afganistan. Shqipëria ka angazhuar oficerë dhe nënoficerë në poste të ndryshme në Shtabet Multinacionale si: në përbërje të Komandës Aleate për Transformim (ACT) në SHBA, të Shtabit të Komandës së Forcave të Bashkuara

në Afganistan, në misionin e vëzhgimit të OKB-së, në UNOMIG, Gjeorgji, në stafin e operacionit ALTHEA, në Shtabin e Komandës Qendrore Amerikane në Tampa, Florida SHBA, në Shtabin e Koalicionit në Bagdad, dhe në Qendrën Rajonale të Armë-Kontrollit në RACVIAC, Kroaci.

Aktualisht, FA kanë angazhuar oficerë në strukturat e NATO-s dhe përfaqësi ushtarake: në IMS, Bruksel; SHAPE, Mons; JFC Brunsum; JFC Napoli dhe komponentët vartës të saj. Do të vazhdojë rritja e numrit të personelit në këto struktura. Në kuadër të SEEBRIG-ut, Shqipëria do të vazhdojë të përfaqësohet në Shtabin e kësaj Brigade. Do të vazhdojmë kontributin me trupa në operacionet e NATO-s dhe të BE-së dhe të kompletojmë me personel vendet e përcaktuara për Forcat e Armatosura shqiptare në shtabet e NATO-s dhe shtabet e tjera multinacionale.

Pra, kjo pjesëmarrje e gjerë dhe ky kontribut aktiv i FA e bën kursin e nivelit të tretë të ketë objektivi të dyfishtë, atë të përgatitjes së oficerëve shqiptarë për të punuar në Shtabet e NATO-s, nëpërmjet asimilimit e përdorimit të gjuhës operacionale si dhe përgatitjes së tyre për ngritje në detyrë a poste më të larta në karrierën e tyre ushtarake.

Por cilët e ndjekin këtë nivel dhe a ka kriter në ndjekjen e tij?

Grupet e planifikuara janë oficerët, nënofficerët, personeli i shërbimit dhe civilët. Ka një kriter të veçantë në selektimin e kandidatëve dhe është pikërisht personeli i administratës J1 i Ministrisë së Mbrojtjes që procedon për këtë çështje. Por siç dihet ka një konkurrencë midis sektorit civil dhe atij ushtarak. Sektori publik zgjedh kandidatët më të mirë nga tregu i punës, ndërsa sektori ushtarak siguron mundësi dhe lehtësira për personelin e tij për ngritje në detyrë dhe zhvillimin profesional të kuadrove të tij të lartë.

Niveli i tretë i gjuhës angleze ka specifikat e tij, në krahasim me nivelin e dytë. Ky nivel fokusohet në koncepte abstrakte dhe në çështje të tilla si për shembull tematika profesionale, ushtarake, teknike, shkencore, kulturore dhe ekonomike. Një folës i nivelit të tretë duhet të jetë në gjendje të kuptojë thelbin e bisedës me një folës të arsimuar të gjuhës angleze. Ai duhet të jetë në gjendje të dialogojë për tematika formale dhe jo formale të gjuhës, për probleme praktike, shoqërore dhe profesionale.

Detyra jonë si pedagogë është që kursantët të përgatitet dhe të jenë në gjendje të dallojnë nivelet e ndryshme stilistikore të gjuhës siç janë humori, ironia dhe tonet e larta emocionale, të demonstrojë aftësi gjuhësore kur prezanton, raporton, shkëmben mendime, me qëllim përdorimin me profesionalizëm të lart të gjuhës operacionale. Ky nivel gjuhësor do t'i jap mundësi gjithsecilit të ngrejë hipoteza, të shpreh mendime, të mbështet ide, të justifikojë vendime, të sqaroj qëndrime e opinione dhe të konstatojë dhe mbrojë politika të caktuara.

Cilat janë sfidat e këtij niveli gjuhësor? Këto sfida kanë dy kahe, së pari janë sfida për vetë ne pedagogët dhe së dyti për grupet që do studiojnë në këto nivele gjuhe.

Pedagogu është gjeneratori dhe moderatori kryesor i informacionit. Ai është përgjegjës në zgjedhjen e përpunimin e tyre. Hartimi i programeve kërkon nga vetë pedagogët që të përzgjedhin materialin e mirëfilltë mësimor të përshtatshëm për këtë nivel. Por ndodh që ky material nuk përputhet me nivelin e bashkëbisedimit. Kjo bën që pedagogët asnjëherë të mos jenë të kënaqur me materialin e përzgjedhur. Por kjo nuk ia ul aspak vlerat punës,

përkundrazi është një shenjë pozitive pasi përpjekjet bëhen për të zgjedhur materialin që është më cilësor dhe më autentik.

Si një nga aspektet më tërheqës të profesionit të mësimdhënies është përpjekja e vazhdueshme e pedagogëve për të dhënë më të mirën për studentët e tyre. Pedagogët e Qendrës sonë përpiqen vazhdimisht të gjejnë metoda dhe teknika sa më efektive për kurset e ndryshme të gjuhës së huaj. Përpjekjet janë në vazhdim, pasi ne nuk ndjehemi të kënaqur me rezultatet e arritura në klasat tona. Për këtë qëllim ne kemi parasysh katër faktorë kryesor për mësimin me sukses të gjuhës angleze.

Qëllimet dhe përmbajtja e programit të gjuhës dhe vazhdimësia e duhur e kurseve; metodat e duhura ose strategjitë e kërkuara për të arritur këto qëllime; interesi i pedagogut dhe efikasiteti i punës së tij; roli i kursantëve në procesin mësimor.

Aftësiimi profesional i pedagogëve është një çështje që kërkon vlerësim, pasi të gjithë janë të specializuar dhe kanë përfunduar ciklin e dytë të studimeve pasuniversitare. Pedagogu i nivelit të tretë ka njohuri bashkëkohore dhe aftësi të larta gjuhësore, teknike dhe diagnostikuese të koncepteve ushtarake. Me fjalë të tjera roli i pedagogut të gjuhës angleze është moderatori i orës së mësimin, ndërmjetësi që përpiket të gjejë zgjidhje gjatë debateve, katalizatori që sjell ndryshime me fleksibilitetin e vet, monitoruesi dhe partneri i duhur në bashkëbisedime.

Cili është qëndrimi i kursantëve në lidhje me gjuhën angleze?

Informacioni që përzgjidhet për diskutim në klasë është relevant me nevojat e kërkesat e tyre. Roli i tyre në aktivitetet e komunikimit, është primar. Për këtë arsye si bazë merret eksperiencia e mëparshme gjuhësore që ata kanë dhe aftësia aktuale në gjuhën e planifikuar. Për të mbledhur informacion rreth kursantëve, pedagogu mund të përdor disa forma pune si:

Studimin mbi kursantin, diskutimin dhe negocimin në lidhje me interesat e nevojat e tyre, pyetësorët me qëllimet e tyre dhe mënyrat e të mësuarit, intervistat për të nxjerrë qëllimet e komunikimit, nevojat gjuhësore në lidhje me arsimimin e përgjithshëm, specifikat e punës dhe të jetës së përditshme dhe së fundi preferencat dhe stilet e të mësuarit.

Kursantët e këtij niveli janë mjaft të motivuar. Për më tepër përgjegjësia që ata kanë është akoma më e madhe në misionet dhe detyrat që realizojnë, ndërsa rreziqet që duhet të përballojnë janë tepër të mëdha. Si rrjedhojë ata janë partnerë të vëmendshëm dhe aktiv gjatë procesit mësimor dhe zotërojnë aftësi të thella mendimi. Në klasë ata gjenerojnë njohuri individuale të larmishme dhe formime të ndryshme kulturore. Si pasojë, planet mësimore nuk janë standarde, ndërsa kërkesat për t'u pranuar në kurse janë të përcaktuara më parë. Si përfundim, niveli i tretë i gjuhës angleze ka sfidat e veta dhe realizimi i tij për ne pedagogët do të thotë që ne të mendojmë saktë e qartë për arsyet e mëposhtme:

- Nivelin e duhur të materialeve autentike dhe burimin e tyre;
- planet mësimore të jenë të përshtatura për këtë nivel;
- niveli profesional i pedagogëve të jetë në lartësinë e duhur;
- niveli i duhur i kursantëve pjesëmarrës në nivel;
- kursantë të motivuar e me objektiva të qarta;

- përmirësim të programit mësimor e ndryshim të tyre.

Të gjitha këto që u përmendën janë rezultat i kërkesave që shtrohen përpara ushtrisë shqiptare, nga marrëveshja e standardizuar e NATO-s (STANAG 6001), për rritjen e kapacitetit gjuhësor të Forcave tona të Armatosura me gjuhë të pasur operacionale. Ndërsa ruajta, përmirësimi i njohurive dhe aftësive gjuhësore është përgjegjësi e çdo individi në veçanti. Personeli i caktuar i MM ka të drejtën e monitorimit të certifikatave të oficerëve, të cilat kanë një afat kohor të kufizuar. Ndërsa detyra jonë si specialistë të gjuhës është të lehtësojë punën e personelit ushtarak në realizimin e objektivave të tyre, për t'u zgjedhur në poste të caktuara. Pra niveli i tretë është një çështje reale dhe e madhe për të gjithë ne, Askush nuk mund ta bind tjetrin që të ndryshoj, por secili prej nesh mbron portën e ndryshimit e cila mund të hapet vetëm prej nesh.

Cili është vizioni i QGJH në përputhje me standardet e NATO-s; cilat janë synimet dhe objektivat e personelit akademik?

Disa nga objektivat, ambiciet dhe prioritetet kryesore të QGJH pas anëtarësimit të Shqipërisë në Aleancën e Atlantikut të Veriut janë:

1. Përballimi i dinamikave globale me ritme të shpejta,
2. Garantimi i kurseve me metoda të reja dhe sa më bashkëkohore,
3. Përgatitja e kurrikulave me një anglishte specifike ushtarake për nivele të ndryshme me në qendër vetë kursantët.

Duhet theksuar se QGJH është e angazhuar maksimalisht dhe po bën përpjekje efektive për realizimin e misionit të saj për të plotësuar nevojat në rritje të Forcave tona të Armatosura për ushtarake me gjuhë operacionale të Aleancës së Atlantikut të Veriut, në kuadrin e integritetit të plotë të tyre në NATO, duke mbështetur drejtpërdrejt me programe gjuhësore dhe shërbime të ndryshme dhe veçanërisht me anë të:

- Përmirësimin të cilësisë së programeve mësimore;
- ngritjes profesionale të pedagogëve të saj;
- përmirësimin të shërbimeve për kursantët si sallës vetëstudimore, laboratorëve, kabinetëve mësimore, etj;
- funksionimit sa më efikas të administratës;
- shkëmbimeve të përvojës me universitete të tjera brenda dhe jashtë vendit; pjesëmarrjes dhe referimeve në konferenca kombëtare dhe rajonale;
- përgatitjes dhe eksperimentimit të modeleve të ndryshme të testeve STANAG 6001 nga departamenti i Testimit;
- koordinimit të punës dhe shkëmbimit të përvojës me qendra të tjera rajonale.
- përgatitjes së materialeve didaktike, programeve mësimore, teksteve të reja me terminologji të mirëfilltë ushtarake, fjalorëve në gjuhë të ndryshme për të plotësuar nevojat e tyre për gjuhën angleze si gjuhë operacionale para dhe gjatë misionëve, në shtabet e NATO-s, në operacione paqeruajtëse, stërvitje e trajnime brenda dhe jashtë vendit.

- kualifikimit të stafit pedagogjik me anë të studimeve individuale pasuniversitare, profesionale dhe shkencore për ngritjen e nivelit të mësimdhënies, në përputhje me misionin dhe funksionin e QGJH-së.
- ballafaqimeve dhe shkëmbimeve të përvojës/feedback me kursantë në misione dhe trajnime në vendet anglishtfolëse, me oficerët e Shtabit në Operacionet Shumëkombëshe,
- aplikimin e strategjive të reja leksikore dhe idetë e reja që stafi i ka vënë në garën e konkurrimit nëpërmjet tematikave aktuale e me vlera bashkëkohore si për shembull: Lufta e Koalicionit, Bashkëveprimi i Forcave, Partneriteti për Paqe, Operacionet e Përbashkëta, Operacionet Paqeruajtëse, Demokracitë e Brishta, Operacionet e NATO-s, Operacionet e Kombeve të Bashkuara, Tregjet e Lira dhe Ekonomia Globale.

Për shkak të këtyre dinamikave të reja globale dhe kufijve të rinj, rritja e interesit në asimilimin dhe përdorimin e gjuhës Angleze, pjesëmarrja në trajnime dhe stërvitje të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, ka bërë që sot më tepër se kurdoherë Gjuha Angleze të zërë një vend më të rëndësishëm se sa mund të imagjinohej. Një argument tjetër bindës është se gjuha zyrtare dhe e para e NATO-s është bërë Anglishtja.

Cilat janë kërkesat që paraqet QGJH përpara Kursantëve?

Sot kursantëve u kërkohet të punojnë në kompjuter shkrime akademike, të bëjnë prezantime në Power Point, të përgatisin brifingje, të përdorin website të ndryshme për të bërë kërkime e analiza të rasteve studimore me tematika specifike ushtarake, bashkëkohore dhe profesionale. Kjo experiencë e dyfishtë e të studiuarit nëpërmjet kërkimit në internet, bën që ata të përftojnë aftësi më të mira gjuhësore, të përmirësojnë sidomos leximin, përkthimin dhe shkrimin. Për më tepër i motivon ata t'i asimilojnë këto aftësi në praktikë, sidomos tani në epokën e re të informacionit.

Kurset e arsimimit profesional të civilëve dhe ushtarakëve janë bërë shumë sfiduese. Kursantëve iu kërkohet të lexojnë në anglisht çdo mbrëmje rreth 50 faqe. Ata shkruajnë memo, letra, raporte, ese, urdhra, përgatisin dhe prezantojnë brifingje në Anglisht; përdorin kompjuterin për të përkthyer dhe përgatitur punë të pavarura me shkrim; debatojnë dhe diskutojnë në grup tematika specifike shoqërore, profesionale, dhe me karakter të mirëfilltë ushtarak. Për të gjithë kursantët aftësitë e dëgjimit, leximit, shkrimit dhe të folurit janë tepër sfiduese për arritjen e rezultateve të kërkuara në fund të kursit dhe të standardeve të përcaktuara nga STANAG 6001.

Por aftësitë e avancuara gjuhësore nuk mund të arrihen brenda një nate. Për më tepër ato nuk mund të mësohen duke i dhënë studentëve një listë fjalësh apo një fjalorth për të memorizuar. Gjatë trajnimit në gjuhën Angleze, një rëndësi e veçantë i kushtohet aftësisë së të folurit. Në orët e bisedave të lira, një vëmendje e madhe i kushtohet pjesëmarrjes efektive në debat me qëllim përvetësimin saktë dhe rrjedhshëm të të folurit. Kërkesat e vazhdueshme të punëve me shkrim janë gjithashtu të nevojshme. Shkrimet akademike nuk përfshijnë thjesht shenjat e pikësimit, gërmëzimin, strukturat e fjalive, por edhe aftësinë për të analizuar e organizuar mendime, për të mbështetur opinione me zotësi.

Aktualisht ekziston një tjetër nevojë gjuhësore me qëllim gërshtimin e aktiviteteve gjuhësore me teknologjinë e përparuar dhe aplikimin e informacionit nga personeli i përzgjedhur

për të punuar në vendet e reja të punës të ngritura pranë shtabeve të NATO-s apo në misione të ndryshme. Përgatitja sa më e mirë dhe e plotë e këtij personeli dhe familjarizimi i tyre me mjedisin e ri gjuhësor ku ata do të shërbejnë pas trajnimit në QGJH, është objektivi kryesor i programit të vitit të ri akademik të stafit tonë.

Përdorimi i Gjuhës Operacionale

Gjuha Angleze është gjuha primare operacionale në NATO dhe si e tillë kërkohet të njihet dhe përvetësohet nga të gjithë ushtarakët shqiptarë në të gjitha nivelet.

Personeli i përzgjedhur për të punuar në strukturat e NATO-s duhet të arrijë standardet gjuhësore të kërkuara sipas përshkrimit të detyrës. Çdo nivel përfaqësimi në strukturat e NATO-s ka të përcaktuar në përshkrimin e detyrës edhe kërkesën për nivelin e njohurive në gjuhën angleze. Dokumenti mbështetës dhe referues për të gjitha vendet anëtare të NATO-s është STANAG 6001.

Realizimi i kërkesave gjuhësore të përcaktuara në "Politikat e arsimimit, trajnimit dhe testimit në gjuhë të huaj" për zhvillimin e deritanishëm të OF mbështeten në:

- Urdhrin e MM nr. 1265 dt. 02.09.2008. Në këtë kuadër, QGJH kryen kurse të gjuhës angleze për nivelin SLP 3-3-3-3, 3-2-3-2, 2-2-2-2 për arritjen e niveleve gjuhësore të kërkuara.
- Testimet për përcaktimin e shkallës së njohurive të Gjuhës së Huaj bëhen në bazën e të gjitha procedurave të STANAG 6001 dhe ALCPT.

QGJH synon aftësimin në Gjuhën Angleze (dhe në gjuhë të tjera të vendeve të NATO-s) e të gjithë personelit ushtarak dhe civil të planifikuar për tu punësuar në stafet e Aleancës ose në operacione të mbështetjes së paqes. Gjithashtu masa specifike janë marrë për integrimin e programeve të karrierës së oficerëve dhe nënoficerëve në kurrikulat e arsimimit. Për t'u siguruar që i gjithë personeli i planifikuar për detyra në shtabe shumëkombëshe, MM, SHP dhe stafi që merret me çështje rutinë në lidhje me NATO-n, të ketë aftësi minimale në gjuhën angleze si poshtë vijon (dëgjim, të folur, lexim, shkrim në përputhje me STANAG 6001, Botimi 2 – SLP (Standardized Language Profile): Oficerët: SLP 3-3-3-3; Nënoficerët: SLP 3-2-3-2. Për vitin 2010, i gjithë personeli i njëjësive të deklaruara duke përfshirë kontributin në Forcën Reaguese të NATO-s (NATO Response Force), të kishte aftësi gjuhësore në gjuhën angleze si vijon:

Oficerët në pozicione komanduese dhe oficerët kryesorë të shtabit të kenë: SLP 3-2-3-2; Të gjithë oficerët e tjerë: SLP 2-2-2-2. Nënoficerët (OR-5 e më lart) që do të kenë kontakte të shpeshta me personel nga vende të tjera të kenë SLP 2-2-2-2. Ndërsa i gjithë personeli i planifikuar për të kryer komunikime taktike: SLP 2-2-1-1

Qendra e Gjuhëve të Huaja në Komandën e Doktrinës dhe Stërvitjes është përgjegjëse për zbatimin e programeve në gjuhë të huaj, politikave dhe procedurave të arsimimit, kualifikimit dhe testimit në gjuhë të huaj në FARSH. Ajo harton programet dhe zhvillon kurse në gjuhë të huaj në përputhje me kapacitetet dhe burimet e disponueshme të Qendrës së Gjuhëve të Huaja.

Qendra e Gjuhëve të Huaja harton kalendarin dhe planin e testeve në gjuhë të huaj të miratuar nga organet përkatës si dhe përditëson të dhënat në bazën testimi si dhe dërgon

rezultatet e testimit në Drejtoritë përkatëse në MM dhe SHP.

Për një përfaqësim sa më dinjitoz të FA në misione paqeruajtëse dhe stërvitje të përbashkëta me vendet e NATO-s, QGJH. ka sugjeruar në vazhdimësi zhvillimin e kurseve intensive afatshkurtra si kurse para misionit, kurse të terminologjisë së NATO-s, kurse për rifreskimin e njohurive gjuhësore.

Stafi i QGJH ka nevojë për tu përditësuar me të rejat e mësimdhënies etj. Për këtë Ministria e Mbrojtjes e shikon të nevojshme të planifikojë mbështetjen me trajnime të vazhdueshme brenda dhe jashtë vendit si në Brunsum, Hollandë, Garmish, Gjermani, Hungari, SHBA, Mbretëria e Bashkuar, Kanada etj.

Referenca:

1. [http://www.acronymfinder.com/Standardization-Agreement-\(NATO\)-\(stanag\).html](http://www.acronymfinder.com/Standardization-Agreement-(NATO)-(stanag).html)
2. <http://www.oos.army.cz/english/nato-standardisation.htm>
3. <http://www.nato.int/cps/en/natolive/stanag.htm>
4. <http://www.oos.army.cz/english/nato-agreement.htm>
5. www.globalnato.org/index.php?...nato_standardization...nato_standardization...
6. [www.docstoc.com/.../NATO-unclassified-NATO-unclassified-1-stanag-6001-\(Edition-2\)](http://www.docstoc.com/.../NATO-unclassified-NATO-unclassified-1-stanag-6001-(Edition-2))
7. www.scribd.com/doc/54724647/27/standardisation
8. www.coerll.utexas.edu/coerll
9. <http://fllc.unt.edu/>

E folura në publik

Majlinda Cukalla
Pedagoge në Akademinë e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”

Abstrakt: Tema “Si të flasësh në publik”, përqendrohet në rëndësinë e aftësive komunikuese të drejtuesit me vartësit, me bashkëpunëtorët, me eprorët e tij si dhe në komunikimin përpara një grupi njerëzish. Komunikimi është një nga cilësitë kryesore dhe më të rëndësishme që duhet të karakterizojë një drejtues.

Mungesa e aftësive komunikuese bën që çdo drejtues të dështojë përpara atij grupi njerëzish që ai drejton, duke mos qenë në gjendje të shprehë njohuritë profesionale që ai zotëron, planet dhe synimet e mira që ka për vartësit e tij.

*Në këtë artikull lexuesi do të njihet qartë me gjuhën e trupit, që është ajo pjesë e komunikimit që shpesh nuk vlerësohet nga drejtuesi apo folësi dhe për të cilën Gëte thotë: “Është e rëndësishme se **çfarë** do të thuash, por më e rëndësishme është mënyra se **si** do ta thuash”. Si-ja do t’i referohet: mimikës, gjestit, qëndrimit të trupit, kontaktit me sy dhe mënyrës së trajtimit të zërit. Të gjithë komponentët e gjuhës së trupit duke përfshirë dhe rëndësinë e pauzës gjatë të folurës do të jepen në mënyrë të hollësishme.*

Sot ka drejtues të cilët kanë njohuri shumë të mira profesionale, punojnë me përkushtim, bëjnë plane dhe kanë synime të mira për atë grup njerëzish që drejtojnë, por, shumë prej tyre nuk kanë aftësi komunikuese, nuk janë në gjendje të shprehin atë bagazh njohurish që zotërojnë, punën, planet apo synimet e tyre.

Gjatë një bashkëbisedimi komunikohet nëpërmjet gjuhës verbale dhe gjuhës joverbale. Gjuha verbale është informacioni, është vetë fjala e folur, ndërsa gjuha joverbale është gjuha e trupit, me të cilën do të nënkuptojmë: qëndrimin i trupit, lëvizjet e duarve, shprehjen e fytyrës, reflekset e saj, kontaktin me sy, mënyrën e trajtimit të zërit, mënyrën e të vështruarit si dhe shumë nuanca dhe reflekse të tjera, të cilat përbëjnë një gjuhë mjaft të veçantë të cilësive fizike të personit folës. Sipas Joachim Knappe, *gjuha e trupit është si një orkestër me shumë instrumente, ku secili ka vlerën e tij.*¹

¹ Hebert Genzmer, “Rhetorik die Kunst der Rede”, DuMont Literatur und Kunst Verlag, Köln 2003, faqe 66.

Kur njeriu flet, flet dhe mimika, flet dhe gjesti, flet qëndrimi, flet dhe vështrimi duke krijuar tek dëgjuesi një vlerësim, një respekt, një prirje për ta besuar apo një prirje për të mos e besuar, një refuzim apo një acarim.

Nëse gjuha e folur prek vetëdijen e dëgjuesit, gjuha e trupit krijon tek dëgjuesi ndjenja dhe një të folur të brendshme të sigurt, efekti i të cilave ja arrin qëllimit të përcimit të suksesshëm të lajmit a informacionit shumë herë më tepër se sa gjuha e folur. Vetë gjuha e folur, duke u mbështetur në gjuhën e trupit merr forcë, bëhet më e gjallë dhe më e kuptueshme. Samy Molcho² shkruan: *”Gjuha e trupit është si gjuha e folur, veçse gjuha e trupit nuk mund të gënjejë”*.

*”Çfarë jemi ne, jemi përmes trupit tonë. Trupi është pasqyra e shpirtit tonë, gjuha e tij janë fjalët e zemrës. Të gjitha lëvizjet e brendshme, ndjenjat, emocionet dhe dëshirat shprehen përmes trupit tonë”*³ Të njohësh dhe të mësosh në mënyrë të vetëdijshme sinjalet e gjuhës së trupit do të thotë: të njohësh më mirë vetveten, të paraqitesh bindës, të vlerësosh më mirë kundërshtarin, të kesh më shumë sukses me njëri tjetrin, të komunikosh më lirshëm dhe më qartë që situatat në jetën e përditshme dhe në atë profesionale t'i kapërcesh.

Kur e pyetën Demostenin cila është pjesa më e rëndësishme e oratorisë ai u përgjigj *“veprimi”*; po tjetër e rëndësishme që duhet t'i kushtojmë vëmendje, ai u përgjigj *“veprimi”*; po pas këtyre të dyjave kush e ka radhën, ai përsëri u përgjigj *“veprimi”*. Njerëzit priren të besojnë veprimet se sa fjalët!⁴

Le të përmendim dy parime kryesore të retorikës, që është dhe teknika e të folurës:

- *Folësi depërton te pritësi jo vetëm nëpërmjet përmbajtjes së lajmit, por edhe nëpërmjet personit të tij.*
- *Folësi, përçuesi i lajmit duhet të vendosë veten e tij në një emërues të përbashkët me lajmin që përçon, që të jetë i besueshëm dhe bindës.*⁵

Kur ju jeni i interesuar për atë çfarë thoni, besoni me të vërtetë në atë dhe dëshironi ta ndani mesazhin tuaj me të tjerët, atëherë lëvizjet tuaja fizike do të vijnë nga brenda dhe ju do të jeni në përshtatje me fjalën.

Duke përfshirë vetveten në mesazhin tuaj, ju do të jeni mjaft natyral dhe spontan pa patur mendime të qëllimshme për atë që jeni duke bërë apo thënë. Për shumë njerëz, nuk është aq e lehtë sa duket, sepse ajo kërkon të heqësh maskën që mbulon “të vërtetin” në publik. Në lidhje me këtë, Dr. Ralph C. Smeadly shprehet: *“Folësi, i cili flet dhe qëndron i qetë, është ai, i cili mund të dëgjohet pa lodhje. Nëse qëndrimi dhe gjestet e tij janë shumë të hijshme dhe modeste, që askush mos t'i vë re ato, ai mund të quhet me të vërtetë i suksesshëm”*.

² Samy Molcho, ekspert i gjuhës së trupit, Profesor i Universitetit të muzikës dhe arteve të bukura në Vjenë.

³ Hebert Genzmer, *“Rhetorik die Kunst der Rede”*, DuMont Literatur und Kunst Verlag, Köln 2003, faqe 158.

⁴ Plutarku, *“Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë”*, SHB “Naim Frashëri” Tiranë, faqe 170

⁵ Fuehrungsakademie der Bundeswehr, *Redentechnik (Rhetorik)*, faqe 5-6.

Kur veprimet tuaja përshtaten me fjalët që thoni, ndikimi i asaj që thoni do të jetë i fortë. Nëse sjellja juaj nuk sinkronizohet me mesazhin e folur atëherë vëmendja e dëgjuesve do të largohet nga fjalimi.

Të bëhesh një folës që ka ndikim tek të tjerët, duhet të çlirohesh nga maska dhe të ndani ndjenjat e vërteta me auditorin tuaj. Auditori do të dijë se çfarë ndjeni për atë që thoni. Nëse ju dëshironi të bindni të tjerët, ju duhet të përhapni bindjen tuaj duke folur nga zemra dhe shpirti juaj.

E thënë ndryshe folësi duhet të flasë jo vetëm nëpërmjet fjalës por edhe nëpërmjet përkushtimit të tij shpirtëror, si rezultat, atij do t'i flasin sytë, qëndrimi i trupit, lëvizjet e duarve, madje dhe rrobat e tij.⁶

Le të shohim në veçanti elementet e gjuhës së trupit që janë: mimika; gjesti; kontakti me sy; qëndrimi i trupit;

Folësi duhet të ketë një njohje të mirë të elementeve të gjuhës së trupit. Por më parë se të shqyrtojmë këta elemente është e rëndësishme të njihet një nga parimet e rëndësishme të komunikimit.

“Të jesh vetvetja”⁷

Kjo do të thotë: Shmangie e imitimeve, shmangie e qëndrimeve të paramenduar për të paraqitur një pamje në mënyrë standarde, apo lëvizje të trupit, të duarve, të mimikës, në mënyrë të stisur, të sajuar, për të arritur artificialisht një efekt maksimal bindjeje. Kjo do të thotë mbi të gjitha se nuk duhet të krijohen korniza të huazuara dhe skematike. “Të jesh vetvetja” do të thotë liri absolute e psikikës, e emocioneve, e shprehjes së fytyrës, e zërit, e qëndrimit të trupit, e lëvizjeve të duarve.

Dhe duke ndodhur kështu, folësi do të ushqehet vetiu, do të mbarset, do të ngarkohet me preokupimin e duhur që i dikton një çast i caktuar, që i dikton komunikimi i brendshëm dhe spontan i momentit. Të gjithë përbërësit e tjerë, si ato psikik ashtu edhe ata emocional, logjik, të mimikës, të gjesteve etj. do të marrin formën e tyre dhe paraqitjen e tyre më natyrale, më të përshtatshme, më komunikuese dhe më bindëse.

Debatet më të famshëm që janë mbajtur ndonjëherë në Amerikë kanë ndodhur më 1858 në shtetin e Illinois midis Senatorit Stefan A. Douglas dhe Abraham Linkolnit. Linkoln ishte i madh dhe i rëndë. Douglas ishte i shkurtër dhe i këndshëm. Këta burra ishin të ndryshëm në karakter, në mendim, në personalitet, në natyrë ashtu sikurse ishin të ndryshëm në fizikun e tyre. Gjestet e Douglas ishin të hijshme, të Linkolnit të ngathta. Douglas ishte krejtësisht i varfër nga humori, Linkoln ishte i famshëm për mënyrën se si i tregonte historitë. Douglas rrallë buzëqeshte. Linkoln vazhdimisht argumentonte me analogji dhe ilustrime. Douglas ishte mendjemadh dhe autoritar. Linkoln ishte modest dhe zemërbutë. Douglas mendonte sa hap e mbyll sytë. Përpunimi i mendimeve të Linkolnit ishte shumë i ngadaltë. Douglas fliste vetëtimthi. Linkoln ishte më i qetë dhe më i matur.

Të dy, të ndryshëm sikurse ishin, ishin folës të zotë sepse ata kishin kurajon dhe sensin e mirë të ishin vetvetja. Nëse ndonjëri nga ata do të imitonte tjetrin, ai mjerisht do të kishte

⁶ Nadine Kmoth, “Koerper Rhetorik”, mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005, faqe 24-25.

⁷ Fuehrungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik), faqe 7.

dështuar. Secili prej tyre, duke i qëndruar besnik dhuntive përkatëse, krijuan individualitetin e tyre.

Në fakt kjo është një këshillë e thjeshtë për t'u dhënë. Por, a është po kaq e thjeshtë për t'u zbatuar? Sipas Marshal Foch arti i luftës *është mjaft i thjeshtë në ide, por për fat të keq i vështirë për t'u zbatuar*.⁸

Për të qenë vetvetja përpara një auditori duhet të praktikohesh. Aktorët e famshëm e dinë këtë. Ata pasi e kanë mësuar tekstin përmendësh dhe e kanë përtypur mirë, e “harrojnë” atë. Atëherë ky tekst do të burojë sipas rrethanës dhe momentit në mënyrë jetësore dhe të vërtetë, të natyrshme dhe bindëse. Sinqeriteti, entuziazmi dhe serioziteti i madh do të ndihmojnë gjithashtu. Kur njerëzit janë nën ndikimin e ndjenjave të tyre, të vetvetes vijnë në sipërfaqe. Pengesat bien. Kulmi i emocioneve është shuar, të gjitha barrierat kanë rënë. Njerëzit sillen spontanisht, flasin spontanisht dhe veprojnë natyrshëm.

1. Mimika (shprehja e fytyrës)

Kontakti i parë midis folësit dhe dëgjuesit, vendoset nëpërmjet mimikës, nëpërmjet shprehjes së fytyrës dhe fizionomisë së një personi që shfaq emocionet e ndjenjat e tij të brendshme.

Mimika përcakton fatin e lidhjes që do të vendoset midis folësit dhe dëgjuesit. Ajo përcakton, nëse kjo do të jetë lidhje e një besimi reciprok, e një kundërvënie të brendshme apo mosrespektim.

Mimika u tregon atyre që dëgjojnë se me çfarë personi kanë të bëjnë. Mimika është një rezultat i përkushtimit të brendshëm, i kërkesës së vërtetë dhe të pastër.

Mimika nuk mund të sajohet, ajo buron nga brenda. Kështu folësi i mirë, oratori që nje mirë rregullat e komunikimit nuk e kontrollon mimikën e tij. Ai kontrollon fillimisht aktin e tij të brendshëm domethënë përcakton qartë qëllimin e bisedës në vetëdijen e tij: *qëllimin dhe përfundimin e lajmit*.⁹

Akti i ndërtuar në këtë mënyrë, që buron sinqerisht nga zemra dhe shpirti, pas një kohe të shkurtër, do të transmetohet e do të reflektojë në mimikë. Pra këshilla që i jepet folësit është: *Beso fillimisht vetë atë që do të thuash dhe pastaj do të jesh në gjendje të bindësh të tjerët.* Mimika dalëngadalë i modulohet, i përshtatet tonalitetit të zërit, logjikës së lajmit që tejçohet dhe kureshtjes e vëmendjes së atyre që dëgjojnë. Kështu krijohet *uniteti komunikues* midis vëmendjes së atyre që dëgjojnë dhe atij që flet. Një fjalë e urtë nga lindja e largët thotë: *Kush buzëqesh fiton.*

Një fytyrë miqësore që rrezaton një dritë buzëqeshjeje dhe mirësie të sinqertë e që buron nga zemra natyrshëm, i fiton shpejt zemrat e dëgjuesve. Por duhet theksuar, se një lajmës i cili përpiket të krijojë një mimikë të stisur e gjoja të besueshme në mënyrë artificiale, është i dështuar dhe do të krijojë një shije refuzuese te dëgjuesi.

Nuk ka rregulla në përdorimin e shprehjeve të veçanta. Nëse ju shmangni pengesat tuaja dhe i lejon vetes t'i përshtatësh natyrshëm mendimeve, qëndrimeve dhe emocioneve tuaja

⁸ Dale Carnegie, “Public speaking for success”, Penguin Group, New-York 2006, faqe 154.

⁹ Majlinda Cukalla, Retorika (leksion), Akademia e Mbrojtjes “Spiro Moisiu”, Tiranë 2004, faqe 13.

atëherë shprehja e fytyrës suaj do t'i përshtatet mesazhit duke treguar sinqeritet, besueshmëri dhe bindje.

2. Kontakti me sy

Kontakti me sy të ndihmon të rregullosh rrjedhjen e komunikimit. Ai sinjalizon interes tek të tjerët dhe rrit besueshmërinë e folësit. Njerëzit të cilët përdorin kontaktin me sy hapin rrjedhën e komunikimit dhe transmetojnë interes, preokupim, ngrohtësi, dhe besueshmëri. Nuk ka mënyrë më të sigurtë për të ndërprerë një marrëdhënie komunikimi midis folësit dhe auditorit se sa mungesa e të parit tek dëgjuesi. Fjala e urtë “*sytë janë pasqyra e shpirtit*” thekson nevojën tuaj për të bindur dëgjuesit me sytë tuaj, sikurse dhe me fjalët tuaja. Vështrimi duhet të jetë i çiltër dhe krejtësisht i pastër, i vëmendshëm mos ta shqetësojë dëgjuesin, të jetë i drejtpërdrejt dhe të mos nënkuptojë gjendje të pasigurta, dykuptimëshe dhe të mos shprehë prirje për të mbuluar apo për të kamufluar diçka.¹⁰ Dëgjuesi në këto raste e pranon folësin brenda vetvetes pa asnjë lloj konflikti. Kjo do të thotë që folësi ka pushtuar zemrat dhe vëmendjen e tyre shumë natyrshëm.

Shikimi i folësit nuk duhet të jetë rivalizues me vështrimin e dëgjuesve, sikur t'u thoshte atyre shikoni, jam unë këtu, ju duhet të dëgjoni. Shikimi i folësit duhet të jetë i qetë, i durueshëm dhe tejkalues ndaj vështrimeve acaruese dhe të ngurta të dëgjuesve, kur këto ndodhin herëpashere gjatë bisedës. Në këtë mënyrë, dëgjuesi i nënshtrohet krejtësisht me dëshirë folësit. Nëse mund të bëhen pyetje gjatë bisedës, folësi duhet të shikojë dëgjuesin në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe ndërkohë të mos shkëpusë vëmendjen nga masa tjetër e dëgjuesve, pra të mos i mënjanojë ato nga vëmendja e tyre, nga syri i tij i brendshëm, sepse kjo do të krijojë një mendim jo të mirë dhe një gjendje acaruese.

Syri i brendshëm i folësit është ajo që folësi shikon brenda vetvetes, është mënyra e vërtetë se si ai trajton dëgjuesin, është marrëdhënia e vërtetë e tij me dëgjuesin. Ky sy i brendshëm është vendimtar në vendosjen e një komunikimi të drejtë dhe ndikon në krijimin e respektit të ndërsjellët. Këtë gjë dëgjuesi nuk e sheh në mënyrë të drejtpërdrejtë por e ndjen së brendshmi.

Nuk ka rëndësi se sa i madh është numri i dëgjuesve, çdo dëgjues dëshiron të ndjejë se ju jeni duke iu drejtuar asaj apo atij. Vetëm duke parë dëgjuesit tuaj si individë ju mund t'i bindni ato se ju jeni i sinqertë dhe i interesuar për ta.

Kur ju flisni, sytë tuaj punojnë edhe si një pajisje kontrolli, që ju mund ta përdorni për të garantuar vëmendjen dhe përqëndrimin e dëgjuesve.

Duke parë auditorin se si po reagon, ju jepet mundësia të korrigjoni sjelljen tuaj apo dhe përzgjedhjen e fjalëve duke rregulluar prezantimin tuaj në përshtatje me rrethanat.

Të kontaktosh me sy me auditorin është një element thelbësor i një të folure të bukur përpara publikut. Ky mjet i thjeshtë mrekullon auditorin, duke tërhequr vëmendjen e tij në fillim të fjalimit dhe duke siguruar interesin e tyre dhe respektin.¹¹

3. Gjesti

¹⁰ Nadine Kmoth, “*Koerper Rhetorik*”, mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005, faqe 57.

Gjesti nënkupton tërësinë e lëvizjeve, të vetëdijshme apo jo, të duarve, krahëve, gishtave, të kokës si dhe të pjesëve të ndryshme të trupit siç janë shpatullat, pjesa e gjunjëve etj.¹² Gjesti flet më shumë se gjuha e folur dhe jo rrallë ai merr fuqi të mëdha shprehëse. Ai mund ta gllabërojë vëmendjen e dëgjuetit si dhe ta ngazëllezë atë.

Të bësh gjeste me kokë dhe duar, është pjesë e komunikimit. Kjo është mënyra në të cilën ne i japim jetë dhe theksojmë fjalën e folur, është normale që ato luajnë një rol të rëndësishëm në të folurën në publik. Gjesti mund të jetë i vlefshëm për të shprehur një pikëpamje të veçantë, por është e rëndësishme që ai të jetë i natyrshëm dhe spontan (jo i paramenduar). Gjestet tepër të ekzagjeruar dhe të detyruar mund të kthehen në disfavorin tuaj, duke hutuar auditorin.

Gjesti është mendimi i brendshëm i shprehur jo me gjuhën e folur por me një lëvizje, me shenja trupore. Një lëvizje koke nga lart poshtë shpreh një pohim më të sigurt se sa do të shprehte fjala “po”. Një lëvizje koke nga e majta në të djathtë apo anasjelltas shpreh një refuzim shumë më të fuqishëm se fjala e shprehur me gojë “jo”. Gjesti zëvendëson tërësisht fjalën e folur. Të gjithë kanë përjetuar efektin e jashtëzakonshëm e të padiskutueshëm të filmave të Çarli Çaplinit, i cili për të komunikuar me spektatorin vepron me gjeste dhe mimikë, sa askush nuk e ndjen mungesën e fjalës në to.

Gjesti ndihmon së tepërmi aftësinë përçuese dhe komunikuese të folësit. Shpesh ai zëvendëson krejtësisht fjalën e folur, madje ngrihet në nivelin e një komunikimi universal; nëpërmjet gjesteve mund të merren vesh njerëz të kulturave të ndryshme, të cilët nuk kuptojnë gjuhën e njëri tjetrit. Gjesti ka qenë dhe mbetet gjithmonë një gjuhë universale e natyrës së gjallë, gjuha më e fuqishme shprehëse dhe komunikuese.¹³ Nëpërmjet gjesteve, lëvizjeve të trupit apo të këmbëve një kafshë komunikon me njerëzit, duke i vënë në dijeni për kërkesat e veta. Nëpërmjet gjesteve një foshnjë kërkon nga e ëma atë që i duhet.

Gjestet janë vetjakë, ato i përshtaten gjithmonë personit, burojnë nga natyra e tij psikofizike. Përgjithësisht, gjesti është pjesë e qëndrueshme, integrale, që nuk mund të ndahet nga gjuha e folur. Që gjesti të jetë një me të folurin dhe kuptimplotë në përçimin e fjalës, duhet patjetër që personi të ketë një fizik dhe një qëndrim trupor të lirshëm, të çliruar si dhe një psikikë të hapur, të pakontraktuar, e cila hap pas hapi gjatë dhënies së një mesazhi të modulohet në mënyrë spontane dhe këtë modulim t’ia transmetojë dhe anës fizike, trupit, duarve, gishtërinjve etj.

Për një folës të talentuar që njeh mirë parimet e komunikimit, gjestet nuk janë të paramenduara, ato janë elementë të frymëzimit dhe të krijimtarisë së momentit të dhënë. Frymëzimi dikton jo vetëm në fjalën e duhur, jo vetëm në kompozimin e duhur të bisedës, por në të njëjtën mënyrë në mimikën dhe gjestin.

Përpiquini të jeni i vetëdijshëm, se çfarë bëni me duart, është mjaft e rëndësishme që t’i mbani ato nën kontroll. Krahët dhe duart duhet të jenë të lirshëm, të natyrshëm dhe jo të duken sikur janë të tepërta dhe kërkojnë një mbështetje apo ndihmë për t’u vendosur diku. Lëvizja e tyre duhet të jetë me vend dhe kuptimplotë, as e tepërt dhe as e ngrirë.

¹¹ Herman Schluter, “Das Handbuch der Rhetorik”, Anaconda Verlag GmbH, Köln 2006, faqe 54.

¹² Fuehrungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik), faqe 8

¹³ Nadine Kmoth, “Koeper Rhetorik”, mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005, faqe 169

Duart nuk duhen as të fshihen prapa se do të dukeni shumë zyrtar si dhe do të ndiheni jo i natyrshëm. Është më mirë të lëvizin krahët në mënyrë të qetë dhe të kontrolluar.

4. Qëndrimi i trupit

Një përbërës tjetër i gjuhës së trupit është qëndrimi i tij, pozicioni i bustit, pjesës së sipërme të trupit. Pozicioni dhe vendqëndrimi, duhet të jetë i tillë që të mundësojë një qëndrim të lirshëm e të qetë të trupit dhe të rrokë përpara vetes të gjithë rrethin e dëgjuesve. Qëndrimi të jetë i drejtë në mënyrë të natyrshme dhe jo “sikur ke gëlltitur okllainë”. Pjesa e bustit duhet të jetë e lirshme dhe përballë dëgjuesit. Nëse ka një podium, mos e përdor atë të mbështetesh përpara apo prapa, sepse reflekton përshtypjen e një plogështie shpirtërore dhe fizike që largon vëmendjen e dëgjuesve. Është e rëndësishme të kesh një qëndrim trupi të qetë dhe të drejtë. Këmbët të jenë të hapura sa është gjerësia e shpatullave, kjo do t’u ndihmojë të ruani ekuilibrin e trupit.

E rëndësishme është edhe mënyra e mbajtjes së supeve; nuk duhen të jenë as të ngritura që të tregojnë mendjemadhësi dhe arrogancë, por as të varura që të tregojnë mosbesim dhe plogështi.

5. Stili i të folurit

Siç është përmendur edhe më lart, është e rëndësishme mënyra si të thuash diçka se sa ajo që thua. Nëse dëshironi të jeni një folës tërheqës, mëso të përdorësh ndryshimin e zërit, të shtosh gjallërinë në dhënien e mesazhit. Ndoshta gjëja më e mirë që mund të bëni për të përmirësuar përcimin e mesazhit është të përdorni modulimin e zërit, të ndryshoni ritmin dhe volumin e tij, si dhe t’i jepni rëndësinë e duhur pushimeve gjatë të folurit. Ndryshimi i zërit duhet të kombinohet me logjikën dhe gjuhën e trupit për të përmirësuar të gjithë dhënien e mesazhit.

Kur ju bëni një prezantim, mos rri i heshtur gjithë frikë – flit në mënyrë miqësore sikur të jini i njohur me auditorin. Flit qartë, në mënyrë të përmbledhur thekso aty ku ju doni të tërhiqni vëmendjen. Përdor zërin për të vënë në pah emocionet, por ki kujdes nga bisedit vazhdimisht në mënyrë pasionante. Pasioni i vazhdueshëm është po aq i keq sa dhe në rastin kur nuk ke aspak.

Një mënyrë e mirë për të përmirësuar ndryshimin e zërit është të praktikohesh duke lexuar me zë të lartë fragmente të autorëve të ndryshëm, duke përçuar emocione të ndryshme. Praktikohu duke përsëritur të njëjtat fjalë, ndrysho ritmin, ndrysho regjistrin, ndrysho mënyrën e trajtimit të zërit deri aty ku ju duket se është në nivelin e duhur.

Artikulimi është shqiptimi i qartë, me theksin e duhur, i kuptueshëm i fjalëve dhe i fjalive. Një artikulum i mirë u jep rëndësinë e duhur të gjitha rrokjeve, si zanoreve ashtu edhe bashkëtingëlloreve, dhe sidomos mbaresave të fjalëve që shpesh neglizhohen prej folësit. Të gjitha germat duhet të artikulohen qartë gjatë të folurit, në mënyrë që të kapen nga veshi i dëgjuesit. Ashtu sikundër do të ndahen në mënyrë të qartë e të dukshme kokrrat nga kalliri i misrit kur ai shkërmoqet, në të njëjtën mënyrë duhet të burojnë rrokjet dhe germat prej gojës së atij që flet. Duhet shmangur e folura nën buzë, nëpër dhëmbë si dhe mërmërimat.

Dobësitë e të folurit mund të shmangen nëpërmjet praktikave, si të lexuarit e ngadalshëm e me zë të lartë dhe ushtrime të ndryshme të cilat zbatohen në mënyrë individuale, sipas dobësive që ka personi. Duhet të kujtojmë këtu, rastin e shumë oratorëve të cilët në fëmijërinë e tyre shfaqnin defekte në të folur, por të shtyrë nga një vullnet i habitshëm i kanë kapërcyer këto “mangësi”. Shembulli ideal për të ilustruar këtë praktikë është Demosteni, i cili kur fliste ngatërrohej, emocionohet dhe i merrej goja nën ndikimin e të tjerëve. Për të ndrequr këtë defekt ai dilte në breg të detit dhe recitonte përmendësh ligjëratat të tëra përpara detit që zhurmonte nga dallgët e fuqishme.¹⁴ Kështu ai mësohej të fliste rrjedhshëm, qartë dhe në mënyrë të qetë përpara zhurmës së dallgëve. Dalëngadalë ai i eliminoi mangësitë e veta dhe u bë një nga oratorët më të mëdhenj të lashtësisë.

Modulimi është ndryshimi i tonit të zërit në fjalë të veçanta brenda një fjalie ose ndryshimi i tonit të zërit në rrokje të caktuara brenda një fjale. Modulimi na lejon të transmetojmë më shumë informacion se sa do të ishte e mundur në mungesë të tij. Kjo është në interes të folësit për të forcuar kuptimin e fjalisë ose të një fjale të vetme gjatë të shprehurit. Një folës i mirë nuk e paraqet fjalinë në mënyrë të njëtrajtshme, monotone, me shpejtësi të njëjtë nga fillimi në fund, por ai përdor tone të ndryshme, shtrirje të ndryshme të gjatësisë së rrokjeve, shpejtësi të ndryshme të thënies së një fjalie, gjithmonë sipas interesit që ai ka për të përçuar tek dëgjuesi më qartë dhe më me shumë ngjyrimë idenë, logjikën dhe përmbajtjen e një fjalie. Nuk e bën folësin më të besueshëm e folura e shpejtë dhe me zë të lartë, çjerrës apo të egër. Përkundrazi, një ton i ulët ka vlerë shumë më të madhe kur i përshtatet momentit të duhur gjatë shprehjes së mendimit, si dhe kur merret në konsideratë vëmendja e dëgjuesit. Në të njëjtën mënyrë, toni i lartë nuk nënkupton të jetë i lartë në vetvete, por gjithmonë në harmoni me momentin e dhënë dhe me tonalitetin e përgjithshëm të fjalisë, jo si qëllim në vetvete.

Është e rëndësishme të theksohet se modulimi hyn në aftësitë vetjake, ai është shumë individual dhe lidhet ngushtë me karakteristikat e tjera të folësit si me forcën e zërit, me diapazonin e brendshëm të tingullit të tij, me gjatësinë e shtatit, pra me vetitë e paraqitjes dhe shumë të dhëna të tjera psikofizike. Çfarë përshlyet do të linte një folës shtatartë e trupmadh me një zë të hollë? Modulimi është një art më vete i të folurit, shumë i rëndësishëm në paraqitjen e mendimeve. Përveç atyre që përmendëm më lart ai lidhet edhe me impulsin e natyrshëm dhe të vërtetë që krijohet të folësi, me situatën për të cilën bëhet fjalë, me botën emocionale dhe vëmendjen e dëgjuesve. Për shembull, një folës i cili nuk ndjen dhe nuk kap në mënyrë intuitive gjendjen shpirtërore të dëgjuesve, nuk do të pikasë çastin kur dëgjuesit të jenë krejtësisht të pavëmendshëm ndaj tij. Ai do të vazhdojë të flasë me tone të qeta, me një modulim monoton duke qenë i sigurt se të tjerët po e dëgjojnë.

Pauza është një mjet kritik i bindës. Kur doni të theksoni një fjalë ndalo më parë për disa sekonda, pikërisht kjo e nxjerr në pah fjalën dhe nëse ju dëshironi me të vërtetë që ajo fjalë të ketë efekt, bëni një pauzë para dhe pas fjalës. Uilliam Shekspir thekson: “*Unë bëj një pauzë, kur filloj rishtaz*”¹⁵.

¹⁴ Plutarku, “*Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë*”, SHB “Naim Frashëri”, Tiranë 1980, faqe 174.

¹⁵ James C. Humes, “*Speak like Churchill stand like Lincoln*”, Three Rivers Press, New York 2002, faqe 1.

Vlera e pauzës njihet mirë nga oratorët më të mirë të gjithë kohërave. Seneka¹⁶, thoshte se *ai që nuk di të pushojë nuk di as të flasë*. Pauza lejon një kuptim dhe perceptim më të mirë të mesazhit ose informacionit që duhet dhënë. Në këtë hapësirë kohe “të lirë” truri deshifron me shpejtësi, krahason, kundërvihet e miraton. Ndodh që oratorë, pedagogë a instruktorë të ndryshëm deklarojnë që në fillim se nuk kanë shumë kohë në dispozicion dhe përpiqen të japin sa më shumë informacion në një kohë sa më të shkurtër dhe këtë e bëjnë, duke vështruar pareshtur orën e tyre. Në të vërtetë kjo ngjall një ndjenjë çoroditjeje te dëgjuesit dhe mbi të gjitha atij nuk i lihet mundësia që të memorizojë informacionin që merr. Pauza ndihmon edhe për një lloj shkëmbimi a ndarje emocionesh. Për përdorimin e saj nuk mund të vendosen rregulla fikse, por në përgjithësi mund të thuhet se ajo përdoret para dhe pas një ideje të rëndësishme. Në rastin e parë ajo do të synojë të tërheqë vëmendjen dhe në rastin e dytë ajo nënvizon rëndësinë e fjalëve të fundit dhe lejon perceptimin më të plotë të informacionit.

Kur vëren shkëputje të vëmendjes së auditorit, folësi duhet të flasë më me ngadalë, duhet të bëjë më shumë pushime gjatë fjalisë, duhet t'i shtrijë më shumë fundet e fjalëve, të përdorë tone më të buta. Këto teknika do lejojnë dëgjuesin të përqendrohet më mirë, të rimarrë dhe të freskojë vëmendjen dhe t'i kuptojë më qartë ato që thuhet.

Linkolni shpesh përdorte pauzën kur fliste. Kur ishte duke përcjellë një ide të rëndësishme dhe dëshironte që kjo ide të bënte një përshtypje të thellë tek dëgjuesit e tij, ai përkulej përpara, i shikonte ata drejtpërsëdrejti në sy për një moment dhe nuk fliste. Kjo qetësi e papritur kishte të njëjtin efekt ashtu sikurse dhe zëri i vrullshëm: Kjo tërheq vëmendje. Kjo bën çdo njërin të vëmendshëm, vigjilent, sy çelur për atë që po ndodh. Për shembull, kur debati i tij i famshëm me Douglas ishte duke u mbyllur dhe të gjitha gjasat tregonin për disfatën e tij, ai u stresua, melankolia e zakonshme e tij u largua nga ai në kohën kur po thoshte fjalët e tij me një ndjenjë të fuqishme dhe prekëse, ku papritmas ai “ndaloi” dhe qëndroi i qetë për një moment, shikoi përreth turmës që qëndronte përpara tij, gjysma indiferente dhe gjysma miqësore, me ata sy të zhytur thellë në mërzi të qetë gjithmonë dukeshin të mbushur me lot të paderdhur. Përkuli duart e tij, ashtu sikurse dhe ata, i lodhur nga kjo betejë pa përkrahje, ai tha me një monotoni të pazakontë: “Miq të mi, është një ndryshim i vogël, një ndryshim tepër i vogël, nëse Douglas ose unë zgjidhemi në Senat të Shteteve të Bashkuara; por çështja madhore që ne kemi paraqitur sot përpara jush është mjaft larg dhe përtej çdo interesi vetjak apo fati politik të ndonjë personi. Miqtë e mi...” ai përsëri bëri një pauzë, dëgjuesit ishin të përqendruar në çdo fjalë, “kjo çështje do të jetojë, do të marrë frymë dhe do të digjet kur gojët e mjera, të pafuqishme të Douglas dhe e imja që belbëzojnë do të jenë të qeta në varr”.¹⁷ Këto fjalë të thjeshta dhe mënyra në të cilën ato u thanë, prekën çdo njeri në thellësi të shpirtit.

Linkolni bënte pauza edhe pas frazave të cilat ai dëshironte t'i theksonte. Ai i shtonte fuqinë fjalëve, duke qëndruar i qetë, ndërkohë kuptimi përthitëj dhe ndikonte në misionin e tij. Askund nuk është e heshtura më e vlefshme se floriri, kur ajo përdoret me mençuri gjatë të folurit. Pauza është mjet i fuqishëm, mjaft i rëndësishëm, por në përgjithësi, folësit fillestarë e anashkalojnë atë.

¹⁶ Filozof dhe shkrimtar romak, shekulli 4 para Krishtit - 65pas Krishtit

¹⁷ Dale Carnegie, “Public speaking for success”, Penguin Group, New-York 2006, faqe 162.

Le të shohim fuqinë e pauzës në fjalimin e Benito Juarez¹⁸. Juarez ishte i pari president që nuk ishte spanjoll, ai ishte një indian, ishte më pak se 162 cm i gjatë dhe mjaft i shëmtuar. “I mjeri Juarez duket si një zhabë” thonin njerëzit e pasur për të. Në moshën 26 vjeçare Juarez drejtonte parlamentin e Meksikës, kur ky indian i rëndomtë u ngrit për të folur, shumica nga auditori e përçmuan, por ai shpiku modelin e tij të prezantimit. Ai nuk foli menjëherë, i hodhi një sy fytyrave të ndryshme në auditor dhe detyroi çdo dëgjues të drejtonin shikimin nga ai. Heshtja pushtoi menjëherë sallën, ai vazhdoi të qëndronte pa folur dhe duke parë me vëmendje parlamentarët, të cilët, sipas Juarez, mund të mendonin për moszotërimin e spanjishtes së tij. Pikërisht për të përforcuar edhe më tepër parashikimin e tyre Juarez përdori një pauzë të gjatë. Përfundimisht pas kësaj qetësie që zgjati, Benito Juarez filloi fjalimin. Fjalët e tij imponuese oshëtinë, nga zëri i tij i lartë, të qarta për auditorin tashmë të vëmendshëm.¹⁹

Një mjeshtër tjetër që e njihte fuqinë e pauzës ishte Napoleoni. Ashtu sikurse Benito Juarez edhe Napoleoni kishte “një gjatësi trupi sfidues”. Napoleoni u fliste trupave francezë me një zë që e tregonte dialektin e tij të një italiani të vrazhdë prej Korsike, ishulli i vendlindjes së tij. Përpara fillimit të fjalimit të betejës, ai do të qëndronte i heshtur nga dyzet në pesëdhjetë sekonda dhe dukej sikur për çdo sekondë që ai priste, rritej në sytë e trupave të tij. Napoleoni i njihte çelsat e karizmës. Metoda e pauzës së fuqishme ishte çelësi për të lartësuar mesazhin e tij²⁰.

Në vitin 1991 mbretëresha e Anglisë Elisabeta e dytë, me jo më e gjatë se 160 cm, shkoi në Uashington për një vizitë zyrtare, podiumi ku ajo do të mbante fjalimin e saj ceremonial ishte parashikuar për lartësinë e presidentit Bush, kështu menjëherë u vendos një stol, në mënyrë që podiumi të bëhej i përshtatshëm edhe për të, përpara se ajo të fliste bëri një pauzë, me qëllim që auditori të reagoonte ndaj heshtjes së saj. Po kështu, edhe në 1957, përpara se ajo të fillonte fjalimin e saj në pallatin qeveritar Williamsburg, në Virginia, Mbretëresha Elisabetë, bëri një pushim aktoresk, i cili rrëmbeu zemrat e auditorit tashmë të përqendruar, përshëndetja e saj ceremoniale tingëlloi mjaft e ngrohtë dhe e çiltër²¹. Kur fjalët e saj u shfaqen në faqet e gazetës ditën tjetër, ato u duken mjaft të thata. Pauza e saj e fuqishme kishte siguruar vëmendjen e dëgjuesve dhe lartësimin e forcës së fjalëve.

Burrat si dhe gratë, qofshin të gjatë apo të shkurtër, marrin gjatësinë e duhur në sytë e auditorit të tyre përmes heshtjes strategjike.

Pauza është e rëndësishme edhe kur dikush në auditorin tuaj ju bën një pyetje, më mirë se të jepni një përgjigje të shpejtë dhe të pamenduar, bëni një pauzë, gjatë të cilës ju mund të përgatiteni për t’u përgjigjur pyetjes duke i shprehur mendimet në fjalë. Përpara se të flisni hartoni përgjigjen në mendjen tuaj – në një fjali me një kryefjalë dhe një kallëzues. Një përgjigje e shpejtë pa u menduar mirë tregon që ju nuk e keni dëgjuar me vëmendje pyetjen. Një pauzë e bërë me qëllim përpara se ju të flisni i shton peshë dhe mençuri si

¹⁸ *Presidenti i parë meksikan i zgjedhur në mënyrë demokratike, (i pari që nuk ishte diktator).*

¹⁹ James C. Humes, “*Speak like Churchill stand like Lincoln*”, Three Rivers Press, New York 2002, fq. 1-2.

²⁰ *Po aty*

²¹ *Po aty, faqe 5-6*

përgjigjes suaj ashtu edhe perceptimit të saj nga auditori. Në këtë mënyrë dëgjuesi mendon se ju keni dëgjuar me të vërtetë atë që ju bëri pyetjen, në vend që të përgjigjeni me nxitim.

Kur ju jeni duke u përgjigjur mendoni për pauzën e fuqishme, sikurse ju vendosni rripin e sigurimit përpara se të ngisni makinën, si një masë sigurie për të parandaluar ndonjë aksident. Prandaj, përpara se ju të përgjigjeni, ju duhet të shihni drejt e në sy bashkëbiseduesin tuaj që pret përgjigje nga ju.

Njeriu nuk mund ta arrijë qëllimin e tij i vetëm, ai nuk mund të fitojë garën pa ndihmë. Përderisa, veprat e gjenive të pikturës si Rafaelo apo Rembrandt u nevojiten kornizat e duhura, po ashtu edhe një fjalimi u nevojiten pauzat e duhura. Një pauzë e fuqishme është si një kornizë, e cila i sjell hijeshi pikturës.

Referenca:

1. Hebert Genzmer, "Rhetorik die Kunst der Rede", DuMont Literatur und Kunst Verlag, Köln 2003.
2. Plutarku, "Jetë njerëzish të shquar të lashtësisë", SHB "Naim Frashëri", Tiranë 1980.
3. Führungsakademie der Bundeswehr, Redentechnik (Rhetorik).
4. Dale Carnegie, "Public speaking for success", Penguin Group, New-York 2006.
5. Majlinda Cukalla, Retorika (leksion), Akademia e Mbrojtjes "Spiro Moisiu", Tiranë 2004.
6. Nadine Kmoth, "Koerper Rhetorik", mvgVerlag, Redline GmbH, Heidelberg 2005.
7. Herman Schluter, "Das Handbuch der Rhetorik", Anaconda Verlag GmbH, Köln 2006.
8. James C. Humes, "Speak like Churchill stand like Lincoln", Three Rivers Press, New York 2002

RUBRIKA E KATËRT

ÇËSHITJE HISTORIKE

Të fundit, por jo për nga rëndësia, kjo revistë trajton çështje historike në fushën e sigurisë dhe të mbrojtjes. Autorët e kësaj fushe trajtojnë aspekte historike që kanë interes për zhvillimin e dijeve dhe personalitetit të një ushtaraku të kohëve moderne.

Ajo trajton çështje nga historia e lashtë, si ajo e Leviatanit të Hobs-it e deri tek çështje të historisë moderne të marrëdhënieve midis organizmave ndërkombëtare në menaxhimin e sigurisë.

Revista Ushtarake mirëpret shkrime në fushën e historisë së shkuar që kanë vlera për historinë e sotme dhe të nesërme. Fusha e historisë dhe e mësimave të nxjerra prej saj duhet shfrytëzuar në kultivimin e dijes tek forca e ardhshme.

Pikëpamjet politike të Hobsit

Dr. Lavdosh Ahmetaj
Pedagog në Universitetin “Kristal”

Abstrakt: *Dy janë shtysat më të mëdha të veprës së Hobsit ‘Leviatani’: së pari, reagimi kundrejt autoritetit fetar, sidomos kundër filozofisë skolastike; së dyti, admirimi i thellë për metodën shkencore, veçanërisht për gjeometrinë. Të dyja këto ndikime patën pasoja të thella, në mendimin e tij politik e moral¹.*

Ndërsa, sistemi i filozofisë së Hobsit është i përbërë prej tre pjesë themelore: pjesa e parë trajton trupin (De corpore), pjesa e dytë trajton fiziologjinë dhe psikologjinë e individëve (De komine), ndërsa pjesa e tretë trajton tërësinë e trupave dhe trupin artificial që quhet shoqëri ose shtet (De Cive).

Hobsi e përjashton zotin dhe entet shpirtërore nga gjykimi filozofik, madje edhe historinë, sepse historia bazohet tek përvoja apo autoriteti, por jo tek arsyetimi. Pra, ai e kufizon objektin e filozofisë tek bota trupore, dhe kjo ndoshta prej konceptit pragmatik të dijës.

Sipas Hobsit (Hobbes), i vetmi virtyt moral është drejtësia dhe drejtësia është bindja ndaj ligjit të shtetit. Kjo do të thotë se, nuk ka asnjë kuptim të flasësh për virtyte në kuptimin absolut, përveçse të shteti. “ E drejta është ajo që përputhet me ligjin ”², për rrjedhojë duhet një rregull, ose një kriter për të gjykuar se çfarë është e drejtë e çfarë është e padrejtë. Në funksion të kësaj çështje, ai zbulonte tek natyra njerëzore dy parime të kundërta: e para, *dëshirën natyrore*, që i shtyn njerëzit të marrin për vete atë për të cilën

¹ *Metoda filozofike e Hobbs-it është e modeluar sipas provave gjeometrike, bazuar në disa parime parësore dhe në përkufizime përmes të cilave nxjerr përfundime. Ai vendosi të krijojë një metodë të tillë filozofike të ngjashme me me provat gjeometrike, pas takimit me Galilein, gjatë udhëtimit të tij në Europë. Duke parë se përfundimet që vinin nga gjeometria ishin të pakundërshtueshme, Hobbsi u rrek të punonte sipas një mënyre të ngjashme në përpilimin e Leviathanit. Në atë kohë shkencëtarët besonin se Zoti e kishte krijuar gjithësinë sipas parimeve gjeometrike. Gjeometria mund të zbulonte natyrën njerëzore dhe të ndihmonte Hobbsi - in në formimin e sistemit të tij. (Thomas Hobbes, Leviatani, Tiranë 2005, f. xii)*

² *po aty, f.xiv*

njerëzit e tjerë kanë nevojë dhe kështu përplasen me njëri-tjetrin; *dhe e dyta, arsye natyrore*, që duhet ta rregullojë këtë dëshirë për të shpëtuar nga një shkatërrim natyror.

Hobsi për harmonizimin e këtyre parimeve në shoqëri mendonte, për një fuqi sovraane, përgjegjëse për mbrojtjen dhe sigurinë, autoriteti absolut i së cilës ishte të siguronte mbrojtjen e të gjithëve. Sepse gjendja e natyrës është në gjendje lufte, e cila krijohet vetvetiu, mjafton që një njeri i vetëm të arrinte të shkelë rregullat e përgjithshme. Ndërsa kuptimi për njeriun, nuk duket se është me patjetër i keq nga natyra, por se paqja në gjendjen e natyrës mund të priset edhe nga një njeri i vetëm. Duke e parë në këtë pikëpamje shoqërinë, Hobsi rekomandon teorinë e një shteti absolut. Dhe nën kujdesin e Leviatanit duhet të nënshkruhet kontrata politike, e cila formulohet në këtë trajtë:

Ia dorëzoi dhe ia besoi të drejtën time për vetëqeverisje një njeriu apo një kuvendi me kusht që t'ia dorëzosh edhe ti tënden dhe këtij njeriu apo kuvendi edhe ti t'i japësh të drejtën për të gjitha veprimet. Kjo është origjina e Leviatanit të madh, apo më mirë për të folur me respekt më të madh e Zotit të Vdekshëm të cilit ne i detyrojmë, përveçse Zotit të Pavdekshëm, paqen tonë dhe sigurinë tonë³.

Ky obligim politik që i jep origjinë shtetit i krahasuar me përbindëshin biblik Leviatan është pikëmbërritja e një filozofie të bazuar mbi ligje të supozuara që rregullojnë natyrën, përfshirë atë të njeriut.

Pra Hobsi sintetizon mendimin e tij duke u nisur nga një filozofi globale, që e koncepton natyrën të rregulluar nga ligje që njeriu mund t'i zbulojë, ashtu siç mund të zbulojë ligjin që rregullon vetë mënyrësjelljen e tij. Dhe ligji që rregullon mënyrësjelljen njerëzore është egoizmi absolut, përqendrimi i impenjimit vetjak në arritjen në shkallën më të lartë të mundshme të kënaqësisë dhe në shmangien e dhimbjes. Egoizmi pa kufij dhe evokimi i vdekjes shoqërojnë analizën e Hobsit, shprehet në këto ide të **Leviatanit**.

Prirja e krejt njerëzimit është një dëshirë e përhershme dhe pa pushim për një fuqi përtej fuqisë, që rresht vetëm me vdekjen. Dhe kjo jo vetëm sepse njeriu shpreson në një kënaqësi më të madhe se ajo të cilën tashmë e gëzon, apo sepse nuk mund të kënaqet me një fuqi më të vogël; por sepse njeriu nuk mund t'i garantojë vetes fuqinë dhe mjetet për një jetë të kënaqshme si ajo që çon, përveçse duke fituar përherë e më tepër fuqi⁴.

Kjo situatë është sintetizuar në shprehjen *Homo homini lupus* (njeriu për njeriun është ujk), për të cilën mendimi i Hobsit është mjaft i njohur. Dhe shpesh kjo formulë paraqitet si përshkrimi i një gjendjeje natyrore zanafillore të supozuar, nga e cila do të nisej njerëzimi për nënshkrimin e kontratës politike. Ajo rrjedh nga nevoja për të shmangur konfliktin e përhershëm që çon njeriun-ujk drejt vetasgjësimit, sepse secili sheh sigurinë e vet vetëm në asgjësimin e tjetrit.

³Thomas Hobbes, *Leviatani*, "Sistemet Politike" Tiranë 2005, f. 133. Njihet tashmë se zbulimi i ligjeve të natyrës është synimi i një epoke që nis me Frensis Bekon dhe që kulmon me ligjet e Njutonit i cili publikon *Principia Mathematica* në vitin 1687, tetë vjet pas vdekjes së Hobsit dhe në prag të "revolucionit të lavdishëm" (1688) që sanksionon përfundimisht në Angli autoritetin e parlamentit. (Njutoni është një vig, domethënë një ithtar i parlamentit, i tillë sa të konsiderohet për shkencat natyrore ai çka vugu Lok është për shkencën politike. L. A.

⁴Thomas Hobbes, *Leviatani*, "gjendja natyrore e njeriut përsa i përket lumturisë dhe mjerimit të njerëzve" Tiranë 2005, f. 76

Ky version negativ hobsian i gjendjes natyrore nuk do të prirej drejt asgjësimit të të ngjashmëve të tij, por drejt bashkëpunimit me ta. Nëse nënshkruan kontratën politike, nuk është për të shmangur më të keqen dhimbjen dhe vdekjen, që rrjedhin nga “lufta e të gjithëve kundër të gjithëve”, por për të përgatitur më të mirën, një bashkëpunim harmonik që i besohet jo vetëm mirësisë “natyrore” të njeriut, por ligjeve të përpikta.

Leviatani shpjegon, se interpretimi i ligjeve natyrore në shtet nuk varet nga librat e filozofisë morale, por nga tre arsye: *së pari*, ligji mbështet në arsyen natyrore; *së dyti*, ligji është ligj, fal pushtetit të sovranit; dhe *së treti*, interpretimi i ligjit natyror është vendim i gjykatësit i caktuar nga autoriteti i sovranit, në shërbim të zgjidhjes së mosmarrëveshjeve. Ndërsa, në aktin e gjykimit gjykatësi nuk bën gjë tjetër veçse shqyrton nëse përputhet më arsyen e drejtësinë natyrore kërkesa e palës.

Hobsi me ligje civile kuptonte ligjet që njerëzit janë të detyruar tu përmbahen jo sepse janë pjesëtarë të një shteti në veçanti, por si pjesëtarë të një shteti përgjithësisht. Ndërsa ligjet e veçanta u takon t'i njohin ata që merren me studimin e ligjeve të vendeve të ndryshme, ndërsa ligjin civil në përgjithësi duhet ta dijë gjithkush⁵

Përgjithësisht pranohet se gjendja e natyrës tek Hobsi është një hipotezë logjike, jo historike; ajo përbën një rrjedhim të nxjerrë nga pasionet, dhe përshkruan mundësinë e formës së jetës, që do të ekzistonte aty ku nuk do të kishte druajtje prej një pushteti të përbashkët. Ai nuk besonte të ishte njohur ndonjëherë një gjendje natyrore e përgjithshme në të gjithë botën edhe pse shihte një përafrim të ngushtë të saj “mes popujve të egër të Amerikës”.⁶

Ndërsa për ta kuptuar në thelb shtetin, Hobsi i referohet Romës antike, duke shpjeguar se, ligji i Romës quhej ligj civil, nga fjala *civitas* që do të thotë shtet. Ndërsa ligji nuk ka sensin e këshillës, por urdhër, e jo urdhër i cilitdo njeriu që i jepet çdo njeriu tjetër, por urdhër vetëm i një personi drejtuar dikujt që qysh më parë ishte i detyruar ti bindej atij. Përsa i përket termit ligj civil, i shtohet vetëm emri i personit që urdhëron, i cili është person *civitas*, që do të thotë njeriu i shtetit. Pra, ligji civil për qytetarin, është ai rregull, që shteti ka urdhëruar, me shkrim ose me mjete të tjera, të cilat shprehin vullnetin e shtetit, për të bërë dallimin midis asaj, që është e drejtë ose e padrejtë. Ky mekanizëm bën cilësimin midis asaj, që është në kundërshtim dhe asaj që nuk është në kundërshtim me rregullat e vendosura. Argumenti thellohet, në referim të një fjalimi publik të Ciceronit, i cili ja atribuon çdo pronësi ligjit civil. Le të braktiset, qoftë edhe një herë të vetme ligji civil, ose të rruhet pa kujdes për të mos thënë të dhunohet, dhe nuk ka asgjë për të cilën dikush mund të jetë i sigurt se do të marrë nga paraardhësit e tij ose do t'ua lërë fëmijëve të vet. Dhe më tej shton, shfuqizoni ligjin civil, dhe askush nuk do të dijë se ç'është e vetja dhe ç'është e tjetrit.⁷

Por, cili është ligjvënësi te Hobsi?

⁵ Thomas Hobbes, *Leviatani, “ligjet civile”* Tiranë 2005, f. 153

⁶ C.B. Macpherson: *Libertà e proprietà alle origini del pensiero borghese. La teoria dell'individualismo possessivo da Hobbes a Locke*, ISEDI, Milano 1978. (Elementë të ligjit natyror dhe politik, 1640; *De Cive*, 1642; *Leviatani*, 1651)

⁷ Thomas Hobbes, *Leviatani, Gjenerimi i shtetit*, Tiranë 2005, f.142

Sipas Leviatanit, atributin e ligjvënësit në të gjitha shtetet e ka sovranit, i cili mund të jetë një njeri i vetëm, (monarki) ose një kuvend njerëzish, e cila mund të quhet demokraci ose aristokraci. Sepse ligjvënësi është ai që bën ligjin. Ndërsa shteti dikton dhe urdhëron zbatimin e ligjit. Pra, sipas arsyetimit hobsian, shteti nuk person dhe rregullimi juridik kryhet përmes përfaqësimit, d.m.th të sovranit si i vetmi ligjvënës. Kjo është arsyeja, që Hobsi mendon se, askush tjetër, veç sovranit nuk mund të ketë mundësinë për të anuluar ligjin, sepse një ligj nuk mund të anulohet ndryshe, vetëm me anë të një ligji tjetër, që e ndalon vënien në zbatim të ligjit të mëparshëm.

Cilat janë raportet e sovranit me zakonin?

Në kushtet politike, kur një zakon i vjetër merr atributet e ligjit, nuk është kohëzgjatja e tij që ia jep atë forcë ligjore, përkundrazi është pëlqimi i sovranit i shprehur edhe përmes heshtjes, sepse heshtja është shenjë e pëlqimit dhe zakoni mbetet si ligj për aq kohë sa sovranit ruan heshtjen lidhur me të (zakonin - ligj). Për pasojë, në kushtet që sovranit shtron një problem juridik, të bazuar në ligjet e bëra më parë, kohëzgjatja e tyre nuk çënon të drejtën e sovranit. Ndërsa juristët (tezmatetë) janë në shërbim, të realizimit teknik të këtyre parimeve, ata kanë për detyrë, të konsiderojnë si ligje zakonore, vetëm ato, që janë me brendi juridike dhe të pranuar si të arsyeshme. Ndërsa e kundërta duhet të ndodh me ato zakone të këqija, të cilat anulohen, sepse nuk kanë aftësi juridike. Por gjykimin, për atë që është e arsyeshme dhe për atë që duhet të anulohet i takon atij që bën ligjin “kuvendet ose monarku sovran”⁸. Kurse në kushtet kur ligjvënësi është bërë i njohur dhe ligjet janë shpallur në mënyrë publike, në mënyrë të mjaftueshme, ka ende dy kushte për t’i bërë ato të detyrueshme: *së pari*, natyra e ligjit nuk është germa, por interpretimi autentik i ligjit, që jep mendimin e ligjvënësit; dhe *së dyti*, interpretimi i të gjitha ligjeve varet nga autoriteti sovran dhe interpretuesit e tyre mund të jenë vetëm ata persona që cakton sovranit, sepse vetëm sovranit ka detyrim t’i bindet nënshtetasi.

Përgjithësisht pranohet se gjendja e natyrës tek Hobsi është një hipotezë logjike, jo historike; ajo përbën një rrjedhim të nxjerrë nga pasionet, dhe përshkruan mundësinë e formës së jetës, që do të ekzistonte aty ku nuk do të kishte druajtje prej një pushteti të përbashkët. Ai nuk besonte të ishte njohur ndonjëherë një gjendje natyrore e përgjithshme në të gjithë botën edhe pse shihte një përafrim të ngushtë të saj “mes popujve të egër të Amerikës”.⁹

Duke u nisur nga pikëpamja e Mekfersonit, mendimi politik anglez, nga shekulli XVII deri në shekullin XIX dallohet për një ide të re, quajtur “individualizëm posesiv” përmes së cilës mund të kuptohet mendimi liberaldemokratik nga Xhon Mill deri në ditët e sotme nëse shihen si rezultati i vijimësisë dhe i rrënjosjes së kësaj teze. Koncepti i individualizmit posesiv premtion gjithashtu të jap një kuptim të ri të teorive kryesore politike të shekullit të gjashtëmbëdhjetë”.¹⁰

⁸ Thomas Hobbes, *Leviatani*, “Zakoni bëhet ligj jo falë kohëzgjatjes, por me pëlqimin e sovranit” Tiranë 2005, f. 155

⁹ Macpherson: *Libertà e proprietà alle origini del pensiero borghese. La teoria dell’individualismo possessivo da Hobbes a Locke*, ISEDI, Milano 1978. (Elementë të ligjit natyror dhe politik, 1640; *De Cive*, 1642; *Leviatani*, 1651)

¹⁰ *Ibid.*

Individualizmi posesiv mund të konsiderohet njëvlerësi i pronave private individuale të Kapitalit Marksist. Ky i projektonte në konceptin e pronës kapitaliste të klasës “jo më individuale; dhe jo e të gjithëve, por vetëm e borgjezëve”¹¹ dhe i jepte një ngjyrim negativ, në kuptimin që do të ishte një pengesë për zhvillimin e mëtejshëm të forcave prodhuese dhe të bashkëjetesës civile. Mекfersoni nuk ndjek Marks-in në këtë drejtim dhe individualizmi posesiv i tij duket një karakteristikë e borgjezisë në ngjitje, një premisë faktike në kuptimin më modern .

Mекferson duket se e studion Hobsin në një pozicion të ndryshëm, nga ai i mbështetësit të shtetit monarkik absolut. Sovraniteti i pandashëm siç është trajtuar mund t'i takojë edhe një kuvendi. Dhe pushteti absolut ka një cak themelor, në kohën kur sovranin nuk garanton sigurinë, detyra e bindjes së nënshtetasve humb vlerën e saj.

Por, duhet të pranohet se, nuk mund të mendohet Hobsi si një pararendës i liberalizmit; Leviatani i tij nuk është një shtet i të drejtës së bazuar mbi ndarjen e pushteteve. Përkundrazi Mario Tronti në konceptin e përqendrimit të autoritetit¹², sheh një modernitet më të madh të Hobsit në krahasim me Lokun në përshquarjen e karakteristikave të asetit politik të shoqërive që i përcaktohen kapitalizmit të pjekur. Ndërsa, në lidhje me Zotin e Vdekshëm, Hobsi i përcakton kështu format e mundshme të shtetit:

Kur përfaqësuesi është një njeri i vetëm, atëherë Shteti është një monarki. Kur është një kuvend i të gjithë atyre që bashkohen, atëherë është një Demokraci apo Shtet popullor. Kur është një kuvend i përbërë vetëm nga një pjesë e atyre që bashkohen, është ajo që quhet Aristokraci. Nuk mund të ketë tjetër tip shteti, pasi është e nevojshme që njëri, disa apo të gjithë të zotërojnë pushtetin suprem, që është i pandashëm.¹³

Siç shihet, vazhdon *logos tripolitikos* i Herodotit, pushteti është përcaktuar me konceptin e përfaqësimit dhe mund të jetë edhe “popullor”, një “demokraci” në të cilën të gjithë zotërojnë pushtetin suprem. Më tej saktësohet se tek Leviatani duhet të garantohet barazia e të gjithëve kundrejt ligjit, arsimit, edukimit. Detyrë e shtetit është edhe të sigurojë mirëqenien materiale, nuk është e lejuar të qënit inaktiv, por atyre që nuk janë në gjendje të punojnë duhet t'u sigurohet ndihma publike pa “risqet e mëshirës private”. Pra, jo vetëm garanton pronën private, por është themelues i kësaj të drejte “pa shtetin dhe para shtetit nuk ka pronë private”¹⁴, Leviatani pengon krijimin e monopoleve që mund të minojnë barazinë e të gjithëve kundrejt ligjit¹⁵: ky është një shtet “demokratik” që duket se i paraprin ligjeve antitrust dhe shtetit të mirëqenies .

Pra pikërisht në “individualizmin posesiv” shihet elementi i vijmësisë mes Hobsit dhe mendimit liberaldemokrat të mëpasëm: dhe marrja nën mbrojtje e pronës nënkupton kontroll të pushtetit ekonomik (monopole) dhe siguri sociale, është e qartë se tek Hobsi mund të shihen edhe karakteristikat themelore të një konceptimi politik që përgatit kushtet teorike për asetin institucional tipik të shoqërisë industriale (demokraci përfaqësuese). Ky aspekt është gjithashtu i rëndësishëm për teorinë e tij mbi pushtetin absolut; për më tepër rrjedh nga autonomia e plotë e politikës nga morali dhe nga religjioni.

¹¹ Karl Marks, *Kapitali 2*, Tiranë 1975, f. 157

¹² Mario Tronti: *Hobbes e Cromwell, në Stato e rivoluzione in Inghilterra*, Milano 1979.

¹³ Thomas Hobbes, *Leviatani*, “Ilojet e ndryshme të shtetit të vendosur nëpërmjet themelimit dhe trashëgimia e pushtetit Sovran” Tiranë 2005, f. 118

Duke ndjekur mendimin hobsian personaliteti njerëzor konceptohet si një makinë vetëlëvizëse që drejtohet nga egoizmi; mënyrësjellja shoqërore nuk diktohet nga morali, por nga përshtatshmëria e rregullave dhe nga autoriteti.

Përsa i përket religjionit, Hobsi, i cili qe akuzuar edhe për pabesim (në fe), e tepron tek **Leviatani** me njohjet formale përndruese, duke e reduktuar krishtërimin në besimin tek Krishti “shpëtimtari ynë”. Pasi është kryer ky akt besimi, njeriu hobsian pranon religjionin vetëm si element të rendit civil. Leviatani përjashton që mund të flitet për shtet të krishterë, të drejtuar nga normat e Ungjillit. Shteti i vetëm që përkufizohet kështu në histori qe Izraeli, roli i të cilit është përmbyllur me ardhjen e Krishtit dhe me misionin e tij shpëtimtar¹⁶.

Siç thotë qartë një tjetër prej studjuesve të Hobsit, Nikola Mateuçi, ligji natyror dhe ligji hyjnor mbesin pothuaj pezull në një gjendje të papërcaktuar nën gjykimin dhe dëshirën e politikanit. Në mendimin politik të Hobsit, sovrani është në botë i Plotfuqishëm si Zoti dhe vetëm në *voluntas* të tij gjendet drejtësia¹⁷. Përmes kësaj analize dallojmë këto veçori të Leviatani.

1. Sovrani është term pavetor që mund të nënkuptojë “shtetin popullor”
2. Lënia mënjane e nderimit kundrejt religjionit, supozohet ateizëm.
3. Bazimi i së drejtës së mbretit mbi “hyjnoren” nuk i përgjigjet frymës së epokës.

Ndërsa nga ana tjetër, Zoti mbetet - edhe për shkencëtarët e mëdhenj si Njutoni - ligjvënësi suprem i gjithësisë dhe religjioni pajtohet plotësisht me shkencën. Pikërisht interpretimet e trajtuara deri më tani lejojnë të kuptohet ajo çka është thelbësore tek Hobsi: *së pari*, ai duhet parë si një prej themeluesve të doktrinës politike të epokës së shkencës; *së dyti*, mendimi i politik, është produkt i përplasjes kulturore; *së treti*, referenca ndaj së drejtës natyrore, në epokën e shkencës; dhe *së katërti*, kemi jehonën e një kulture femërore, refleksion i cili mund të nisë nga vetë titulli i veprës.¹⁸

Ndërsa te *Mbretëria e errësirës*.¹⁹ Hobsi braktis tonin e ftohtë që përshkon tre pjesët e mëparshme, për të përshtatur stilin e sulmit, në rradhë të parë kundër kishës së Romës, por në realitet kundër botës së magjisë dhe të bestytnisë që papizmi do të trashëgonte nga

¹⁶ Thomas Hobbes, *Leviatani, Shteti i krishterë, Tiranë 2005, f.235 - 241*

¹⁷ Matteucci: *Introduzione a Hobbes, il Mulino, Bolonjë 1982.*

¹⁸ *Leviatani është një përbindësh biblik (që shfaqet në librin e Jovit) dhe “nuk ka fuqi mbi tokë që mund të krahasohet me të tijën”. Përgjithësisht mendohet se pikërisht për këtë cilësi plotfuqie Hobsi ka përdorur termin Leviathan. Por të zgjedhësh një përbindësh për të përcaktuar asetin politik, është në vetvete i pazakontë. Duhet shtuar se sipas leximit biblik, Leviathan është i gjinisë femërore. Njëvlerësi mashkullor është Behemoth (emër që Hobsi do ta zgjedhë si titull të një shkrimi të mëpasëm me nëntitullin: Historia e shkaqeve të luftërave civile në Angli, 1668*

¹⁸. *Zoti i vdekshëm i Hobsit është pra një përbindësh femëror. Ndërsa më tej: Leviatani përmban një të katërtën pjesë me titullin: Mbretëria e errësirës. Aty vërehet se, në lidhje me veprën më të madhe të ideatorit dhe me atë të mëparshmen De Cive: Thomas Hobbes, Leviatani, “ligjet civile” Tiranë 2005, f. 153*

¹⁹ *Thomas Hobbes, Leviatani, “Mbretëria e errësirës” Tiranë 2005, f. 254 (Ndërsa te Mbretëria e errësirës kemi një lidhje me De Cive. Këto dy vepra janë të ndara në tre pjesë, që mbajnë si tituj përkatësisht: liria, pushteti; religjioni; njeriu; Shteti; Shteti i krishterë Ndërsa Leviatani, në të vërtetë ka një të katërtën e saj, që qëndron megjithatë jashtë njësisë së strukturës, me titullin)*

lashtësia heleno-romake. Mbretëria e errësirës është ajo e magjisë dhe e demonizmit, që rridhte, prej padijes nga ana e njerëzve, të cilët nuk janë në gjendje të shpjegojnë shkaqet e vërteta të fenomeneve politike dhe sociale.

Hobsi nuk mendonte se shtrigëria e tyre është një pushtet i njëmendtë, por se megjithatë janë ndëshkuar me të drejtë për besimin e rremë që kanë se mund të kryejnë veprime keqdashëse, bashkë me qëllimin për t'i kryer ato, në rast se munden; veprimtaria e tyre është më pranë një religjioni të ri sesa një mjeshtërie apo një shkence²⁰.

Ky është një vlerësim për predikuesit e rremë, të cilët mundohen me doktrina të errëta dhe jo shkencore, i prezantojnë si interpretime juridike, për të arritur sundim mbi njerëzit, me dënimin e të cilëve fillon pjesa e katërt e **Leviatanit**. Njerëzit shkelin ligjet të shtyrë nga predikuesit e rremë, të cilët kanë këto tipare:

1. Janë një klasë njerëzish, që mjeshtërisht interpretojnë keq ligjin e natyrës, duke e vënë në mospajtim me ligjin civil.
2. Doktrina e tyre e bazuar në disa tradita të kohëve të shkuara, që janë në kundërshtim me detyrën e një nënshtetasi.
3. Njeriu kur tmerrohet prej shpirtrave dhe prej supersticionit të vet apo prej besimit të tepruar që i ka dhënë të tjerëve, të cilët i kanë treguar ëndrra dhe vizione të çuditshme, nëse për këtë ai do të bëjë diçka të kundërt me ligjet, nuk do të duhet shfajësuar nga tmerri i tij.²¹

Prandaj pjesa e fundit e **Leviatanit** është kushtuar një bote të ndryshme, që mund të vëre në rrezik integritetin e nënshtetasis, në të cilën gërshetohen “disa tradita të kohëve të shkuara, doktrinat e predikuesve të rremë dhe religjioni i ri i shtrigave”²².

Natyrisht objekti kryesor i polemikës hobsiane, është pushteti religjioz, në radhë të parë ai i kishës katolike, që pretendon të kufizojë atë politik; me synimin që të riafirmojë me një interpretim absolut sovranitetin mbi atë të institucioneve politike, por së brendshmi këtij konceptimi vjen shqetësimi prej mbretërisë së errësirës. Me këtë term Leviatani përkufizon pushtetin e Papës, i cili kishte arritur të njihej si peshkopi mbarëbotëror nën pretendimin e pasardhësit të Shën Pjetrit, gjithë kjo hierarki (mbretëria e errësirës) krahasohet me mbretërinë e zanave d.m.th me përrallat e plakave në Angli për fantazmat e shpirtrat dhe për marifetet që ata kurdisin natën.

Ndërsa, duke studiuar fillimet e këtij sundimi krishtian, shihet se papati ishte fantazma e perandorisë së vdekur romake e ulur me kurorë mbi varrin e saj. Sepse papati lindi nga rrënojat e pushteti pagan²³. Analiza e kësaj mbretërie shkon deri në kritikën ekstreme, duke i akuzuar klerikët se, ata u heqin të rinjve përdorimin e arsyes, përmes shpërdorimit të shkrimeve të shenjta. Për pasojë pushteti shpirtëror i papës mbështetet vetëm në frikën, që njerëzit e mashtruar kanë nga shkishërimi. Përmes këtyre mjeteve kleri pretendonte, se

²⁰ Thomas Hobbes, *Leviatani*, “Mbretëria e errësirës” Tiranë 2005, f. 254.

²¹ Thomas Hobbes, *Leviatani*, “Mbretëria e errësirës” Tiranë 2005, f. 254.

²² Thomas Hobbes, *Leviatani*, “Mbretëria e errësirës” Tiranë 2005, f. 260.

²³ Thomas Hobbes, *Leviatani*, *Mbretëria e errësirës*, Tiranë 2005, f.197

mbretëria e Perëndisë ekziston në botë, dhe mbi këtë bazë kërkesa e tij ishte, të kishte pushtet të pavarur, nga ai i shtetit civil

Filozofi i shtetit absolut i njeh gruas një rol, që rrjedh nga mospërjashtimi i ekzistencës historike të matriarkatit dhe nga funksioni gjenetik i saj, edukimi i fëmijëve. Kjo pikëpamje e shtyn Hobsin, të mos besojë në epërsinë natyrore të burrit ndaj gruas, por në sundimin e fituar nëpërmjet konfliktit. Këtë e përsos te *De Cive*, duke arsyetuar se, pabarazia e forcave natyrore është tepër e vogël që mashkulli të mund të fitojë epërsi mbi femrën pa iu drejtuar luftës. Kjo dukuri, është si rrjedhojë e fitores në këtë luftë, që pjesa më e madhe e shteteve janë drejtuar nga etërit dhe jo nga nënat²⁴. Leviatani, nuk është gjë tjetër veçse, një përbindësh femëror në funksion të interesave sociale dhe politike të shoqërisë njerëzore, e cila sipas tij e ka të domosdoshëm funksionimin e një Leviatani shtetëror. Por pse Hobsi pohonte “frika dhe unë jemi binjakë”.

Kjo ka të bëjë me lindjen e tij të parakohshme, që erdhi si rrjedhojë e frikës së të ëmës prej sulmit të paralajmëruar të Armadës spanjolle kundër Anglisë dhe po ta studiojmë frikën si filozofi, ajo vë në lëvizje të gjithë botëkuptimin hobsian: frikë prej luftës, mbi të gjitha prej luftës civile; por frikë edhe prej sfidës kulturore të mbretërisë së errësirës, të përbindëshave me nuanca femërore, të shtrigave, të magjisë. E njëjta frikë që kishte mbushur plot me turra drush Europën, që i kishte bërë vitet e pjekurisë së Hobsit si vite qendrorë të jetës së tij shkencore.

Analiza hobsiane e gjykon personalitetin njerëzor si një makinë vetëlëvizëse që drejtohet nga egoizmi; mënyrësjellja shoqërore nuk diktohet nga morali, por nga përshtatshmëria e rregullave dhe nga autoriteti.

Referenca:

1. Thomas Hobbes, Leviatani, Tiranë 2005, f. xii
2. Thomas Hobbes, Leviatani, “Sistemet Politike” Tiranë 2005, f. 133
3. Thomas Hobbes, Leviatani, “Ligjet Civile” Tiranë 2005, f. 153
4. C.B. Macpherson: Libertà e proprietà alle origini del pensiero borghese. La teoria dell'individualismo possessivo da Hobbes a Locke, ISEDI, Milano 1978. (Elemente të ligjit natyror dhe politik, 1640; De Cive, 1642; Leviatani, 1651)
5. Thomas Hobbes, Leviatani, “Gjenerimi i shtetit”, Tiranë 2005, f142
6. Karl Marks, Kapitali 2, Tiranë 1975, f. 157
7. Mario Tronti: Hobbes e Cromwell, në “Stato e rivoluzione in Inghilterra”, Milano 1979.
8. Thomas Hobbes, Leviatani, “Shteti i krishterë”, Tiranë 2005, f.235 - 241
9. Matteucci: Introduzione a Hobbes, il Mulino, Bolonjë 1982.
10. Thomas Hobbes, Leviatani, “Mbretëria e errësirës” Tiranë 2005, f. 197-254.

Marrëdhëniet NATO–BE

MA. Edmond Nushi
Drejtoria e Politikave Strategjike të Sigurisë dhe Mbrojtjes

Abstrakt: *Viti 2011 shënon përvjetorin e 12-të të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP) të Bashkimit Evropian (BE), e cila tani quhet Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP) dhe përvjetorin e 62-të të Paktit të Atlantikut të Veriut (NATO).*

Ndryshime të shumta kanë ndodhur dhe janë në proces jo vetëm në kontinentin evropian por edhe më gjerë.

Është fakt historik se bashkëpunimi i SHBA me vendet evropiane ka qenë i pandashëm. Koha provoi dhe ka shtruar si domosdoshmëri vazhdimin e këtij bashkëpunimi në kushte dhe rrethana të reja.

Pikërisht në këtë shkrim mbështetur në eksperiencën e grumbulluar dhe situatat aktuale e të perspektivës, sillen një sërë argumentesh për thellimin e bashkëpunimit në fushën e mbrojtjes midis NATO-s dhe BE.

Ky vit shënon përvjetorin e 12-të të Politikës Europiane të Sigurisë dhe Mbrojtjes (ESDP) të Bashkimit Evropian (BE), e cila tani quhet Politika e Përbashkët për Sigurinë dhe Mbrojtjen (CSDP) dhe përvjetorin e 62-të të Paktit të Atlantikut të Veriut (NATO). Gjatë këtyre viteve kanë ndodhur ndryshime të mëdha dhe të dy institucionet kanë kaluar nëpër momente të veçanta të transformimit si dhe të analizës së vetvetes.

Pas një periudhe të gjatë të debati dhe reflektimi, Bashkimi Evropian, më në fund, ratifikoi në nëntor 2009, Traktatin e Lisbonës. Në vijim ka filluar një numër reformash shumë ambicioze institucionale për të prezantuar veten si një fuqi më të besueshme në politikën botërore. Me kërkesë të Këshillit të Europës, pak kohë më parë u publikua raporti “Projekti Evropian 2030 - Sfidat dhe Mundësitë”, i cili u përgatit nga një grup i specializuar ekspertësh.

Raporti nënvizon sfidat dhe mundësitë me të cilat përballet BE-ja për të prezantuar veten si një “assertive power - fuqi të sigurt”, në politikën botërore. Raporti gjithashtu kërkon që BE të bëhet një fuqi “ambicioze” dhe “transformuese” në politikën botërore dhe të rrisë kapacitetet e saj ushtarake.

Në mënyrë të ngjashme, me kërkesë të Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s Rasmusen, Grupi i Ekspertëve i udhëhequr nga ish-Sekretarja Amerikane e Shtetit, Madlen Ollbrajt (Madeleine Albright), përgatiti raportin “NATO 2020: Siguri e garantuar - Angazhim Dinamik”, i cili përbënte bazën e draftit për Koncepti e Ri Strategjik, miratuar në Samitin e Lisbonës nga Kryetarët e Shteteve dhe Qeverive të vendeve të NATO-s.

Raporti, i cili u botua më 17 maj 2010, përcaktonte kërcënimet e reja me të cilat përballet Aleanca, për më shumë se një dekadë që nga publikimi i dokumentit të Konceptit Strategjik të vitit 1999. Ky raport dhe Koncepti i Ri Strategjik bëjnë një numër sugjerimesh shumë ambicioze për të ardhmen e NATO-s, duke përfshirë përmirësimin e qasjes gjithëpërfshirëse të NATO-s, e cila kombinon veprimet ushtarake dhe civile në përgjigje të administrimit të krizave. Sipas qasjes gjithëpërfshirëse, NATO-s i kërkohet që, krahas zhvillimit të aftësive të saj civile, të ketë prioritet forcimin e bashkëpunimit me aktorët ndërkombëtarë, si OKB-ja dhe BE-ja.

Në deklaratën e Samitit të Lisbonës, mbi marrëdhëniet NATO-BE, thuhej se:

“NATO dhe Bashkimi Europian (BE) ndajnë vlera të përbashkëta dhe interesa strategjike dhe janë duke punuar krah për krah në operacione të menaxhimit të krizës. Ne jemi të vendosur, për këtë arsye, për përmirësimin e partneritetit strategjik NATO-BE, siç është rënë dakord nga dy organizatat tona. Ne i mirëpresim nismat e fundit nga disa aleatë dhe idetë e propozuara nga Sekretari i Përgjithshëm. Duke u bazuar në këto iniciativa dhe në udhëzimet e ofruara nga Koncepti i ri Strategjik, ne inkurajojmë Sekretarin e Përgjithshëm të vazhdojë të punojë me Përfaqësuesin e Lartë të BE-së...”

“NATO njih rëndësinë e një mbrojtjeje europiane më të fortë e të aftë dhe përsëritet përpjekjet e BE-së për forcimin e aftësive dhe kapaciteteve të saj për adresimin e sfidave të përbashkëta të sigurisë, me të cilat përballen si NATO ashtu edhe BE. Këto zhvillime kanë implikime dhe rëndësi domethënëse për Aleancën si një e tërë dhe kjo është arsyeja që NATO është e gatshme të mbështesë dhe të punojë me BE-në në këto përpjekje të përforcuara të përbashkëta, duke njohur edhe shqetësimet aktuale të Aleatëve. Aleatët, jo anëtarë të BE-së, kanë dhënë dhe vazhdojnë të japin kontribute të konsiderueshme në këto përpjekje”.

Kuadri aktual i bashkëpunimit

Gjatë viteve '90, NATO dhe BE nisën hapat e para për të institucionalizuar marrëdhëniet e tyre, për të rritur më shumë përgjegjësinë ndaj çështjeve të mbrojtjes në Europë. Vlerat politike që ishin baza e marrëdhënieve NATO-BE u përcaktuan në dhjetor të vitit 2002.

Për shkak të zgjerimit të dy organizatave në vitin 2004 si dhe anëtarësimit të Bullgarisë dhe Rumanisë në Bashkimin Europian, në vitin 2007, –tashmë NATO dhe BE kanë 21 anëtarë të përbashkët.

Historiku i bashkëpunimit

Zyrtarët e NATO-s dhe BE-së janë takuar në mënyrë të rregullt për të diskutuar çështje me interes të përbashkët. Këto takime kanë qenë të niveleve të ndryshme, në nivel Ministrash, ambasadorësh, përfaqësuesish ushtarakë dhe këshilltarësh.

Përfaqësues të Përhershëm ushtarakë janë koordinuar me marrëveshje për të pasur një bashkëpunim në nivel operativ. Një grup koordinator i NATO-s ka operuar tek stafi i ushtarakëve të BE-së, që në nëntor 2005 dhe një zyrë e BE-së u instalua në SHAPE (Komanda Strategjike e NATO-s për Operacione në Mons, Belgjikë), në mars të 2006.

Një shkëmbim letrash midis Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s dhe të Presidencës të Bashkimit Evropian, në janar të vitit 2001, kanë përcaktuar sferën e bashkëpunimit dhe modalitetet për konsultim në çështjet e sigurisë ndërmjet dy organizatave. Deklarata mbi ESDP, në dhjetor të vitit 2002 dhe marrëveshja për strukturën e bashkëpunimit, në mars 2003, shënoi rritjen e këtij bashkëpunimi.

Deklarata e NATO-s dhe BE-së mbi ESDP

Deklarata e NATO-s dhe BE-së mbi ESDP (*European Security and Defence Policy*) që u miratua në 16 dhjetor 2002, riafirmoi që BE do të ketë akses në aftësitë e NATO-s për të planifikuar operacionet e tyre ushtarake dhe përsëriti vlerat politike të strategjisë për partneritetet, si konsultim të mirë reciprok. NATO dhe BE do të jenë të barabartë në të drejtën e tyre për marrë vendime në mënyrë të pavarur, respektim për interesat e anëtarëve të BE-së dhe të NATO-s, respekt ndaj Kartës së Kombeve të Bashkuara si dhe koherencë, transparencë dhe inkurajim reciprok për të rritur aftësitë ushtarake që kërkohen nga të dyja organizatat.

NATO dhe Bashkimi Evropian, të cilët kanë 21 anëtarë të përbashkët, kanë institucionalizuar bashkëpunimin e tyre me Marrëveshjen “Berlin Plus”, e cila është titulli i shkurtuar i një pakete marrëveshesh ndërmjet NATO-s dhe BE-së, bazuar në konkluzionet e Samitit të NATO-s në Uashington (1999). “Berlin Plus” përbëhet nga pjesët e mëdha si më poshtë:

- Marrëveshja e Sigurisë NATO-BE;
- Sigurimi i aksesit të kapacitetet planëzuese të NATO-s për Operacionet e Menaxhimit të Krizës (CMO), drejtuar nga BE;
- Disponibiliteti i aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s për Operacionet e Menaxhimit të Krizës (CMO), drejtuar nga BE;
- Procedurat për dhënien, monitorimin, kthimin dhe tërheqjen e aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s;
- Termat e referencës për Zëvendëskomandantin Suprem të Forcave Aleate në Europë (DSACEUR) dhe opsione të komandës europiane për NATO-n;
- Modalitetet për konsultimet BE-NATO, në kontekst të shfrytëzimit nga BE të aseteve dhe kapaciteteve të NATO-s gjatë një Operacioni të Menaxhimit të Krizës (CMO), drejtuar nga BE.
- Modalitetet për forcimin koherent dhe të ndërsjellë të Kërkesave për Kapacitete.

Të gjitha pjesët e mësipërme janë “lidhur” bashkë me të ashtuquajturën “Marrëveshje Kuadër”, e cila konsiston në një shkëmbim letrash ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Këshillit të BE-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm të NATO-s, më datë 17 mars 2003.

Që nga kjo datë, paketa e marrëveshjeve “Berlin Plus” është në fuqi dhe shërben si bazë për marrëdhëniet praktike ndërmjet BE-së dhe NATO-s, duke i mundësuar BE-së të ketë

mbështetjen planëzuese të NATO-s dhe kapacitete e asete të NATO-s në kryerjen e çdo operacioni.

Bashkëpunimi në rajon

Bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe BE-së në Ballkan cilësohet si bashkëpunimi më i mirë që dy organizatat kanë pasur deri më tani.

Në korrik të vitit 2003, Bashkimi Evropian dhe NATO kanë publikuar dokumentin “Përfaqja e përbashkët për Ballkanin Perëndimor”. Dokumenti përcakton zonat thelbësore për bashkëpunimin, vizionin e përbashkët dhe vendosmërinë e të dyja organizatave për të sjellë stabilitet në këtë rajon.

- Ish- Republika Jugosllave e Maqedonisë. Më 31 mars 2003, Operacioni i BE-së, Concordia, mori përsipër përgjegjësinë nga misioni i NATO-s, Operacioni Harmonia e Aleatëve (Operation Allied Harmony), në ish-Republikën Jugosllave të Maqedonisë.

- Bosnjë - Hercegovina. Bashkimi Evropian zëvendësoi misionin SFOR të NATO-s me një mision të ri, me emër “Operation Althea”, në dhjetor të 2004. Forcat e BE-së, EUFOR, operojnë nën marrëveshjen “Berlin-Plus”. Gjithashtu Selia e operacioneve të BE-së ndodhet në SHAPE.

- Kosova. NATO ka qenë organizata paqeruajtëse udhëheqëse në Kosovë (KFOR), duke filluar në vitin 1999. BE-ja ka kontribuar, me anë të aseteve civile në Misionin e OKB-së në Kosovë (UNMIK), për vite dhe ka pranuar të marrë përsipër pjesën e policisë në misionin e OKB-s. EULEX, në Kosovë, është vendosur më dhjetor 2008 dhe përbën misionin më të madh civil që është lançuar ndonjëherë nga ESDP (European Security and Defence Policy). Qëllimi kryesor është që të asistojë dhe të ndihmojë qeverinë e Kosovës në zbatimin e ligjeve, veçanërisht policët, sistemin gjyqësor dhe pikat doganore. EULEX punon ngushtë me KFOR-in në këtë fushë.

Bashkëpunimi në rajone të tjera

- Afganistani. NATO dhe BE-ja kanë rolet kryesore në arritjen e paqes dhe stabilitetit në Afganistan, në kuadër të përpjekjeve të komunitetit ndërkombëtar për të zbatuar përfaqshen gjithëpërfshirëse në ndihmën për vendin. ISAF ndihmon për të krijuar një mjedis të qëndrueshëm dhe të sigurt, në mënyrë që qeveria Afgane të ndërtojë institucione demokratike, të zgjerojë zbatimin e ligjeve dhe të rindërtojë vendin.

EUPOL, misioni i BE-së në Afganistan, ka filluar në vitin 2007. EUPOL filloi programin për të reformuar sistemin gjyqësor dhe ka dhënë fonde edhe për projekte civile. Problemet më të mëdha, të hasura në praktikën e bashkëpunimit ndërmjet NATO-s dhe BE-së, janë hasur në bashkëpunimin konkret ndërmjet ISAF dhe EUPOL.

- Darfur. Si NATO dhe BE kanë mbështetur misionin e Bashkimit Afrikan në Darfur, me aktorë të tjerë që kanë ndihmuar në kuadër të sigurimit kryesisht të transportit ajror.

- Pirateria. Nga shtatori i vitit 2008, forcat detare të NATO-s dhe BE-së janë vendosur së bashku me vende të tjera, afër bregdetit të Somalisë, për misionin e tyre kundër piratëve.

Nga kritikët, pavarësisht se duket se, në mungesë të një kuadri politik, në praktikë ky bashkëpunim është i mirë, ekzistenca e dy misioneve të ndara, të dyja me mandat të Këshillit të Sigurimit, cilësohet “e turpshme”.

Fusha të tjera bashkëpunimi

- Aftësitë. NATO dhe BE kanë formuar Grupin e aftësive (NATO-BE Capability Group), në maj 2003, me synimin që të sigurohet koherencë si dhe të përforcohen dhe zhvillohen aftësitë e tyre të përbashkëta.

- Terrorizmi dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë. NATO dhe BE janë të bindura të luftojnë terrorizmin dhe përhapjen e armëve të shkatërrimit në masë. Këto organizata kanë shkëmbyer informacione rreth aktiviteteve të tyre në fushën e mbrojtjes civile nga kërcënimet kimike, biologjike, radiologjike dhe bërthamore.

- Pjesëmarrja. Për shkak të zgjerimit të dy organizatave në vitin 2004, si dhe anëtarësimin e Bullgarisë dhe Rumanisë në Bashkimin Evropian, në vitin 2007, NATO dhe BE kanë aktualisht 21 anëtarë të përbashkët.

Kanadaja, Islanda, Norvegjia, Turqia, SHBA, si anëtare të NATO-s por jo anëtare të BE-se, marrin pjesë në të gjitha takimet e përbashkëta NATO-BE. Gjithashtu, e njëjta gjë vlen për vende si Austria, Finlanda, Suedia, Malta që janë anëtare të BE-së, por jo anëtare të programin PfP të NATO-s.

Qipro nuk është anëtare e Pfp dhe nuk ka një marrëveshje për sigurinë me NATO-n. Për këtë arsye, Qipro nuk mund të ketë akses në informacionet e klasifikuara dhe nuk mund të jetë pjesëmarrëse në takimet zyrtare NATO-BE.

Kjo, si pasojë e vendimeve të marra në dhjetor 2002 nga NATO dhe BE, përpara zgjerimit të organizatave në 2004, kur NATO kishte 19 anëtarë dhe BE kishte 15. Qipro, nga ana tjetër, mund të marrë pjesë në takimet jo-zyrtare të niveleve të ndryshme.

Problemet e bashkëpunimit

Problemet kryesore në marrëdhëniet NATO-BE janë theksuar tepër qartë në Deklaratën e Samitit Strasburg/Kehl, në mënyrë të përmbledhur-ESDP, (tani CSDP), duhet të zhvillohet në një mënyrë plotësuese dhe jo antagonistike me NATO-n. Ky konstatim bën thirrje për një bashkëpunim më të sigurtë dhe intensiv ndërmjet dy organizatave, të cilat siç thuhet, citojmë-”gjenden në të njëjtin qytet, por jetojnë në planetë të ndryshëm”.

Problemi madhor dhe substancial janë marrëdhëniet Greko-Turko-Qipriote, paraqitur më poshtë. Pa zgjidhjen përfundimtare të problemeve të këto marrëdhënie dhe pa zbatimin edhe në praktikë të Traktatit të Lisbonës, nuk mund të shpresohet në një marrëdhënie normale ndërmjet BE-së dhe NATO-s, pavarësisht se disa masa paraprake, të tilla si ato që rekomandohen nga Ketrin Eshtën (Catherine Ashton) mund të përmirësojnë deri diku klimën e bashkëpunimit.

Nevoja për bashkëpunim

Në mënyrë më specifike, bashkëpunimi ndërmjet NATO-s dhe BE-së është i nevojshëm kryesisht në fushat e rëndësishme si më poshtë:

1. Përqasja gjithëpërfshirëse: Aktualisht bashkëpunimi NATO-BE është më tepër i nevojshëm në terren. Mësimet kryesore të operacioneve të fundit të NATO-s në B-H, Kosovë dhe Afganistan tregojnë qartazi se operacionet ushtarake duhet të integrohen në tërësi me aktivitetet e rikonstruktimit, të drejtuara nga civilët. Të tilla janë p.sh. aktivitete që lidhen me ndërtimin e qeverisjes dhe gjykatat, trajnimin e policisë, rifillimin e prodhimit bujqësor, sigurimin e ujit të pijshëm, energjisë elektrike, shërbimet shëndetësore, etj.

Në mënyrë të përmbledhur, kjo do të thotë që në operacionet e ardhshme, krahas komponentit ushtarak dhe atij diplomatik, duhet përfshirë edhe komponenti i zhvillimit, fakt i cili është pranuar nga NATO që në Samitin e Rigës, 2006.

Tanimë, NATO po ndërmerr një numër detyrash jo-ushtarake, si asistencë policore, etj. Aleanca, në fakt, këtë gjë po e kryen *ad hoc* dhe e shtyrë nga nevoja konkrete, ndërsa shtete anëtare kanë filluar të ndërtojnë, në izolim nga njëri-tjetri, kapacitete të tyre civile. NATO nuk ka një mekanizëm për të gjeneruar, komanduar dhe koordinuar kapacitete civile, edhe kur në një zonë të caktuar nuk ka aktorë të tjerë, si p.sh. në jug të Afganistanit. Deri më tani, përpjekjet për të ngritur, qoftë edhe kapacitete modeste civile brenda NATO-s, janë shtyrë nga konkurrenca me BE-në¹. Çdo herë që kjo çështje ngrihet, një apo më shumë aleatë europianë e hedhin poshtë, si një dublikim të panevojshëm me kapacitetet e BE-së.

Nga ana e saj BE ka asete civile dhe një seli operacionale civile në fazën fillestare dhe ka ndërmarrë shumë më tepër misione civile se NATO, pavarësisht se përpjekjet e BE-së lënë shumë për të dëshiruar, përsa i përket kapaciteteve dhe strategjisë.

Por NATO nuk ka akses në burimet civile të BE-së, për shkak të dy arsyeve kryesore:

- Dëshira burokratike-politike për të ndërtuar këto asete, në izolim nga NATO dhe,
- Rruga pa krye në marrëdhëniet turko-qipriote dhe ndikimi i tyre në marrëdhëniet ndërmjet dy organizatave.

Edhe pse BE ka akses në asetet dhe kapacitetet e NATO-s, bazuar në Berlin+, mundësia që BE të dislokojë trupa për angazhim në luftime të drejtpërdrejta me intensitet të lartë nuk duket e mundur, të paktën në një afat të parashikueshëm të shkurtër në të ardhmen.

Në një periudhë afatshkurtër, BE e NATO duket se do të jenë pa një kapacitet të integruar dhe të duhur civil-ushtarak, të aftë për planifikim dhe komandim të të gjithë spektrit të operacioneve.

Në pamundësi për të arritur një situatë ideale, ku NATO dhe BE të ndajnë një kapacitet të përbashkët civilo-ushtarak, deri në përmirësimin e këtyre marrëdhënieve dhe mundësimin e aksesit të NATO-s në burimet e BE-së, opsioni më i mirë për NATO-n ndoshta do të ishte zhvillimi i një kapaciteti planëzues dhe komandues civil (në një nivel të ulët).

2. Risigurimi i Aleatëve lindorë: Çështja e dytë më e rëndësishme në marrëdhëniet NATO-BE është çështja sesi do të veprohet me Rusinë. Koncepti i ri Strategjik i miratuar në Samitin e Lisbonës, propozon masa të reja për të “qetësuar” aleatët në Europën veriore, apo qendrore, të cilët i druhen një konfrontimi (kryesisht të natyrës jo-tradicionale) të ri të mundshëm me Rusinë.

Megjithatë këto sigurime të NATO-s për Aleatët nuk do të mund të shuajnë plotësisht shqetësimet e aleatëve si Sllovakia apo Bullgaria, të cilët i druhen më tepër kërcënimeve jo-ushtarake nga Rusia, siç janë sulmet nëpërmjet rrjeteve të internetit, ndërprerjes së naftës dhe gazit, apo blerjes së infrastrukturës kyçe të energjisë në këto vende.

Shumë kundërmasa për përballimin e këtyre sfidave janë, në mënyrë natyrale, në kompetencën dhe përgjegjësinë e BE-së dhe jo të NATO-s, megjithatë NATO mund të ndihmojë p.sh. në shkëmbimin e inteligjencës mbi Rusinë, ndarjen e mësimave të nxjerra nga qendrat kundër terrorizmit në internet, etj. Asnjë nga këto nuk do të jetë e mundur nëse BE dhe NATO nuk bashkëpunojnë më ngushtë.

3. Përballimi i Krizës Financiare: Si një komplikim i mëtejshëm për të gjitha zhvillimet e rëndësishme që kanë ndodhur dhe nevojën gjithnjë e në rritje për dialog, që nga viti 2008, kriza ekonomike globale ka paraqitur sfida të tjera për të dy organizatat (BE dhe NATO). Ka një rritje të masave shtrënguese buxhetore në të dy institucionet. Gjatë dy viteve të fundit, shpenzimet e mbrojtjes nga vendet europiane, anëtare të NATO-s, janë zvogëluar me rreth 45 miliardë dollarë, shumë që është e barabartë me tërë buxhetin vjetor të mbrojtjes të Gjermanisë.

Duke marrë në konsideratë krizën me të cilën ballafaqohet Europa, bazuar edhe në dëshirën/ambicien për të mbetur një aktor të besueshëm i sigurisë dhe për ruajtjen e aftësisë së bashkëpunimit transatlantik, në Konferencën e përvitshme të Sigurisë që zhvillohet në Mynih, Sekretari i Përgjithshëm i NATO-s Rasmussen, theksoi rëndësinë e realizimit në praktikë të “Smart-Defense”, që do të thotë jo ndërprerje të projekteve, por përdorim më efikas të burimeve, bazuar në një bashkëpunim esencial midis vendeve. “Smart-Defense” është një pohim që po dëgjohet shpesh në takimet e NATO-s të niveleve të ndryshme. Pra një partneritet i fortë strategjik NATO-BE do të sillte shumë përfitime jo vetëm në aspektin politik e operacional, por në atë financiar.

Pozicioni/Qëndrimi i Turqisë, në kuadër të bashkëpunimit NATO-BE

- Turqia ka shfaqur një pozicion konstruktiv dhe një kontribut pozitiv drejt marrëdhënieve të mira NATO-BE, pavarësisht problemeve të njohura politike.
- Turqia thekson se BE ka dështuar të plotësojë detyrimet e saj ndaj vendeve partnere të BE-së si Turqia, edhe pse Turqia është një nga vendet kryesore që kontribuon në misionet dhe operacionet e CSDP-s.
- Në kuadër të bashkëpunimit NATO-BE, BE dhe NATO nuk kanë shkëmbyer të njëjtën qartësi apo transparencë. NATO dhe BE e kanë të prishur balancën e niveleve të transparencës dhe sinqeritetit midis tyre.
- Turqia mbështet plotësisht rritjen e bashkëpunimit NATO-BE, në përputhje me strukturën e rënë dakord (Berlin+).
- Turqia, duke qenë një nga vendet jo-anëtare që kontribuon më shumë në misionet/operacionet e BE-së, thekson domosdoshmërinë e heqjes së kufizimeve nga ana e BE-së për pjesëmarrjen e vendeve aleate jo-anëtare të BE-së në CSDP.
- Turqia mbetet një nga aktorët kryesorë europianë në NATO dhe me rëndësi thelbësore për interesat e sigurisë transatlantike. Problemet diplomatike midis Turqisë dhe Qipros vazhdojnë të shkaktojnë tensione midis BE-së dhe NATO-s. Kjo temë, jo vetëm që

nxit debat teorik, por gjithashtu ka rëndësi politike për të ardhmen e marrëdhënieve të sigurisë transatlantike.

- Marrëdhëniet e Turqisë me Greqinë vazhdojnë të zhvillohen pozitivisht në vitet e fundit. Kriza e fundit ekonomike në Greqi ka treguar se Greqia ka nevojë për mbështetjen ekonomike nga Turqia. Krahas anëtarësimit në NATO, anëtarësimi i Turqisë në BE do të shërbente si një element i fortë sigurie për parandalimin e tensioneve të mundshme diplomatike apo ushtarake midis Turqisë dhe Greqisë ose midis Turqisë dhe Qipros.
- Përveç kësaj, megjithë krizën ekonomike globale, shpenzimet e mbrojtjes së Turqisë shkojnë deri në 5.6% të PBB të saj. Ky fakt duhet marrë në konsideratë dhe dëshmon se nuk është në interesin e BE-së për të vazhduar me përjashtimin nga CSDP të një vendi të tillë të fortë.

Masa që mund të përmirësojnë bashkëpunimin NATO-BE

- Duke marrë parasysh zhvillimet që nga viti 2003, duhet punuar për zgjidhjen e çështjeve politike me nivel të lartë, të cilat kanë penguar efektivisht zhvillimin dhe zbatimin e strategjisë të partneritetit midis NATO-s dhe BE-së.
- Duhet marrë masa konkrete që mund të rrisin bashkëpunimin NATO-BE në praktikë dhe, në të njëjtën kohë, duhet të respektohet struktura dhe parimet që drejtojnë këto dy organizata, me qëllim që të ruhet autonomia e tyre.
- Meqenëse CSDP dhe operacionet e menaxhimit të krizave të NATO-s operojnë në të njëjtën fushë, atëherë marrëveshje midis EUPOL Afganistan dhe ISAF, EULEX Kosovë dhe KFOR duhet të shihen si çështje me prioritet parësor.
- Një masë tjetër: Përforsimi i praktikës së takimeve jozyrtare ndërmjet Përfaqësuesit të Lartë (PL) të BE-së dhe Sekretarit të Përgjithshëm (SP) të NATO-s mbi çështjet operative dhe me interes të përbashkët. Kjo mund të arrihet me konsultime ndërmjet PL të BE-së dhe SP të NATO-s, mbi menaxhimin e krizave dhe rritjen e aftësive. Stafet e organizatave duhet të kenë kontakt të vazhdueshëm.
- Takimet jozyrtare midis BE dhe NATO-s, ku përfshihen të gjitha vendet anëtare në këto dy organizata, duhet të kenë vijimësi, duke shfrytëzuar strukturat e miratuara ndërmjet të dy organizatave dhe duhet të ketë në vijim nxitje të mirëkuptimit të përbashkët dhe transparencë.
- Duhet bërë një shfrytëzim maksimal i formateve jozyrtare transatlantike, duke përfshirë në format Ministri të Punëve të Jashtme, Ministri të Mbrojtjes dhe vazhdimin e praktikës së takimeve të këtij lloji, politikat e mbrojtjes në nivel drejtorësh, etj.
- Duhet zhvilluar seminare mbi çështje me interes të përbashkët, si për shembull një seminar mbi Afganistanin.
- Procedurat e CSDP dhe Planifikimi i Mbrojtjes së NATO-s (Defence Planning) duhet të rrisin transparencën e informacioneve të përbashkëta dhe arritjen e një gjuhe të përbashkët midis të gjithë vendeve anëtare.

- Aty ku NATO dhe BE kanë operacione të përbashkëta, këto organizata duhet të forcojnë sinergjitë për trajnime në menaxhimin e krizave.

Referencat:

1. Koncepti Strategjik i NATO-s, 2010
2. Deklarata e Samitit të Lisbonës
3. Rekomandimet e Grupit të Ekspertëve mbi Konceptin e ri Strategjik të NATO-s, 17 maj 2010
4. Deklarata e Samitit të Strasburg/Kehl
5. European Security Strategy
6. Report on the Implementation of the European Security Strategy,
7. The Future of EU-NATO Security Relations as Explained in a
8. Comparative Foreign Policy Analysis of French and Turkish Grand Strategies
9. Workshop on “Strengthening the EU-NATO Relationship”, 2nd June 2010, Madrid
10. NATO-EU, UN Rapporto Difficile, Amm. Sq. Ferdinando di MONTEFORTE, Rappresentante Militare Italiano presso i Comitati Militari della NATO e dell’UE
11. Draft Internal Security Strategy for the European Union: “Towards a European Security Model”, 23 February 2010
13. Informal Meeting of Defense Ministers (Palma de Mallorca, 24 and 25 February 2010)

Vështrim i përgjithshëm për tre sisteme ndërkombëtare të paqes

Elira Luli
Specialiste në Degën e Protokollit
Ministria e Mbrojtjes

Abstrakt: *Ngjarje të tilla si: Paqja e Vestfalisë, Kongresi i Vjenës dhe Sistemi i Versajës, janë përpjekje konkrete, ku aktorë të rëndësishëm ndërkombëtarë janë përpjekur të krijojnë modele të tyre moderne të ekuilibrave dhe të stabilitetit, drejt një rendi të ri evropian ose botëror me synime sa më afatgjata, ku gjejnë zgjidhje dhe objektivat politike në raport me interesat e tyre kombëtare. Ngjarjet e mësipërme të shoqëruara me aktet përkatëse ndërkombëtare, i përkasin kohërave moderne të shteteve, të cilat synojnë gjithnjë e më shumë drejt përmbajtjeve të tyre si shtete kombe, të cilat me ekperiencat e tyre diplomatike kanë vënë themelet e së drejtës ndërkombëtare moderne.*

Periodha, nga gjysma e parë e shek. të 17-të deri në fillimet e shek. të 20-të, përfshin ngjarje të rëndësishme në marrëdhëniet ndërkombëtare. Ngjarjet e ndodhura gjatë kësaj kohe përfshijnë një hark kohor prej gati 300 vjetësh. Në këtë hark kohor, shoqëria europiane, e lodhur nga vështirësitë ekonomike, nga armiqtë e vjetra e të reja politiko-ushtarake, shpesh me origjinë mesjetare dhe nga shterimi i rezervave të të gjitha llojeve që sillnin luftërat dhe konfliktet e shumta, fillon të kuptojë se nuk është vetëm forca mjeti kryesor i politikës, por janë dhe aksionet politike-diplomatike si negociatat, marrëveshjet e ndryshme, traktatet, etj. Madje, nisma të tilla mund të rregullonin shumë më mirë, shumë më gjatë dhe me kosto më të ulët, raportet e ndryshme midis shteteve, se sa mjetet e forcës dhe të luftës, pa hequr dorë nga objektivat apo synimet politike, shtetet konkurente.

Këto ngjarje të kësaj kohe, mund të themi se, identifikohen me një periudhë ku shtetet kryesore të Europës, paraqesin shenja emancipimi të politikave shtetërore, modernizim të mekanizmave të shtetit dhe forcim të institucioneve bazë të tij, ku diplomacia kthehet në një instrument shumë të rëndësishëm në dorën e shteteve të konsoliduara dhe ku shkolla e diplomacisë, personalitetet dhe tradita e saj fillojnë e marrin fytyrën e shtetit që i mbizotëron ato. Kjo është koha kur interesat e shtetit filluan të shkëputen nga interesat e fesë, kur shtetet e sukseshme konsiderohen të tillë nga suksesi i politikanëve dhe burrave të shtetit që i drejtojnë ato dhe kur shoqëria njëzore, megjithë vështirësitë dhe problemet, ka filluar të drejtohet drejt logjikës dhe arsyes njerëzore, sepse dhuna dhe forca nuk sjell rend, qetësi dhe stabilitet.

Në fakt, janë rregullat e lojës, vendosja e ekuilibrave mes partnerëve të mëdhej e të vegjël, ato që mund të krijojnë rend dhe stabilitet në një rajon dhe më gjerë. Ngjarje të tilla si: Paqja e Vestfalisë, Kongresi i Vjenës dhe Sistemi i Versajës janë përpjekje konkrete që, aktorë të ndryshëm ndërkombëtarë, megjithë dobësitë që dalin në pah sipas ngjarjeve, janë përpjekur që të krijojnë modelet e tyre moderne të ekuilibrave dhe të stabilitetit, drejt një rendi të ri europian ose botëror, me synime sa më afatgjata, ku gjej-në zgjidhje dhe objektivat politike, në raport me interesat e tyre kombëtare. Pra, mund të themi se koha për të cilën flitet dhe ngjarjet e mësipërme, të shoqëruara me aktet përkatëse ndërkombëtare, i përkasin kohërave të reja të politikës dhe diplomacisë, ose ndryshe, asaj periudhe kohore që mund të quhet si periudha moderne e shteteve, të cilat synojnë gjithnjë e më shumë drejt përmbajtjeve të tyre si shtete kombe ose kombe shtete.

Duke analizuar këto sisteme, me gjithë ndarjen kohore të tyre, dalin në pah shumë gjëra të përbashkëta si dhe grupet ose aleancat e aktorëve kryesore politiko-diplomatikë, interesat e palëve, bashkimi i tyre në aleanca, palët fituese dhe palët humbëse dhe rezultatet kryesore të prodhuara prej tyre, nëpërmjet akteve politike-diplomatike. Këto ngjarje të rëndësishme ndërkombëtare, kohëzgjatja e tyre dhe shkaqet e dobësisë ose të suksesit të këtyre përvojave politike, diplomatike të cilat, për një kohë relativisht të gjatë, i kanë dhënë tonin politikave europiane dhe atyre botërore, duke nxjerrë në pah shtete, burra shteti dhe politika që kanë ndikuar jo pak në marrëdhëniet ndërkombëtare, ose në atë që sot quhet bota moderne politike e cila, si çdo gjë tjetër në këtë botë, vazhdon të ecë në një proces evolucioni pozitiv dhe shpresojmë, si asnjëherë tjetër, drejt qëndrueshmërisë, paqes, të mirave dhe progresit të shoqërisë njerëzore, jashtë të cilave politikat e sotme nuk do të kishin asnjë kuptim.

Krahasimi ndërmjet shteteve dhe që i krijuan këto sisteme

Duke përdorur një metodë analizuuese, përshkruese dhe krahasuese në sistemet e mësipërme, trajtimi i materialit analizon kryesisht dy rrafshë:

1. atë të politikës së shteteve të veçanta, duke përfshirë këtu dhe shtetet aleate;
2. atë të përpjekjeve dhe manovrave diplomatike të realizuara, gjatë këtyre sistemeve, nga shtetet të cilët kanë qenë aktorët kryesorë në këto ngjarje.

Përfaqset politike të sistemeve të Vestfalisë, të Kongresit të Vjenës dhe të Versajës:

Të tre këto sisteme u orvatën të ndërtonin një rend të ri botëror, duke patur si synim ekuilibrat e forcave dhe realizimin e pikësynimeve të disa shteteve kryesore, pjesëmarrëse aktive në këto ngjarje.

Paqja e Vestfalisë

Në Paqen e Vestfalisë ishte Franca e Kardinalit Rishëlje e cila, duke përfituar nga luftërat fetare që bëri Ferdinanti i Habsburgëve, si një katolik i bindur, me moton “Një perandori, një komb, një fe” dhe feja duhet të ishte motivi i vetëm për të bërë luftë, krijoi një shtet të fuqishëm i cili, për një kohë të gjatë, do të ishte fuqi kryesore dhe imponuese në Europën kontinentale, duke konkurruar me Anglinë, Austrinë dhe Spanjën, deri në bashkimin e Gjermanisë, në vitin 1871, nga Bismarku.

Në sistemin e Vestfalisë, për herë të parë, lindi koncepti politik-diplomatik “Raison d’état”, i cili u shndërrua në një koncept politik për botën moderne që po lindte. Ky koncept politiko-diplomatik zëvendësoi konceptin mesjetar të vlerave morale universale dhe do të ishte parim operativ i politikës franceze. Më vonë, ai do të jetë i pranishëm në të gjitha ngjarjet e mëvonshme të kësaj natyre dhe do të shfaqet me forcë edhe në Kongresin e Vjenës dhe në Sistemin e Versajës, si një koncept që iu vjen për shtat shteteve fituese, por dhe që iu vjen në ndihmë mënyrave të ndryshme pragmatike të sjelljeve për aktorët e ndryshëm, që luajnë në skakierën e shahut të politikës.

Natyrat njerëzore, sikurse janë të prirura për shkatërrime, janë të prirura dhe të çudisin botën me ide dhe veprime. Në kulmin e mrekullisë së kësaj ngjarjeje qëndron fakti se si një princ katolik i devotshëm, që duhet të kishte përshëndetur ndërmarrjen e Princit Ferdinand për forcimin e katolicizmit në Europë, arriti të verë interesat e Francës mbi çdo synim fetar. Kur Habsburgët luftonin vetëm për një qëllim që kishte prekur gjithë katolicizmin, Kardinali Rishëlje kishte dritë mendore të hidheshe në arsye shumë të avancuara gjeopolitike, përta i përket vendit të tij. Ai ishte i vendosur të parandalonte pikërisht një fitore kundër reformizmit, për hir të atyre që sot quhen “Interesat kombëtare shtetërore dhe të sigurimit” e që atëherë u quajtën për herë të parë “Raison d’état”.

Në kohën kur fryma progresive e historisë së njerëzimit dhe proceset natyrore, duken sikur ngrihen drejt një ere të re, proceset anti-reformiste çojnë në katastrofa të mëdha siç ishte lufta 30-vjeçare, e cila shpërtheu në Europën Qendrore më 1618, duke u kthyer në një nga luftrat më të egra të njerëzimit. Lufta 30 vjeçare ishte pasojë e përpjekjeve të Ferdinandit të Dytë për të rigjallëruar universalizmin katolik, për të zhdukur protestanizmin dhe për të rivendosur kontrollin perandorak mbi princërit e Europës.

Sikur perandorët Habsburgas të ishin aq vizionarë e të mund ta kuptonin se në ç’pozitë të favorshme ishin për të arritur atë çfarë Rishëljeja i trembej, do të kishin penguar me kohë fuqizimin e Francës. Këtë pikë të dobët, kundërshtari i tyre diti ta shfrytëzoi me një art të rrallë.

Paqja e Vestfalisë, në të vërtetë, i dha fund kësaj lufte tridhjetëvjeçare, por i dha dhe hov doktrinës “Raison d’état”, si parim drejtues i diplomacisë europiane. Me këtë ngjarje mori vull koncepti kombi-shtet dhe institucionalizimi i diplomacisë dhe i ushtrive. Ky sistem i dha fund luftrave fetare në Europë. Më pas të gjitha sistemet e tjera nuk do të diskutonin më për probleme fetare.

Këtu mbaron edhe ndikimi i fesë mbi politikën në Europë, gjë e cila, deri në atë kohë, kishte qenë shumë e pranishme në jetën politiko-shtetërore. Politikat shtetërore, mbas luftës 30-vjeçare, do të laicizohen duke pasur si udhërrëfyes “Raison d’état”, do të ecin në rrugën e emancipimit të tyre kombëtar dhe shoqëror.

Ishte pikërisht kjo paqe e cila hap siparin e epokës të shtetit modern europian.

Çfarë solli Paqja e Kongresit të Vjenës?

Në paqen e Kongresit të Vjenës ishte Anglia dhe Austria të cilat, me manovrat e tyre, bënë që koncepti i ekuilibrit të forcës të bëhej motoja e gjithë zhvillimeve dhe veprimtarive të kongresit. Humbja e Napoleon Bonapartit do të sillte një rend të ri botëror, krejt ndryshe nga ai lloj që ishte përpjekur të krijonte ai.

Ata shpikën një mundësi tjetër për rregullimin e ekuilibrave të rinj botërorë, atë të “Triumfit të legalitetit” ose të rikthimit të legjitimitetit, nëpërmjet të cilit, duke rikthyer monarkitë e mëparshme të përmbysura nga Napoleoni, rikthenin edhe njëherë “*status quo*-në” e mëparshme të ekuilibrave, duke mbajtur nën kontroll Francën dhe ndonjë vend tjetër që mund të rrëzote përsëri rendin e ri botëror. Kështu, në bazë të këtyre ve-ndimeve, në Francë u rikthyen Burbonët, në Spanjë dhe Portugali u rikthyen monarkitë e përmbysura, në Sardenjë dinastia e Savojës dhe në Holandë dinastia e Oranzhit. Kurse në Romë u rikthye Papa, i cili rifitoi statusin e tij papal. Nga ana tjetër, për të ruajtur kë-të “*status quo*” të re, ata krijuan edhe “Lidhjen e Shenjtë”, e cila mund të jetë aleanca e parë politiko-ushtarake moderne, që merrte përsipër ruajtjen e një rendi të ri politik botëror, nën mbikqyrjen e superfuqive të kohës, që garantonin paqen dhe sigurinë në botë.

Çfarë solli Konferenca e Paqes në Paris?

Në Konferencën e Paqes në Paris, megjithëse u kapërcyen dhe u harruan shumë nga parimet e njohura ndërkombëtare sepse, në emër të ruajtjes së ekuilibrave të forcave, u cënuan vetë ekuilibrat në themel, përsëri kemi një rend të ri botëror, i cili u rregullua me sistemet e paqes midis vendeve fituese dhe vendeve humbëse, duke krijuar një paqe më të brishtë se asnjëherë më parë. Rruga që çoi në këtë sistem ishte krijimi i Gjermanisë si komb, në një shtet të vetëm. Duke qënë se u krijua shumë vonë, në raport me përvojën shtetërore që kishin vendet e tjera, ky shtet i ri do të sillte prishjen e disa ekuilibrave për një fakt; politikat e vjetra europiane po zëvendësoheshin nga filozofi të reja dhe politika të vetëpërmbytjes dhe të arsyes. Shumë shtete të Europës e kishin kaluar periudhën e sfidave dhe të luftrave, përfshirë dhe ato “të hekurit dhe të zjarrit.” Filozofia në të cilën po mbështetej shteti i ri gjerman ishte filozofia e forcës, duke bërë rikthim mbrapsht të ciklit të politikave, që vetvetiu do prishnin ekuilibrat!

Vetë ndërhyrja e Amerikës, si një forcë e re në çështjet e Europës, me protagonist Uillsonin, do të sillte shumë ide të reja, të para nga këndvështrimi amerikan që, deri në atë moment, kishte qënë moskokçarës përse i përket politikës, progresit dhe paqes në Europë. Politikat e Amerikës erdhën me një koncept të ri në Europë, me atë të paqes e të një sigurie sa më të qëndrueshme dhe me të drejtën e vetëvendosjes së popujve të robëruar të shumë shteteve që, deri tani, ishin kishin qënë të diskriminuar dhe të papërfaqësuar. Sipas pikëpamjes së Amerikës nuk ishte vetëvendosja që shkaktonte luftrat, por mungesa e saj; nuk ishte mungesa e ekuilibrit të forcës që prishte stabilitetin por rendja pas tij. Por, sa e lehtë do të ishte të zbatoheshin këto ide të reja në një sistem tradicional që trashëgohej prej dekadash ashtu?! I tillë ishte Sistemi i Versajës dhe sistemet e tjera të Konferencës së Paqes në Paris të cilët, edhe pse u shoqëruan me një zgjidhje shumë të madhe parandaluese dhe të sigurt, siç ishte Lidhja e Kombeve, nuk arriti të garantonte këtë rend të ri botëror, jo më shumë se për 20 vjet.

Fuqitë e mëdha, aktorët kryesorë të tre sistemeve ndërkombëtare

Përveç ngjarjeve, duhet vënë re dhe analizuar me kujdes pozicioni dhe këndvështrimi i aktorëve kryesorë të këtyre ngjarjeve. Siç shikohet, gjatë këtyre tre proceseve, disa shtete kryesore, pjesëmarrëse dhe disa personalitete kanë pasur rol vendimtar dhe konkretisht: Perandoria e Shenjtë Romake (Habsburgët), Franca, Anglia, Austria (Habsburge), Rusia, Prusia dhe më vonë Gjermania e, pas vitit 1871, SHBA, etj.

Po të analizojmë me kujdes, gjatë këtyre 300 vjetëve, në të tre sistemet dhe, pikërisht, në mes të këtyre grupe-shteteve kryesore, dalin fitues vetëm 2 shtete kombe: Anglia dhe Franca, kurse shtetet gjermane, ashtu siç tregojnë edhe emrat e ndryshëm të tyre, enden për 300 vjet në kërkim të identitetit dhe në kërkim të afirmimit të tyre në politikëbërjen dhe vendimmarrjet për proceset dhe zhvillimet europiane të kohërave moderne. Në Sistemin e Vestfalisë, Franca del fituese ndaj Habsburgëve, ndërsa Perandoria Habsburgase shkërmoqet. Në Kongresin e Vjenës, megjithëse përsëri në pozita inferiore, pas humbjeve spektakolare të betejave të fundit të Napoleonit, Franca arriti të ruajë territorin dhe fuqinë e saj, duke ndryshuar vetëm regjimin politik, kurse në Sistemin e Versajës, shfaqet në pozitat e saj më superiore dhe imponuese në kontinet, duke vënë për fund faktorin politik dhe ushtarak gjerman. Po kështu, mund të themi për Anglinë e cila, duke përfituar nga pozitat ishullore, nga fuqia e saj ekonomike dhe aftësitë politike dhe institucionale në fushën e politikbërjes, si një dirigjent i madh, ka ditur të drejtojë dhe të mbajë ekuilibrat politikë në Europë, gjithnjë në favor të sigurisë dhe të zhvillimeve ekonomike dhe ekspansioniste të saj, në raport me shtetet e tjera. Ndërsa shtetet e tjera, të cilat i përmendëm më lart, gjatë këtyre 300 vjetëve, kanë patur ngritjet dhe uljet e tyre, gjithnjë në raport me kurthet dhe ballafaqimet e mëdha, të drejtuara me mjeshhtëri nga Anglia dhe Franca.

Këto të çojnë në disa përfundime si vijon: Fuqia dhe potenciali i shoqërisë njerëzore del mbi gjithçka. Duke kapërcyer çdo pengesë, çdo ngjarje historike, specia e njeriut është e mbujtur në mënyrë të atillë që të sjell, me energjite e saj marramendëse, progres ose regres në jetën reale.

Kështu Gjermania prishi gjithë ekuilibrat e vendeve me përvojë të Europës dhe bëri një kthim mbrapa të politikës së këtyre vendeve me qeverisje liberale dhe demokratike, pasi këto vende e kishin tejkaluar politikën e hekurit e të zjarrit, që Gjermania e re nxiste në vitet 30- të.

Nëse Gjermania justifikohet deri diku për shkak të mungesës së përvojës dhe mungesës së trashëgimisë në rrjedhën politike e diplomatike, si mundet që fuqitë europiane të justifikonin qëndrimet në Konferencën e Parisit, pas luftës së parë botërore? Nëse mund të jetë përvoja që përbën ndryshimin mes shtetesh, atëhere si mundet të diktonin ata një paqe aq të turpshme për Gjermaninë? Kur një rregull në diplomaci është që një shteti të mundur duhet të dish t'i ofrosh paqen e jo ta përbuzësh, sepse armikun e sotëm mund ta kesh aleatin e së nesërme, ose anasjelltas.

Në këtë rast theksi bie mbi udhëheqësit duke na vërtetuar që ka udhëheqes të mëdhenj dhe pseudo-udhëheqes, duke na bindur shumë mirë se ç'mund të jetë në gjendje të bëjë fuqia njerëzore me veprimet e saj të matura ose të pamatura.

Referencat:

1. Politika, Marrëdhëniet ndërkombëtare dhe diplomacia 1600-1899. Gj. Boriçi
2. Marrëdhëniet ndërkombëtare në vorbullën e diplomacisë. Gj. Boriçi
3. Diplomacia, Henry Kissinger
4. www.newworldencyclopedia.org – Peace of Westphalia
5. www.pvhs.chico.k12.ca.us – Congress of Vienna

KUJTESË

PËR BASHKËPUNËTORËT E REVISTËS USHTARAKE

Të nderuar bashkëpunëtorë të Revistës Ushtarake

“Revista Ushtarake” është një Revistë kërkimore me fokus teoriko-shkencor. Ajo është revistë e elitës ushtarake të FA dhe e analistëve të spikatur civilë që, nëpërmjet shkrimeve të tyre, synojnë jo vetëm të informojnë por, në radhë të parë, të ofrojnë zgjidhje për çështjet më të rëndësishme të reformës të sigurisë dhe të mbrojtjes në nivel strategjik, operacional dhe taktik. Pra, prioriteti numër një i RU janë vlerat aplikative të krijimtarisë origjinale të autorit.

Edhe njëherë ftojme studentët e talentuar ushtarakë, akademistët e sistemit të kurseve të larta të AM, instruktorët, pedagogët, punonjësit kërkimorë, analistët, komandantët, shefat dhe trajnuesit e të gjithë institucioneve e njësisive të FA të RSH, analistët e pavarur civilë apo ushtarakë në fushën e sigurisë e të mbrojtjes, që të angazhohen dhe organizohen për ndërtimin e komunitetit të tyre tepër të nderuar e të respektuar të punës kërkimore.

Në vijim, Redaksia e RU jep disa udhëzime e të dhëna teknike për strukturën e artikujve të autorëve (bashkautorëve) të Revistës Ushtarake.

Struktura e artikullit

Titulli. Emërtimi i artikullit

Autori, Bashkautori: Jepet autori apo bashkautorët e artikullit.

Abstrakti: Është pjesa që paraprin një artikull (trajtesë). Tek abstrakti/përmbledhja autori shkurtimisht duhet të paraqesë karakteristikat e artikullit (thelbin apo çështjet themelore të trajtesës, synimet e autorit, këndvështrimin, përfundimet apo rekomandimet, etj.). Abstrakti nuk zëvendëson parathënien e vetë artikullit. Ai zë rreth 1/2 e faqes dhe nuk duhet t'i kalojë 400 fjalë.

Paraqitja, gjatësia: Pjesa kryesore e shkrimit (përfshi parathënien dhe konkluzionet) shkruhet në gjuhën shqipe dhe të jetë maksimumi 6-8 faqe kompjuterike (15 000-25 000 shkronja e shenja, duke përfshirë edhe boshllëqet) përfshi edhe “end notes” dhe informacionin shtesë.

Formati: Faqja duhet të jetë e formatit A4; Lloji i shkrimit: “Times New Roman”; Madhësia e shkrimit 11,5. Kryeradha (Paragrafi i ri) përcaktohet me një rresht bosh. Paraqitja e tekstit të jetë e thjeshtë dhe në minimum të alternativave të stileve dhe formatimit. Kapitujt

nuk duhet të jenë të numëruar; teksti duhet të jetë një strukturë me maksimumin 3 nivele. Duhet të shmangen tekstet e theksuara me bold apo shkronjat me ngjyra. Shkrimi i pjerrët dhe thonjëzat duhet të përdoren vetëm për citimet e burimeve të përdorura dhe literaturës.

Grafikët, tabelat dhe imazhe të tjera duhet të bëhen të formatuara në grup duke evituar shpërbërjen e tyre. Ato duhet të vendosen sa më qartë në një pozicion të përshtatshëm pranë tekstit që i shpjegon ato. Të gjitha imazhet duhet të pasqyrohen në mënyrë të tillë që lexueshmëria të mos ndikohet nga reduktimi i madhësisë dhe printerët bardhë e zi. Nëse një imazh është marrë nga një burim tjetër, është e domosdoshme që të citohet burimi respektiv i tij.

Artikujt duhet të dërgohen të printuar dhe në mënyrë elektronike në Redaksinë e Revistës Ushtarake. Për ata artikuj që nuk i plotësojnë kërkesat e mësipërme të formatit dhe të gjuhës, Redaksia vendos nëse do t'i rikthehen autorëve për përmirësim, apo do të përjashtohen nga procesi i paraqitjes në Bord.

Dokumentacioni: Redaksia e RU vlerëson me rëndësi të veçantë paraqitjen nga çdo autor të artikujve e trajtesave me referenca dhe “footnotes” si dhe, në fund të materialit, të vendosë literaturën e shfrytëzuar. “Footnotes” duhet të respektojnë, në mënyrë korrekte, rregullat kombëtare e ndërkombëtare ku të përfshihen; Mbiemri, emri (autorit që i referohet), titulli i materialit të referimit, emri i entit botues, vendi i botimit, viti i botimit, numri i faqeve ku referohet, numrin ISBN, website-in ku ndodhet artikulli. (*p.sh. SMITH, James Carl, NOWAK, George. Siguria në Shekullin e 21-të: Histori e panjohur. 2nd edicion. New York, London: Oxford University Press, 2006. 235 p. ISBN 0071448209, [**Biografia:** Së bashku me shkrimin, autori të dërgojë edhe një përshkrim të shkurtër biografik me rreth 100 fjalë ku të përfshijë: emrin, mbiemrin, gradën, pozicionin e punës, arsimimin, angazhimet kërkimore, fotografinë, numrin e telefonit dhe adresën elektronike.](http://www.iir.cz/display.asp?lng=uk&ida=.”)</i></p></div><div data-bbox=)*

Stili: Shkrimi duhet të prezantojë një strukturë të thjeshtë, duke përdorur tituj dhe nëntituj. Është e rëndësishme që, në fund të shkrimit, autori ta mbyllë me disa konkluzione dhe përfitimet nga ky artikull.

Artikulli nuk duhet të përmbajë material të klasifikuar dhe duhet të zbatojë rregullat e klasifikimit të informacionit. Artikulli nuk duhet të përmbajë ngjyrimë/qëndrime politike apo partiake.

Për informacion të mëtejshëm, mund të kontaktoni me:

Dega e Botimeve (Redaksia e RU), Qendra e Analizave të Mbrojtjes, Komanda e KDS.

Mail: Komanda e Doktrinës dhe Stërvitjes, QAM, Dega e Botimeve.

Kutia Postare 24 23, Rruga e Dibrës, Tiranë, Shqipëri.

Nr. Tel: 00355(4)23 63 465 ext 10 76, 10 37

Nr. Fax: 00355(4)23 69 179

Mobile: 0694162334/0694116518

Email: revistaushtarake@aaf.mil.al

